AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I KULTURËS POPULLORE

392

LIRIKA POPULLORE

1

FOLKLOR SHQIPTAR

Seria IV

KËNGË RITUALE DHE TË PUNËS

VËLLIMI I PARË

Përgatitur:

QEMAL HAXHIHASANI

KOZMA VASILI

Punë ndihmëse tekniko-shkencore: ERVEHE BARUTI

HYRJE

Me këtë vëllim nis një seri e re e korpusit të folklorit shqiptar: seria e Lirikës popullore. Ideja e botimit të folklorit tonë në seri sipas parimit gjinor-tematik u shtrua rreth një qerek shekulli më parë. Atëherë, me krijimin e Institutit të Folklorit (1960), një komision i formuar nga specialistë të kësaj fushe, i zgjeruar edhe me studiues të fushave të afërta — etnografë, gjuhtarë, historianë, kritikë të letërsisë etj., duke pasur parasysh mësimet e Partisë e të shokut Enver Hoxha rreth vlerësimit të kulturës tradicionale popullore kombëtare[1], të asaj «pasurie të madhe shpirtërore të popullit e të Atdheut që ka mbajtur gjallë kombin tonë në stuhi e furtuna», miratoi botimin e gjerë të pasurive folklorike shqiptare në pesë seri: I. Proza popullore; II. Epika legjendare (Cikli i kreshnikëve etj.); III. Epika historike; IV. Lirika popullore dhe V. Fol-

1) Rezolucion i Kongresit të I të Partisë komuniste shqiptare. Tiranë 1948.
Enver Hoxha. Për shkencën I f. 44-45, 87-88, 264-265; II. 67, 183-186, 187-193, 223. 229, 529, 531-532, 604,605.

klori i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe i periudhës së socializmit. Deri tani nga ky korpus janë vënë në qarkullim ose janë në procesin e botimit 28 vëllime. Seritë e përmendura qëndrojnë të hapura dhe zgjerohen vazhdimisht me vëllime të reja.

Nga vitet '80 ky botim i gjerë i folklorit tonë u përfshi në korpusin e Akademisë: «Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar». Shoku Ramiz Alia në Plenumin e 8-të të KQ të PPSH porosiste: «Puna që ka nisur Akademia e Shkencave për botimin e «Trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar» në fushën e folklorit, gjuhës, letërsisë, etnografisë, mendimit shoqëror, politik, pedagogjik etj. duhet të ecë me ritme më të shpejta dhe të bëhet në nivelin e duhur shkencor, që të evidentojë më mirë vlerat kulturore e artistike të popullit tonë në shekuj dhe të shërbejë si bazë e gjerë burimore për të bërë sinteza më të thella rreth problemeve kyçe të këtyre shkencave»[1].

Duke pasur si bazë këto orientime të Partisë filloi e vazhdon edhe botimi i serisë së Lirikës popullore, e cila do të jetë një dëshmi tjetër e rëndësishme, një tjetër monument i vyer i universit poetik të ngritur nëpër shekuj nga gjenia e pashtershme krijuese e popullit tonë.[2]

Këngët lirike, ashtu si edhe krijimet e tjera popullore, përfaqësojnë një pasuri të madhe të kulturës sonë kombëtare. Nëse këngët epike me ngjarjet që pasqyrojnë, me përpjekjet kundër forcave të errëta regresive, na sjellin mesazhet e ndodhive historike, këngët e lirikës, si reflekse të ndjenjave intime popullore, na fusin në botën shpirtërore të masave tona punonjëse, në emocionet, mbresat, shqetësimet, gëzimet e dëshirat e tyre. Lirika ka natyrën dhe veçoritë e saj të krijimit. Mjafton një rrethanë e veçantë, një motiv mallëngjyes, një ndjenjë a një klithmë shpirtërore që këto këngë të marrin rrugën e lindjes.

Këngët popullore lirike këndohen nga njerëz të çdo moshe, të ndërlidhura me çaste e ngjarje të gëzuara a të dhimbshme të jetës — në lindje, dasma, vdekje, joshje të gjumit të fëmijës, në mjedise intime familjare, në punë e në çlodhje, në takime festive me thekse lirike.

Veriu u jep shpeshherë këtyre këngëve emra të ndry-

---

1) Ramiz Alia. Puna kërkimore-shkencore t'i shërbejë zhvillimit aktual e perspektiv të vendit. Tiranë 1980, f. 66.

2) Një vëllim i kësaj serie me *këngë për nizamët e kurbetin* është botuar si vëllim i tretë i saj më 1981.

shëm: *kangë* a *kajkë të buta* (në dallim nga këngët epike që thirren këtu edhe kangë të forta, kangë pushke), *të gryjta, bylbylish, dizeni* etj. Por më shumë ato marrin emra në përgjithësi (Veri e Jug) sipas llojit e tematikës: kangë *dasmë, djepi, çikash, nusesh, kurbeti, nizami, vaje, ligje* etj. Edhe në format e praktikimit ato kanë veçoritë e veta. Llojet kryesore të lirikës në veri — këngët e dashurisë, të dasmës, të kurbetit, të nizamit etj. shoqërohen me çifteli a sharki, ndërsa në Jug inkuadrohen në sistemin polifonik, me përjashtim të ndonjë lloji të veçantë si këngët e djepit, të festave të motmotit etj. që interpretohen edhe në mënyrë monofonike.

Folkloristët tanë në të kaluarën i kanë dhënë përparësi mbledhjes së këngëve epike, për të vënë në dukje traditat luftarake e liridashëse të popullit tonë, përpjekjet e tij të paprera për pavarësi kombëtare dhe përparim shoqëror. Megjithëkëtë as në përmbledhjet tona të para folklorike nuk kanë munguar krijimet e lirikës, këngët e praktikat zakonore për lindjen e vdekjen, këngët për dashurinë e dasmën, humorin, lodrat, vallet etj. me të cilat mishërohej bota e madhe shpirtërore e masave tona punonjëse.

Shenjëzime për ekzistencën e lirikës popullore shqiptare gjenden te veprat e humanistit tonë Marin Barleti. Në «Historinë e Skënderbeut» p.sh., bashkë me të dhënat për këngët me të cilat lartësoheshin fitoret e luftërave heroike kundërosmane të shek. XV, nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit, ka shënime me interes edhe për folklorin tonë lirik — për doket e zakonet, lodrat e vallet popullore me të cilat kremtoheshin fitoret, për klithmat e humbjeve, vajtimin e të rënëve, për zinë që pllakosi vendin me vdekjen e heroit etj.[1]

Një material konkret të pasurive të lirikës shqiptare të kësaj periudhe na e jep, ndonëse tërthorazi, lirika e arbëreshëve të Italisë, të cilët e sollën atje nga mëmëdheu me të gjithë problematikën që kishte ajo në atë kohë.

Interes kanë në këtë kuadër disa shënime të rastësishme udhëtarësh, historianësh etj. si ajo e një humanisti

---

1) M. Barleti. Historia e Skënderbeut. Përkthimi shqip 1964 f. 51, 113, 169, 177, 216, 238, 249, 255, 282, 283, 333, 338, 349, 377, 378, 397 etj.

të shek. XV, apo ndonjë shënim tjetër i mëvonshëm.[1]

Dëshminë e parë për përmbajtjen e këngëve lirike na e sjell «Doreshkrimi i Kieutit» (1737)[2]. Pothuajse gjysma e këngëve të këtij doreshkrimi i përket lirikës. Janë këto kryesisht këngë dashurie e dasme, si edhe ndonjë fragment balade erotike që na bëjnë të njohur për herë të parë motivet e këtyre temave të lirikës arbëreshe.

Kuadri i lirikës së diasporës erdh duke u zgjeruar me botimet e shek. XIX të Krispit,[3] Dorsës,[4] Kamardës[5] dhe sidomos me përmbledhjen më të autoritetshme të folklorit arbëresh. me Rapsoditë e De Radës.[6]

Te Krispi e Dorsa zotërojnë më shumë përshkrimet zakonore që shoqërojnë këngët e dasmës, vajet, festat popullore, ndërsa dy autorët e fundit, sidomos De Rada, na jep me përmbledhjen e tij klasike një kuadër të përgjithshëm të folklorit lirik arbëresh.

Për folklorin e truallit shqiptar dëshminë më të plotë të temave, motiveve dhe të konvencioneve artistike të lirikës popullore të shekullit të kaluar e përbëjnë regjistrimet e folkloristit tonë të njohur Th. Mitko. Në vëllimin e tij «Bleta shqiptare»[7] janë paraqitur të grupuara në cikle të veçanta këngë për të vegjlit (këngë të vjetra alegorike dhe për të qeshur), këngë për festat kalendarike, këngë të dasmës, të dashurisë etj. Një numër këngësh të tilla pati edhe në materialet që u gjendën më vonë në doreshkrimet e tij.[8]

---

1) Humanisti Mihail Apostoli nga Kreta i shkruan një mikut të tij me 30 mars 1467 për një skenë vaji që i kishte takuar të shihte në një fshat shqiptar në Bregun e Bunës:... «Njeri nga ata (të plagosurit) vdiq rreth orës 3. Shqiptarët e vajtuan në këtë mënyrë: Të afërmit u grumbulluan rreth kufomës dhe ia nisën vajit mortor. Burrat qëndronin në këmbë, gratë ishin ulur»...

2) Michele Marchianó, Canti popolari albanesi... Publicati da un manoscritto della prima metà del secolo XVIII. Foggia, 1908.

3) Giuseppe Crispi. Memorie storiche di talune costumanze appartenenti alle colonie greco-albanesi di Sicilia, Palermo, 1853.

4) Vincenzo Dorsa. Sugli albanesi. Napoli, 1847.

5) Demetrio Camarda. Appendice ai saggio di Grammatologia comparata sulla lingua albanese. Prato, 1866.

6) Girolamo De Rada. Rapsodie d'un' poema albanese. Firenze, 1866.

7) Thimi Mitko, Bëleta shqyptare. Aleksandri, 1878.

8) Shih: Thimi Mitko: Vepra. Tiranë, 1981.

Nga mbledhësit e parë të lirikës së Veriut u dallua Z. Jubani[1]. Për t'u përmendur janë edhe regjistrimet e këngëve lirike të Bajronit[2] e të Karaxhiqit,[3] sidomos ato të Hanit,[4] të Rainholdit nga arbëreshët e Greqisë,[5] të Dozonit[6], Pedersenit[7], e Majerit[8]. Materiale me vlerë nga lirika jonë popullore u paraqitën në «Valët e Detit» të S. Dines[9] si edhe në vëllimin «Kangë popullore gegnishte»[10]. Nga botimet e viteve 1912-1944 janë për t'u shënuar përmbledhja «Folklor shqiptar».[11] *Visaret e Kombit* III[12]; IV[13]; V[14]; X[15]; XIII[16]; XIV[17]; XV[18]; *Përmbledhja Folklorë III*[19]; *Këngë e britma nga qyteti i djegur*[20]; si edhe materialet e shtypit periodik të botuara brenda dhe jashtë vendit.[21]

Gjendja e kërkimeve rreth lirikës popullore, ashtu si edhe për gjinitë e tjera, ndryshoi thellësisht pas Çlirimit. Punonjësit shkencorë të Sektorit të Folklorit zhvilluan kërkime sistematike në të gjitha krahinat e vendit dhe për tërë llojet e kësaj gjinie, duke i shoqëruar materialet me shënimet e nevojshme të pasaportizimit. Këto

---

1) Zef Jubani. Raccolta di canti popolari e rapsodie di poemi albanesi. Trieste, 1871.
2) George Gordon; Lord Byron. Child Harold. London 1812-1854.
3) V.N.Jokli. Vuks albanische. Liederssammbeng. Beograd, 1921.
4) Johan George von Hahn. Albanesiache Studien. II Jena-Wien, 1853-54.
5) Dr. Caroli Henrici Theodori Reinhold. Noctes Pelasgicae. Athenia, 1855.
6) Auguste Dozon. Manuel de la langue Chkipe ou albanaise. Paris, 1879.
7) Holger Pedersen. Albanesiche Texte mit Glossar. Leipzig, 1895.
8) Gustav Meyer. Albanesische Studien VI. Wien 1897.
9) Spiro Dine. Valët e Detit. Sofia, 1908.
10) Këngë popullore gegnishte. Saraevo, 1911.
11) Stavro Frashëri. Folklor shqiptar. Durrës, 1936.
12) Visaret e Kombit. Vëll. III. Tiranë 1937.
13) » » Vëll. IV. T, 1939.
14) » » Vëll. V. T, 1941.
15) » » Vëll. X. T, 1944.
16) » » Vëll. XIII. T, 1944.
17) » » Vëll. XIV. T, 1944.
18) » » Vëll. XV. T, 1944.
19) Folklorë III (Kangë e vajtime), Shkodër 1940.
20) Mitrush Kuteli, Këngë e britma nga qyteti i djegur. T. 1944
21) Revista Albania (1897-1909), Dituria (1909); Edukata e re, Normalisti, Cirka, Shkolla Kombëtare etj.

materiale arrijnë në disa dhjetëra mijë njësi. Pas krijimit të Institutit të Folklorit, më 1960 regjistrimet e këngëve janë realizuar kryesisht me magnetofon. Deri më 1985 regjistrimet e tilla lirike arrinin në rreth 13 mijë njësi, nga të cilat shumicën e përbënin këngët e dasmës e të dashurisë (rreth 5000 njësi secila, këngët e folklorit të ritit (rreth 4500), këngët rituale të punës, të festave kalendarike, këngë djepi, lodra, vaje, nizami, kurbeti, shoqërore, humoristike, shpendësh, thirrje, imitime etj. Është për t'u përmendur këtu puna e bërë për folklorin letrar nga Z. Sako, Q. Haxhihasani, J. Panajoti, K. Harito, K. Vasili, A. Mustaqi, A. Fico, A. Xhagolli; ndërsa për folklorin muzikor e koreografik nga M. Daiu, E. Dheri, B. Kruta, H. Filja, R. Bogdani, F. Daja, P. Miso.

Një ndihmë të veçantë për pasurimin e fondeve letrare të lirikës kanë dhënë bashkëpunëtorët e jashtëm: R. Alikaj, T. Dizdari, Dhimitër S. Shuteriqi, R. Sokoli, F.M. Rrapaj, M. Muho, P. Gjidede, B. Gaçe, Sh. Hoxha, K. Zdruli, K. Shtjefni, K. Zelaj, M. Kondi, T. Starova, J. Nushi, H. Kolgjegjaj etj.

Të periudhës së pasçlirimit janë edhe botimet: *Këngë popullore lirike*, (një botim antologjik i plotë për llojet e ndryshme të lirikës së gjithë vendit me këngë djepi, vargje fëmijësh, lodrash e këngësh zbavitëse, këngë dashurie, këngë e valle dasme, vaje e këngë të përvajshme, këngë e vargje festash, këngë nizami, kurbeti, pune)[1], *Këngë e popullit* (gjithashtu me karakter antologjik)[2]; *Poezia popullore arbëreshe* (ku përfshihen një numër këngësh dashurie e dasme arbëreshe të përshtatura edhe në gjuhën e sotme)[3]. Me krijimin e Institutit të Folklorit u botuan disa vëllime me tekste lirike të shoqëruara edhe me transkriptimet e melodive përkatëse si *Këngë popullore*[4], *Këngë popullore dashurie*[5]; *250 këngë popullore dasme*[6], *Këngë djepi*»[7]. Këngë të gjinisë së lirikës janë përfshirë edhe në botime të tjera të Institutit të Folklorit, dhe më vonë të Institutit të Kulturës Popullore si në vëllimet e serisë së

1) Këngë popullore lirike. T., 1955.
2) Dhimitër S. Shuteriqi. Kënga e popullit. T., 1955.
3) Ziaudin Kodra. Poezija popullore arbëreshe. T., 1957.
4) Këngë popullore (me nota), T., 1964.
5) Këngë popullore dashurie, T., 1965.
6) 250 këngë popullore dasme. T., 1966.
7) Këngë popullore djepi. T. 1982.

periudhës së Ndërtimit Socialist[1], të serisë së Mbledhësve të folklorit,[2] të Festivaleve,[3] në *Almanakët* e shtëpive të kulturës të rretheve[4] etj.

Kërkime sistematike janë ndërmarrë për llojet e ndryshme të lirikës edhe në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Jugosllavi. Si rezultat i këtyre kërkimeve janë botuar më 1953 vëllimi *Këngë popullore shqiptare* të *Kosovë-Metohisë* bleni III[5]. Instituti Albanologjik i Prishtinës ka botuar më 1978, 1980, 1984 përkatësisht vëllimet: *Këngë dashurie*[6], *Këngë dasme I*[7], *Këngë të ndryshme*[8]. Janë botuar gjithashtu përmbledhje të veçanta këngësh të kësaj gjinie nga autorë të ndryshëm.[9] Këngë lirike nga Kosova me transkriptime muzikore janë përfshirë në serinë e vëllimeve *Folklor muzikor shqiptar* etj[10].

Materiale me interes nga folklori lirik arbëresh, përveç botimeve të përmendura më lart, janë paraqitur edhe në vëllimet *Shqiptarët në Itali.*[11] *Këngë tradicionale*[12] etj. Ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore janë botuar këngë të tilla edhe në revistat e ndryshme arbëreshe si «Katundi ynë», «Lidhja», «Zjarri», «Mondo albanese» etj.

Pas Luftës së Dytë Botërore kanë filluar të dalin në

---

1) Këngë popullore të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe të periudhës së Ndërtimit Socialist. Vëllime I-VII.

2) J. Nushi. «Folklor nga krahina e Myzeqesë» (1982); Sh. Hoxha. «Lirikë popullore nga rrethi i Kukësit» (1982); J. Panajoti «Këngë popullore nga rrethi i Korçës» (1982); F. M. Rrapaj «Këngë popullore nga Çamëria» (1983); K. Zdruli «K. P. nga «Devolli i Sipërm»; M. Kondi nga «Lugina e Kardhiqit» (1987); T. Starova. K.p. nga rrethi i Pogradecit.

3) Festival folklorik kombëtar Nr. 1-2. Festival folklorik kombëtar nr. 3 etj.

4) «Buçet kënga labe» vëll. I-IV të Shtëpisë së Kulturës Vlorë, Almanakët e Mirditës, Lezhës, Shkodrës, Tepelenës; Durrësit etj.

5) Këngë popullore shqiptare të Kosovë-Metohisë. Bleni III. Prishtinë 1953.

6) Këngë dashurie. Pr. 1978.

7) Këngë dasme I. Pr. 1980; II. Pr. 1984.

8) Këngë të ndryshme. Pr. 1984.

9) Gj. Hasanaj Malësori këndon 1971. D. Shala. Këngë popullore lirike. Pr. 1972; D. Shala. H. Kaitazi. F. Shkodra. M. Halimi. Nina nana dhe këngë e lojna fëmijësh I. Pr. 1976; J. Xh. Ukaj. Këngë popullore nga Gucia Pr. 1978.

10) Lorenc Antoni. Folklor muzikor shqiptar. Vëll. I-X; R. Munishi. Këndimi i femrave të Podgurit. Pr. 1979.

11) Antonio Scura. Gli. Albanesi in Italia. New-York. 1912.

12) Gjuseppe Schiro. Canti tradizionali. Napoli. 1923.

dritë materiale me interes edhe nga lirika e arbëreshëve të Greqisë. Për t'u përmendur janë në këtë drejtim botimet e Jani P. Gjikës[1], Vangjel Lapit[2], Maria Dedës[3] etj.

Nëse botimet e materialeve faktike të kësaj gjinie kanë ecur në një rrugë të mbarë nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për studimin e tyre. Punimet e ndërmarra para Çlirimit kanë qenë të kufizuara dhe me karakter të përgjithshëm. Një vështrim shkencor sintetik i llojeve kryesore të lirikës është dhënë në monografinë studimore të prof. Eqrem Çabeit «Për gjenezën e literaturës shqipe»[4]. Edhe pas Çlirimit kanë munguar studime të gjera për llojet të veçanta të kësaj gjinie. Punimet e realizuara kanë pasur më shumë si qëllim paraqitjen e pasurisë së ndonjë lloji të lirikës në ndonjë krahinë a vëllim të caktuar, ose kanë qenë me karakter e përmasa kumtesash të mbajtura në sesione të ndryshme shkencore[5]. Si përpjekje të para përgjithësuese të problemeve të tyre mund të merren trajtimet e realizuara nëpër tekstet e folklorit për shkollat e larta e të mesme[6].

Lirika, në fillimet e saj, ka qenë poezi e destinuar për t'u kënduar me shoqërimin e një instrumenti — me instrumentin posthomerik-lirën, prej nga ka marrë edhe emrin. Në kohën antike gjenitë e artit iu drejtuan më shumë epopesë, që i përgjigjej më mirë shpirtit të kohës. Vetëm kur u bë më i fuqishëm sensi i individualitetit dhe pati filluar një art me karakter më lirik, duke shpërbërë tanimë themelet e madhërishme të eposit, kur rritej nevoja për t'i dhënë ekspozicion artistik dhe solemnitet

---

1) Jani P. Gjikas. «Arvanitika tragudhia tu Kavo d'Oro» [Këngë shqiptare në Kavo d'Oro], Athina. «Oi Arvanites kai to arvanitiko tragudhi stin Helladha» [Shqiptarët dhe kënga shqiptare në Greqi], Athina 1978.

2) Vangjel Lapi, Arvanitiko moirollogi [Vaje shqiptare]. Athinë, 1985.

3) Maria Mihail-Dede. Arvanitika tragudhia [Këngë shqiptare]. Athinë. A. 1981. B. 1983.

4) Eqrem Çabej. Për gjenezën e literaturës shqipe. Shkodër, 1939.

5) Zihni Sako. Disa elementë të dasmës, si shprehje e njësisë së kulturës shpirtërore të popullit tonë. «Konferenca e II e studimeve albanologjike». Vëll. III T. 1968. f. 37-41; D. Shala. Vepër e përmendur. Parathënia; Z. Kodra, Vep. e përm. Parathënia etj.

6) Dhimitër S. Shuteriqi. Folklora shqiptare. T. 1949; Z. Sako Folklor shqiptar. T. 1953; Historia e Letërsisë shqipe. I. 1959. f. 3-136 etj.

moral objekteve të caktuara të kultit (rreth shek. VIII para e.re), merr zhvillim dhe bëhet një formë artistike zotëruese edhe *lirika*. Duke iu referuar antikitetit, *lirika* mori në zanafillën e vet forma që lidheshin me kultet e hyjnive-shoqërimin me instrumentet, karakter dialogjik e veçori që e afronin më shumë me format dramatike, ku individualiteti subjektiv ishte shumë më pak i theksuar se në lirikën moderne. Një konkretizim i përgjithshëm i veçorive të lirikës u arrit në Mesjetë. Këto veçori u konkretizuan sidomos në periudhën e Rilindjes (Humanizmit). Humanizmi, duke ngritur lart personalitetin e njeriut, hapi udhë të gjëra edhe për zhvillimin e lirikës. Por epoka eminente e lirizmit u bë romantizmi, me përpjekjet e tij të gjithanshme për çlirimin e personalitetit të individit. Megjithëkëtë ndërmarrjet për një përkufizim shkencor të lirikës dhe një klasifikim të saj me vlerë të qëndrueshme u përkasin kohëve të fundit. Në të vërtetë përkufizimet e dhëna, qoftë edhe në këto kohë vuajnë shpeshherë ose nga gjerësia ose nga ngushtësia e hapësirës së tyre. Për lirikën e kultivuar quhen si lloje të saj elegjia, himni, soneta, madrigali etj. Në strukturën e një poezie lirike janë përvijësuar disa veçori të përgjithshme si shkurtësia, dendësia e shprehjes, po edhe thjeshtësia e saj; theksi i veçantë efektiv sentimental; shprehja e një gjendjeje momentare shpirtërore, ngjyrime tonesh personale, karakteri intim i temave të saj etj. Me këtë pranim estetik modern përfshihen në gjininë e lirikës një sërë kompozimesh me një fizionomi pak a shumë të përcaktuar.

Lirika popullore në shumë aspekte përputhet me këto vija të fizionomisë së lirikës së kultivuar; por ajo ka në shumë anë origjinalitetin e vet. Poezia popullore lirike për sa i përket origjinës është po kaq e hershme, në mos edhe më e përparshme sesa krijimet epike. Lloje të veçanta të saj si ato të ndikimit mbi forcat e natyrës, e kanë zanafillën në periudha kaq të lashta sa ç'është njerëzimi vetë. Të tilla janë një sërë këngësh rituale të punës, të festave popullore, të dukurive të natyrës etj. Me këtë periudhë është lidhur karakteri ritual dhe sinkretik i disa formave të saj. Në gjirin e funksioneve ceremoniale kanë lindur lidhjet e lirikës me elementet e arteve të tjera — të muzikës, valles, shfaqjeve dramatike etj. Këto bëhen prirje të qëndrueshme në specifikën, në melodizmin, organizimin ritmik etj. të lirikës. Edhe për sa i përket strukturës, lirika popullore ka mëvehtësitë e saj. Përkundrejt

formave të lirikës së kultivuar-himnit, elegjisë, odës, sonetës etj. që janë të panjohura për të, ajo ka veçoritë e veta artistike. Lirika popullore ka gjithashtu edhe fusha të përcaktuara për sa i përket përmbajtjes.

Zakonisht objekt i krijimeve lirike popullore bëhen tema që interesojnë masat e gjera punonjëse — siç janë ato të punës, të dashurisë, të protestave sociale etj. Por nuk mbeten jashtë tyre edhe ndjenja të thjeshta intime individuale. Ato realizohen si një ditar i madh lirik që kënaq nevojën e afirmimit të individit. Lirikat popullore drejtpërdrejt ose në formën e ëndërrimeve, të shpresës, himnizojnë lumturinë, mohojnë vdekjen, afirmojnë përjetësinë e njeriut.

Lirika përkufizohet zakonisht si një gjini që përmbledh llojet e shkurtra në vargje. Objekti i saj kryesor janë përjetimet e brendshme, që lidhen me vetën e parë ose kalojnë edhe në vetën e tretë e të dytë, duke ruajtur po këtë orientim të zbulimit të botës lirike të njeriut. Si anonime dhe mbarëpopullore lirika, me kalimin e kohës, përpunohet, skalitet dhe merr vlera përgjithësuese dhe kolektive të dukshme. Megjithatë thelbi i saj lirik mbetet. Kur flasim për karakterin objektiv të lirikës kemi parasysh pikërisht përjetimet e brendëshme që u përmendën. Por, kuptohet, se kjo anë subjektive është refleks i botës reale, i marrëdhënieve njerëzore që pasqyrohen në ndërgjegjen e njeriut. Në lirikën popullore, për arsyet që u thanë, është më i dukshëm procesi i një lloj objektivizimi. Shkak për këtë bëhet edhe mënjanimi i individit, tipet e poezisë së popullit dhe monumentet që ngre ai me kalimin e kohës për jetën dhe botën shpirtërore të njeriut.

E krahasuar me epikën lirika ndjek kahe disi të ndryshme:

a. Ndërsa epika është e prirur për të paraqitur ngjarjet që ndodhin objektivisht jashtë botës shpirtërore të rapsodit, ashtu siç zhvillohen në rrjedhën e tyre, lirika sjell kryesisht botën shpirtërore të këngëtarit, ndjenjat e emocionet e tij. Në poezinë epike vendin kryesor e ze informacioni mbi realitetin e ngjarjeve, lidhur me veprime të caktuara të njerëzve, me botën e objekteve dhe marrëdhëniet midis tyre; kurse në krijimet lirike këngëtari, në vend që të procedojë në aksionet e jashtme, në ngjarjet që ndodhin objektivisht, përkundrazi qëndron në vetvete për të paraqitur ndjenjat e veta si refleks i

botës së jashtme. Çdo gjë për të cilën flet lirika është shprehje e përvojës së drejtpërdrejtë dhe individuale e subjektit, është përvojë subjektive, që bëhet njëkohësisht edhe përvojë e përgjithshme. Nga këto drejtime të ndryshme të ekspozicionit poetik, tërhiqet vëmendja edhe për karakterin objektiv të epikës dhe atë subjektiv të lirikës.

b. Eposi qëndron i lidhur me epoka të caktuara origjinale të historisë së një populli, duke e përmbledhur në një vepër unike tërësinë e shpirtit, të kulturës, të historisë së tij; kurse lirika mund të burojë në të gjitha epokat e zhvillimit historik kombëtar. Ajo duhet të rrjedhë në tërësinë e plotësinë e saj, jo në një epokë të vetme, por në bashkëzanim me interesat, përfytyrimet e qëllimet kombëtare në të gjitha kohët e zhvillimit të veçantë të historisë së një populli.

c. Në lirikë individi duhet të paraqitet sa më i pasur në fantazi, në shprehje që të japë në mënyrë sa më të plotë gjendjen e tij shpirtërore, shkallën sa më të lartë të ndjenjave të tij, të kënaqësisë, dhembjes, dashurisë, urrejtjes etj. Këto sigurisht janë të lidhura me fakte reale, me situata që bëhen për rapsodin bazë e shprehjes së tij shpirtërore — me fenomenologjinë p.sh. të lindjes, të dashurisë, dasmës, vdekjes, nizamit, kurbetit etj. Por, ndërsa nga njera anë është i lidhur me fakte konkrete të jetës, nga një anë tjetër ai është i lirë t'i vështrojë ato nga këndshikime të veçanta të gjendjes së tij shpirtërore poetike. Këtu nuk ka një tërësi rrethanash objektive që të zhvillohen si në epos, por ndërhyjnë përkundrazi mënyra e konceptimit, e interpretimit të ndjenjave, e reflektimit për të paraqitur atë që është më thelbësore, më e qensishme në krijimin artistik. Te krijimi epik rapsodi shfrytëzon ekspozicionin, tregimin e ngjarjeve, të atyre që ndodhin jashtë tij, ndërsa te krijimi lirik, në vend që të veprojë në paraqitjen e ngjarjeve, përkundrazi paraqit shpirtin e tij që ndjen e vepron. Dhe, duke qenë kjo brendia e asaj pasurie që duhet të karakterizojë realizimin artistik, shprehja e saj drejtohet me përparësi edhe në aspekte të tjera të ekspozicionit, siç janë shoqërimi i fjalës me jonet muzikore, tingujt instrumental, lëvizjet e valles etj. Këndej vihet në dukje edhe një tipar tjetër i rëndësishëm i lirikës, karakteri *sinkretik* i saj, lidhja e ngushtë e fjalës me melodinë, lëvizjet e valles etj.

ç. Në lirikën e kultivuar ka raste kur krijimi poetik bie edhe në pozita subjektiviteti, kurse në lirikën po-

Nr. 52388

pullore pikëpamje të tilla janë më të rralla e nuk hedhin rrënjë. Kudhra kolektive gjatë qarkullimit folklorik i kalit ndjenjat subjektive, i përpunon, i pastron dhe u jep një përmbajtje të lartë etiko-morale. Jeta në këto krijime është e veshur me ndjenja fisnike njerëzore. Bota e ngushtë vetiake ngjizet në një unitet rigoroz me botën e përbashkët emocionale të kolektivit.

d. Për t'u nënvizuar në këtë kënd vështrimi është edhe fakti se krijimet poetike nuk sjellin gjithmonë frymëzime e ndjenja të kulluara lirike ose epike. Shpeshherë mpleksen në të njëjtin krijim ndjenja të ndryshme të karakterit lirik ose epik, siç e sjell rrjedha e natyrshme e jetës. Kështu ndodh p.sh. që motive të mirëfillta lirike si «Vaji i Ajkunës», përshkrime të natyrës etj. gërshetohen në disa raste në përmbajtjen e eposit tonë heroik, në ato të këngëve historike etj., ashtu si edhe anasjelltas elemente të epikës ngjizen organikisht në një numër këngësh lirike. Ky gërshetim spikat në mënyrë të veçantë në këngët e lirikës politike dhe sidomos në ato të folklorit bashkëkohor — të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të periudhës së socializmit. Në këto krijime janë aq të dukshme këto mpleksje të botës intime individuale me aspiratat shoqërore sa e bën shpeshherë të vështirë përfshirjen e tyre në nëndarjet klasike të lirikës e epikës, duke nxjerrë si nevojë të domosdoshme rishikimin e skemave të klasifikimit klasik dhe vendosjen e kritereve dhe emërtimeve të reja për këngët e kësaj periudhe, si për ato të rolit udhëheqës të Partisë e të shokut Enver Hoxha, industrializimin, kolektivizimin, mbrojtjen etj.

dh. Një veçori themelore e dallimit të këngëve lirike është mungesa e rrëfimit epik, e paraqitjes përshkrimore, objektive të ngjarjeve.

e. Veçori tjetër që e dallon këngën lirike nga ajo epike është zakonisht mungesa e subjektit. Kënga lirike nuk ka fabul dhe për rrjedhojë nuk i njeh ato shkallëzime metodike, që karakterizojnë zakonisht subjektin epik. Megjithatë duhet thënë se këto veçori nuk priten me thikë. Ka raste kur edhe në krijimet e lirikës nuk mungon ndonjë çast narrativ, kur brendija e tyre shtjellohet me përshkrime edhe elemente që mbajnë vulën historike të kohës, por këto mund të quhen thjesht subjekte lirike. Kështu p.sh. kënga e njohur *«Ra kuraja në Janinë,/ ku më gjet mua të zinë/ në malet me trëndelinë/ tek kullosij bagëtinë./ Të shkretat-o dhent e mia,/ do t'i hajë lukunia* është ndër-

tuar mbi përshkrimin e një fakti historik, por ky përshkrim është i prirur për të krijuar tek dëgjuesi jo mbresat e një tregimi, por të një gjendje shpirtërore të asaj melankolie e trishtimi në të cilin rapsodi ka qenë i zhytur nga ky fakt historik. Vaji i thënë nga një malsore nga Gruda rreth vitit 1918 është një shembull i përsosur jo vetëm i krijimit lirik — i dhëmbjes së thellë të nënës — për humbjen e vajzës që bie viktimë e egërsisë së normave kanunore, por edhe i asociasioneve mjeshtërore të dhimbjes individuale me atë të dhimbjes së përgjithshme që zotëronte në atë kohë për fatet tragjike të atdheut: një shembull i lartë i njësimit artistik të individuales me shoqëroren, i kalimit nga ndjenjat më të thella intime në gjendjen e përgjithshme tragjike të shpërbërjes së kombit:... «*Mori loke, mori bi,/ qyqja e mjera un n'ket shpi,/ a t'kjaj vedin a t'kjaj ty?/ T'kjaj vllazni e t'kjaj bajrak,/ t'kjaj Malcin' për rreth e qark?/ Oj zemra e eme bi,/ hej-hej!... A t'kjaj t'gjallt a t'kjaj ty dekun?/ Qyqja un' e mbetun vetun!/ Ta kjaj vedin me lot gjakut,/ t'ia baj gjamen mbar' bajrakut,/ t'i thrras t'dekunt me m'ndimue,/ për me njeh'e me mjerue,/ t'u kallxoj se mbetëm shkret,/ n'vendin ton, si t'im n'gerbet/... Nji krajl hyn e tjetri del,/ aj na rrah, tjetri na shkel/... Qyqja nan', qyqja Shqypni,/ Hot e Grud' te Mali i Zi!/ Bija e eme nën dhe t'zi,/ Bija e eme nën dhe t'zi,/hej-hej!.* (Visaret III. 179).

Pasuritë e lirikës popullore janë të gjera dhe të larmishme. Mund të thuhet se s'ka çast të rëndësishëm të jetës së njeriut — lindje a vdekje, dashuri e martesë, s'ka skaj të botës së tij shpirtërore që nuk ka lënë jehonën e vet në krijimet e kësaj gjinie. Pasuritë e saj tërheqin kështu vemendjen me shumëllojshmërinë e temave, me specifikën dhe origjinalitetin e tyre. Përfshihen këtu të gjitha krijimet e ciklit të jetës nga djepi në varr, nga lodrat fëminore në këngët e përvajshme, nga çastet gazmore, shakatë, gostitë e takimet festive familjare, në hallet, shqetësimet e plagët shoqërore të kohës, në protestat kundër shfrytëzimit klasor e shtypjes kombëtare. Nga pikëpamja kronologjike ka midis tyre këngë me prejardhje të lashtë, që sjellin në brendi dhe në ndërtimin artistik elemente botëkuptimore dhe praktika rituale të epokave të hershme, sikurse ka të tjera që dëshmojnë për rrugën e zhvillimit të qytetërimit popullor gjatë shekujve.

Një sërë krijimesh lirike — tema e motive janë me

qarkullim ballkanik, evropian dhe më tej. Këto e kanë burimin te njejtësia tipologjike gjithënjerëzore e folklorit, te psikologjia e përbashkët e njeriut, e cila, në kohë dhe kushte të caktuara, krijon dukuri folklorike — këngë, valle e praktika rituale të përafërta. Të tilla janë p. sh. këngët dhe praktikat rituale për festat popullore të motmotit, ato për dukuritë atmosferike — diellin, hënën, ndjelljen e shiut, për ujin e ri si simbol të lashtë të pjellorisë etj.

Pasuria e ceremonive festive të pranverës — këngëve, valleve e praktikave rituale — që vihen re te popujt e Evropës dhe të Azisë ka një bazë të përbashkët ekonomiko-shoqërore: vizionin për një të ardhme të begatë të jetës, duke u dhënë këtyre praktikave forma origjinale materializimi sipas forcave krijuese të çdo etnije. Për ndjelljen e shiut në kohë thatësire popujt e të gjithë kontinenteve — Evropës, Afrikës, Azisë, Amerikës e Australisë u janë drejtuar pothuajse në të njëjtën mënyrë forcave qiellore. Edhe në kuadrin e interferencave sinkronike e diakronike (plotësimeve, përshtatjeve, çvendosjeve të elementeve të një cikli etj.) kanë luajtur rol të njëjtët faktorë ekonomikë, magjikë, fetarë, juridikë e artistikë me të cilat njeriu është përpjekur t'ia nënshtrojë nevojave të jetës sipas horizontit të tij kulturor e artistik. Dukuritë e përbashkëta natyrore, shkalla e formimit dhe arsye të tjera që u përmendën, kanë lojtur rol me rëndësi në përftimin e ceremonive dhe të poezisë lirike sipas festave dhe praktikave rituale. Po, krahas kësaj, duhet thënë se këto ceremoni dhe cikle poetike festive kanë dallimet dhe veçoritë e tyre që lidhen me kushte historike, me tiparet etnokulturore që kanë lindur në mjedise dhe mendësi të ndryshme në jetën e popujve. Prandaj vërehen edhe veçansi dhe çaste të papërsëritëshme, krahas asaj së përgjithëshmes njerëzore, të buruar në kushte të përafërta të jetesës dhe të mënyrës së perceptimit të dukurive.

Duke lexuar këngët rituale dhe të punës, që ka krijuar populli ynë, para së gjithash, të bien në sy motivet e përbashkëta kombëtare. Në variante të ndryshme, me larmi formash, ato janë kënduar në të gjitha viset e Shqipërisë si edhe kudo ku ka shqiptarë. Kuptohet qartë se një fakt i tillë flet për unitetin etnik dhe kombëtar, për frymëzime të njëjta të një populli me traditat, historinë dhe konstitucionin e tij shpirtëror. Larmia krahinore ka shpjegimin e vet historiko-shoqëror, po është edhe një dëshmi e pasu-

risë artistike, është shprehje dhe formë e egzistencës së kulturës popullore, e cila brenda një uniteti të dukshëm dallohet për diversitet formash e variantesh.

Momenti i dallimeve etno-kulturore dhe i treguesve të qartë të unitetit kombëtar në lirikën popullore, duke zënë fill që nga ajo më e lashta, nënkupton edhe elementet e përbashkëta që lindin popujt, sidomos ata fqinj me njeri-tjetrin.

Një shumicë aferish e kanë burimin te përvetësimi i një shtrati të lashtë kulturor të përbashkët si edhe te ndikimet e anasjellta gjatë zhvillimit historik të popujve. Folklori i popujve të Ballkanit, sidomos ai lirik, është shumë kuptimplotë në këtë drejtim. Duke përvetësuar mjaft elemente nga trashëgimi kulturor i popujve të lashtë të Ballkanit, duke jetuar për shekuj me radhë në të njëjtët kufij administrativë të Bizancit, Perandorisë Osmane etj. dhe në kushte të përafërta historiko-shoqërore u krijua ajo tërësi kulturore që përbën qytetërimin popullor ballkanik. Nga një vështrim qoftë edhe të shpejtë do të zbuloheshin një sërë pikash të përbashkëta në lirikën e popujve të këtij gadishulli. Kështu p.sh. zakoni i veroreve që u viheshin të vegjëlve «për shëndet» në festat pranverore ka qenë praktikuar nga shqiptarët, grekët; maqedonët etj. Te ne veroret janë quajtur *marse, verore, guduvere, kosa, larse; te maqedonët godi-godica;* te bullgarët *letnik;* te rumunët *màrtisa, martenita;* te grekët ο Μαρτης. Njësoj si te ne ato vareshin në degë të trandafilit, shegëve etj. kur vinin dallandyshet e para, duke u kënduar vargje me të cilët shpreheshin urime për shëndet, gëzim e lumturi: *Dallëndyshe faqekuqe,/ bishtgërshërë, sqep gjilpërë,/ na këtë verore shpjere buzë detit,/ të m'i sjellësh bukë shëndetit.* Te maqedonët: *Llastojte, gramotnite...* te grekët. τα χελιδονισματα ose το χελιδονισμο... Gjithmonë për shëndet e bollëk zbukuroheshin në këto festa dvert e dritaret me degë të gjelbërta e me lule e kohës; viheshin në magje e në thesin e miellit degë ullinjsh, spërkatej shtëpia, njerëzit e bagëtitë me ujë të ri. Të njejtat praktika rituale bëheshin për purifikimin, djegien, largimin a «shitjen» e të këqiave — sëmundjeve, gjumit, përtacërisë tek të tjerët; po ato praktika me këmborë ditën e Vangjelizmoit për trembjen e gjarpërinjve dhe të dëmtuesve të njerëzve, bujqësisë e blegtorisë. Po ato zakone rrokullisje nëpër bar ditën e shën Gjergjit, për të marrë kontakt me tokën si në lashtësi. Në këto

festa vajzat maqedone, ashtu si edhe vajzat tona, bënin kurora me ngjitësa, filiza shelgu etj. dhe i vinin në krye për largimin e dhimbjeve dhe për shëndet, duke përsëritur vargjet: *«Povidu gllava bolit/ mene ne... Povidu pollovina bolit,/mene ne...*) Të* gjithë popujt e Ballkanit — shqiptarët, grekët, sllavët e rumunët kanë pasë zakon të ngrinin ditën e shën Gjergjit shtregullat (lëkundset, shilarsit, kunën). Lëkundjet në shtregull, si një rit magjik, për bollëk, shëndet dhe largimin e dëmtuesve të bujqësisë, blegtorisë e njerëzve, kanë qenë dokumentuar në gjetjet arkeologjike të Ballkanit që në periudhën parahelene.

Duke pasur pranë njëra-tjetrës lloje e tema të përafërta, mund të evidentohen më qartë tiparet e veçanta të këtyre popujve. Nga studimi i tyre krahasues bëhen më të dukshme veçoritë origjinale të çdo kulture, marrëdhëniet midis kombëtares e ndërkombëtares, vihet në baza më të shëndosha shkenca krahasimtare folklorike. Këtu nuk është fjala për të dhënë çertifikata përparësie lindjeje kësaj ose asaj dukurie të folklorit, por për të përcaktuar sa më qartë origjinalitetin e jetës artistike që ajo ka bërë në këtë ose atë popull.

Megjithëse studimi i gjerë i vlerave të llojeve të ndryshme të lirikës sonë popullore do të realizohet me parathëniet e hyrjet studimore të vëllimeve përkatës, disa çështje lidhur me vendin, origjinalitetin dhe funksionin e tyre në historinë e trashëgimit tonë kulturor mund të parashtrohen paraprakisht edhe në këtë parathënie.

Lirika popullore, sikurse është përmendur edhe më lart, e ka marrë pikënisjen nga periudha të hershme, kur zotëronin botëkuptime të lashta lidhur me qëndrimet ndaj forcave të natyrës, të bashkëveprimeve me to, me animizimin e personifikimin e tyre. Këto vihen re jo vetëm në krijimet e disa llojeve të veçanta, siç janë këngët e praktikat rituale për festat popullore kalendarike, në yshtjet etj., por edhe në shtresa të hershme që ruhen në disa fusha të veçanta si në ceremonialin e dasmës, në këngët e lindjes, në vajet, gjamën etj.

Te krijimi i këtyre shtresave arkaike që janë bazë për historinë e qytetërimit njerëzor, ka gjëra të përafërta midis popujve, por ato paraqiten me veçori që janë mjaft të qarta e origjinale në folklorin e çdo populli. Mbijetojat

---

*) Gjoja koka dhëmb,/ mua jo...

e këtyre besimeve e kulteve primitive kanë ardhur deri në kohët tona, por ato e kanë humbur tanimë rolin e tyre ritual, duke përfunduar shpeshherë në këngë humoristike të vegjlish, siç ndodh p.sh. me një sërë këngësh të festave kalendarike të vitit.

Për periudhën e lashtësisë është folur gjerë në pjesën e dytë të kësaj parathënie që bën paraqitjen e lëndës së vëllimit të parë të kësaj serie. Këtu do të ndalemi më shumë në periudhën e feudalizmit. Dihet se shumica e këngëve tona popullore janë krijime të fshatarësisë. Si të tilla ato pasqyrojnë, në radhë të parë, dukuri të jetës së këtij grupi shoqëror. Tregues i qartë i karakterit kombëtar të lirikës sonë popullore në këtë kuadër është lidhja e këngëve dhe e praktikave rituale me veprimtaritë tradicionale të popullit tonë — me bujqësinë e blegtorinë. Shumësia e këngëve për këto mjeshtëri, përshkrimet e proceseve të tyre themelore, kuadri i saktë i veprimeve dhe i mjediseve ku zhvillohen këto mjeshtëri, tingujt e tyre melodikë etj. flasin për fizionominë kombëtare të lirikës sonë popullore. Jo vetëm motivet e ritet të këtyre mjeshtërive tradicionale të popullit tonë, siç janë ato për mbjelljet, korrjet, shirjet; për ngjitjen e bagëtive në bjeshkë, për punët e stanit, kullotjet, mjeljet, përpunimin e qumshtit etj., por edhe krijimet e përafërta për vreshtarinë, ullirin, bletarinë, kultivimin e lirit, endjen në avlëmend, peshkimin etj. tërheqin vëmendjen si fusha veprimtarish me baza të lashta tradicionale për popullin tonë. Të gjitha këto janë fiksuar me një sërë vëzhgimesh meteorologjike, hollësirash e ecurish punësh, kulturash e prodhimesh; sidomos bujqësore e blegtorale në pajtim të plotë me klimën dhe relievin e trojeve tona, me një përvojë të gjatë e konkrete vendase.

Elemente të veçanta të këtyre mjeshtërive tradicionale të popullit tonë janë vërtetuar edhe në lirikën popullore të diasporës — të arbëreshëve të Greqisë e të Italisë: fakte këto që flasin qartë si për lashtësinë, ashtu dhe për rrënjët e tyre të përbashkëta kombëtare.

Nga tërësia e këtyre këngëve del se populli ynë ka pasë një nderim të veçantë për punën, prandaj e ka ngritur atë edhe në rrafshe poetike, të sanksionuara edhe me norma e praktika zakonore rituale.

Ngarkesë të veçantë etniko-kombëtare nga periudha e mesjetës sjellin edhe këngët e ceremonialit të dasmës,

të lindjes, të djepit, vajet etj. Këtu tërheqin vemendjen këshillat, normat, parimet morale për rrënjosjen e disa koncepteve patriarkale në marrëdhëniet burrë-grua, nuse-vjehërr, vargjet për mbushjen e shtëpisë me djem etj. Në këtë kuadër janë për t'u vënë në dukje edhe disa epitete karakteristike me ngarkesë social-emocionale nga ky formacion që u jepen dhëndërit apo heroit të këngës në tekstet e sidomos në refrenet e tyre — epitetet *bej, aga, çifçi; qehaja; gjitar,* etj. që shprehin thelbin shoqëror të periudhës.

Ndikimet nga periudha e kapitalizmit, për vetë zhvillimin e kufizuar që ka pasur në vendin tonë ky formacion, janë të pakta. Megjithëkëtë në lloje të caktuara të lirikës shoqërore si në këngët e kurbetit, në këngët e dasmës etj. nuk mungojnë edhe dukuri e situata nga kjo periudhë. Kurbetçinjt p.sh. punojnë në miniera — «300 pash nën tokë» dhe në kushte të tilla sa që, kur dalin mbi dhe, «nuk e njeh nëna djalin». Për to flasin herë-herë inventaret e pajës në disa këngë dasme, disa formulime në këngët e djepit etj.

Ndikime të rëndësishme ka përftuar lirika jonë popullore gjatë periudhës së ndërtimit socialist. Elementet e reja në këtë kuadër, janë kaq të shumta dhe shfaqen me një peshë të tillë specifike në lloje të ndryshme të lirikës — në këngët e dashurisë, të dasmës, në vajet etj.: në përmbajtjen e tyre politike, ideologjike, social-kulturore dhe në thesarin poetik, sa që e nxjerrin në pah në mënyrë fare të qartë epokën e re të krijimit të tyre — epokën e socializmit.

Tregues të rëndësishëm për karakterin etnik — kombëtar të lirikës sonë popullore bëhen edhe normat morale, — siç janë dashuria për vendin; lidhja e thellë me familjen, nderi, besa, mikpritja, mirësjellja etj. që gërshetohen në llojet e temat e kësaj gjinie. Fryma e tyre përshkon gati çdo këngë. Ato vlerësohen si baza e jetës së popullit tonë në çdo skaj të atdheut — në Veri e në Jug, në zonat malore, në bregdet e kudo. Kurbetçinjtë nizami, sado larg të jetë përplasur nga dallgët e jetës, mendon të kthehet me doemos një ditë në vendin e tij. Edhe në çastet më tragjike të jetës siç ndodh në këngët «Mbeçë more shokë, mbeçë,/ përtej Urën e Qabesë» ai mendon për njerzit e dashur të familjes — nënën, gruan, motrën, fëmijët. Dhimbja dhe hidhërimi për fatin e rëndë

janë të pandara nga kujdesi për të afërmit e vet, për vendlindjen.

Në këtë kompleks të botës shpirtërore të popullit tonë spikat si një veçori e qartë te lirika jonë popullore një kuptim materialist në vështrimin e dukurive të jetës dhe në vlerësimin e saj. Lirika jonë popullore nuk e ka të pranishme temën dhe frymën mistike; përkundrazi kudo në këngët e lindjes, të dashurisë, të dasmës, deri në vajet shihet përgjithësisht një trajtim materialist i dukurive të ndryshme të jetës. Te llojet e ndryshme të lirikës sonë spikat besimi në forcën e arsyes dhe në mundësitë e njeriut për transformimin e natyrës. Një tregues të këtij tipari të rëndësishëm të lirikës sonë popullore e përfaqësojnë këngët për demaskimin e veseve të klerikëve — të paditurisë, të sjelljes kontradiktore me ato që predikonin, të shkeljes prej tyre të normave morale-shoqërore etj.

Karakteri kombëtar i lirikës sonë popullore gjen shprehjen e vet edhe në konceptet estetike. Është një pasuri e tërë konceptesh të tilla lidhur me idealet e së bukurës, një tërësi figurash, metaforesh etj. që gjallëron mendimin poetik të llojeve, temave e teksteve të këngëve tona popullore lirike. Konsekuente të një materializimi të së bukurës në konceptimin e së dobishmes, të energjisë, të dinamikës; të forcave veprimtare të njeriut në jetë, spikat në to një mendim i shëndoshë estetik. Këngëtari popullor e do ta ketë miken, të dashurën, — të shëndetshme, të kuqe si «thana në degë», të gjallë e të shkathtë si thëllëza që fluturon «bigë më bigë», dinamike në çdo punë — në korrje, në shirje, në bjeshkë, në kullotje, në punët e stanit e të shtëpisë.

Karakteri kombëtar në lirikat tona popullore gjen shprehje në elementet karakteristike të natyrës së vendlindjes, të rrethit e mjedisit blegtoral, të bimësisë e faunës së atdheut, me të cilat janë gërshetuar me një aftësi krijuese të papërsëritshme figurat, krahasimet, epitetet etj. Në sfond të tërë këtyre pasurive qëndron natyra e vendit tonë — malet, fushat, bregdeti ynë i mrekullueshëm, që kanë bërë kurdoherë burimin e jetës ekonomike të masave tona punonjëse, qëndron bimësia dhe fauna jonë karakteristike — lisat, bredhat, ullinjtë, agrumet, trendelina, manushaqet, sorkadhet, thëllëzat etj. që kanë zgjuar tek njerëzit tanë brez pas brezi ndjenjën

e vrojtimit dhe të admirimit, që kanë krijuar në ta me tërë bukurinë e tyre një origjinalitet poetik të përsosur. Krijimet e lirikës sonë popullore janë gatuar në rrjedhën gurgulluese të jetës shqiptare, me ndjenjat, meditimet, dëshirat e aspiratat e masave tona punonjëse, me aftësitë e talentit poetik dhe të imagjinatës së tyre krijuese.

Këto tipare thelbësore të fizionomisë kombëtare të lirikës sonë gjejnë më në fund shprehje adekuate edhe në tërë elementet e stilit dhe të gjuhës. Një motiv sado i thjeshtë të jetë në mendim, me anë të një realizimi stilistik e gjuhësor të përsosur ngrihet në një vepër të vërtetë arti. Thurja e figurave me elemente të mjedisit të truallit kombëtar — krahasimet e shtatit të vajzës me *halat* e *çetinat* e bjeshkës, paraqitja e brishtësisë saj me *lulet e nerenxave, lejmonave* e *portokallave*, e zhdërvjelltësisë dhe elegancës me *«libardhat që fërfëllojnë nëpër Dri»*; vlerat potenciale të leksikut popullor, frazat, kompozitat, fjalori i zgjedhur plot freski dhe elegancë me të cilin vishen mendimet poetike, ndjenjat e emocionet popullore i sigurojnë lirikës sonë një nivel të lartë artistik dhe ngjyrë origjinale të mirëfilltë kombëtare. Të gjitha këto janë rezultat i zhvillimit të jetës dhe të historisë sonë etnokulturore që dëshmojnë për personalitetin krijues të popullit tonë që ka dhënë prova të aftësive të tij krijuese gjeniale në të gjitha hallkat e jetës së tij intime lirike — në marrëdhëniet familjare e shoqërore, në punë, në çlodhje e kudo.

Këto tipare janë të përbashkëta për lirikën popullore të të gjitha krahinave etnofolklorike shqiptare. Kemi të bëjmë kështu me një unitet, me një njësi gjithëkombëtare në tërë fushat e lirikës sonë popullore. Vështruar në këtë prizëm do të gjenden edhe tipare të veçanta që e dallojnë njërën krahinë prej tjetrës, njërin rreth prej tjetrit. Kështu tërheqin vëmendjen larmia dhe eleganca e lirikave të dasmës të qytetit të Shkodrës, të këngëve të shregullave dhe atyre humoristike të këtij rajoni: karakteri i qashtër dhe transparent i lirikave të Krajës: ritmet e vrullshme të këngëve të dashurisë së malësisë së Gjakovës, apo eleganca dhe karakteri disi krenar i këngës erotike labe; ai kolorit i zjarrtë nostalgjik për mëmëdheun i këngëve arbëreshe etj. Por të gjitha këto dëshmojnë për komponente të qensishme që kanë ushqyer nëpër shekuj fondet e lirikës sonë, duke farkëtuar ato lidhje krahinore, ato karakterizime që përcaktojnë origjinalitetin e pasu-

rive të lirikës së popullit tonë në përgjithësi. Njësia e këtyre pasurive shpirtërore të masave tona punonjëse, origjinaliteti dhe karakteri i tyre autentik kombëtar shfaqet në mënyrë të veçantë te bashkësia e cikleve dhe e problematikës, te përmbajtja dhe aftësia për të pasqyruar çastet më të qensishme të jetës, — te bashkësia e qëndrimit ideoemocional e stilit, në gjuhë, në intonacionet muzikore dhe në ritmet e lëvizjet e valleve që gjejnë shprehjen e tyre në llojet e nëndarjet e lirikës sonë — te këngët e djepit, të dashurisë, të dasmës etj. Në tërësinë e tyre ato bëhen dëshmi të veçorive origjinale të kombit, të unitetit të tij kulturor e artistik. Sikurse është përmendur edhe më lart këngët lirike burojnë më drejtpërdrejti nga ndjenjat e popullit, kështu që janë të lidhura më ngushtë me psikologjinë etnike. Ato nuk huazohen kaq lehtë sa p.sh. krijimet epike, baladat etj. Këto të fundit i janë shtruar pothuajse rregullisht një procesi huazues të anasjelltë në marrëdhëniet kulturore midis popujve, të favorizuar nga faktorë të ndryshëm emocionalë, bilinguizmi etj. Ndërsa pasuritë e lirikës popullore e sjellin më të pastër dhe më të dukshëm origjinalitetin e konsolidimit etnik dhe njësinë kulturore të kombit.

Edhe në fushën e lidhjeve krahinore e kombëtare pasuritë e lirikës ndiekin kahe dhe rrugë të veçanta. Fondi kombëtar i lirikës popullore është formuar mbi bazën e pasurive të krahinave të ndryshme sipas ligjësive që kanë vepruar në mënyrë të përbashkët në të tre nivelet — në atë tematik, të paradigmave morfologjike e sintaksore si dhe në atë të vlerave artistike. Në përgjithësi çdo krahinë e truallit kombëtar ka të njëjtat lloje, tema e praktika rituale. Po ato këngë e rite për festat kalendarike — ditën e verës, shën Gjergjit, llazoret etj.; po ato këngë për mjeshtëritë tradicionale — bujqësinë, blegtorinë, bletarinë, vreshtarinë, kultivimin e ullirit, përpunimin e qumshtit, të avlëmendit etj.: po ato këngë për yshtjet, dukuritë atmosferike, diellin, hënën, po ato faza e këngë të ceremonialit të dasmës për përgatitjet e druve, bluarjen e drithit, zënien e kulaçit, dërgimin e pajës, marrjen e nuses, familjarizimin e saj me mjedisin e ri të shtëpisë së dhëndrit, vënien në magje, dërgimin në krua; po ato elemente simbolike të jetës patriarkale etj. Në

festat kalendarike hasen të njejtat zakone p.sh. për zjarret, ritet magjike për begati e shëndet, po ato shqetësime për zbukurimin e shtëpive me lule e gjelbërime të kohës, për shpërthimin e forcës gjallërore të ujit të ri, po ato praktika me vënien e veroreve, po ato vargje për dallëndyshet, qyqen, bilbilin, gjonin etj. Tërheqin vëmendjen në këtë kuadër jo vetëm përbërjet tematike po edhe elementet e përbashkëta edhe në ndërtimin e këngëve. Le të marrim një shembull: këngët për diellin e retë fillojnë me të njejtat vargje nga Çamëria: *«Re re, koko re,/ lëshona diellin bëdhe»*, në Përmet, Kolonjë, Korçë, Pogradec, Skrapar, Vlorë; në Dukagjin e Vermosh: *«Re re kumare,/ na lësho diellin se po fle»*; deri në Tropojë, Gjakovë e Kosovë: *«Re re kumare,/ pse ma zune diellin-e?»* Elemente të tillë të përbashkët janë të zakonshme jo vetëm për krahinat e ndryshme të atdheut, por edhe për folklorin e diasporës — të abëreshëve të Greqisë dhe të Italisë. Një sërë këngësh e praktikash të ceremonialit të dasmës si ato për kulaçin, për nisjen e ardhjen e krushqëve, lyerjen e portës së dhëndrit me mjaltë etj. Këngët «Rrëmbeu korbi një thëllëzë»... «Liej gishtërit me mjaltë nusez-o etj. këndohen gati një lloj si në ngulimet e diasporës ashtu edhe në krahina të Jugut. Në fshatrat arbëreshe të Atikës (Greqi) festohej me një madhështi të veçantë dita e Verës, llazoret e sidomos dita e shën Gjergjit. Në këtë rast të fundit këndoheshin e luheshin valle të posaçme: Lule shigjerjanjote» etj. ashtu sikurse luhen këngët e vallet e shregullave në Shpat (Elbasan), Mokër (Pogradec), Shkodër, Kosovë e gjetkë. Po në këtë mënyrë janë pothuajse të njejta te arbëreshët e Greqisë, Italisë dhe në mëmëdhe këngët e dërgimit të nuses për të marrë ujë në krua; ato për veçoritë e fshatrave, lodrat, këngët agadike etj. Të përbashkëta janë shpeshherë deri formula e shprehie me të cilat hapeshin këngët rituale të yshtjeve siç ndodh p.sh. te vargjet *«Këtu mpi, këtu shpi,/ këtu çobani me dhi»*, vargjet e lodrave: *«Lart e më lart,/ dola në pazarl»*, *«Njera isht aiithmonë»* etj. që dëgjohen në Jug dhe te Arbëreshët e Greqisë; formulat nga baladat e hershme erotike: «Mbeta motmot më rrogë» të arbëreshëve të Italisë dhe të krahinave të Veriut etj. Këto dukuri të përbashkëta të procesit të madh të diasporës shqiptare shërbejnë si gurë shënues për datimin e mjaft fakteve të folklorit shqiptar, për evidentimin e njësisë, të hapësirës dhe të rrënjëve gjenetike të kësaj trashëgimie të madhe

kulturore. Me veçoritë e tyre të përbashkëta ato përbëjnë një tërësi vlerash që organizohen në një sistem të përgjithshëm. Për ngjizjen e tyre veprojnë një sërë ligjesh që i japin gjinisë një ekuilibër të qëndrueshëm, një arkitekturë të caktuar, e cila përbën fizionominë e saj kombëtare. Lidhjet e përbashkëta brenda sistemit karakterizohen në radhë të parë nga një njësi historike, nga një prirje unifikuese që synon në realizimin e një arkitekture të përbashkët, por, në një anë tjetër, edhe nga një prirje e vazhdueshme risish që nuk e mbyllin sistemin në një rreth statik, të çfarëdoshëm; duke e bërë atë njëkohësisht një sistem me elemente shndërrimesh të paprera. Sistemi i gjinisë së lirikës, ashtu si edhe sistemet e gjinive të tjera folklorike, nuk janë të palëvizshme. Ato përmbledhin në vetvete një sërë risish (inovacionesh) në funksion të nevojave të imponuara nga kushtet e reja historiko-shoqërore. Lirika jonë popullore, me tërë kmpleksitetin e llojeve të saj, është krijuar në rrjedhën e shekujve si një shpërthim i vetvetishëm i botës shpirtërore të popullit tonë. Në themel të kësaj krijimtarie qëndrojnë përpjekjet e përbashkëta për ta gëzuar dhe begatuar jetën, për ta ruajtur këtë trashëgim kulturor nga agresionet e armiqve që janë orvatur të na sundojnë dhe asgjësojnë. Këto pasuri të lirikës kanë marrë gjatë shekujve ngjyra kohore në përmbajtjen dhe në formën e tyre. Këtu gjejnë shprehje aftësitë krijuese të popullit tonë, lidhjet shumë të ngushta me vendlindjen, mjedisin karakteristik të atdheut, me krenarinë e patriotizmin, me forcën dhe vitalitetin e masave tona punonjëse. Ka midis tyre elemente mitologjike parakristiane, rite e besime që i përkasin epokave të lashta, të cilat, me gjithë kundërvënietdhe përpjekjet asimiluese të feve monoteistike, nuk e kanë humbur specifikën e tyre si dëshmi të shkallëve të zhvillimit shoqëror. Motivet e subjektet e vjetra ruhen nga tradita për një kohë shumë më të gjatë sesa marrëdhëniet shoqërore që i kanë krijuar ato. Megjithëkëtë ato shuhen kur futen në kontradikta mjaft të hapura me normat e kohës, ose zëvendësohen nga elemente të reja si ndodh p.sh. me krijimet tona të periudhës së socializmit. Ka raste midis këtyre të fundit si këngët e praktikat për dukuritë atmosferike, vshtjet etj. që kanë dalë nga qarkullimi; ka të tjera si këngët e nizamit, të kurbetit etj. që kanë humbur bazën jetësore të krijimit të tyre. Gjatë kësaj periudhe kanë filluar të futen elemente të reja, që i japin shumë llojeve të lirikës sonë popullore një kthesë

të rëndësishme, e cila e bën të domosdoshme përmbledhjen e tyre në botime të veçanta, mbasi fusin themele, koncepte e parime krijuese të reja, në krijimtarinë tonë folklorike. Të tilla janë p.sh. këngët për punën në fushën e industrializimit, të kolektivizimit bujqësor, këngë për patriotizmin socialist, për mbrojtjen e pronës shoqërore etj. Njohja e këtyre pasurive në tërë veçoritë e tyre të qëndrueshme dhe proceset e zhvillimit të tyre hedh dritë mbi origjinalitetin e kulturës sonë popullore, mbi talentin poetik dhe aftësitë krijuese të popullit tonë, mbi psikologjinë dhe vetëdijen e tij etnike. Studimi i këtyre pasurive ndihmon në njohjen e aspekteve të veçanta të ndërgjegjes së tij estetike, të thellësisë dhe çiltërisë së ndjenjave të tij, të prirjeve për të kthyer në këngë e valle të gjithë situatat e veçanta të shpirtit të kombit.

Llojet e lirikës popullore, të krahasuara me ato të lirikës së kultivuar kanë specifikën e tyre të veçantë. Jo vetëm përmbajtja e tyre ngërthen tema e subjekte të ndryshme, por edhe gjithë kompleksi i rrethanave që i kanë dhënë frymëzim koncepteve estetike, gjithë praktikat ceremoniale, ritmet e melodikës, shoqërimi me elegancën e valleve e të veshjeve popullore, u japin atyre një individualitet të posaçëm.

Ndër të tjera, këngët e djepit janë të pasura në fantazi dhe në mjete shprehëse. Sado e rëndë që ishte në të kaluarën jeta e përditshme, ato e çonin fëminë me pegasin e fantazisë në të ardhmet më të ndritshme: midis grigjesh, visesh të begatshme, përpjekjesh, luftrash, që t'u siguronin lumturinë e ëndërruar. I rritnin, i bënin «mbi shoqet e shokët e mëhallës», me plang, me nuse, me dhen e dhi, kapedanë, trima si «Skanderbegu», në ninullat e Luftës si «Enver Hoxha me partizanë». Këto imazhe poetike, që thëthiteshin me qumshtin e nanës mbeteshin themelitë mbi të cilat do të ngrihej tërë bota e perceptimeve artistike e së ardhmes së të voglit.

Këngët e dashurisë shpalosin ndjenjat e çiltra të të rinjve, të gërshetuara në rrethanat e jetës së dikurshme patriarkale. E dashura, mikja, në këto këngë është një figurë reale e fshatit shqiptar, një figurë e gjallë, dinamike. I dashuri e takon atë në mal duke kullotur bagëtinë, në fushë duke mbjellur e korrur, duke larë të kroi. Këngët shprehnin ndjenjat e qashtra që lëkundnin

zemrat e të rinjve. Vajza flet kokunjur me turp, me frikë mos e shohin bota, ndërsa djali ruan tonin burrëror. Fjalët e tyre janë të matura edhe në shqetësimet më të mëdha shpirtërore. Bukuria e vajzës përshkruhet me tabllo të gjalla. *Mike me shami mënjanë,/ ngadalë se dogje fshanë.* Epitetet merren nga mjedisi i jetës fshatare. Vajza është thëllëzë mali, sorkadhe, milonjë leshraverdhë, trëndelinë etj. Këngët e Veriut priren shpesh nga paraqitja e vlerave fizike të vajzës duke arritur ndonjëherë deri në tone natyraliste. Nën ndikimin e traditave epike ka raste këtu, kur ato sjellin edhe një farë fabule në ndërtimin e tyre, siç ndodh p.sh. me këngët e ndarjes së të dashurve nga transumancat, kurbeti etj.

Në repertorin e këngëve të dashurisë gjenden motive, vërtet të thjeshta, por plot emocione të thella e realiste, që hedhin dritë mbi kushtet në të cilat është zhvilluar në të kaluarën kjo ndjenjë e madhe njerëzore në botën e të rinjve tanë. Ka në to rrethana që tregojnë vështirësitë, pengesat, thashethemet, ndrydhjet e personalitetit të tyre nga normat kanunore patriarkale; kurse ka edhe motive me frymë elegjiake nga vdekja e parakohshme e ndonjerit prej të dashurve etj. Megjithëkëto, në qëndër të këtij repertori mbetet kurdoherë vlerësimi i dashurisë si një ndjenjë e madhe e optimiste, si një fenomen njerëzor shumë i rëndësishëm që shpie në krijimin e familjes, në vazhdimësinë e jetës dhe jo si një ndjenjë «konsumi» ku kërkojnë ta katandisin «konsumistët» e shoqërisë borgjeze.

Një vend të veçantë ze në lirikën tonë popullore, dasma, Ceremoniali i saj, për shkak të vëmendjes së vazhdueshme që i ka kushtuar njeriu martesës gjatë zhvillimit të shoqërisë njerëzore, është mjaft i pasur. Shihen këtu, siç u përmend edhe më lart, gjurma kulturash dhe sistemesh ekonomiko-shoqërore të ndryshme: elemente të martesave të hershme me rapt, bestytni për ruajtjen nga forcat e këqia, për shtimin e të martuarve dhe të fisit, mbeturina juridike për të drejtat që gëzonte dikur, natën e martesës, i pari i fisit, rite për ruajtjen e epërsisë patriarkale, për shtimin e familjes me djem etj. Këngët e dasmës janë të lidhura me fazat e zhvillimit të saj; me ritet e fejesës, e ato të përgatitjeve të druve, miellit, brumit, me ardhjen e miqëve, me ekspozimin e pajës, me veshjen e nuses, rruajtjen e dhëndrit, me nisjen e kthimin e krushqëve, me vënien e nuses në valle, me familjarizimin në mjedisin e ri të shtë-

pisë së dhëndrrit, së fundi me mbylljen e dasmës dhe gostitë që bëheshin pas martesës. Të gjitha këto lartësonin dashurinë, besnikërinë, bashkëshortore, familjen, fëmijët, vazhdimësinë e jetës. Me këto kënge e praktikat ceremoniale, me përcjelljet dhe pritjet e krushqve, me dialogët koralë, me bukurinë e larminë e kostumeve, buçitjen e daulleve e krismat e pushkëve, me dollitë, urimet, humorin e harenë e përgjithshme, dasma merrte pamjen e një spektakli festiv, që mbetej si një nga ngjarjet më të gëzuara publike, në kushtet e rënda të jetës së dikurshme të masave tona punonjëse.

Një atmosferë të kundërt krijonin vajet, tek të cilat gjenden gjithashtu vlera të shumta poetike dhe një sërë praktikash zakonore me zanafillë të lashtë. Në Veri ka qenë praktikuar deri në prag të Çlirimit gjama, një lloj vajtimi që bëhej nga burrat, shoqëruar me lëvizje të caktuara të trupit, me rrahje të kraharorit, dikur edhe me çjerrje të fytyrës. Njëri prej gjamatorëve improvizonte, duke luajtur rolin e korifeut, ndërsa të tjerët përsëritnin vargje klishe më shumë me thirrjet *«Eh-eh-eh.»* Gjama niste me shprthime ekspresive: *I mjeri u për ty o NN!! mjeri u për ty o vlla (axhë, baxhanak, mik, shoq,* etj. sipas rastit). Në to shfrytëzoheshin edhe formula të tjera (të kristalizuara nga tradita). Mbi këto skema përshkruhej jeta e të vdekurit-mençuria, trimëria, mikpritja, aftësitë e tij të veçanta. Me të tilla vajtime nderoheshin sidomos ata që binin trimërisht nëpër luftëra ose ata që gëzonin një nderim në rrethin shoqëror. Një shembull të këtyre traditave e gjejmë te Barleti në gjamën që bën Leka Dukagjini për vdekjen e Skëndërbeut. Gjurmë akoma më të lashta na sjell cikli i kreshnikëve në vajin e njohur *«Ajkuna kjan Omerin»*, ku shprehet me një forcë e bukuri të jashtëzakonshme dhembja e nënës për humbjen e të birit.

Në përgjithësi të vdekurin e vajtojnë gratë. Njëra, aio më e afërta a më e dashura shpreh ndjenjat e dhembjes së saj, ndërsa të tjerat përsërisin thirrma vajtuese. Vajtimin e bëjnë zakonisht familjarët dhe miqtë e të vdekurit. Por në të kaluarën, në raste të veçanta, merreshin për vaje edhe gra që dinin të qanin. Thuhej në të tilla raste se i vdekuri qahej me *vejme* (Elbasan), me *katrrime* (Tiranë), me *bote* (Jug).

Vajet kanë karakter improvizues dhe shfrytëzoh

vetëm në çastet ceremoniale të vdekjes. Por tekste të krijuara nga rapsodë të talentuar për vajtimin e njerëzve të rënë heroikisht nëpër luftëra, ktheheshin ndonjëherë edhe në këngë trimërie, duke u çliruar nga refrenet dhe elementet e tjera elegjiake. Në këtë vazhdë janë kënduar si këngë trimash një sërë vajesh për dëshmorët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Vajet dallohen për pasurinë e figurave-krahasimeve, epiteteve, similitudave etj. që krijohen me aftësi nga improvizatorë të talentuar dhe kristalizohen nga tradita. Kanë mbetur në fondin e qëndrueshëm të vajeve vargjet për gratë që kanë qenë shtylla të shtëpisë: *M'i hoqe kyçet e mezit,/ si trimi armët e brezit...* (Labëri); për një luftëtar që s'e njihte frikën: *Zemra jote me çika,/ syri yt me shtatë drita... Kordhën e maje me dhëmbë,/ dyfekun' e çkrehje ma këmbë* (J. G. Hahn, Alb. Stud. Vëll. II 134); për një fëmijë që këputet në lulen e jetës: *T'i m'u pajke (pike) si molla në gem,/ ti m'u pajke si zogu n'flurem (fluturim)* (Lurë).

Vajet, me gjithë karakterin e tyre elegjiak, shprehin me një ndjeshmëri të thellë dashurinë për jetën, meditime, për t'i mbyllur rrugën vdekjes. Ato për të rënët në luftërat çlirimtare mbartin elemente patriotike. Kurse vajet për dëshmorët e Luftës Nalionalçlirimtare përshkohen nga idetë e çlirimit të atdheut e të popullit, nga idetë optimiste për ndërtimin e një bote të re: *Lule more trima,/ që ratë për atdhe,/ ju kish rritur nëna /për një botë të re.*

Të një natyre të afërt me vajet janë këngët e nizamit, që lindën në kushtet e rënda të pushtimit osman. Me vuajtjet e fatkeqësitë që krijonte jeta ushtarake, sidomos me tragjedinë e humbjes së djemurisë nëpër luftërat ku i shpinte pushtuesi, këto këngë morën karakterin e një vajtimi të përgjithshëm publik: *Dal në brek e shikoj fshanë,/ derë më derë po qajnë,/ u vanë djemtë nizamë... Qani nëna, sa të shëmbi,/ mundim'i djemve që bëni,/ u vate për dhjamë qeni...* (Labëri)

Tragjedinë e kësaj plage të dikurshme na e sjell, me tërë tendosjen e saj shpirtërore, cikli patetik gjithëkombëtar i vdekjes së trimit — i këngëve *Mbeçë more shokë, mbeç... Ku po këndon njaj zogu i zi* etj.

Varfëria ekonomike, e krijuar në kushtet e pushtimeve të huaja dhe të sistemeve antipopullore u bë burim edhe për një cikël tjetër këngësh me karakter po elegjiak — për kën-

gët e kurbetit. Motiv qëndror i tyre mbeten plagët e rënda shoqërore që hapte «ksenitia», mërgimi në Stamboll, Misir, Vllahi, Francë, Amerikë: dramat familjare, ndarjet, shpeshherë, të përjetshme nga nënat, nuset, fëmijët, vuajtjet e mërgimtarëve nëpër vise të panjohura, malli i pashuar për vendin e njerëzit. Këngët e kurbetit janë lotët e një jete të tillë: *O Stamboll i shkretë,/ të rëntë zjarri, të djegtë;/ rëntë zjarri an' e mb'anë,/ që na mban ti burrat tanë... Dyzet dit në det të zi,/ zjarri moj Ameriqi.*

Brenga e përgjithshme dhe malli i pashuar për mëmëdhenë e braktisur, krijoi edhe në lirikën arbëreshe një cikël të veçantë elegjiak-patriotik. Krijime të këtij cikli kanë fiksuar çaste që ngjallin emocione të thella shpirtërore nga tragjedia e largimit të këtyre popullatave: çaste heroizmi, nderi, sedre kombëtare. Ato përshkohen tej e tej nga kujtimet plot ëmbëlsi të trishtuar të atdheut të largët, nga shpresat sado të vagëlluara, por këmbëngulëse, për t'u kthyer ndonjë ditë në gji të tij.

Lirika popullore karakterizohet prej një gjerësie tematike, që i përgjigjet hapësirës së botës shpirtërore të masave punonjëse. Në pasuritë e saj gjen pasqyrim çdo rrethanë e veçantë që lëkund ndjenjat e mendimet e tyre. Zgjerohet hapësira e saj me këngët që shprehin ndjenjat e protestës kundër formave të ndryshme të shfrytëzimit ekonomiko-shoqëror-ndjenja të revoltës kundër formave administrative shtetërore të pushtuesit, kundër shtypjes kombëtare, dhunës, forcës, sistemit të taksave etj.: me ato kundër shtypjes klasore-kundër feudoborgjezisë, obskurantizmit fetar. Nga një anë tjetër në hapësirat e lirikës hasen gjithashtu tema që shprehin admirimin për bukuritë e natyrës, kënaqësitë që provon njeriu në ngadhnjimin e së mirës, të së drejtës, të së vërtetës, ndaj së keqes e gënjeshtrës; të përparimtares e demokratikes ndaj së vjetrës, konservatores e reaksionares; ka vargje argëtimesh e lodrash; ka motive didaktike për mosha e gjini të ndryshme etj.

Krijimet e lirikës sonë popullore dallohen me pasuritë origjinale të mjeteve të shprehjes stilistike. Në shumëllojshmërinë dhe elegancën e tyre ndihet shpirti popullor, brishtësia dhe hapësira e ndjenjave të masave tona punonjëse. Ato na japin konceptet e popullit për natyrën, botën që na rrethon, forcën imagjinuese e talentin e tij poetik. Burim frymëzimi, në këngët tona lirike për krijime epi-

tetesh krahasimesh metaforash etj. bëhen trupat qiellorë--dielli, hëna, yjet. Me shkëlqimin e tyre janë ndërtuar figura me frymëmarrje të gjerë emocionale, shprehet gazi e hareja që sjell lindja e fëmisë: *Të dielën, që me saba,/ ç'u këput një yll e ra,/ iu bë NN-it vëlla* (Kl 3): dëshirat dhe ëndrrat e qashtra që vijojnë prej gojës së nënave në ledhatimet gjumësjellëse të ninullave: *Flej mori cuc' e mshili sytë, kur t'm'i çilsh, i çilsh si hyjtë* (Folklorë III 20); krahasohet bukuria magjepse e së dashurës: *Grykergjëndeja kur shkon,/ as na flet as kuvendon,/ ashtu si e kish zakon,/ si dielli na rështron,/ lëshon shënjë na rerbon* (Hahn 131).

Në lirikat shfrytëzohen dendur malet për krijime figurash me përpjestime të mëdha. Vëllimi dhe pesha e tyre gjigande, qetësia shekullore dhe qëndrimi madhështor, i kanë dhënë shkas fantazisë popullore për personifikime edhe hiperbolizime çastesh të thella psikologjike. Në fatkeqësi të rënda malet «gjëmojnë» «rënkojnë» «kullojnë serrë», «mbajnë zi». Ato ftohen për t'u bërë jehonë vuajtjeve të mëdha shpirtërore. Nga ana tjetër me to ndërtohen figura po me përmasa të tilla edhe për ndjenja gëzimi, siç është p.sh. mbushja e tyre me lule e dushk nga kalimi i krushqëve, ulja që t'i hapin rrugë hënës (nuses) për të dalë.

Një vend të gjerë zënë në figurshmërinë e lirikës shpendët-pëllumbi, thëllëza, sqifteri, gjeraqina, petriti, guguçet, dallëndyshet, libardhat, lejlekët etj. Populli zgjedh me një aftësi të jashtëzakonshme nga mjedise që njeh brez pas brezi prej shekujsh elementet më tipike të ngjashmërive të objekteve që krahason. Tek një nga zogjtë e preferuar të figurave të këngëve të dashurisë e të dasmës, te thëllëza p.sh., vlerëson jetën e saj të lirë, shkathtësinë e fluturimit, po edhe ndjeshmërinë para rrezikut, që i krahason me shkathtësinë, ndjeshmërinë, ndruajtjet e vajzës. Ndjenjat e zjarrta të dashurisë gjejnë shpesh shprehje në këngët e bilbilit. Gjeraqinat, libardhat, dallëndyshet, guguçet, japin krahasime e metafora që simbolizojnë, përkatësisht, shkathtësinë, zhdërvjelltësinë, druajtjen, bukurinë, qëndrimin e përmbajtur të nuses: ndërsa sokoli, sqifteri, petriti — forcën, krenarinë, hijeshinë e dhëndërrit.

Bota bimore me larminë e llojeve, të ngjyrave, të erërave etj. është një tjetër fushë që ka frymëzuar figurshmërinë poetike të lirikës. Elementet më të preferuara mi-

dis tyre janë lulet e drurët e maleve tona — trëndelina, manushaqja, kaçeja, manxuraja, thana, pjergulla, shega, molla, dardha, qiparizi, hala në bjeshkë. Në figurat e këngëve lirike shfrytëzohen gjithashtu (flutura, xixilloja, bukureza etj.), elemente nga bota minerale (floriri, argjëndi, gurët e çmuar), objekte të përpunuara nga mjeshtëri të ndryshme.

Prania e elementeve që shfrytëzohen në tërësinë e mjeteve stilistike, prejardhja, cilësia, gjerësia e përhapjes dhe stabiliteti i tyre, harmonizimi i konkordancave në paraqitjen e së përgjithshmes dhe të tipikes së dukurive të jetës ngrenë probleme me interes si për vetë sistemin e figurshmërisë poetike, ashtu edhe për çështje të tjera të gjenezës dhe karakterit të poezisë. Prania dhe stabiliteti i disa elementeve të caktuara — bjeshka, sorkadhja, thëllëza, thana, pjergulla, shega: i disa formave në strukturën e figurave në epitetet, krahasimet, personifikimet, alegoritë etj., jo vetëm në krahinat e ndryshme të vendit (Veri e Jug), po edhe në folklorin e diasporës hedh dritë mbi unitetin e traditave tona folklorike që nga periudha e mesjetës. Pasuria e elementeve nga mjedisi i jetës fshatare, nga fauna dhe flora malore, rrënjët e tyre të thella në figurat poetike, sigurisht nuk mund të shkëputen nga karakteri i traditave blegtorale dhe bujqësore të popullit tonë. Ngjyrat e veçanta të objekteve që shfrytëzohen në figurat ndihmojnë për gjeografizimin e krijimeve poetike. Sorkadhet, sutat sumbullore, thëllëzat, bredhat, trëndelina etj. të çojnë në viset malore të vendit; kojrrilat lejlekët, mjellmet, nerënxat e portokallet në viset fushore e bregdetare; lulet e kultivuara — trëndafilat, esheboja, karafilat e zambakët — në folklorin qytetar. Rrezet e përhapjes së disa objekteve të krahasimit, drejtimet, përparshmëritë e tyre ndihmojnë shpeshherë për analiza e konkluzione të rëndësishme si brenda kuadrit të folkloristikës kombëtare, ashtu edhe në atë të marrëdhënieve me vendet fqinj. Edhe në rrafshin diakronik, figurat me relikte mitologjike (me zana, orë, drangoj), ato me objekte të prejardhur nga sfera të ndryshme ekonomike e kulturore (florinjtë e Venedikut, duketët, kollonatat e Serezit, hajmalitë me flutura, pallat me gajtanë, harbitë e lara me flori etj.) shtrojnë probleme studimore me interes për brendinë e tyre shoqërore, për lokalizimin kohor e gjeografik.

Rol të rëndësishëm në lidhjen e brendshme të këngës

luan ritmi, organizimi i fjalës së tekstit dhe i tingujve të melodisë saj. Ritmika e këngëve popullore në lirikë është plot jetë. Ajo i përgjigjet me një harmoni e bukuri të veçantë rregullsive të caktuara. Këngët rituale, të lodrave të të vegjëlve etj. janë ndërtuar me vargje të thjeshtë -2, 4, 5, 6 rroksha që sjellin elemente rudimentale të metrikës sonë popullore. Vargu karakteristik për shumicën e llojeve të lirikës sonë është 8 rrokshi. Në disa raste, sidomos në zonat juglindore, përdoren edhe 6 rroksha të dyzuar; në disa raste të tjera bëhen kombinime të 8 rrokshi; edhe me 4 e 6 rroksha të refrenit.

Zakonisht vargjet mbarojnë me asonanca dhe rima të puthura. Mungesa e rimës flet për një ndërtim arkaik. Këngët janë në monokolonë. Ndërtimi strofik niset kryesisht nga kërkesa të melodisë apo të një organizimi të veçantë të aksionit, siç ndodh në këngët agadike, iterative. Praktika e strofave katërshe me rima të kryqëzuara etj. paraqit raste të rralla dhe i përket shpeshherë ndikimeve të poezisë së kultivuar.

Rol të posaçëm luan në këngët e lirikës popullore refreni, që në disa raste, si në vajet, në disa këngë dasme, dashurie, etj. merr funksione korale.

Refreni nxjerr në pah idenë qendrore të këngës. Ai i nënvizon me një vijë të qartë dhe i bën si të prekshme me dorë virtytet themelore të heroit — nuses, dhëndrrit, mikes etj. Me përsëritjet e vazhdueshme ai tërheq vemendjen e dëgjuesit dhe lë mbresa të pashlyeshme në ndërgjegjen e tij: Do të marr, pa marr' s'të le./ *buzëkuqe kadife!...* mbike nerënxa në det/ *nerenx-o!...*'. T'enjten të vijnë sinitë,/ *yll moj hënë, yll moj dritë!...* Lumthi ti more baba./ *Lumthi ti!*. Te këngët e përvajshme, me refrenet, dalin në relievi brenga e ndjenja të dhimbshme: Oj Fush' e Korabit,/ *oj e mjera une!...* Në mes t'atyre dy male./ *o lele, lel bobo!...* Vemendje tërheqin me lashtësinë dhe funksionet e tyre artistike edhe refrenet onomatopeikë.

Kënga lirike me elementet dhe organizimin e saj të posaçëm ritmik, është e prirur për t'u kënduar në valle. Në këto raste dhe në ato të interpretimit muzikor metrika e vargut merr një shtrirje tjetër, duke u zgjeruar me pjesëza mbushëse *(tha, more, vaj, oh)*.

Melodité e këngëve lirike janë më të larmishme sesa të epikës. Zbulohen në to aspekte të ndryshme të botës shpirtërore sipas specifikës së zhanrit. Çdo lloj i lirikës

— këngët e lindjes, ninullat, këngët e dashurisë, të dasmës, të mërgimit ekonomik e ushtarak, vajet etj., kanë intonacionet e tyre. Melodinë, ashtu si edhe tekstet, ndryjnë frymën e historisë. Me tonalitetin e metrikën e tyre virtuoze ato i japin pulsin këngës. Ndërtimet melodike gjallërojnë fjalët edhe në rastet kur këto janë vetëm një recital i thjeshtë.

Lumi i ndjenjave të lirikës me gjithë atë kompleksitet përjetimesh të larta njerëzore, me motivet e panumërta që pulsojnë në tekstet e melodinë e këtyre këngëve, me ngjyrat e pafundme të peizazhit dhe të mjeteve shprehëse, me gjithë atë rrjedhë të pashtershme psikologjike që gurgullon në melodinë e këngëve të djepit, të dashurisë, të dasmës, të putirit, në këngët e tepsisë, në vajet, në këngët që këndohen me fyt nga vajzat malsore, në bjeshkë, te këngët e shatit, të lodrave etj., janë dëshmi e aftësive krijuese, e talentit poetik të masave tona punonjëse. Të gjitha këto e bëjnë lirikën një monument të kulturës sonë kombëtare. Ato formojnë njëkohësisht ndihmesën tonë në tërësinë e kulturës së përgjithshme.

Shtresat kulturore të lirikës janë mbrujtur në historinë mijëvjeçare të popullit tonë. Pjellë e një zhvillimi të përhershëm, ato kanë pësuar shndërrime të vazhdueshme. Me rëndësi është të përqendrohet vemendja në këtë kuadër te disa rrjedha të reja të botës shpirtërore bashkëkohore. Është e njohur ndjenja e patriotizmit që ka ushqyer një sërë këngësh të lirikës sonë tradicionale. Kjo ndjenjë në kushtet bashkëkohore ka marrë një dimension të ri. Nëse format e hershme të riteve e praktikave të dikurshme patën prodhuar llojet e nënllojet e lirikës tradicionale me theks më shumë zakonor: këto ndjenja bashkëkohore po i japin shkas sot lindjes së lirikës sociale me një theks kryesisht politik.

Me këtë zhvillim diakronik dhe hapësinor të llojeve e të nënllojeve të lirikës është i lidhur edhe problemi i njësisë kombëtare dhe i larmisë krahinore të këngëve. Vetë zhvillimi i cikleve e temave të njëjta të lirikës — këngëve të lindjes, të djepit, dashurisë, dasmës, nizamit, kurbetit etj., flet për atë njësi të përbashkët që vihet re jo vetëm në gjymtyrët e brendshme të kombit, por edhe në ato të shkëputura nga atdheu shekuj më parë, siç dëshmon folklori i ngulimeve të diasporës. Për këtë fakt flasin gjithashtu edhe shtrirjet e mjaft dukurive të

veçanta në sistemin e strukturave artistike — të objekteve të figuracionit, të ritmeve etj.

Me të drejtë është theksuar nga studiuesit tanë: «Një ndarje gjeografike-regjonale e këngëve popullore shqiptare nuk mund të ndërmirret as nga brendia e tyre shpirtërore, nga kuptimi i botës, as nga ana e tyre formale, as edhe nga mjetet e brendëshme të shprehjes si metaforat e figurat. Sepse këto elemente janë përfaqësuar këtu kudo me të njëjtën mënyrë, pra studimi i tyre jep si përfundim shumë më fort njësinë e ngjeshur të tyre sesa ndarjen e këngës popullore shqiptare. Një ndarje mund ta bëjmë më lehtas pas mjeteve të jashtme të shprehjes nga ana metrikeritmike dhe muzikale».[1]

Faktorët e përbashkët historiko-kulturorë krijojnë edhe dukuri të përbashkëta. Megjithëkëtë investigimet diakroni-sinkroni, krahas këtyre lidhjeve të përbashkëta gjithëkombëtare, nxjerrin në pah edhe elementet e veçanta krahinore që vihen re qoftë edhe në fasadat e tyre.

Lirikat lindin zakonisht në truallin e gjerë dhe të tensionuar të ndjenjave masive popullore. Për vetë karakterin e tyre social ato kanë shpeshherë si autorë gratë-nënat, motrat, bashkëshortet që kanë shprehur ndjenjat e tyre të fuqishme — mallin e tyre të pashuar për njerëzit e dashur që u kanë mbetur në mërgim, për humbjen e bashkëfamiljarëve, dashurinë për të afërmit etj. Shpesh këngët lirike improvizohen në proceset themelore të jetës, sikurse ndodh me këngët e lindjes, të djepit, në fazat e ndryshme të dasmës, në vajet etj. Pa rënë në absolutizime, mund të thuhet se te krijimi dhe bartja e këngës lirike dallohet më shumë pjesëmarrja e gruas, kurse te kënga epike pjesëmarrja e burrit. Ndryshe nga autorët e këngëve epike, që i imponohen auditorit me aftësitë e tyre krijuese dhe interpretuese, autorët e këngëve lirike shkëlqejnë e zhduken pa bujë, duke u mbuluar nga mjegulla e anonimatit. Megjithëkëtë ato shprehin situata të thella shpirtërore, situata tipike të farkëtuara në kudhrën e jetës, duke kombinuar emocionet e shijet e tyre individuale me ato të masave të gjera popullore. Krijimet e tyre, të hartuara sipas tipologjisë, strukturave dhe ligjësorive specifike tradicionale, dendur janë me një nivel artistik të paarritshëm. Le të sjellim për ilustrim ndonjë

1) E. Çabej: Studime gjuhësore vëll. V f. 127-128.

shembull. Tradita si autorë të njerës prej kengeve më përfaqësuese të mërgimit tonë ekonomik. kënges aq të njohur kuksiane «Moj Fush' e Korabit», shenjëzon një nuse të re nga fshati Radomir, e cila kishte përjetuar me tërë dramat e veta plagët e rënda të kurbetit. Thuhet se bashkëshorti i saj për vite të tëra me radhë i kalonte muajt e verës në bjeshkët e Korabit dhe muajt e dimrit në kullotat bregdetare të Selanikut. Kënga jep një kuadër të mahnitshëm të gjendjes shpirtërore të kësaj nuseje të re që nuk i takonte të qëndronte me bashkëshortin e saj veçse dy herë të vetme në vit (kur ngjitej dhe ulej nga bjeshkët e Korabit). Në vargjet e saj ka realizëm, çiltëri ndjenjash, klithje, dashuri, xhelozi, revoltë, shpërthim. Heroina mallkon *«O moj Fush' e Korabit,/ seç na erdhe hakit,/ seç na dave shtratit»*. I shoqi nga kujdesi për bagëtinë dhe nxitimi i nisjes harron në shtrat elemente simbolike «mandilin», «qostekun e sahatit», «çibukun» etj. Ajo e përshkruan me sy të përlotur rrugën nga do të kalojë me grigjen e tij: Vracën, Urën e Kvirit, Vasijen, Sllatinën e qendrat e tjera nga do të përshkojë deri në Selanik. Këto nuk jepen thjeshtë si toponime, por si emërtime funksionalë të një itinerari që i grabit qenien më të shtrenjtë. Flitet aty për dyshimet e shqetësimet që i ngjallen në mendje *«Vajzat e Sllatinës,/ me tre bishta shpinës»*, që mund t'ia rrëmbejnë zemrën njeriut të saj më të dashur; përmenden sllavet e greket që rrezikojnë ta bëjnë për vete atje në mërgim me shërbimet e lajkat e tyre etj. Kënga është e vjetër thotë tradita. Në të shpërthen një botë e tërë ndjenjash të çiltëra, të brishta, me një paraqitje sa të natyrshme aq edhe të thellë e fisnike. Kënga njihet prej disa brezash nga të mëdhenj e të vegjël në gjithë Kukësin dhe krahinat për rreth. Thuhet se s'ka bari të këtyre anëve që të mos e dijë të plotë ose të përmbledhur tekstin e saj. Ajo jeton si një dhijatë, si një ngushëllim i thellë që i heq bariut kuksian dhembjet shpirtërore, i heq dëshprimin, i këput distancat, e bie në vatër, në shtratin e tij familjar. Fakti që zhvillimi poetik është në vetën e parë dhe me një strukturë verbale të dukshme vetiake nuk i kufizon efektet e saj, përkundrazi u jep një hapësirë të një madhësie që rrezaton në tërë etninë.

Të njejtat fjalë mund të thuhen për vajin aq të njohur të asaj nëne malësore nga Gruda, që vajton vajzën

e vetme, vdekur në kushtet e kaosit të normave drakoniane të kanunit dhe të një pshtjellimi të përgjithshëm kombëtar «*Ku a kanë mirë me ndjellun zi/ Hej, hej!*» Krijime të tilla nën miratimin e farkëtimin kolektiv, i japin lirikës sonë popullore një potencë ndjenjash dhe vlerash artistike të paarritshme.

Sikurse është nënvizuar edhe në fillim tërësia e materialeve të botuara dhe atyre arkivale bashkë me dëshmitë dokumentuese përkatëse, me fotografimet e filmimet e rapsodëve, të valleve, të veshjeve popullore, të zakoneve e praktikave ceremoniale etj. përbëjnë një panoramë të plotë të pasurive të lirikës sonë popullore që lejon ndërmarrjen e një botimi të gjerë brenda korpusit të folklorit shqiptar dhe të trashëgimisë kulturore kombëtare të popullit tonë. Një problem i rëndësishëm që del nga një ndërmarrje e tillë është padyshim ajo e klasifikimit të këtyre materialeve për t'i paraqitur ato në një tërësi organike, në një sistem me ligje koherente të krijimit e të evolucionit, për t'i vendosur këto cikle në një radhë të tillë që të çojnë nga një lloj në tjetrin në mënyrë të natyrshme dhe harmonike. Lirika, përsa i përket përkufizimit si gjini letrare, ka disa epërsi ndaj gjinive të tjera; por kur futesh në nënndarjet e saj, në llojet dhe përbërjen e tyre, lindin probleme që e vështirësojnë mundësinë e një klasifikimi adekuat universal. Në letërsinë e përgjithshme folklorike janë praktikuar skema të ndryshme. Janë ndarë këngët lirike p.sh., në: 1. Këngë zakonore; 2. Mitologjike; 3. Pune; 4. Luftarake; 5. Familjare; 6. Dashurie; 7. Humoristike e satirike.

Në ndonjë rast është marrë si bazë për klasifikimin e tyre shoqërimi me valle a me instrumenta muzikorë etj. Në përvojën tonë studimore pas Çlirimit kanë filluar të përdoren dy nënndarje të mëdha të kësaj gjinie: 1. Lirika familjare dhe 2. Lirika shoqërore. Në të parën janë përfshirë temat nga lindja deri në varr; ndërsa në të dytën këngët e punës, të mërgimit ushtarak e ekonomik, kundër shfrytëzimit klasor. etj.[1]

Në klasifikimin dhe tipologjinë e një gjinie letrare duhen mbajtur parasysh disa parime: a. Të njihen ligjet

1) Një ndarje e tillë bëhet dhe në «Historinë e letërsisë shqipe» vëll. I, Tiranë 1959.

e krijimit, të qarkullimit dhe të zhvillimit të saj — koha e zanafillës, elementet fikse dhe ato të lëvizshme: të dallohen strukturat arkaike prej atyre që përftohen më vonë. b. Të shtrihen këto si në fushën e tekstit, ashtu edhe në atë të melodisë. c. Të hierarkizohen elementet morfologjikë për përcaktimin e teksteve, e tipeve melodikë, nëntipeve e varianteve etj.

Duke pasur parasysh këto kërkesa do të veprohet edhe në sistemimin e llojeve të ndryshme të lirikës sonë popullore. Në radhë të parë mendojmë të ruhet në vija të përgjithëshme praktika e ndarjes së lirikës në dy fushat e mëdha. I. Lirikë shoqërore dhe II. Lirikë familjare. Megjithë ndonjë papërshtatshmëri të tyre (ka raste kur emërtimi lirikë shoqërore nuk mund të veçohet nga cikle të lirikës familjare, sikurse edhe anasjelltas) ndarja në këto dy fusha ndihmon për sistemimin e materialeve në dy grupe që i lidh në vetvete një parim funksional. Teza marksiste sipas së cilës produkti shpirtëror integrohet rregullisht në prodhimin material dhe prejardhja kronologjike e vetë këngëve të sugjerojnë një klasifikim pak a shumë të tillë: I. 1. Në fushën e parë, të lirikës shoqërore, të përmblidhen: a. këngët rituale të punës b. këngët për festat popullore kalendarike, c. Vargjet e këngët për yshtjet, dukuritë atmosferike, për lulet, zogjtë e kafshët. 2. Në një grup të dytë të përfshihen këngët humoristike për marrëdhëniet shoqërore dhe 3. në një të tretë këngët për mërgimin ekonomik e ushtarak. 4. Kurse një grup i fundit t'u kushtohet këngëve të lirikës politike.

II. Në fushën e dytë, në lirikën familjare, të ndiqej strukturimi sipas parimit të njohur të rrjedhës së jetës: 1. Këngë për lindjen e ninullat; 2. Vargje e këngë për të vegjëlit, lodrat etj. 3. Këngët e dashurisë. 4. Këngët e ceremonialit të martesës dhe 5. Vajet e gjama.

Llojet me gjerësi të veçantë si p.sh. këngët e dashurisë, të dasmës etj. do të jepen në dy ose më shumë vëllime, të radhitur njeri pas tjetrit. Vëllimi i fundit që do të mbylli serinë do t'i kushtohet këngëve të lirikës politike edhe për faktin se në të do të përfshihen krijime për ngjarje përkatësisht më të reja.

Kështu seria do të paraqitej edhe me plotërinë e duhur, edhe me një vazhdimësi të harmonishme e organike.

Në zgjedhjen dhe paraqitjen e materialeve do të ndi-

qen të njëjtat parime, që janë ndjekur edhe në vëllimet e serive të tjera.

Do të përfshihen në to materiale të botuara dhe të pabotuara duke u dhënë përparësi teksteve më të plota dhe më të realizuara artistikisht.

Karakteri i këtyre botimeve për ta paraqitur sa më gjerësisht dhe më besnikërisht jetën e popullit në të gjitha rrjedhat e saj, nga realiteti shoqëror deri në shfrimet intime individuale do të bëjë që të paraqiten në këto vëllime edhe materiale me ndikime nga sistemet e ndryshme shfrytëzuese dhe ideologjia e klasave në fuqi. Në një sërë tekstesh do të vihen re edhe kufizime botëkuptimore të masave punonjëse, të luftës së tyre në kushtet e prapambetjes kulturore për mposhtjen e forcave të natyrës. Do të tërheqin vemendjen në këto materiale edhe tekste me ndikime nga ideologjitë fetare, me besime e botkuptime të errta që kanë qenë të pashmangshme në një stad të ulët të zhvillimit ekonomik e shoqëror. Megjithë mangësitë e tyre, këto janë të domosdoshme për të dokumentuar rrugën e vështirë dhe etapat e zhvillimit nëpër të cilat kanë kaluar masat punonjëse me luftën e tyre të vazhdueshme për mposhtjen e forcave të errëta, regresive, për të dalë në rrugën e drejtë, të begatisë dhe të përparimit. Këto të dhëna janë të domosdoshme për t'u përgjegjur kërkesave studimore si të folkloristëve, ashtu edhe të studiuesve të fushave të tjera — etnografëve, historianëve, sociologëve, estetëve, kritikëve të letërsisë. Sido qoftë elemente të tilla botëkuptimore, doke, zakone e besime të kota janë fare të kufizuara në krahasim me gjithë ato materiale ku shkëlqen realiteti i jetës, optimizmi i përhershëm i popullit, besimi i patundur në forcat e tij për arritjen e fitoreve.

Në ndërtimin e vëllimeve, zgjedhjen dhe paraqitjen e këngëve, do të ndiqen të njejtat parime që janë ndjekur edhe në vëllimet e serive të tjera.

Si rregull do të paraqiten tekstet më të plota dhe më të realizuara artistikisht midis materialeve të botuara dhe sidomos atyre arkivale. Tekstet bazë do të shoqërohen edhe me variante kur këto sjellin elemente të reja si nga përmbajtja ashtu edhe nga përhapja gjeografike dhe vlerat artistike. Në çdo tekst do të jepet vendi dhe koha e mbledhjes. Për tekstet e botuara, kur mungojnë të dhënat, do të jepet si kohë e mbledhjes viti i botimit të vëllimit

përkatës. Kështu p.sh. për tekstet e marra nga «Bleta shqiptare» e Th. Mitkos, «Valët e Detit» të S. Dines, «Visareve të Kombit» vëll. III. V. etj. do të jepen përkatësisht: vitet 1878, 1908, 1938, 1944.

Në redaktimin gjuhësor janë ruajtur me besnikëri veçoritë e të folmeve të krahinave përkatëse. Për të shmangur luhatjet fonetike etj. është vepruar sipas shënimeve që jepen në pasqyrën e posaçme në fund të vëllimit.

*

* *

Në vëllimin e parë të serisë së Lirikës janë paraqitur këngët dhe praktikat rituale që lidhen me punën, festat popullore kalendarike, natyrën e dukuritë e saj. Këto fusha marrin përparësi jo vetëm nga pesha që kanë si kategori të rëndësishme të gjinisë, po edhe si një tërësi etnokulturore me një njësi të përbashkët normash të krijimit dhe të evolucionit. Ato lidhen midis tyre nga përmbajtja e temave dhe arkaiciteti i elementeve semantikë e morfologjikë të ndërtimit të tyre, nga karakteri i strukturës dhe sistemi i konvencioneve të tyre artistike.

Nëpërmjet të këtyre krijimeve ne njihemi me etapa të hershme të artit popullor, me hapat e para që hedh mendimi poetik i popullit në rrugën e zhvillimit të tij. Dhe këto hapa fillestare na qartësojnë vështrimin mbi rrugën e zhvillimit të përgjithshëm të letërsisë sonë popullore, na fusin në botën e ndërlikuar të faktorëve ekonomiko-shoqërorë që kanë kushtëzuar gjenezën e këtyre krijimeve. Është për t'u nënvizuar që në fillim se në themeli të shfaqjeve të para estetike dhe të praktikave që shoqërojnë ato, qëndrojnë interesat ekonomike, nevojat që e shtynin njeriun për sigurimin e jetesës me anë të punës.

Puna, si themel i jetës, ka qenë kurdoherë burim i botës shpirtërore të njeriut. Klasikët e marksizëm-leninizmit, duke folur për proceset shoqërore, politike e shpirtërore kanë nënvizuar se «të gjitha këto kushtëzohen, në radhë të parë, nga mënyra e prodhimit të jetës materiale».[1] «Jeta shoqërore ka vënë në dukje shoku Enver Hoxha,

1) Marks-Engels. Vepra të zgjedhura — përkth. shqip. 1958, vëll. I. f. 336.

është në thelb një proces material, sepse në themel të saj, qëndron puna».[1]

Në procesin e punës, të luftës që bënin grupet e para të njerëzve me natyrën lindën edhe format e para të artit. Në zanafillë të këtyre formave, është jehona e përpjekjeve të njerëzve për sigurimin e jetës me mbledhjen e fryteve, në gjah etj., janë mbresat dhe emocionet që i lindnin njeriut gjatë këtyre përpjekjeve. Në këto procese morën zhvillim edhe motivet e para të punës, të shoqëruara këto me atë kompleks kultesh e besimesh që kanë qenë karakteristike për shoqërinë primitive. Njerëzit e kësaj periudhe nuk arrinin të kuptonin shkaqet e dukurive të natyrës — të thatësirave, shirave, furtunave etj., të cilat ushtronin ndikim kryesisht mbi prodhimet bujqësore. Duke qenë të pafuqishëm për të vepruar kundrejt tyre me mjete reale, ata mundoheshin ta arrinin këtë me veprime që diktoheshin dhe nga fantazia prej nga lindën përfytyrime të tilla, besime në ekzistencën e këtyre forcave të mbinatyrshme, besimet e religjonit pagan. Elemente të këtyre besimeve lidhen me kulte të ndryshme — të diellit, hënës, të yjeve e të tokës, me kultin e maleve, ujrave, fushave, bimësisë, me vende të caktuara në praktikat e tyre sakrale në shtëpi, në fshat, në krua, në objekte kulti; me periudha të ndryshme të vitit — në pranverë, verë, vjeshtë e dimër. Por të gjitha këto i bashkon një themel i përbashkët, një lidhje e brendshme, e thellë, jetësore që shpreh ndjenjën e fuqishme të njeriut për të jetuar, besimin e tij për të mposhtur vështirësitë dhe rreziqet që i dilnin përpara, vullnetin e tij për të përballuar nevojat ekonomike me një jetë të përhershme veprimtare. Nëpërmjet të kësaj rruge, sado rudimentale në fillimet e saj, u arrit edhe zhvillimi dialektik i shoqërisë. «Njeriu, duke vepruar mbi natyrën e jashtme, ka theksuar shoku Enver Hoxha, e transformonte atë, por në këtë veprimtari të tij, ai transformon njëkohësisht edhe vetveten, zhvillon shijet dhe zotësitë e tij».[2]

Me përmbajtjen e tyre të lashtë materialet e këtij vëllimi na zbulojnë praninë e disa prej veçorive tipike të kulturës shpirtërore të të parëve tanë. Në këtë vështrim këto fusha të folklorit japin një material me vlerë për

1) E. Hoxha. Për shkencën. I. f. 416.
2) Po aty.

njohjen e kuadrit kulturor të epokës, për njohjen e kulteve dhe domethënien e disa ceremonive religjioze pagane etj. Përmes tyre ne ndjejmë forcën krijuese të popullit tonë, të gjallërisë dhe origjinalitetit të tij poetik. Ato na tregojnë se folklori ynë që në fillimet e veta është një tërësi organike me një sistem normash koherente, të lidhura me punën, me veprimtarinë e tij të përditshme prodhuese.

Njeriu ynë i thjeshtë, malsori, bujku e bariu ynë mbeti historikisht në thelb të shpirtit të tij i lidhur pas një botëkuptimi jetësor real. Edhe pse në disa nga këto praktika e këngë mundi të mpleksen ndonjë element me ngjyrë fetare, kjo krijimtari, prapa fasadave të jashtme kristiane e islamike, ruajti fizionominë e një qytetërimi popullor të lashtë pagan. Siç do të shihet edhe nga materialet konkrete, në krijimet tona folklorike, më shumë se për mrekullitë e Ristozit, bëhet fjalë për lulet, përtëritjet e natyrës në pranverë, më tepër se për legjendat e ringjalljes së Llazrit, urohet «sa lule në Tomorr aq dhen e dhi në oborr», për djem e nuse punëtore; sa «furka që ka në kasolle». Më shumë se për mrekullitë e shenjtorëve — shën Gjergjit, shën Gjinit, shën Pjetrit aty flitet për gjallërimin e jetës me këngë e me valle, për mbushjen e hambarëve, për një jetë aktive, të gëzuar e të lumtur.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ndikimet e kulturave të jashtme, me të cilat populli ynë u ndesh gjatë zhvillimit të tij historik. Pa minimizuar pasojat e këtyre ndikimeve, gjurmat që kanë lënë në traditat tona popullore, pushtimet e ndryshme nga antikiteti e mesjeta deri te sundimi pesëshekullor osman, në thesarin e këtyre traditave zotërojnë veçoritë origjinale të një fondi të lashtë etnokulturor kombëtar.

*

* *

Si prodhim artistik i disa shekujve këto këngë përfaqësojnë një burim me vlerë të madhe informative.

I. Vendin kryesor këtu, sikurse do të shihet, e zenë këngët e punës. Më shumë se gjysma e këngëve të vëllimit (rreth 260 këngë) trajtojnë këtë temë. Puna, si një fenomen i lashtë jetësor, është pasqyruar në krijimet

folklorike, e gërshetuar me motivet dhe në format më të ndryshme — në balada që flasin për ndërtime me përmasa të mëdha (kala e ura); në tregime ku bëhet fjalë për udhë e pallate me bukuri të mahnitëshme, në krijimet intime të lirikës popullore si në këngët e djepit, të dashurisë e të dasmës, deri në vajet e ligjet; në një varg fjalësh të urta ku shprehen vlerësime për rolin e punës si themel i jetës, pikëpamjet etike për frytet dhe për edukimin me konceptet e saj. Por qëllimi i këtij botimi nuk është të japë një kuadër të këtyre vlerësimeve. Këtu janë paraqitur vetëm ato krijime që bëjnë fjalë drejtpërdrejtë për llojet e ndryshme të veprimtarisë prodhuese të popullit tonë, për punët bujqësore e blegtorale, gjahun e peshkimin, për zejet e ndryshme me të cilat janë marrë masat tona punonjëse në të kaluarën, për punët e brendshme shtëpiake — gatimin, endjen në avlemend, qëndisjen etj. që janë ushtruar brenda rrethit tonë familjar. Nga ky shkak kanë mbetur jashtë kësaj përmbledhje një numër temash të rëndësishme nga kjo fushë si ato të këngëve kundër shfrytëzimit klasor të punës, që do të paraqiten në vëllime të tjera të kësaj serie, këngët e kushteve të rënda në të cilat jetonin punonjësit gjatë emigracionit ekonomik apo motive të tjera pune që do të përfshihen në zhanre të ndryshme të lirikës. Edhe nga pikëpamja kronologjike në lëndën e këtij vëllimi jemi ndalur vetëm në këngët tradicionale, për të dhënë kuadrin e marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore në kushtet e shoqërisë feudo-borgjeze. Nuk janë përfshirë këtu këngët e punës të periudhës së Ndërtimit socialist, të cilat përfaqësojnë një botëkuptim të ri ideologjik, të formuar nga orientimet ideologjike të Partisë, nga interesi i përgjithshëm dhe solidariteti shoqëror i forcimit të pronës socialiste etj.

Shumica e këngëve të vëllimit i përkasin mjeshtrive tradicionale, bujqësisë dhe blegtorisë. Ato janë frymëzuar dhe kanë lindur në mjedisin dhe në proçeset e ndryshme të këtyre veprimtarive të hershme dhe të qënësishme të jetës ekonomiko-shoqërore të masave tona punonjëse. Këngët për punët bujqësore p.sh sjellin emocionet e bujkut gjatë mbjelljes, korrjes, shirjes etj.; ato të blegtorisë kanë lindur nën frymëzimet që japin hapësirat e kullotave, kontaktet me natyrën, me bjeshkët, me mrizet, me çastet e hareshme të jetës blegtorale etj., por edhe me vështirësitë e saj — me përballimin e acareve të dimrit, me shqetë-

simet për sigurimin e ushqimit të bagëtive kur borërat mbulojnë vendin etj.

Në këngët për këto dy veprimtari tradicionale të ushtruara nga masat tona punonjëse kemi një lidhje të thellë e gjenuine të tyre me natyrën, një pozicion të qëndrueshëm ndaj kuptimit dhe të rolit të saj në jetën e njerëzve. Te lënda poetike e këtyre këngëve ndjehen tingëllimet, emocionet, mahnitjet për bukuritë e natyrës. Në figurat e tyre spikat ai vështrim i mprehtë e i mençur popullor për ato që ndodhin rreth njeriut të punës. Përfytyrime të fuqishme poetike paraqesin me një aftësi të veçantë përgjithësuese dhe komunikimi atë që ndjen bujku e blegtori në brendi të shpirtit të tij nga kontaktet me natyrën dhe me dukuritë e saj në stinët e ndryshme të vitit, të lidhura këto gjithmonë me interesat e tij jetësore.

Për bujkun pranvera është stina e përgatitjeve të mëdha, e shqetësimeve që në hapat e para për arritjen e të korrave të bollshme. Janë një sërë veprimesh që të çojnë drejt qëllimeve të tilla. Dhe çdo hap duhej hedhur me kujdes e mençuri.

Bujqit ndiqnin me vemendje gjelbërimin e pyjeve, shkrirjen e borës, ngrohtësinë e vlagën e tokës për të nisur nga mbjelljet e veprimet e tjera bujqësore. «Ne, thonë bujqit, në kohën kur fiku kishte çelë tri fletë, ose kur dushku kishte filluar të gjelbëronte, shkonin çdo mëngjes në tokat që kishim përgatitur për mbjellje dhe prisnim që t'i zinte dielli. Nëse ugari ishte mbuluar me «fije teli» (fije merimangash) që shkëlqenin nën rrezet e diellit, atëhere toka ishte gati për t'u mbjellë; në të kundërtën prisnim edhe disa ditë.»[1] Në këto kushte bujku kish krijuar një përvojë të tij shekullore.

Kujdes i veçantë i kushtohej zgjedhjes dhe ruajtjes së farës. Ky kujdes fillonte që në periudhën e korrjes dhe të shirjes, kur bujku pjesën më të mirë e linte për farë. Kallëzat e zgjedhur me kokrra të plota e rrjeshta të drejtë, lidheshin bukur nëpërmjet xhufkash të lëna apostafat dhe vareshin në trarët e dhomës së zjarrit për t'u tharë e ruajtur nga dëmtuesit. Një sërë besimesh e ritesh shoqëronin çdo fazë të ruajtjes dhe përdorimit të farës.

---

1) Spiro Shkurti «Mbjellja e drithërave». Ethnografia shqiptare 14.6.1986 f. 46.

Sikurse del edhe nga materialet e këtij vëllimi populli ynë ka pasë krijuar një sërë këngësh e vallesh dhe një kod të tërë dokesh, urimesh, shprehjesh e praktikash magjike për proceset e ndryshme bujqësore. Shumë prej tyre e kanë burimin nga kohët më të lashta, siç janë ato për flijimet që i bëheshin demonit të tokës dhe të farës. Një numër prej tyre, që lidhen me shkallë të caktuara të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të njerëzimit, ndeshen në mënyrë të përafërt edhe në popuj të tjerë. Studiues të ndryshëm kanë vënë në dukje karakterin dhe funksionin e këtyre riteve.[1] Për popullin tonë ato hedhin dritë mbi fakte të rëndësishëm: E para këto praktika rituale e krijime poetike, duke qenë të përbashkëta në shumë krahina të vendit dhe në diasporë, dëshmojnë për unitetin e kulturës sonë popullore, për unitetin etnik të popullit tonë. E dyta, duke qenë edhe me rrënjë kaq të thella në psikologjinë dhe botëkuptimin e të parvet tanë, ato e renditin popullin tonë midis popujve që kanë lëvruar prej kohësh traditat e jetës bujqësore. Këto praktika rituale zakone e besime pagane, po zhduken plotësisht tani në periudhën e kolektivizimit bujqësor, me futjen në përdorim të mjeteve të mekanizuara moderne dhe me zhvillimin e përgjithshëm kulturor të fshatarësisë sonë në kushtet e ndërtimit të socializmit.

Pranvera ishte gjithashtu për blegtorin stina që pritej me padurim, stina e përmbushjes së ëndërrimeve të tij, e ngjitjes në male, në bjeshkë, ku do të gjente kullota të pasura për grigjet, që me aq mundim i kishte nxjerrë nga stina e vështirë e dimrit. Imazhet poetike të marra nga realiteti i referohen kësaj gjendje psikologjike dhe frymëzimi popullor. Për bujkun dhe blegtorin dimri nuk mund të ishte veçse një kohë e mërzitshme e melankolike që e largonte nga frymëmarrja e gjerë e përjetuar midis entuziazmit të punës dhe të mjedisit të gjallë të natyrës. Prandaj blegtorët prisnin me padurim që ky largim i detyruar i stinës së inaksionit të merrte fund sa më parë. Kështu ata prisnin me ankth që dielli pranveror të rifillonte forcën për t'i çuar sërish të gëzuar midis asaj jete të gjallë, për t'ia rifilluar sërish plot hare punës së rregullimit të almiseve, pastrimit të kanaleve, ndreqjes së

1) James G. Frazer. «Il ramo d'oro». Vol. II. Torino, 1950.

gardhinjëve, djegies së barërave, lëvrimit të tokës, përgatitjeve për shtegtimet e mëdha të bagëtive nëpër vetminë e bjeshkëve dhe hapësirat e kullotave verore. Dhe kur shikonin se qiellit i kthehej kaltërsia dhe malit gjelbërimi ato mbusheshin me një ngazëllim shpirtëror që shpërthen si hymn për bukuritë e pranverës: *Iku dimri, erdhi vera,/ erdh behari, çeli ferra./ borziloku e trëndafili, mbani vesh se ç'thot' bilbili...* (Përmet VK IV). Ky është kuptimi i vërtetë i këngëve pranverore për lulet, zogjtë, tokën, malin, fushën. Të shohish këtu vetëm një prirje të dashurisë së fshatarit për natyrën; të vësh në dukje këtu thjeshtë shprehjen e drejtpërdrejtë të asaj ndjenje që jemi mësuar ta quajmë nga ndikimi i letërsisë së kultivuar «sentiment i natyrës», do të ishte një interpretim jo i saktë i psikologjisë popullore.

Në kuadrin e bukurive që na paraqesin këngët e popullit për rikthimin e pranverës ishte e natyrëshme që vemendjen e parë ta tërhiqnin lulet. Dhe midis tyre ishte e qartë që më shumë se nga lulet e kultivuara do të këndoheshin lulet endemike të maleve tona me të cilat bariu, fshatari ishte njohur brez pas brezi: — *Ju male, gjithë sa jini,/ Të parën lule kë kini?/ — Të parën kemi lulkaçen,/ të dytën manushaqen...* Por edhe pemët — dardhat, mollët etj., me ndikimet e thella shpirtërore që sjellin lulëzimet e tyre nuk mbeten pa u kënduar, madje edhe me forma të ndjera e të fuqishme metaforike *Sa qënka gëzuar dardha,/ qenka veshur me të bardha! Sa qenka gëzuar molla,/ qenka veshur me të holla!* Ndërsa përfytyrimet poetike me lule të kultivuara karafila, eshebojë, trandafila etj. hasen kryesisht në këngët e pjesës qendrore dhe veriore të vendit. Edhe këto, herë-herë, si ndikime të letërsisë popullore orientale.

Në këngët e mirëfillta të popullit pranvera është kënduar gjithmonë e gërshetuar thellë me veprimtarinë bujqësore e blegtorale, me florën e faunën karakteristike të vendit, me jetën aktive të masave tona punonjëse.

Ka në këto këngë ndjenja dhe vlera poetike që dëshmojnë për botën e madhe shpirtërore, talentin — dhe aftësitë krijuese të popullit. Dekori pranveror hynte gjithkah te njerëzit. Me lulet dhe gjelbërimet e para të pranverës zbukuroheshin dyerët e dritaret, magjet, tundësit, ahuret e vathnajet e bagëtive. Është shtruar ndonjëherë se në këto doke e zakone janë fiksuar elemente kulturash

të lashta. Është pohuar p.sh. se te zbukurimet e shtëpive me degë të gjelbërta kemi relikte kultesh paraagrare, mbeturina të kulteve të pyllit, nga koha kur njeriu gjente në të ushqimet e para (gështenjat, glëndet etj.). Është thënë gjithashtu se te këto rite pranverore gjenden elemente kultesh që u sollën nga Lindja prej popujve të parë indoevropjanë për festat e tyre të dikurshme të pranverës. Pa dashur të futemi në këto çështje që dalin nga qëllimet e kësaj parathënie nuk mund të qëndrojmë pa nënvizuar se tërë këto elemente mund të ishin përftuar fare mirë në vend edhe pa qenë nevoja për një bartje nga gjithë ai itinerar i largët kohor e gjeografik.

2. Proceset e krijimit ngrejnë probleme thelbësore për veprimtarinë artistike, për parimet që drejtojnë këto procese e veprimtari. Parë në këtë vështrim tematika e këngëve të punës që paraqiten në këtë vëllim do të shihet se ndryshon sipas përbërjes gjeografike, relievit të tokës, sipas traditave të formuara për mjeshtri të ndryshme në këtë ose atë krahinë. Kështu krahas këngëve për blegtorinë e bujqësinë që janë të pranishme pothuajse në gjithë vendin ka mjeshtëri të posaçme si detaria, peshkimi, vreshtaria, këngët për bletët, kositjen etj., që të çojnë në treva të caktuara, duke nxjerrë në dukje një panoramë tipike të veprimtarive që janë zhvilluar në vendin tonë sipas relievit gjeografik dhe kushteve klimatike. Ka pastaj raste kur disa procese pune janë kënduar me variante më të shumta dhe disa me një numër këngësh më të kufizuar. Kështu p.sh., do të shihet se këngët për mbjelljet, korrjet e shirjet e të lashtave janë më të shumta, ndërsa nuk ndodh e njëjta gjë edhe për mbledhjen e shirjen e misrit. Këtu, sikurse u përmend edhe më lart ka lozur rol, midis të tjerash, edhe fakti se kultura e misrit përfaqëson një traditë më të re përkatësisht me atë të të lashtave.

Në çdo rast kënga sjell në thelb një emocion të brendshëm. Këngët blegtorale p.sh. në disa raste marrin karakter idilik: lartësohen në to bjeshkët e malet që kundërmojnë erë trëndelinë, pylli ku «ia thonë këngës bilbilat», «fushat e lulëzuara, mrizet, krojet e gurrat, ku gurgullojnë ujëra të kulluara e të freskëta». Herë përshkruhet ai patos lirik që krijohet në shpirtin e blegtorit nga simfonia e kumborëve dhe blegërima e shqerrave, nga melodité e fyellit e të culës dyjare. Herë paraqiten këngët e

bareshave kur shkojnë të mbledhin boronica bjeshkëve. Herë këndohet për ngritjet e zbritjet e karvajeve. Herë hymnizohet jeta intime familjare e stanit kur bariu kthehet nga kullota dhe e shoqja e pret buzë vathës me vedra nëpër duar për mjeljen e tyre etj. Më të kufizuara janë nga këto ngarkesa emocionale këngët që flasin për punët bujqësore. Po edhe këtu nuk mungon një motiv i brendshëm diku më pak e diku më shumë i hapur ose alegorik. Zakonisht në këto këngë të fundit paraqitet rinia, djem e vajza që nuk janë pa një farë lidhje shpirtërore midis tyre. Në këngë të caktuara jehon zëri i gjallë i punës — «Të bëhet punë e tillë e madhe që të ndiejnë kojshitë. mëhalla. fshati» (219). Te disa këngë, p.sh. te ato të punimit të lirit përmenden herë-herë vështirësitë e rritjes dhe të punimit të tij *(Mbolla li te plepi i gjatë)*; herë hallet e jetës (paja, përgatitjet e martesës etj.) Te këngët e mokrës a të mullirit *(Bluj mokën a mulli, bluj)* trajtohen ide të ndryshme alegorike me karakter shfrytëzimi klasor, vështirësitë e jetës, mungesa e bukës etj.) Në këngët e lundrimit flitet për rreziqet e jetës së detit (furtunat). herë për atmosferën e gëzuar që krijohej me kthimin e detarve nga udhëtimet e largëta. Populli nuk është asnjëherë abstrakt në krijimet e tij. Sado të thjeshta dhe të fshehura të jenë motivet bazë të këngëve, ato nuk janë të xhveshura nga qëllime të caktuara funksionale.

Mund të thuhet se diapazoni i emocioneve në këngët e punës është përgjithësisht i kufizuar. Megjithëkëtë nuk mungojnë edhe këtu herë-herë skena me një bukuri të rrallë për jetën veprimtare popullore. Në këngën dardhare «Lart nga Mesohori» (546) p.sh., shohim të shkojnë «çupa e nuse me buklica në supe». Ato zenë vend «nëpër sofatet prej guri anës ujrave të kulluara të izvorit». Lahen këtu pëlhurat e pajës, lahen fustanë e xhamadanë të veshjeve të përditshme. Puna e tyre shoqërohet me melodité magjepëse të këngëve. Goditjet e kopanëve në këtë asmosferë. thotë kënga, tingëllojnë si iso. Së fundi kënga mbyllet me skenën e larjes «gushë e faqe, pulpë e llërë me shkumbë sapuni që moskovolit» të vetë këtyre nereideve. Kemi në këngë të tilla një hymn të vërtetë të jetës nikoqire e optimiste të fshatrave tona, një jetë plot kulturë që të ngjall një krenari të ligjshme kombëtare.

3. Materialet e diasporës që janë inkuadruar në temat e ndryshme të punës shenjëzojnë ide me interes. Disa prej

tyre dëshmojnë për vazhdimësinë që kanë pasur në mjedisin e ri ku u vendosën arbëreshët pas mërgimit fatkeq nga mëmëdheu disa mjeshtëri të tyre tradicionale si kultivimi i ullirit, i vreshtarisë, jeta blegtorale, punimi i qumështit, i leshit, i pëlhurës në argali etj. Elemente të tillë të diasporës përbëjnë pika referimi, dëshmi kuptimplote për rrënjë gjenetike të përbashkëta, për një jetë të njësuar ekonomiko-kulturore të Arbërisë Mesjetare. Disa elemente të tjerë si këngët për recinarët (te Arbëreshët e Greqisë) etj. tregojnë se ata kultivuan edhe mjeshtëri të tjera duke u përshtatur me kushtet e reja të mjedisit të ri.

4. Të dhëna të këtyre këngëve që përfaqësojnë një përvojë shekullore të popullit tonë, hedhin dritë edhe mbi probleme të ndryshme të etnogjenezës. Për ilustrim po kufizohemi vetëm në një fakt. Në këtë përmbledhje janë paraqitur 26 këngë për bletarinë, të zgjedhura këto nga një numër shumë më i madh variantesh që ndodhen në fondet tona arkivore. Nga prejardhja e tyre shihet se këto këngë mbulojnë gjeografikisht pothuajse tërë vendin, nga skaji jugor: Çamëri, Gjirokastër, Përmet (Podgoran e Malëshovë), Vlorë (Drashovicë), Lushnjë (Mërtish e Krutje), Pogradec (Gurras), deri në krahinat qendrore dhe skajin verior: Tiranë (Bastar, Ibë, Laknas, Marikaj, Ndroq), Dibër (Vleshë, Zalldardhë), Mirditë, Mat, Lezhë, Shkodër (Boks, Dukagjin, Koplik, Lohe), Kukës, Tropojë, Kosovë (Gjilan, Llap, Llaushë, Llukë e Epërme, Preshevë etj.). Tematika e këtyre këngëve, vërtetë nuk është shumë e larmishme, megjithëkëtë variantet e shumta, nga njera anë, përhapja e tyre pothuajse në gjithë truallin shqiptar në tjetrën, dëshmojnë për një veprimtari të rëndësishme ekonomike me një përvojë të gjatë tradicionale. Për këtë fakt flasin edhe vetë konceptet e këngëve — struktura e tyre, humanizimi (personifikimi) i objektit dhe gjithë semiotika e komunikimit: ato zëra monotonë të vazhdueshëm me anë të përplasjes së gurëve, fërshëllimave, thirmave onomatopeike të njëpasnjëshme: *yp, yp, yp... mat, mat, mat... hu, hu, hu... pi, pi, pi...*; tërësia e epiteteve me ngarkesën e tyre të posaçme kuptimore e artistike: *e butë, e zgjutë, punëtore, e bukur, e amël, e uruar, zanë, drenushë, bilëz-o: nusez e re* etj., me dëshirat e shprehura me formula të jetës njerëzore: *ardhsh e bardhë, e butë, e amël, mos e len loken me u mërzitë, hin në konak të ri, hin në shpinë e re,*

në odë me xhama, primu ama bijare, bahu motër me rllazni, bahu zojë shpie me sunu; me trembjet me shiun, erërat, borën që do ta dëmtonin për vdekje po të mbetej jashtë etj. Aq të fuqishme janë konceptet e antropoformizmit në këto këngë sa mbretëresha e re thirret deri me emra poetike njerëzore: *«Hajde Marë, Mari, Marinë, mblidhi bijat, «futu e rregulloi punët si zojë shpie, si nikoqire, rehatoi në shpinë e re».* Bleta dëmtohet nga syu i keq si njerëzit. Asaj i premtohet se do ta ruajnë si jetën njerëzore deri me barut e me pushkë. Të gjitha këto dëshmojnë për një konceptim të lashtë e të përbashkët ritual në krijimin e këtyre këngëve. Këtë kuadër antropomorfik e plotëson më së fundi ai nderim i veçantë që jeton në ndërgjegjen e masave tona fshatare për bletën. Kudo në Shqipëri në Jug, në Labëri, në Kosovë, Malësi të Veriut, nuk përdoret, si në rastin e insekteve, apo të kafshëve shprehja «ka cofë a ngordhur një bletë», por shprehja që përdoret zakonisht për njerëzit: «paska dekë nji bletë». Në Kolonjë dhe në disa krahina të tjera të vendit e kanë për keq të shkelet mjalti me këmbë. Prandaj ujin me të cilin laheshin duartë kur hahej mjaltë nuk e derdhnin në çdo vend, por në një vijë, në përrua a lum. Të gjitha këto dëshmojnë se bletaria ka qenë një veprimtari e rëndësishme ekonomike, e njohur dhe e kultivuar që së lashti në vendin tonë. Për këtë fakt flet edhe mbrojtja e saj deri në normat kanunore. Në kanunin e Lekë Dukagjinit ka 16 paragrafë (nr. 199-214) që bëjnë fjalë për një qëllim të tillë.

Duke paraqitur jetën dhe zhvillimin ekonomik të ilirëve, veçanërisht atyre jugorë, është theksuar se ata kanë qenë «bletarë të shkëlqyeshëm dhe prodhues të mjaltit».[1] Por këto tradita të ilirëve shpeshherë janë vënë nën tutelën e kulturës greke, janë paraqitur si të prejardhura prej saj. Është theksuar p.sh. «të dhënat e sigurta për bletën si shtazë shenjte i kemi për trevën ilire shi në lidhje me praninë e kolonistëve grekë në brigjet adriatike e jonike, pra me praninë e ndikimit grek në jetën shpirtërore ilire.[2] Me këtë prani dhe me këto ndikime janë të lidhura të gjitha paraqitjet e bletës, të njohur deri tani në trevën ilire». Materialet tona etnologjike, që janë të

1) A. Stipceviq, «Simbolet e kultit te ilirët« Prishtinë, 1983, f. 101-102.

2) Po aty.

gjalla akoma edhe sot në gojë të popullit flasin për të tjera fakte. E para se tradita që e quan bletën si diçka «të shejtë» nuk jeton vetëm në viset e përmendura bregdetare (ku ka qenë i pranishëm ndikimi grek (Apoloni e Durrësi), por në tërë hinterlandin e Ilirisë jugore. Madje sipas këtyre materialeve zonat më intensive të kësaj kulture janë zonat e brendshme: Në Kosovë, Malësi të Veriut, Malësi të Gjakovës (krs. shprehjen «mjalt zogash — Tropojë, Dibër, Mirditë, Lezhë, Tiranë, Mokër, Gramsh, Labëri etj. E dyta se një shtrirje e tillë hapsinore dëshmon në rrafshin diakronik se kjo kulturë është me prejardhje gjenetike drejtpërsëdrejti nga shtresa e simboleve të kulteve ilire. Së treti se ilirët aftësitë me të cilat dalloheshin si «bletarë të shkëlqyeshëm» nuk i morën nga prania e kolonistëve grekë, por i kishin si tradita të tyre autoktone, të kushtëzuara nga relievi dhe flora e trojeve të tyre. Dhe e katërta, në pasojë të këtyre argumentimeve, nga ekzistenca e këtyre materialeve dhe e këtyre traditave që ruhen në ndërgjegjen e popullit tonë si në asnjë etni tjetër të Ballkanit, na jepet një tjetër argument rreth prejardhjes së traditave të popullit shqiptar drejtpërdrejtë nga lashtësia etnokulturore ilire.

II. Vendin e dytë, për nga gjerësia, e zenë në këtë vëllim këngët e festave kalendarike — të pranverës, verës, vjeshtës dhe dimrit. Këto festa, siç do të shihet edhe nga përmbajtja e këngëve, në thelb të tyre janë festa të prodhimit, festa që sjellin jehonën e një jete veprimtare, të punëve konkrete të stinëve. Dhe si të tilla ato kanë një lidhje të brendshme organike midis tyre, që dëshmon për rregullsinë e një shoqërie të organizuar me bazë punën.

Mbi këtë bazë dhe në kushtet e relievit e të klimës së territorit të tij populli ynë ka pasë krijuar nga kohët e hershme kalendarin e vet vjetor. Janë shfaqur mendime se ky kalendar ndahej në 8 pjesë të barabarta me nga 45 ditë secila. Fillimi e mbarimi i tyre ishte lidhur me fillimin dhe përfundimin e punëve bujqësore e blegtorale të stinës duke u shoqëruar me festa popullore të posaçme.[1]

Shfaqjet e ndryshme të periodicitetit natyror, kursi i diellit, fazat e hënës, këmbimet pranverë, verë, vjeshtë, dimër, ditë, natë etj. kanë krijuar, ashtu si në popujt e tjerë, edhe në popullin tonë, mite, besime e rite kara-

1) Rr. Zojzi «Gjurmët e nji kalendari primitiv në popullin tonë». Buletin i Institutit të Shkencave 1949, nr. 1, f. 85-112.

kteristike. Romaniteti, pastaj kristianizmi, imponuan përkatësisht kalendarin diellor julian nga viti 46 para erës sonë dhe atë gregorian pas shkurtit 1582. Në se ne nuk kemi dëshmi të shkruara që protoshqiptarët para Çezarit të kenë përdorur kalendarin hënor ose hënordiellor (lunar ose lunarsolar) ka një tërësi materialesh të përcjella tradicionalisht gojë më gojë, një tërësi të dhënash etnologjike që hedhin dritë mbi faktin se të parët tanë kanë pasë një koncept të tyre për ndarjen e kohës në një qerthull kalendarik vjetor. Një pasuri e tërë vëzhgimesh e konstatimesh, praktikash e ceremonish që kanë jetuar dhe jetojnë akoma sot si relike në krahina të ndryshme të vendit, ndihmojnë për qartësimin e aspekteve të hollësishme të këtij kalendari. Për popullsitë blegtorale e bujqësore, para se njësitë e kufizuara kohore (muajët, javët, ditët), ishin ndarjet e mëdha, dimër e verë që tërhiqnin vemendjen e tyre. Ky koncept ka jetuar gjerësisht në botëkuptimin tonë popullor dhe është shprehur në caqet e njohura për marrëdhëniet e kontraktimet bujqësore e blegtorale shën Gjergj e shën Mitër (pajtimet e puntorisë, mbarështrimi i bagëtive, i punëve bujqësore, qeratë etj.). Por, përveç kësaj ndarje, e cila duhet të ketë gjetur praktikim kryesisht në zonat malore të vendit, nuk kanë qenë të panjohura për popullin tonë edhe blloqet tremujore, siç tregon p.sh., koncepti semantik leksikor i vjeshtave (vjeshtë e parë, e dytë, e tretë). Për t'u përmendur janë vëzhgimet që kanë qenë praktikuar në shumë krahina të vendit për ciklin vjetor me anë të ndriçimit të majave të maleve përkatëse nga rrezet e diellit, për hapësira kohe më të ngushta sipas periodicitetit të prodhimeve bujqësore e blegtorale; shprehjet për shkallëzimet e ditës — me «një, dy, tre pash apo hostenë diell», orientimet e barinjve, karvanarëve, udhëtarëve etj. me yjet e natës — shejzat, yllin e mëngjezit (të dritës a të karvanit), me rolin që u jepej disa punëve në bujqësi sipas fazave dhe ndikimeve të hënës etj. Edhe ndarjet javore e mujore me emërtimet e tyre sipas koncepteve të lashta mitologjike; kultet e praktikat e ndryshme ceremoniale për festat kalendarike etj. janë tregues kuptimplotë që flasin për ekzistencën e një kalendari të lashtë me bazë sistemin diellor po edhe hënor. Më pas shekujt e romanitetit të gadishullit ballkanik futën edhe në kalendarin tonë popullor ndikime të kalendarit diellor julian siç tregojnë edhe emrat e muajve shtator,

tetor, nëntor, dhjetor. Ndërsa ndikimi i sistemit tjetër kalendarik gregorian mbeti si një praktikë që filloi të veprojë vetëm në këto kohët e fundit nëpërmjet shkollimit. Interesat ekonomike bujqësore e blegtorale etj., kanë qenë përbërësit vendimtarë që kanë kushtëzuar përllogaritjet e kalendarit tonë popullor.

Të dhënat për festat e veçanta kalendarike — kohën, doket e zakonet, ceremonitë, praktikat rituale etj. për secilën nga këto festa jepen sipas krahinave të ndryshme në këngët përkatëse që paraqiten kronologjikisht në këtë përmbledhje. Më poshtë po grupohen disa veçori të përgjithshme sipas stinëve.

1. *Cikli pranveror.* Përfshin këngët që shprehin kënaqësitë shpirtërore për ardhjen e stinës së re — për përtritjen e natyrës, për fillimin e punëve bujqësore, blegtorale etj. *Po na vjen e bardha verë/ joho verë!...* Ato janë një hymnizim i kësaj përtrirje të përgjithshme. Ndihet kjo në kujdesin me të cilin zbukurohen me gjelbërime e lule të stinës shtëpitë, ahuret e vathnajet e bagëtive. Ndihet në zjarret pastrues (purifikues) që ndizen në çdo shtëpi, lagje a fshat; në këngët e vallet që këndohen nga të rinjtë e të rejat rreth këtyre zjarreve; në lidhjet rituale të veroreve. Ndihet në zgjimin e nënave pa zbardhur drita, për të marrë ujë të ri; në spërkatjet rituale të njerëzve e të sendeve, po edhe të skutave kryesore të shtëpisë; në kujdesin e gjithë pjestarve të familjes për t'u zgjuar sa më shpejt që «të mos i mundin qyqet», të mos i zerë kënga e tyre në shtrat; në emocionet që krijojnë shëtitjet në natyrë, këngët e vallet, mbledhjet e luleve — manushaqeve, karakafteve, taçeve e luleve të tjera të kohës.

Cikli i pranverës përfshin shumicën e këngëve dhe të festave popullore kalendarike: Ditën e parë të stinës — *Ditën e verës, Verëzës a Ditëverës* (që bie më 1 mars sipas kalendarit të vjetër dhe 14 mars sipas kalendarit të ri. Në ndonjë krahinë festohej edhe më vonë sipas ku shteve gjeografike e klimaterike të vendit. Gjirokastra p.sh. Ditën e verës e festonte më 1 maj); *25 marsin* (Vangjelizmonë a Nevruzin), *Llazoret, Ditën e luleve, shën Gjergjin, Rusicat* (Nga 125 këngë të këtyre festave rreth 100 i përkasin ciklit pranveror). Krahas të përgjithshmes këto festa e këngë kanë edhe të veçantat e tyre. *Dita e Verës* është nga festat më të dashura, më poetike dhe më të pasura

me asociasione pagane. Të paharruara mbeten në mendjen e njerëzve jehona gazmore e këngëve darkën e kësaj feste, dialogët plot humor midis lagjeve e fshatrave për garat e zjarreve, vërtitjet e varavashkave të përflakura, ceremonitë e ndryshme që zhvillohen në familje — vendosja e veroreve, lodrat, urimet, nomatisjet, pastrimet e spërkatjet me ujë të ri jashtë saj — shëtitjet, këngët e vallet, ndjesat e përqafimet me njeri-tjetrin etj.[1]

Këngët e festës janë zakonisht të thjeshta: thirje magjike dhe dialogë me pranverën, natyrën, lulet, zogjtë; me djemtë, vajzat, nuset: *O moj ditvere,/ shiçir si na erdhe... O ti moj verë/ o ho ho ho,/ del të të sho,/ sa e mira je,/ si nuse e re...* Këto biseda me stinën «dikur mund të kenë pasur një karakter e funksion utilitar, ashtu siç kanë p.sh. vargjet që u drejtohen dallandysheve për të shpënë veroret anës detit» dhe «për t'u sjellë njerëzve shëndet» ose për t'u larguar «të ligat në mal të shkretë». Zogjëve u jepet sihariqi i ardhjes së pranverës: *Ore zogj i ferrës,/ na erdh Dita e Verës...* Vajzave e nuseve veç ormisjeve: *Trazoni zilifet,/ mos t'na munin çiçet...* u kujtohen edhe detyrat në kuadrin e jetës patriarkale: *grajhi cuca hejret,/ mos t'na munin shelnjet;/ grajhi të lajm' façet/ e t'çelim konaçet.* Disa këngë të kësaj feste bashkë me gjallërimin e natyrës: *Lum e lum po na del Vera,/ mushen kodrat dhen e shtjerra...* gërshetojnë motivin e dashurisë dhe të martesave: *Top e more top,/ hare lalo oo,/ jalla për gjat mot;/ për gjat mot e jetë,/ vllaznit ton' sinjet,/ t'i martojm' të krejtë,/ t'i martojm' për Verë,/ me lule me erë...*

Në repertorin e kësaj feste ka vargje që recitohen në vende e çaste të caktuara si p.sh., kur shkojnë në agim për të mbushur ujë të ri te kroni, me të cilët shprehen dëshira për shëndet forcë, bollëk dhe jetë të gjatë: *Kuq -kuq si molla,/ gjom-gjom si bari,/ i fort' i fort' si guri...* Me përjashtim të këtij rasti të fundit këngët e kësaj feste kanë një karakter manifestiv: këndohen në grupe të rijsh.

---

1) Për doket e zakonet e këtyre festave flitet gjerësisht edhe në punimet: *R. Sokoli* «Kangët ritual» në të kremtet vjetore të popullit tonë». *Studime filologjike* 1964, nr. 4 f. 163-199; *M. Tirta* «Kulte të bujqësisë dhe të blegtorisë në popullin tonë». *Etnografia shqiptare IX* 1980 f. 155-206; *Sh. Pllana.* «Krijimtaria poetike në ritet e motmotit *Jehona* 1981, nr. 9-10 f. 52-59.

njëkohësisht ose me alternime, ndenjur ose në valle. Në çaste të veçanta si p.sh. rreth zjarrmoreve, ato alternohen me grupe të distancuara lagje me lagje, fshat me fshat, të gërshetuara me elemente humoristikë për t'i lënë njëra palë tjetrës «të ligat e Verës». Karakteri pagan i këtyre këngëve del rregullisht në kultin e luleve, në bashkëbisedimet me festën, zogjtë, natyrën. Si fondi i praktikave rituale, ashtu edhe ai i këngëve dhe i valleve që lidhen me këto festa, përbën një pasuri kulturore me vlerë që populli ynë e krijoi dhe e trashëgoi nga lashtësia. Është për t'u nënvizuar se asnjë çast i kësaj feste dhe në asnjë krahinë të vendit tonë nuk përzihen ritet e saj me elemente të feve monoteistike. Ajo mbeti si një nga festat tona popullore tradicionale ku shprehen më me origjinalitet lidhjet e thella shpirtërore të shqiptarit me përtritjen e natyrës, përtritjen e jetës, botën e luleve, të punës, të pjellorisë.

Edhe festa e 25 marsit me gjithë emërtimet e ndryshme të saj sipas krahinave dhe konfesioneve fetare — Vangjelizmo, Nunciata, Nevruzi, — duhet të jetë një festë me shtrat të lashtë, lidhur me kthesën pranverore të diellit (ekinoksin e pranverës). Për këtë flasin pikat e takimit të kësaj feste me kultet e «nënës së madhe», të vdekjes dhe të ringjalljes së perëndive që kanë qenë të njohura te disa popuj të vjetër të Mesdheut (grekët, romakët etj.[1])

Një festë e rëndësishme pranverore ishin edhe *Llazoret* që binin aty nga mezi i prillit. Megjithëqë mbante emrin e një shenjtori të krishterë zakonet e kësaj feste ishin, në përgjithësi pagane. Në këtë ditë të vegjëlit shkonin shtëpi më shtëpi duke kënduar e uruar për shtimin e familjes: *Sa lule mbi qershi,/ aqë trima në shtëpi;/ sa furka në kasolle,/ aqë nuse punëtore...* për shëndet e mirëqënie: *Sa lule në Tomorr,/ aqë dhen e dhi n'oborr.* E zonja e shtëpisë i gostitëte të vegjëlit me vezë, që përbënin dhuratën simbolike të ditës: *Plakë, plakë venë,/ se s'ta kemi ngenë.* Praktika rituale thuajse të njëjta kanë jetuar për këtë festë në krahinat tona të Jugut dhe në ngulimet arbëreshe të Greqisë dhe të Italisë. Variantet që na sjell nga Arbëreshët e Greqisë folkloristi ynë i njohur Th. Mitko në «Bletën shqiptare» si edhe folkloristë

1) Shih edhe M. Tirta. Punim i përmendur f. 163.

të tjerë paraqesim vija të përbashkëta midis këngëve të kësaj feste të krahinave të Jugut dhe varianteve arbëreshe jo vetëm në zakone të përgjithshme, por deri edhe në formulime e shprehje thuajse të njëjta: *Erdhi Lazëri mbë derë./ bjeri pulësë të pjellë.*

Këngët e Llazoreve kanë pasur një përhapje të gjerë në pjesën qëndrore të vendit si në fshatra të Kavajës, Shijakut, Durrësit e Tiranës. Këtu, edhe pse banorët ishin të besimit muhamedan, ruanin të njëjtin emërtim të krishterë për festën *Llazoret* dhe bënin të njëjtat zakone e praktika rituale.

Në këtë festë mplekseshin motive të ndryshme jetësore siç ishin p.sh. «Farkimi i shpatave», «numërimi i asprave», «mbledhja e luleve» etj. që nuk kishin asnjë lidhje me besimet fetare. Në ndonjë variant të këngëve të saj shihen përpjekje për zëvendësimin e tekstit të lashtë pagan me mrekullitë e legjendës kristiane të ringjalljes së Llazrit. Por këto përpjekje kanë qenë pa rezultat. Me përjashtim të ndonjë rasti tepër të rrallë, shtrati i festës dhe ai i këngëve përkatëse ruajti, në përgjithësi, përmbajtjen e lashtë pagane.

Në disa krahina Llazoret (gratë që shkonin nëpër shtëpitë fshatare për të mbledhur dhurata) merrnin me vete një kukëll, të cilën e shëtitnin nëpër lëmenj e shtëpia. Zakonin e kukllës, që duket të jetë mbeturinë e kulteve të lashta bujqësore dioniziake, e kanë pasur edhe arbëreshët e Italisë. Ndërsa dhurata e vezëve si simbol i përtritjes së jetës ka qenë e njohur edhe në shumë popuj të tjerë.

Me Llazoret, në disa krahina si në Mokër të Pogradecit, në Korçë e Kolonjë ka qenë gërshetuar edhe festa e mbledhjes së luleve në mal. Ky rit ka frymëzuar këngë alegorike të ndryshme. Është e njohur në folklorin tonë ashtu si edhe në këtë arbëresh balada e rrëmbimit të vashës gjatë mbledhjes së luleve nga trimi. Edhe në shtresën e këtyre këngëve ruhen relikte të hershme që tërheqin vemendjen për zanafillën dhe funksionet e tyre të lashta socialestetike.

Në zonat juglindore të vendit si në Korçë, Kolonjë etj. kanë qenë festuar para Çlirimit, nga fundi i prandërës, Rusicat. Në këtë ditë vajzat e nuset e reja delnin shëtitje, mblidhnin lule dhe përkujtonin të vdekurit.

Sipas bestytnive të moçme lulet ishin simbole në të

cilat shndërrohej shpirti i të vdekurve. Zakon karakteristik i kësaj feste ka qenë varrimi i «nënës së diellit». Në mbarim të ditës vajzat e nuset venin e varrosnin anës së ndonjë përroi a lumi një kukull. Bënin me këtë rast të gjitha ceremonitë e varrimit: hapnin një si gropë ku vendosnin kukllën dhe vajtonin sikur të kishin përpara një vdekje reale, duke thirrur me ngashërim: «Nënë moj nënë, kuku erdhi dielli e s'të gjeti».

Vend shumë të rëndësishëm në ciklin e festave pranverore të popullit tonë ka pas zënë festa e shën Gjergjit, që kremtohej më 23 prill sipas kalendarit të vjetër ose 6 maj sipas kalendarit të ri. Traditat e kësaj feste deri pak vjet përpara i shihje të gjalla në tërë truallin shqiptar. Ashtu si Dita e Verës edhe shën Gjergji në shumë treva të atdheut, sidomos në trevat malore Lumë, Has, Dibër, Mat etj. quhej kryeviti. Kjo ditë duhet t'i gjente shtëpitë të lyera me gëlqere, orenditë të lara, oborret e vathnajat të pastruara nga çdo shenjë e dimrit, njerëzit të veshur me rroba të reja.

Në darkën e festës bëheshin po ato rite për zbukurimin e shtëpive me degë të gjelbra e me lule, po ato zjarrmorë purifikues, po ato kapërcime brohoritëse, po ato këngë e valle si në darkën e Ditës së Verës. Që në agim vajzat e nuset delnin e rrokulliseshin nëpër livadhe, relikt ky i kultit të kontakteve me tokën, duke kërkuar përmbushjen e dëshirave që kishin sipas rasteve: vajzat — fat për martesë, nuset — shtimin me fëmi, etj. Vendosshin në krye dhe në brez kurora kulpërash «për të mos ndjerë dhimbje gjatë vitit». Pa zbardhur drita, mbushej uj i ri me të cilin bënin pastrime rituale. Spërkatnin skutat e shtëpisë dhe objektet e saj — magjet, tundësit, hambarët. Nëpër ara ngriheshin degë të gjelbërta, (potka) për të trembur dëmtuesit. Më tepër sesa një festë me karakter bujqësor shën Gjergji ka pasë te ne karakter blegtoral. Në këtë ditë u jepej bagëtive kripë e përzier me gjithë lulet e barërat e stinës. Atëherë ndaheshin shqerrat dhe fillonte mjelja e dhënve. Në këtë ditë do të therej qengji më i mirë i tufës, do të bëheshin ëmbëlsira me kulloshtër, do të nisnin përgatitjet për shtegtimin e bagëtive në kullotat malore. Aq e rëndësishme ishte kjo festë për popullin tonë sa disa krahina si Luma, Dibra e Mati e kishin të domosdoshme festimin e saj në familje nga kurbetarët, kudo që të ndodheshin nëpër

Ballkan, madje e deri në Stamboll. Në atmosferën e gëzuar të kësaj feste lidheshin gjithashtu marrëveshjet për fejesa e martesa, për punë, zënie të shtëpive me qera etj.

Shën Gjergji ishte festa që dallohej për pasurinë dhe origjinalitetin e lodrave popullore. Zakon i përgjithshëm ka qenë në këtë festë lodrimi në shregull, që merrte sipas krahinave, emërtime të ndryshme: *sallanxhak, hulajë, lushaq* (Kosovë dhe shqiptarët në Maqedoni), *shmjegull* (Librazhd), *shregull, shtregull* (Shkodër), *shilarës, shilarth (Tiranë), kunë, kolovajzë* (Jugë) etj.

Në Kosovë shregullat ngriheshin kryesisht nga vajzat e nuset e reja (këto të fundit e festonin shën Gjergjin më shumë në shtëpi të prindërve). Ideja qendrore e këngëve, edhe këtu, është hymnizimi i përtritjes së jetës siç tregojnë këto vargje alegorike me të cilët hapej festa nder shqiptarët e Manastirit: *Seç mbolla një mollë,/ molla lëshoi rrënjë,/ rrënja lëshoi degë,/ dega lëshoi fletë, fleta lëshoi lule,/ lulja bëri mollë.* Disa këngë kosovare, krahas haresë së përgjithshme për ardhjen e festës, bëjnë fjalë për përgatitjet e saj: lyerjet e shtëpive me «qireç», ngritjen e shregullave, për këngët, vallet e lodrat e castit. Në disa krahina, si p.sh. në Shpat të Elbasanit këto këngë formojnë një cikël të veçantë të quajtur: *«kënga shën Gjergji»*.

Cikli i këngëve të shregullave zgjerohej dendur me tema të ndryshme narrative lirike, me idile dashurish, këngë dasme etj. Përmbajtja e tyre përshkohej shpesh me ngjyra të këndshme humoristike. Megjithë hapësirën e diapazonit të ciklit këto këngë paraqitnin në thelësi të tyre një lidhje organike me karakterin e festës. Tërësia e praktikave rituale së bashku me ciklet e këngëve, valleve dhe lodrave përkatëse të shën Gjergjit dëshmojnë se kjo festë i përket një procesi të lashtë e të gjatë kulturor të krijuar nga aftësitë dhe talenti poetik i masave tona punonjëse nën frymëzimet që jep stina më e bukur dhe më gjallëruese e vitit, siç është stina e pranverës.

Relikte të një trashigimi kulturor të lashtë sjellin edhe shfaqjet e karnevaleve, të cilat kanë qenë praktikuar në kohë e festa të ndryshme — në Kolendrat, festa pranverore — Llazoret, shën Gjergj etj. Diku me emër popullorë — *Rrogeçë, Syrretë* (Korçë, Gjirokastër). *Ojmam* (Zymb-Kosovë) etj., diku me emrin *Karnevale* (Shkodër), ato kanë gjëllitur si një traditë autoktone, pothuajse në

të gjithë vendin. Janë këto një lloj maskarade, ku njerëzit, të shndërruar në veshjet e tyre, ushtronin role me karakter politiko-social. Burra, të veshur si gra, demaskonin martesat midis moshash të pabarabarta. Të nisur nga autoriteti i pozitave të ndryshme administrative dhe shoqërore (si kryepleq, xhandarë, pojakë, klerikë, tregtarë, bejlerë, komandantë, prefektë etj.) demaskonin me vargje humoristike forma të ndryshme të shtypjes dhe të shfrytëzimit klasor në kuadrin e jetës së ngushtë të fshatit, a të qytetit, sjelljet prepotente të nëpunësve, ushtarakëve, njerëzve të ligjit etj.

Cikli i festave pranverore, me tërësinë e këngëve, valleve, zakoneve, besimeve dhe praktikave rituale, që janë kremtuar në një mënyrë pothuajse të njëllojtë në gjithë vendin, përbën, jo vetëm ciklin më të pasur të festave tona popullore, por edhe një nga ciklet më karakteristike të kulturës sonë tradicionale. Krijimet e këtij cikli, me pikënisjen e tyre nga një shtrat i përbashkët, siç ka qenë ai i stërgjyshërve tanë ilirë dhe me pasurimin me elemente të reja në kushtet e zhvillimit historiko-shoqëror të popullit tonë, kanë formuar hallka të rëndësishme të njësisë sonë etnokulturore. Nga një anë tjetër, parë në një këndvështrimi më të gjerë, cikli i këtyre festave ka përfaqësuar edhe një cikël me rëndësi në kuadrin e traditave kulturore të gadishullit ballkanik, të kushtëzuar qoftë nga trashëgimi i shtresave të lashta kulturore të këtij gadishulli, qoftë nga konteksti i zhvillimit historik dhe bashkëveprimet e anasjellta kulturore të popujve të tij. Kemi përmendur në pjesën e parë të kësaj parathënie se elemente të veçanta të këtij cikli si lodrat me shregulla, kultet e diellit, të tokës, të ndjelljes së shiut etj. janë dokumentuar në Ballkan që në periudhën parahelene. Elemente të tilla që dëshmojnë për një shtrat të lashtë të përbashkët kulturor gjen pothuajse në të gjitha festat e veçanta të këtij cikli — në Ditën e Verës, Llazoret, shën Gjergjin etj.

Këto festa tani e kanë humbur funksionin e tyre të dikurshëm, duke përfunduar në lodra, këngë e praktika zbavitëse të vegjëlish. Megjithëkëtë ato ruajnë materiale me shumë interes për të ndjekur shkallët e zhvillimit të kulturës popullore të këtyre popujve.

Cikli i verës Përfshin festat e shën Gjinit (24 qershor) dhe të shën Pjetrit (29 qershor). Si zakone karakteristike

të këtyre festave kanë qenë zjarret ku digjeshin kryesisht kashtërat dhe barërat e këqij dhe hiri i hidhej tokës si për plehërim ritual. Në zjarret digjeshin edhe rrogoze të vjetër, kashtëra etj. për «pastrimin e shtëpisë, thuhej, nga të ligat e dimrit». Fëmijtë thurnin kurora prej një lloj bari të quajtur «triko» dhe me të në krye qarkullonin nëpër fshat, duke kënduar këngë të këtyre festave. Këto këngë, në fazën e tyre fundit, kanë pasë mbetur në një numër të kufizuar dhe të varfëra në ide. Me që festat binin afër kohës së të korruravet flitej në to për prodhime të bollshme. Në disa krahina, gjatë këtyre festave, sidomos në shën Gjin, bëhej qethja e bagëtive. Zakonet e praktikat rituale, të ruajtura në krahina të ndryshme të vendit, tregonin se këto festa kanë qenë kryesisht me karakter bujqësor e blegtoral. Emrat e shejtërve të krishterë duhet të kenë zëvendësuar hyjni të lashta të popullit tonë. Sidoqoftë prania e tyre ka qenë e kushtëzuar nga dita më e gjatë e vitit (21 qershor) dhe nga praktika popullore magjike të lidhura me këtë rast.

Festa të rëndësishme kolektive të stinës së verës kanë qenë *festat e malit* që binin rreth 15 gushtit. Në këto festa zhvilloheshin ceremoni pelegrinazhi në majat më të larta të maleve që ndodheshin pranë: Luma ngjiteshin në Gjallicë, Hasi e Gjakova në Pashtrik, Mali i Zi i Dukagjinit në Runjë, Kraja e Ana e Malit në Rumije. Martaneshi në Liqenin e Zi, Kruja në Sarisalltek, krahinat rreth Tomorrit në Kulmak e në Majën e Çukës, Kurveleshi në Këndrevicë etj. Vizitorët duhet t'i gjenin rrezet e para të diellit në majat e këtyre maleve. Pavarësisht nga përkatësia fetare, atje bëheshin të njëjtat përkushtime dhe të njëjtat rite për nderimin e diellit, të njëjtat argëtime dhe të njëjtat kërkesa për përmbushjen e dëshirave të pelegrinëve. Në këtë kohë ndërmerreshin udhëtime edhe në drejtim të kundërt: ulje nga viset malore në brigjet e detit (p.sh. malsorët e Shpatit, të Çermenikës etj., shkonin në bregdetin e Durrësit, ata të Beratit në Seman, etj.) Praktikat rituale të zhvilluara me këtë rast kishin të bënin me rite të pjellorisë.

Cikli i vjeshtës. Edhe festat popullore të kësaj stine ishin të kufizuara. Ka mendime që 1 shtatori në disa krahina tona si në Rrëzë të Tepelenës, Kurvelesh, Shpat etj. ka qenë quajtur *kryeviti,* ditë e vitit të ri. Dhe kjo

ka qenë lidhur me punët bujqësore që kryheshin në vjeshtë për të lashtat.[1]

Festë e kësaj stine, e njohur gjerësisht nga populli ynë, ka qenë shën Mitri (26 tetor). Kjo festë ka shënuar në popull kryesisht një cak kalendarik — mbarimin e verës dhe fillimin e stinës së dimrit. Ashtu si festa e shën Gjergjit edhe shën Mitri ka qenë kremtuar mjaft nga arbëreshët e Italisë e të Greqisë. Të dy këto figura fetare — shën Gjergji e shën Mitri — janë quajtur prej tyre si mbrojtës të shqiptarëve në luftërat kundërosmane të shek. XV, të udhëhequra nga Skënderbeu. Prandaj këto festa janë kremtuar nga arbëreshët me një nderim të veçantë, duke u kënduar për to edhe këngë me frymë patriotike. Nga ky shkak, për faktin e shfrytëzimit të tyre në dobi të ruajtjes së identitetit etnik të arbëreshëve gjatë kohëve, disa fragmente të këtyre këngëve, sado me origjinë librore, janë përfshirë edhe në këtë vëllim.

Cikli i dimrit. Festat më të rëndësishme të kësaj stine që kanë qenë kremtuar me ceremoni rituale në popullin tonë kanë qenë *Kolendrat* dhe *Buzmi*. Të dyja këto festa janë me prejardhje të lashtë dhe lidhen me përtritjen e fuqisë diellore. me «kthimin e diellit për verë». Kolendrat janë kremtuar më 24 dhjetor pothuajse në gjithë vendin. Kristianizmi qe përpjekur ta bënte këtë festë të vjetër pagane një festë të vetën, si ditë të lindjes së Krishtit (Krishtlindje). Ndonëse ka qenë kremtuar kryesisht nga popullsia e besimit të krishterë, ajo nuk qe shlyer edhe nga ndërgjegja e popullsisë myslimane. Në Shkodër kjo festë kremtohej nga myslimanët me emrin «festa e *Kullanave*» ditën që binte bora e parë. Këngët e kolendrave (ashtu si edhe të kullanave) këndoheshin nga grupe të rinjsh që shkonin shtëpi më shtëpi, duke uruar si në festat e tjera për shtimin e familjes me «djem e nuse punëtore», për shëndet e mbarësi në prodhimet bujqësore e blegtorale etj. Zakonisht kolendarët, të vegjëlit që shkonin në grup, gostiteshin me dhurata të ndryshme sipas rastit — me kuleçë që bëheshin posaçërisht për atë festë, me fiq të thatë, arra. portokalla. kufeta etj. Kur nuk shiheshin shenja për gostitjen e kolendarëve këngët zgjateshin me vargje plot humor që vinin në lojë kopracinë e zonjës së shtëpisë.

1) Shih. M. Tirta. Pun. i përmen. f. 168, 169.

Në një kohë me kolendrat binte festa e *Buzmit*, që ka qenë kremtuar deri vonë nga krahina të ish besimit katolik të Veriut: Shala e Shoshi, Puka, Mirdita, Nikaj-Mërturi, Rrafshi i Dukagjinit (Kosovë) etj. Edhe *Buzmi* është një nga festat më të lashta dhe më origjinale të kremtimeve tona popullore. Në këtë festë kanë qenë ruajtur deri në prag të Çlirimit praktika të lashta rituale. Me seriozitet të veçantë përgatitej dhe sillej në vatër objekti simbolik i festës — *Buzmi*. Një djalë, me prindër që i jetonin, trokiste në portë dhe njoftonte me këngë: *Po vjen Buzmi bujar/ me gjeth e me bar,/ me edha, me shtjerra,/ mbas tyne vjen vera*. Kryefamiljari e priste dhe e vendoste me nderim *Buzmin* në vatër dhe e gostitëte, duke vënë në një skaj të tij, pak nga çdo gjë që kishte në sofër të festës: pije, gjellë, ëmbëlsira, pemë. Sofra lihej e shtruar dhe drita e ndezur gjithë natën, duke menduar se do të vinin shpirtërat e të parëve. Të gjitha këto dëshmonin për një trashëgim kulturor të hershëm. Aq i madh ishte nderimi i malsorvet për këtë festë sa emrin e saj e kishin futur deri në formulat e tyre të betimit: *Për natën e Buzmit! Pasha Buzmin nuk e kam bamë çate punë!* Në disa krahina të Veriut i vinin rrotull arave natën e *Buzmit*, duke shkrepur një dru të ndezur dhe duke përsëritur vargjet: *Gac' e karricë,/ gac' e shtërrinj* që donin të thonin «sa gaca (shkëndia) delnin nga shkrepja e drurëve, aq karrica (masë) bereqet apo shtjerra marrshim». Ka në to praktika rite që të çojnë në mënyrë të qartë në trashëgimin kulturor ilir. Të tilla kanë qenë p.sh. zakonet e disa fshatrave të Pukës e Mirditës që natën e *Buzmit* bënin nëpër ara rrathë me kashtëra të lashtash e kallamboqi të ndezura dhe uleshin në qendër të tyre për të ngrënë ushqimet rituale të festës. Ky rit të kujton një prej simboleve karakteristike të kulteve ilire — diellin — që përfytyrohej si një disk i zjarrtë. Në disa fshatra të tjerë brenda këtyre rrathëve shtohej edhe një kryqëzim i formuar po prej degësh të ndezura. Është me interes vështrimi i këtyre praktikave si ndikime të mëvonshme të krishterimit, por do t'ishte akoma më i madh interesi në se studimi i tyre do të çonte në gjurmë kulturash parakristiane si p.sh. te koncepti solar që kishte kryqi i thyer te ilirët. Interesa të tilla do të kishte edhe argumentimi i relikteve të tjera të këtyre festave si p.sh. animizimi i Buzmit, lënia e sofrës shtruar, e dritës

ndezur etj. që mund të shpjegohen si mbeturina të kulteve të manizmit të të parve tanë, të koncepteve sociale për nderimin e stërgjyshit të fisit, etj. Praktika pak a shumë të aferta janë vënë re edhe në popuj të tjerë. Në disa rajone të Hindisë p.sh. e kanë pasë zakon të hidhnin në zjarr diçka nga gatesat rituale të bukës së re për stërgjyshërit e fisit.[1] Te këto relikte mund të kemi elemente të konceptimeve magjike ndaj botës, që përjashtojnë ndërmjetësinë e perëndive midis njerëzve dhe natyrës, që shpjegojnë pozicionin konkret ndaj shpirtit të stërgjyshit si mbrojtës në jetën e përditshme të fisit, lidhjet e tij me rrethin familjar, me viset e shejtëruara në shtëpi, në fshat, në krahinë (Krs. konceptin e forcës mbrojtëse të orës për njerëzit, fisin malin etj.)

Këto shpjegojnë arsyen pse Olimpi shqiptar nuk ishte i populluar. Protoshqiptarët kishin kultet e hyjnive të tyre. Edhe ky fakt përbën një argument jo të parëndësishëm për të dëshmuar mbi prejardhjen gjenetike të popullit tonë nga ilirët. Grekët e romakët kishin krijuar një kult të gjerë dhe të ndryshëm hyjnish. Populli ynë vazhdoi të qëndrojë, në thellësi të shpirtit të tij, i lidhur me këto besime të të parve, edhe pse adaptoi kristianizmin e islamizmin, edhe kur këto doktrina monoteistike u përpoqën të fusin në brendi të jetës së popullit tonë, të festave popullore etj, konceptet e besimeve të tyre fetare.

Gjuhtarët tanë kanë shpjeguar se fjala *buzëm* është një fjalë autoktone e shqipes, e trashëguar nga fondi i lashtë indoevropjan.[2]

Mbeturina të riteve të Buzmit kanë jetuar në Jug-Himarë, Gjirokastër etj. si edhe te arbëreshët e Greqisë. Ky dimension diakronik dhe hapsinor nga njera anë, ruajtja e shtratit pagan në tjetrën, i japin kësaj feste një vend të veçantë në repertorin e festave tona popullore kalendarike.

III. Përveç këngëve të punës dhe të festave popullore, janë përfshirë në këtë vëllim edhe këngë e vargje për yshtjet — për të këputurit misht, kundër sëmundjeve, marrjes mësysh etj., për ndjelljen e shiut (Dordolecin, Ronën); për dukuritë e natyrës — diellin, hënën, retë —

1) James G. Frazer. Vepër e përmendur f. 139.
2) E. Çabej Studime gjuhësore, II. f. 86.

si edhe për kafshët, zogjtë, insektet etj. Këto krijime burojnë nga një shtrat botëkuptimor pak a shumë i përafërt. Si të tilla ato plotësojnë njera-tjetrën dhe qëndrojnë në një kuadër organik me materialet e tjera të vëllimit (këngët rituale të punës dhe të festave kalendarike). Poezia nuk mund të shkëputet nga përpjekjet që bën njeriu për të vepruar mbi forcat e natyrës nëpërmjet shprehjes poetike verbale, për të realizuar dëshirat e tij në mposhtjen e së keqes, largimin e sëmundjeve etj., qoftë edhe me forma të diktuara nga fantazia. Yshtjet, primet e praktikat me karakter magjik u kanë paraprirë formave të arsyes. Ato dëshmojnë për një epokë të caktuar të zhvillimit njerëzor. Këngët për natyrën dhe dukuritë e saj krijojnë një shtrat organik për këngët e punës e të festave popullore. Dielli, hëna, mjergulla, retë, shiu kanë qenë në qendër të vëmendjes së masave punonjëse, lidhur me veprimtaritë e tyre bujqësore e blegtorale. Ndërsa elementet e veçantë-zogjtë, kafshët, etj. i japin një gjallëri të posaçme kuadrit të përgjithshëm të këngëve, duke nxjerrë më mirë në pah origjinalitetin e peizazhit të Atdheut.

Duke u nisur nga kronologjia botëkuptimore dhe lidhjet e tyre të brendshme, këngët e këtij kapitulli (të yshtjeve etj.) janë vendosur *menjëherë* pas këngëve të kapitullit të parë.

Në kapitullin e tretë të këtij vëllimi janë paraqitur këngët për temat e ndryshme të punës, të grupuara këto sipas natyrës, funksionit dhe rolit që kanë lozur në jetën e përditshme të popullit tonë. Në ciklin e fundit janë përmbledhur këngët për punët e brendshme familjare të cilat në pjesën e tyre më të madhe, kryhen nga gratë.

Në kohën tonë, pothuajse gjithë festat, kalendarike me ritet e zakonet përkatëse, kanë humbur domethënien e tyre fetare — magjike dhe nuk janë ruajtur veçse si argëtime popullore dhe zakone për të qeshur.

Përsa i përket zgjedhjes e paraqitjes edhe të materialeve të këtij vëllimi janë hasur vështirësi të ndryshme.

Sikurse është përmendur edhe më lart, këngët rituale të punës, për shkak të distancimit kohor, kanë qenë mbledhur e botuar në një numër të kufizuar në përmbledhjet folklorike të periudhës para Luftës së dytë botërore. Shumica e këtyre këngëve, si brenda kufijve politikë të RPS të Shqipërisë, ashtu edhe jashtë tyre dhe në ngulimet arbëreshe janë regjistruar kryesisht pas kësaj Lufte. Kjo

ka bërë që këto këngë të sjellin në përmbajtjen e tyre edhe ndonjë element botëkuptimor të mëvonshëm që e cënon saktësinë autentike të materialit. Diçka më shumë janë botuar para Luftës vargje nga repertori i këngëve të festave popullore kalendarike të dukurive të natyrës etj.[1]

Edhe punimet studimore rreth problemeve të tyre, në krahasim me ato të gjinive dhe llojeve të tjera të folklorit tonë, kanë qënë të kufizuara dhe i përkasin kryesisht periudhës pas Luftës.[2]

Në paraqitjen e materialeve të kësaj përmbledhje jemi përpjekur që: 1. Këngët të mos shkëputen nga lidhjet e tyre organike me praktikat përkatëse ceremoniale. 2. Variantet të jenë me një shtrirje sa më të plotë në hapësirë dhe në kohë. Kështu teksteve të regjistruara brenda truallit kombëtar u janë vënë pranë, sa herë që ka qenë e mundur, edhe variantet e diasporës. Pa lënë mënjanë parimin e seleksionimit, janë përfshirë shpeshherë variantet që sjellin veçori konservative të periudhave të hershme, po edhe të tilla me risi (inovacione) të mëvonshme. 3. Së fundi është pasur kujdes që lënda e vëllimit të paraqitet me një sistem metodik ku këngët e ritet e festave të motmotit me ato të tematikës së mirëfilltë të punës të jenë me një vazhdimësi të natyrshme dhe një bashkërenditje logjike. Në një sistemim të tillë jemi nisur kryesisht nga materialet tona, duke mos lënë mënjanë edhe përvojën analogjike të vendeve të tjera. Kemi ndjekur, kështu parimin e grupimit të materialeve sipas tematikës dhe cikleve të festave të motmotit, duke filluar vitin nga stina e pranverës, si stina e parë e qerthullit kalendarik popullor dhe duke përfunduar me këngët e ritet e stinës së dimrit. Brenda çdo stine, janë dhënë vargjet e ritet për muajët, kohën, dukuritë e natyrës etj., pastaj janë renditur këngët për festat popullore dhe në fund këngët e

1) Materiale për këto të fundit (praktikat rituale dhe këngët e festave kalendarike) janë botuar në «Bletën shqiptare» 1878) të Th. Mitkos, «Valët e Detit» (1908) të S. Dines, «Visaret e Kombit» vëllimi III (1937), XIII (194), XV (1944) si dhe në botimet e arbëreshëve të Italisë — Dorsës (1847), Z. Krispit (1853), De Radës (1866), Kamardës (1866) etj.

2) Midis tyre vlejnë të përmenden punimet e trajtuara në dispencet e para të shkollave tona të larta: Dh. S. Shuteriqi 1949. Z. Sako në kapitullin e Folklorit të Historisë së Letërsisë shqipe. vëll. I. 1959. f. 15-30; Rr. Zojzi, R. Sokoli, M. Tirta, Sh. Pllana. Punime të përmendura.

mirëfillta për punët e ndryshme bujqësore, blegtorale etj. Gjerësia e materialeve ka lejuar në përgjithësi një klasifikim të rregullt sipas këtyre parimeve. Sidoqoftë duhet pohuar se është e vështirë të mënjanohen të gjitha mangësitë për t'i gjetur çdo kënge me saktësi të plotë vendin e duhur. Megjithëkëtë grupimi i këngëve sipas këtyre parimeve ka një sërë anësh të dobishme. Me të krijohet një tërësi harmonike me një tingëllim jetësor real. Natyra përbën burimin e jetës. Ndryshimet e saj të vazhdueshme gjatë stinëve jo vetëm që sigurojnë llojet e ndryshme të prodhimeve bujqësore, blegtorale etj., por edhe zgjojnë te njerëzit ndjenjën e vrojtimit e të admirimit; u japin atyre një burim frymëzimi estetik të pashtershëm. Rrjedhimisht materialet e vëllimit me një renditje të tillë bëhen më të kapshme dhe me një ndikim më të madh në rolin e tyre funksional historik dhe edukues.

Vëllimet e lirikës popullore do të përfaqësojnë një nga kapitujt më të qenësishëm e më spektakularë të trashëgimisë sonë folklorike, e cila ngrihet si një përmendore e gjallë e origjinalitetit të gjenisë artistike të popullit tonë, e vitalitetit të tij të rrallë, e pasqyrimit të qëndresës së tij shekullore dhe të paepur kundër pushtuesve të huaj, e vlerave të larta demokratike e artistike dhe e interesit të përgjithshëm të folklorit tonë për studimin e folklorit ballkanas. Kjo vepër e madhe, sintezë që paraqitet në kuadrin e «Trashëgimit kulturor të popullit shqiptar», u përgjigjet orientimeve të dhëna prej Partisë dhe udhëheqësit tonë shokut Enver Hoxha që në vitet e para të pushtetit popullor, për të zbuluar dhe vënë në dukje të faqeve më të bukura të kulturës sonë demokratike kombëtare. Ajo u bë e mundëshme vetëm në kushtet e krijuara në rrugën e socializmit.

QEMAL HAXHIHASANI

KËNGË RITUALE

1

IKU DIMRI ERDHI VERA

Iku dimri, erdhi vera,
erdh behari, çeli ferra,
borziloku e trëndafili,
mbani vesh ç'thotë birbili:
«Erdhi vera, çeli molla
me shëndet robat e holla!
Sa qënka gëzuar dardha,
qënka veshur në të bardha!
Pemët gjithë në burbuqe,
me shëndet rrobat e kuqe!
Kopet' me këmbor' e zile,
pylli veshur me jeshile».

Përmet, 1944

2

PO NA VJEN E BARDHA VERË

Po na vjen e bardha verë[1],
joho verë[2],
ti na ardhsh me t'mira shumë,
ti na ardhsh me djem shumë,
ti na ardhsh me nuse shumë,
ti na ardhsh me shtjerra shumë,
ti na ardhsh me dhen shumë!

Luzni — Dibër, 1937

1) Stina e pranverës; në kuptim më të ngushtë festa e Ditës së Verës që paralajmëron ardhjen e kësaj stine.
2) Varg karakteristik që shpreh harenë popullore për ardhjen e pranverës. Përsëritet si refren.

3

U SHKOQ NJEGLLA DRINIT

U shkoq njeglla Drinit[1],
shkuen mujt e dimnit;
hipi njeglla ferrës,
erdhën mujt e verës[2].

Luzni — Dibër, 1937

1) Këtu me kuptimin: «ra mjegulla Drinit»».

2) Këndohet nga të vegjëlit në pranverë kur fillojnë të bien mjegullat përmbi Drin, pas thyerjes së natës. Këto mjegulla, që qëndrojnë derisa shnëdrisin rrezet e para të diellit, paralajmërojnë ardhjen e pranverës.

4

NAN' Ç'KA DETI QI NDRIÇON

— Nan' ç'ka deti qi ndriçon?
— Tash at dielli e plaron[1],
moj bija jeme.
— Çka kopshti qi asht zbukuruc?
— Ket pranvera na e ka prue,
moj bija jeme.
— Pse dalldyshet ikin për hava?
— Tash të ftoft-o ma nuk ka,
moj vajzuka[2] jeme.
— Ç'jan' kto zogj, o mori nanë?
— Kto pranvera na i ka dhanë,
moj bija jeme.

Ulqin, 1976

1) Praron (me disimilimin e bashkëtingëllores r).
2) Vajzë + prapashtesa përkëdhelëse *uka*: vajzë e dashur.

5

LUM E LUM PO NA DEL VERA

Lum e lum po na del[1] vera,
mushen kodrat dhen e shtjerra;
dhen e shtjerra, djem beqarë,
kundra t'zeza, çarap' me larë[2].

Opojë — Prizren, 1976

1) Po vjen.
2) Këndohet natën e Verës.

6

CUCA MORI CUCA

Cuca, mori cuca,
trazoni zilifet,
mos t'na munin çiçet;[1]
grajhi,[2] cuca, hejret,
mos t'na munin shelnjet;
grajhi të lajm' façet
e t'çelim konaçet.

Shumbat — Dibër, 1956

1) Qytet.
2) Ngrihuni.

7

DELNI CUCA DELNI

Delni, cuca, delni,
se na erdhi vera,
na u mushën gjeshkët[1]
me dhen e me shqerra.
Delni, cuca, delni,
se na erdhi vera,
vin' nuset e reja
me rruza, me tela.

Sllatinë — Dibër, 1952

1) Bjeshkët.

8

TOP O MORE TOP

Top, o more top,
hare lalo oo[1],
jalla për gjat mot[2];
për gjat mot e jetë,
vllaznit ton' sinjet.
t'i martojm' të krejtë[3];
t'i martojm' për verë,
me lule me erë:
t'i martojm' për vjeshtë.
tre kollana nxheshë;
t'i martojm' për dimën,
t'u nxheshim martinën!*

Shumbat — Dibër, 1962

---

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) Urim: të jemi me shëndet të plotë gjatë gjithë vitit!
3) Tjetër urim: «për të martuar vëllezërit.»
*) Gjatë festave pranverore bëheshin shpeshherë edhe lidhjet e fejesave. Thuhet se në disa krahina ka qenë zakon, që vajzat, pasi luanin me djemtë tërë ditën, u hidhnin në qafë një shami simbolike. Kjo mbetej si shenjë e pëlqimit të tyre për fejesë.

9

QIQE QIQE E PARA QIQE

Qiqe, qiqe, e para qiqe,
pash mu, pash ty,
pash vllan', me njanin si,
sa vjet kam me rru,
qaq ke me m'diftu!
Në mos diftofsh, u qërrofsh![1]

Mat, 1960

1) E thoshin të vegjlit kur dëgjonin qyqen për herë të parë. Pastaj mbanin vesh, sa herë të bënte qyqja «ku», aq vjet mendonin se do të jetonin.

10

MIR' SE NA GJET

Mir' se na gjet
Vera sivjet!
Për shumë vjet!
O ti moj Verë,
o ho ho ho,
del të të sho,
sa e mira je,
si nuse e re!!

Barmash — Kolonjë, 1955

---

1) Një nga këngët karakteristike të Ditës së Verës. Kjo ditë që festohej më 1 mars sipas kalendarit të vjetër, ose më 14 mars sipas kalendarit të ri, mbahej si fillim i pranverës, si ditë kryeviti. Si e tillë ajo ka qenë festuar në të gjithë vendin dhe ishte një nga të kremtet popullore më të dashura e më të rëndësishme të motmotit. *Dita e Verës, Ditëverja* a *Verëza* duhej t'i gjente shtëpitë të lyera, njerëzit me rroba të reja. Që në mbrëmje shtëpitë zbukuroheshin me degë të gjelbra dhe me lule. Jashtë nëpër oborre e kopshtije ndizeshin zjarret karakteristikë — *dajlinat, dumetë* apo *kashtoret*. Kudo përgatiteshin për këtë ditë gatesa e ëmbëlsira të posaçme. Në Elbasan, p.sh., thereshin gjela deti, bëheshin revani e ballakume, ziheshin vezë e misra, bliheshin fiq të thatë, arra, gështenja etj. Këto ndaheshin në mbrëmje për çdo pjesëtar të familjes, duke përfshirë edhe ata që ndodheshin larg me punë, a ushtarë etj. Natën e Verës bëheshin *veroret, larsat* a *guduveret* me penj të bardhë e të kuq mëndafshi. Verorja e parë me një para metalike të

vjetër i lidhej tundësit «për t'u shtuar bulmeti». Njerëzit ngriheshin herët dhe shkonin të laheshin në krua për të lënë të ligat dhe për të marrë të mirat. Më shpejt ngrihej e zonja e shtëpisë, e cila mbushte ujë të ri në krua dhe spërkatte me të vendin e bagëtinë. Ajo u jepte të vegjëlve nga pak ëmbëlsirë dhe u fërkonte fytyrën me vezë duke u thënë: «Qofshi të ëmbël si ëmbëlsirat dhe të bardhë si veza». Po kështu dilnin në mëngjes nuset e reja dhe bënin urime: «qofsha e bardhë si veja, e kuqe si vera» etj. Në disa krahina si në Pogradec, Korçë etj. fëmijët kur ktheheshin nga kroi, sillnin disa kleçka dhe me to imitonin zogjtë *ciu, ciu* (për shtimin e tyre). Zakone të ndryshme bëheshin për shëndet, bollëk, mbarësi në njerëzit, në prodhimet e vitit, në bagëti. Për këtë qëllim vinin edhe të rinj «këmbëmbarë» që gostiteshin me ëmbëlsirat e ditës. Zakon i përgjithshëm ka qenë dalja e të rinjve, nuseve e burrave po edhe e të moshuarve shëtitje dhe kalimi i tërë ditës me lodra, këngë e valle. Kjo festë në disa krahina quhej edhe dita e ndjesave, e faljes së zënieve. Siç thotë populli në këtë ditë, «i therë, i grirë të ishje» do t'i flisje tjetrit, do ta përqafoje dhe do ta urojë: «Nga mot gëzuar!»

Festa e Ditës së Verës është nga festat popullore më të përgjithshme, më të lashta dhe më origjinalet ku ndikimi i feve monoteiste ka qenë pothuajse fare i pandjeshëm.

11

ORE ZOGJ I FERRËS

Ore zogj[1] i ferrës,
na erdh Dit' e Verës.
Dita e Verës erdh e shkoi,
lumi aj si e përxhoi![2]

Bicaj — Kukës, 1959
Bob. 189/11

---

1) Zog (g > gj).
2) E këndojnë të vegjlit kur shkojnë të lidhin moknat.

(Transkriptimi muzikor nr. 1)

12

DILNI NUSE ME GËRSHETA

Dilni, nuse me gërsheta,
po ju bina kukureka;
dilni. plaka. dilni, nuse
po ju bina lula t'kuqe.

Opojë — Prizren, 1976

1) Këndohet nga të rinjtë e të rejat në mbrëmjen e Verës, kur kthehen me lulet e para që kanë mbledhur rreth e rrotull. Me to zbukurohen dyert e oborrit, të shtëpisë së zjarrit e dhomave të tjera, të ahurit të bagëtive, hambarët, djepet, shtresat e fjetjes etj.

13

DAJLINAT E PRANVERËS

Dajlinat e pranverës
marrshi ethet e verës!!

Mat. 1960

---

1) Një nga praktikat rituale më të njohura në festat tona popullore të vitit ka qenë ndezja e zjarreve për purifikim e pjellori. Ato gjallëronin festat e Ditës së Verës, të shën Gjergjit, të shën Gjinit, Kolendrat, Buzimin e Vitin e Ri. Zjarret e Natës së Verës, *dalinat, daulinat* e *dajlinat* ndizeshin në oborre, kopshtije a bregore në mënyrë kolektive, — me lagje e fshatçe. Me këtë rast grupet ngacmonin njëri-tjetrin se kush do ta bënte zjarrin më të madh e duke kënduar këngë të posaçme humoristike (shih këngët që vijojnë). Zjarret bëheshin me dëllinja, kashtë e barëra të thatë. Njerëzit i kapërcenin duke thënë vargjet e mësipërme ose këndonin e vallzonin rreth tyre. Në disa krahina si në Mat, Dibër etj. shëtitnin edhe me ura të ndezura në duar ose me vravashka zjarri, të cilat i rrotullonin në ajër.

14

OR NN[1] I MARRU

Or NN[1] i marru,
zjarmi juj qenka shu,
qenka shu m'at dinjà,
humshi e mo dalshi ma,
Or NN e këqi,
marrshit klloqt e zi;
klloqt e zi e klloqt e bardhë,
truma-truma nëpër shkallë.[2]

Peladhi — Dibër, 1970
Bob. 767/11

1) Përmendej emri i lagjes ose fshatit me të cilin haheshin për zjarret e Ditës së Verës.
2) Rënshi, u rrukullisshi nga shkallët truma-truma.

15

KUQ-KUQ SI MOLLA

Kuq-kuq si molla,
gjom[1]-gjom si bari,
i fort'-i fort' si guri![2]

Bulqizë — Dibër, 1970

1) I njomë.
2) Vargjet përsëriteshin me zë të ulur 3 herë te kroi, kur shkonin për të mbushur «ujë të ri», në agimin e Ditës së Verës.

16

BONI PATA GA GA GA

Boni pata ga. ga. ga.
grajhi[1], ori nuse. ma;
boni xheli ki. ki. ki.
grajhi, mushni. uj të ri![2]

Cerem — Dibër, 1962

1) Ngrihuni
2) Thuhej në agimin e Ditës së Verës, kur do të shkonin për të mbushur «ujë të ri» a «ujë të pafolë» në krua.

17

BIE LODRA DUM DUM DUM

Bie lodra dum. dum. dum,
u lshofsha gjumt. or katun;
bie curla ti. ti. ti,
u lshofsha gjumt shpi për shpi![1]

Dragu – Dibër. 1970
Bob. 761/12

1) Në mëngjesin e Ditës së Verës, të rinjtë çoheshin herët dhe u binin lodrave duke thënë vargjet e mësipërme, për të zgjuar shokët e lagjes.

18

TOLI TOMOLI

Toli, tomoli,[1]
to gajtani, pelivani.
Shkoi Çela[2] nëpër ne,
as na jep një koqe ve.
Iu dhënt' zoti tre pënd' qe.
Tre pënd' qe, tre pënd' buaj,
aq para në një muaj.
Sa lesh mi tre desh,
aq bereqet të kesh.
Sa gjëma ka murrizi,
aqë xhunga t'ket' kurrizi!
Sa gjëma ka lajthata,
aqë xhunga të ket' vatra![3]

Lushnjë, 1964

1) Varg onomatopeik.
2) Figurë mitologjike sipas besimeve popullore sillte mbarësi.
3) Vargjet 10-14 thuheshin kur përcilleshin pa u gostitur nga e zonja e shtëpisë.

19

VERA VERA KOKOVERA

Vera, Vera. kokovera,
moj zonj' e uruar,
fle apo je zgjuar?
Hiqi, moj, llozë derës,
erdhi, moj. Dit' e Verës,
se na vijn' beqarë,
na vijn' duke qarë,
me një thes të grisur,
duke u rrukullisur.

Starje — Kolonjë, 1957
Bob. 189/11

(Transkriptimi muzikor nr. 2)

20

ERDHI DIT' E VERËS

Erdhi Dit' e Verës,
hiqi llozë derës!
Nxirna *cicën* e rakisë,
të urojm' të zon' e shpisë.
Sa lesh mi tre desh,
aq të mira të kesh!
Sa qime në tre kuaj,
aqë *aspra* në një muaj.[1]

Lashovë — Kolonjë, 1955

1) Një tregues i rëndësishëm për karakterin masiv të festës së «Ditës së Verës» është shtrirja hapësinore e këngëve dhe e praktikave rituale të saj. Në fondet e arkivuara të Institutit të Kulturës Popullore («Këngë të festave kalendarike» Vëll. III) për këtë festë janë mbledhur këngë të ndryshme në: *Berat; Dibër* — Arras, Bulqizë, Ceren, Dragun, Peladhi, Sllatinë, Steblevë, Shumbat, Vasije, Zerqan; *Elbasan; Gjirokastër* — Labovë; *Kolonjë* — Barmash, Lashovë, Qinam, Taç i Sipërm; *Korçë* — Arrzë, Boboshticë, Bradvicë, Dardhë, Sinicë; *Kukës* — Arrëz, Bicaj; *Librazhd; Lushnjë; Mat* — Lis; *Përmet* — Malëshovë, Sukë; *Pogradec* — Potkozhan; *Skrapar* — Çorovodë; *Tepelenë* — Dhëmblan, Turan, Vasjar; *Tiranë* — Shëmri, Shëngjergj; *Vlorë* — Poro, Qeparo.

21

MARSI-MARSI

a) Marsi, marsi,
drurët i mbarsi.

Jug, 1908

b) Marsi karsi,[1]
po drut' u dogjën.

Arbëreshët e Italisë, 1943

c) Marsi harsi,
zbrazet koshi,
qafëkokoshi,
çqepet gardhi,
digjet druri,
digjet zemërkauri.

Jug, 1908

1) Iku, shkoi.

22

DOLLI MARSI HYRI PRILLI

a) Dolli marsi, hyri prilli,
me ferman këndon bilbili!

Jug. 1908

b) Prilli bën lulet,
e maji ka hijenë.[1]

Arbëreshët e Italisë, 1943

c) Marsi, drurët i mbarsi;
prilli mbush çeturët,
maji dejon grurët.

Kuç — Vlorë, 1952

1) Bukurinë, nderin.

23

PRILLI IM VËLLA

Prilli, im vëlla,
m'jep tri dit' hua,
ta thaj plakën me gjithçka[1].

Elbasan, 1949

1) Në tri ditët e para të prillit, sipas kalendarit të vjetër kur bën ftohtë zakonisht populli thotë: «janë plakat». Kjo lidhet me legjendën që vijon: «Një plakë, si kaloi ditët e marsit, e shau atë dhe nisi të ngjitej në mal për të kullotur bagëtinë. Marsi i zemëruar, i kërkoi tri ditë hua prillit, që t'ia merrte hakun plakës, por ky nuk ia dha. Atëherë iu drejtua shkurtit, i cili ia plotësoi dëshirën (dhe ky «prandaj ka mbetur i shkurtër»). Bëri kaq ftohët ato tri ditë sa u ngri plaka majë malit e u bë gur me gjithë dhentë. Shpesh lokalizohet edhe mali ku thuhet se ka ndodhur ngjarja: Cukal-Shkodër, Gjalicë-Kukës, Rumie-Krajë, Mariash-Pejë, Lenije-Gramsh, Gramoz-Kolonjë, Këndrevicë-Tepelenë etj. Legjenda është e njohur edhe në popujt e bregdetit lindor e jugor të Mesdheut.

24

KUR KA DAL' PLAKA NË BJESHKË

Kur ka dal' plaka në bjeshkë,
ajo marsit i esht ludhnue:[1]
— Tërt kallnuer, se dola n'fruer!
Tërli-vërli, Marul-o,
pshtova desht' stjepët-o![2]
Marsi, karsi esht idhnue;
ka than': — O prill, vëlla,
a m'i nep tri dit' huva,
ta mys plakën me gjith ç'ka?
Menjer' prilli çoi fërtunin,
myti plakën e katunin.
Ater' marsi fort u gzu,
se u gri[3], plaka e u ba dru;
tuj hjek' ed e tuj hjek' u,
me[4] malit iu desh me maru.

Ljare — Shestan, 1958

---

1) I është lëvduar.
2) Gjeptë.
3) U ngri, ngriu.
4) Majë, sipër, mbi.
Vargëzimi i legjendës për tri ditët e ftohta të prillit (Shih shënimin e këngës së mëparshme).

25 .

IKËNI GJARPËNJ IKËNI SHTËRPËNJ

Ikëni, gjarpënj, ikëni, shtërpënj,
se vjen i Vangjelizmoi,
pa ju vret, pa ju pret,
me kordh' edhe me dyfek[1].

Jug. 1878

---

1) Më 25 mars (sipas kalendarit të ri) festohej nga ortodoksët Vangjelizmoi, nga katolikët Dita e Zojës dhe nga myslimanët Nevruzi. Në mbrëmje bëheshin zjarre me dëllinja. Të vegjlit duke tundur këmborët rreth shtëpive, oborreve, arave thoshin vargjet e mësipërme, për të trembur minjtë, gjarpërinjtë etj. Në disa krahina si në Skrapar, atë ditë fshatarët nuk punonin dhe thoshin se «është toka lehonë». Myslimanët bënin byrekë me 12 lloj lakrash, ku fshihnin një para metalike për fat. Është e vetmja festë popullore e vitit që ka pësuar ndikim islamik. Me 25 marsin janë lidhur edhe ritet e përtëritjes së pashkëve kristiane e hebraike. Me gjithë këto ndikime kristiane e islamike, në origjinë qëndrojnë rite e besime të lashta, që kanë të bëjnë me ekuinoksin e pranverës dhe me ringjalljen e natyrës. Siç shihet, edhe kënga, me përjashtim të emrit, e ka ruajtur të pastër shtratin e saj pagan.

26

IKNI GJËRPINJ IKNI SHTRËPINJ

Ikni, gjërpinj, ikni, shtrëpinj,
ikni, shtëza, dhe ju, minj,
se vjen marsi, ju përpin;
harrin dhe Vangjelizmoj,
t'ju presë e t'ju shkurtojë;
pa t'ju hedhë në përrua,
t'ju hajë qen e langua!

Jug. 1908

27

IKËNI GJILPINJ

Ikëni gjilpinj,
ikëni shapinj,
se erdhi Vangjelizmoi,
t'u presë e t'u shkurtoi!
Pa u djeg e u bën hi,
dhe u hedh në det të zi!!

Mursi — Sarandë, 1970

1) Këndohej nga fëmijët Ditën e Verës kur endeshin poshtë e lart duke tundur zile e këmborë.

28

IKNI MI IKNI ZHAPI

Ikni, mi, ikni, zhapi,
se ësh' e vjen marsi,
me gjith' ato hajdhi.
Mit' e zhapit, e gjitonisë,
u mbjodhëshin gjith' te kjo shpi.[1]

Arbëreshët e Italisë
Shën Benedikt Ullano, 1964

1) Kjo këngë arbëreshe flet për zakone e praktika rituale të përbashkëta me ato të mëmëdheut. Në të nuk përmendet emri i Vangjelizmoit. Nga ky fakt mund të thuhet se ky ndikim i krishterimit i përket një periudhe më të vonë se mërgimi i tyre.

Një variant i kësaj kënge është edhe ajo e mbledhur në Poro të Vlorës (AIK. P. Gjidede fl. 51, f. 68 — 1960): «Ikni mi,/ se vjen zoti shën Themi».

Në këtë ditë merrnin një hozhek (hell) dhe me të shponin qoshet e shtëpisë, gjerdhet etj. Këtë dru pastaj e hidhnin në kopshtin e ndonjë gjitoni ose në lumë «që minjtë të shkonin tek ata ose të mbyteshin në lumë».

29

IKNI GJËRPINJ IKNI SHTËRPINJ

Ikni, gjërpinj, ikni, shtërpinj
se po vjen Vangjelizmoi,
pa ju pret, pa ju vret,
po me kordh' e me dyfek,
pa ju hedh në përrua,
t'ju hajë qen' e langua!

Postenan — Kolonjë, 1955

Krs. Rehovë-Kolonjë, bob. 155/34; Dardhë-Korçë, 1962; Buhal-Përmet, 1957; Badlonjë-Përmet, 1964 bob. 321/10, Malëshovë-Përmet, 1957.

30

PO BJE DIELLI KIKA M'KIKA

Po bje dielli kika m'kika,
çohni, cuca, se duel drita.
Po bje dielli përmoj shpi,
hajdi, cuca, për uj' t'ri[1].

Bushat — Kukës, 1982

1) Ditën e Nevruzit fëmijët ngriheshin pa aguar e shkonin në përrenj a në burime për të mbushur «ujë të ri».

31

JENE PO KNON ZOGJI MORE N'LAPA T'FERRËS

Jene, po knon zogji, more, n'lapa t'ferrës,
po bajmë shalihor, more, Ditën e Verës.
Jene, po knon zogji, more, n'lapa t'rrushit,
po bajmë shalihor, more, Ditën e Novruzit.[1]

Përbreg — Kukës, 1982

1) Kënga këndohej kur fëmijët ngrinin shilarëset.

32

O PËLLUMTH O PËLLUMTH-O

— O pëllumth. o pëllumth-o,
mos më pe Llazuarë?[1]
— Këtu drejt ka shkuarë.
ndë derë të zotitë.
Ay zot se qysh punon?
Kill'e aspër numuron.
Darovit Llazuarë,
ashtu dalç gëzuarë,
me djathë ndë napëzë,
me nuse për qafëzë.
Sa lule ndë Tomor,
aqe nuse ndë hobor;
sa lule ndë qershi,
aqe djem ndëpër shtëpi!

Jug. 1878

1) Këndohej nga të vegjilit në Llazoret. Kjo festë është në thelb një festë pranverore me karakter pagan. (Krs. Vargun e parë: «O pëllumth, o pëllumth-o», urimet për bollëk, për shëndet, për djem e nuse sa «lule në Tomorr»). Krishterimi është përpjekur t'i japë, ngjyrat e veta fetare duke e lidhur me mrekullitë e «ringjalljes së

shën Llazërit». Si e tillë ajo festohet një javë para Pashkëve (te katolikët më 18 prill me kalendarin e ri, ndërsa te ortodoksët më 25 prill). Me gjithë ndikimet fetare, populli ruajti zakonet e praktikat e vjetra. Në darkën e festës, të vegjlit me shporta të zbukuruara shkonin duke kënduar nëpër fshat. E zonja e shtëpisë dilte e i gostitte me vezë, para etj. Në disa krahina si në Korçë, në disa vise të Shqipërisë së Mesme etj., veç fëmijëve, shkonin për Llazore edhe gra nga shtresa e varfër, duke mbajtur në duar një kukull prej lecke «nuskë». Prej këtej ka mbetur shprehja «kanë ardhur Llazoret» me kuptimin «ka ardhur pranvera».

Zakonet e festës kanë shumë elemente që vijnë nga një shtresë e hershme dhe që kanë paralelizma edhe në popuj të tjerë. Kuklla është quajtur si mbeturinë e kultit të Dionisit. Vezët paraqesin gjithashtu një zakon të lashtë të njohur edhe nga egjiptianët e vjetër, babilonasit, persianët. Me Llazoret janë të lidhura edhe praktikat e mbledhjes së luleve dhe të zbukurimit të banesave me to; (shih këngët që vijojnë).

33

LLAZËRI LLAZUARË

Llazëri, Llazuarë!
Mos patë Llazuarë?
Aty dreq ka shkuarë,
të farkonjë shpatënë,
shpatënë të zotitë.
Andaj erdhëmë dhe ne,
të na japsh një koqeve.
Ashtu paç tri pëndë qe.
Sa qepra edhe dërrasa,
aqë nuse, aqë vasha.
Sa lesh më treqint desh,
aqë bereqet të kesh,
Sa lesh më treqint buaj,
aqë para ndë një muaj!

Jug. 1908

34

ERDHI LAZËRI MBË DERË

Erdhi Lazëri mbë derë,
bjeri pulësë të pjellë,
jepni Lazërit një ve,
se u err e do të ve.
Do të vejë ndë More
janë turqit e krishte[1],
hanë gjalp e monove.
Ng' atje para vjen andara,
shën Mëria tye klara,
tye klar' e tye thirrë,
se i vranë monobirrë.[2]
Mbëlethni lule, lule malit,
të ia vëmë torrë varit.

Arbëreshët e Greqisë, *1878*

---

1) Th. Mitko e sjell këtë motërzim nga arbëreshët e Greqisë. Këngë të tilla kanë mbledhur në këto ngulime edhe vetë autorët arbëreshë (J. Gjika, V. Lapis, M. Dhedhe). Ato ndeshen edhe te arbëreshët e Italisë, sikurse kuptohet nga këngët që vijojnë. Të gjitha këto dëshmojnë për njësinë e traditave etnokulturore të popullit tonë para pushtimit osman.

2) Djalin e vetëm.

35

O MIRË MBRËMA

O mirë mbrëma!
O mir, menatë!
Erdha t'ju thoshia
një fjalë t'mirë.
Një punë t'madhe
bë perëndia,
përpara gjithëve
te Betania...
O Lazër, Lazër,
eja t'rrëfyesh,
si u farmëkose
te dheu i zi!
Lazëri u ngre,
nga varri krisi,
u fal tyn zoti
e jerdh e nisi,
O zot, o zot,
farmëk i math
isht' ajo botë![1]

Arbëreshët e Italisë
Piana, 1923

1) Nga botuesi i mëparshëm kjo këngë është paraqitur si shumë e lashtë, e njohur në gjithë ngulimet arbëreshe të Siqelisë. Për ruaj-

tjen e këtyre praktikave të arbëreshët dëshmojnë edhe autorë të tjerë. Zef Kripsi në veprën e tij «Memorie storiche» flet për zakonin e veshjes së një të riu që u prin të tjerëve me rroba të bardha dhe për vajtjen derë më derë duke kënduar me zë të përmallshëm një këngë që tregon mrekullinë e ringjalljes së Llazrit». F. Falsone në «I canti ecclesiastici greco-Siculi» — Padovë 1936 sjell si strofë të fundit të një këngë të tillë vargjet: *O ku(sh) t'na gjegjij,/ paçit hare;/ ejani, sillni,/ bjerni ato ve.* Sikurse shihet, në përmbajtje të këngës së mësipërme, qëndron legjenda fetare e ringjalljes së Llazërit.

36

MBLIDHI MOJ ÇUPA MBLIDHI

Mblidhi, moj çupa, mblidhi,
të vemë,
të vemë për manushaqe;
t'ia vëmë Lla-,
t'ia vem' Llazorit në faqe.
Dy në fa-
dy në faqe, një në ballë.
Vanë,
vanë, moj lule, vanë,
s'ëmësë,
s'ëmësë, moj, i thanë:
«hëngri,
hëngri, lule, hëngri,
gjarpri të-
gjarpri tët, moj, bijë.»
— O, n' e hëngri, u shëroftë,
trimi, moj,
trimi, moj, u trashëgoftë!

Potkozhan — Pogradec, 1957

37

LLAZËRI SHËN LLAZËRI

Llazëri. shën Llazëri,
foli dhi-or-dhisë,[1]
të zonjës shtëpisë,
të na dal në shkallë,
seç i ka një fjalë,[2]
të na nxjeri venë,
se s'ia kemi ngenë,
do vemi dhe në të tjerë.
Ti, moj. që s'na dhe venë,
të bëftë bufi folenë!

Brezhdan — Përmet, 1957
Bob. 164/2

1) Në disa variante: Foli dhria dhrisë.
2) Kupto: «Llazëri».

(Transkriptimi muzikor nr. 3)

38

PLAKË PLAKË VENË

Plakë, plakë, venë,
se s'ta kemi ngenë,
ngenë e llazorëve,
trima kanakarëve.
Ti që na dhe venë,
zoti iu dhëntë shëndenë.
Ti që s'na dhe venë,
kukua të bëft' folenë[1].

Karjan — Gjirokastër, 1962
Bob. 206/13

1) Me kuptimin: iu rrenoftë shtëpia, iu bëftë gërmadhë

(Transkriptimi muzikor nr. 4)

39

LLAZORE

Llazore,
u gjeçim gëzuar-o,
djem' çupa martuar-o!
Sa lule në qershi,
djem e nuse në shtëpi!
Sa lule në Tomor,
djem e nuse në obor!
Llazorja s'ësht' përditë,
por është një er' në vit.

Hoçisht — Korçë, 1962
Bob. 206/2

10

LLAZORE LLAZORE-JE

Llazore, llazore-je,
falu, more, falu-je,
fale zotn-e shtëpisë-e,
qi na bani nderën-e,
ndera gjeti verën-e![1]
Ti moj nuse, duerkuqe,
ty të lumshin durët-e,
dil përcill llazoret-e,
llazoret e motit-e!
Sa furka n'at kasolle,
aqi nuse punëtore,
sa lesh m'ato desh,
aqi bereqet të kesh!
Dil, moj Xhike, qofsh e bardhë,
dil përcill llazoret-e,
se s'na jen me nejtun-e,
se do shkojm' gjetiu-je!
Llazoret ke mani,
dil, o nuse, t'rroft' Hasani;[2]

---

1) Ndonëse të besimit mysliman, fshatra të ndryshme të rrethit të Tiranës, të Kavajës e të Durrësit i festonin llazoret njësoj si fshatrat e besimit të krishter.

2) Shpesh improvizoheshin vargje sipas rastit për njerëzit e shtëpive ku kalonin.

Llazoret ke gardhi,
dil, o nuse, t'rroft' Hajdari!
Sa gjeth m'ate kumbull,
nesër gdhifshi gjith' garrumbull,
sa gjeth m'ate fik,
nesër gdhifshi gjith' calik![1]

Prezë — Tiranë, 1944

1) Vargjet e fundit thuheshin në shtëpitë dorështrënguara, që nuk i gostitnin.

41

O LLAZORE LLAZORISKA

O Llazore. llazoriska,
koqeven' qi ban lariska.
Meskopalla xifkate
dhe limoni shpatat-e,
shpatat e të zotit-e.
Ej zot e jarabi,
jepi zot-o ksaj shtëpi
me samune dhe qahi,
me livere lahuri.
Hej. zot i ktij konaku,
na qit gja se na ra barku.
Në ma dhanç nji kokërr ve,
çuni t'marrt' nji nuse t're.
Në m'i dhanç nja dy-tre teka,
efendi-o tunjatjeta.
Në m'i dhanç nji dor' me gjema,
çuni juj ju xant kalema.
Në ma dhanç nji kokërr palë,
zoti ju ju dhant' nji djalë.
Oj halle. oj pallë,
koqeven' e pulës bardhë.
Oj teze. oj reze,
koqeven' e pulës zezë.
Jan' llazoret mun ke porta,
na qit gja, se na zu nata.

Jan' llazoret mu ke dera,
na qit gja, se erdhi vera.
Jan' llazoret mu ke praku,
o efendi t'u shoft' oxhaku.
Hu sot e hu mot,
qesja jote metët plot.

Kavajë — Durrës, 1957

42

LLAZORE LLAZORE

Llazore, llazore,
fali zotit, fali-e,
qi na bani nerën-e,
nerën e ksaj verës-e.
Oj halle, oj topalle,
koqeven-e pulës bardh-e.
Oj teze, oj reze,
koqeven-e pulës zez-e.
Fusha nëpër fushat,
m'u grisën brekushat;
ferra nëpër ferrat,
m'u grisën opengat.

Shijak — Durrës, 1957

43

LLAZORET KE DERA

Llazoret ke dera,
dil se po vjen vera.
Llazore, llazoriska,
due ven' qi t'ban lariska.
Po s'ma dhe,
ka qori,
të shkoft' plori;
ka carani,
t'shkoft' Shegani!

Shëngjergj — Tiranë, 1949

44

OZI E BOZI

Ozi e bozi,
erdhi martallozi.
Pepe, peksime.
pa na nxir dy koqe ve,
ashtu dalçi mot me ne;
mot me ne gëzuarë,
djemtë të martuarë,
Sa lule ka qershia.
aqë djem pastë shtëpia,
sa lule ka ajo thanë.
aqë çoban' e stopanë;
sa qepra në çati,
aqë nuse në shtëpi.
sa qepra në kashtore,
aqë nuse punëtore![1]

Sevran — Skrapar, 1955

1) Nga materialet që ndodhen në Arkivin e IKP («Këngë të festave kalendarike» Vëll. III) këngë për festën e Ilazoreve janë mbledhur në këto rrethe: *Berat* — Moravë; *Durrës* — Kavajë, Shijak, Shinavlash, Xikular; *Elbasan* — Fikas; *Fier* — Seman, Sheqi Madh; *Gjirokastër* — Labovë, Peshkëpi; *Kolonjë* — Gostivisht, Leskovik, Podë, Postenan, Shtikë; *Korçë* — Bradvicë, Dardhë, Hoçisht, Poloskë; *Lushnjë* — Divjakë, Krutje e Sipërme; *Mat* — Germenj; *Përmet* — Këlcyrë; *Pogradec* — Pleshisht, Potkozhan, Sllatinjë; *Sarandë* — Mursi, Xarë; *Tiranë* — Ahmetoq, Gjeç, Fushë, Kashar, Marikaj, Mner, Mënik, Ndroq, Pezë, Prezë, Skuter, Vaqar, Vorë; *Vlorë* — Ilias — Vuno, Mifol, Poro — Myzeqe, Qeparo, Velçë; *arbëreshët e Greqisë.*

45

TI MOJ NUSE E RE

Ti, moj nuse e re,
jepi Lazarit një ve,
pse ka dhrom[1] e do të ve [jë]
ade[2] batanë.[3]
të skalisinjë[4] bozdanë,[5]
t'e skalisnjë me grep[6] t'ergjëndë,
t'e potisnjë[7] me ver' t'emblë.
Erdha Lazari për ve,
ngru, ti nusezë e re,
të qëndismë nga një ve,
t'e tregojmë[8] ndë More,
çë jan' tërë të kështe,[9]
hanë gjalpë edhe ve.[10]

Arbëreshët e Greqisë
Mesogji — Atikë, 1978

---

1) Rrugë.
2) Andej.
3) Matanë.
4) Mih.
5 Kopshtin.
6) Me shatë.
7) Ujis.
8) Dërgoj.
9) Ky varg në disa variante dëgjohet: çë jan' turqë të kështe».
10) Këndohet nga të vegjlit që shkojnë për urim shtëpi më shtëpi në fshat ditën e llazoreve.

46

FOLI DHRIA DHRISË

Foli dhria dhrisë.[1]
foli zotit të shtëpisë,
të na japi venë.
pse s'ia kemi ngenë.
Çë skalis me çë skalis,
me grep t'ergjend' e skalis,
me uj' e embl' e potis.

*
* *

Çarë shtëpi ishtë kjo,
e mbushur e bukur,
edhe ambarëtë plot janë,
edhe si lum kush rri brenda.[2]

*
* *

Aj, moj zonjë e shtëpisë,
sellë qelqetë e rakisë.

1) I foli hardhia vreshtit.
2) Grupi i fëmijëve shpreh lëvdata për shtëpinë, zonjën e shtëpisë, djemtë, vajzat, kryefamiljarin.

Edhe sa lesh kanë tre deshë,
kaq të miratë të i keshë.[1]

Arbëreshët e Greqisë
Vilë — Atikë, 1978

1) Urimi në fusd të këngës, i njëjtë me atë të klngëve të mëmëdheut.

47

NANI DË TË LIDHURA

Nani,[1] dë të Lidhura[2],
ishtë puna sigura[3].
Ande la nga pilura[4]
vinjënë të Lidhura.
Ndë të Lidhura, ndë Pashkë,
do kërcejmë tërë bashkë.
Ndë të Lidhura, ndë Pashkë,
si të bënei të lidhimë bashkë[5].

Arbëreshët e Greqisë
Perahora — Korinth, 1978

---

1) Tani.
2) Në të Lidhurat, në Kreshmët.
3) Është puna (fejesa) e sigurt.
4) Andej lart nga errësirat (humbëtirat).
5) Si të bëhej që t'i festonin së bashku.

Te arbëreshët e Greqisë të Lidhurat (Kreshmët) përbënin rastin më të volitshëm për argëtim dhe vallëzim të përgjithshëm. Atmosfera e gëzueshme që krijohej, mbulimi i fytyrës me maska, derdhja e njerëzve nëpër rrugë e sheshe etj, ndikonin shpesh në marrjen e vendimeve për martesë. Aq të përhapura ishin në këto festa këngët e vallet sa ato quheshin edhe «java e ballëlës» (java e vallëzimit). Këngët që këndoheshin kishin zakonisht karakter të gëzueshëm dhe humoristik.

48

VELIKOJA ZBRISTE MALIT

Velikoja zbriste malit,
tuke dredhurë fill arit;
po dreth ar e po punon,
kësul' ndreq edhe ndërton.
Velikoja xbriste malit,
tuke dredhurë fill arit;
po dreth, po qëndis me dorë,
i bën rreth, i bën kurorë.
Velikoja ndëpër mal,
tuke dredhur mëndafsh all;
ndëpër mal e ndëpër çukë,
i ndërton, i bën këpucë.[1]

Jug, 1878

1) Tjetër këngë rituale që këndohej «*Ditën e luleve*»

49

LULETË U BURBUQASNË

Luletë u burbuqasnë,[1]
katakajmene Stefanë,[2]
luletë u burbuqasnë,
shokëtë u ravonjasnë,[3]
Luletë u mbluanë,[4]
shokëtë u martuanë.[5]

Arbëreshët e Greqisë
Perahora — Korinth, 1978

---

1) Nxorën burbuqe.
2) Shumë i mjeri Stefan.
3) Shokët u fejuan.
4) Lulet u çelën.
5) Është një prej këngëve karakteristike që arbëreshët e Greqisë këndojnë për Pashkë. Në atmosferën e këtyre festave pranverore, me natyrën e lulëzuar, me shtëpitë e oborret e zbardhura, me aromën e pishave, vajzat venë inat me njëra tjetrën se cila do të ketë vjollcat më të bukura në kopshtin e saj. Është festa kur do të vishen me teshat më të bukura dhe do të takohen me djemtë në sheshe e në kishë. Por është edhe festa e premtimeve për martesë si edhe e krekosjes së të fejuarve ose të sapomartuarve në vallet e përgjithshme të fshatit. Një atmosferë e tillë, kujdesi për lulet etj., të kujton karakterin pagan të kësaj feste, që spikat edhe në krahina të tjera të Shqipërisë (Shpat, Mokër, Kolonjë etj.).

50

NIKULICA DHE GRAMOSI

Nikulica dhe Gramosi[1],
ndë mest na rënëke Ristosi[2].
Qënëke trimi edhe vasha.
S'ëmësë van' e i thanë:
— Të zu gjarpëri tët bijë.
— Nd' e zu gjarpri, u shëroftë.
nd' e zu trimi, u trashëgoftë!

Jug, 1878

1) Male të Korçës dhe të Kolonjës.
2) Element fetar i gërshetuar pa shtjellim. Motivi bazë i këngës qëndron në vargjet që vijojnë 3-7, motiv ky edhe i disa këngëve karakteristike arbëreshe.

51

O RISTO STANESTI

O Risto stanesti,
Ristozi bëke një kishë.
N'atë kish' ç'paske brenda, o lele!
Qenka trimi edhe vasha.
Vasha na qëndiste,
trimi zografiste.
Vanë s'ëmës i thanë:
— Hëngri gjarpri tëtë bijë.
— N'e zu gjarpri, u shëroftë.
n'e zu trimi, u trashëgoftë.

Pogradec, 1944

1) Ky motiv që ndeshet edhe në këngët e mëparshme, lartëson vazhdimësinë e jetës. Me gjithë elementet fetare të mpleksura në fillim të këngës, subjekti i saj në përgjithësi përputhet me përtëritjen e natyrës, që përbën motivin bazë të festave pranverore.

52

GJEGJNI VASHAZ SOMENATË

Gjegjni, vashaz, somenatë,[1]
ju mos rrini më mbë shtrat,
diellja e Pashkvet na u di,[2]
ju mos rrini më ndë shpi.
Kush e tuar e kush shtuall,[3]
kush e ka nd'at argali,[4]
le t'hinjë mbrënda ndë se duall
e u mbëlliftë mbrënda ndë shpi!
Le t'rrirë pështjelë me një llunxuall,[5]
kush e ka nd' ata mitarë![6]
Ndë se prana hëngër derkun
e ni, më nëng ka çë t'harë,
le t'zërë [këmbët] bashk' me xerkun![7]

Arbëreshët e Italisë
Frasnitë — Kozencë, 1894

1) Dëgjoni, vajza, këtë mëngjes.
2) U gdhi.
3) Kush e ka endur e kush e ka mbledhur.
4) Avlëmënd, tezgjah.
5) Çarçaf, (nga it. lenzuolo.)
6) Çarçaf dysheku.
7) Këndohej nga vajzat arbëreshe për të ftuar shoqet në festë, kur gdhihej e diela e Pashkëve.

Pashkët ashtu si edhe festat e tjera te arbereshet e Italisë, dallohen nga praktikat fetare të ritit të veçante ortodoks dhe elementet me karakter patriotik të përmbajtjes së tyre. Dora d'Istria ka nënvizuar: «Tri ditët e Pashkeve te arbereshet e Italisë, u kushtohen veçanërisht valleve dhe këngëve popullore kombëtare. Për këta të mërguar fatkeqë ngadhnjimi i jetës mbi vdekjen njejtësohej me fitoret e Skënderbeut mbi gjysmëhënën në ditët e Pashkëve.» «E. Xhordano në «Falklore albanese in Italia» — 1957, i paraqit këto zakone, sipas një dorëshkrimi të B. Bilotës (Zakonet e Frasnitës — 1894) si vijon: Ditëve të Pashkëve arbëreshët këndojnë këngë që lartësojnë fitoret e Skënderbeut dhe virtytet e shqiptarëvet (besën, guximin, trimërinë). Gratë dhe vajzat, të veshura me rrobat e tyre më të bukura, ftojnë njëra tjetren, me këngën që jepet më lart, për të marrë pjesë në festë. Formohen kështu vargje valltaresh që shkojnë duke vallëzuar nëpër rrugët e fshatit. Gazi dhe hareja shkëlqejnë në fytyrat e tyre. Në këtë kohë hyn një grup trimash hipur mbi kuaj, të quajtur «pjelzit» (pleqtë). Pas tyre vijnë një grup të rinjsh, të veshur edhe këta me kostumet tradicionale. Me flamurët përpara ata përkujtojnë hyrjen ngadhnjimtare të Skënderbeut në Krujë. Në të njëjtin shesh arrin pastaj një grup i tretë kalorësish që sjell me vete njerez të lidhur e të rreckosur që simbolizojnë ushtarë osmanë të zënë rob. Këto skena gjallërohen me dialogë solemn për fitoret e shqiptarëve. Edhe të hënën vazhdojnë të njëjtat zakone. Ditën e martë, festimet arrijnë kulmin. Në këtë ditë, që quhet «e marta e lëtinjet», një grup të rinjsh rendnin e u vinin në fytyrë, të gjithë atyre që nuk ishin arbëreshë, me gisht një shenjë të zezë. Autori i përmendur shkruan se simbolika e kësaj ceremonie është vullneti i arbëreshëve për të afirmuar origjinën e tyre etnike. Vende vende si në Frasnite, Porcile dhe Çivita, këto zakone ruhen edhe sot.

53

NEVE KUSH NA BËRI NDERË

Neve kush na bëri nderë,
akuavit[1] na dha për verë?
Po si sot edhe ngaherë,
shpia tij mos pastë vrer.
Shoku in' mir' e shkoftë
e gjith' bilt ai martoftë!...
Rroft' ai sa buka e vera,
qoft' i ruajtur dh'aj si ndera!
Mbjoft' nga vit ai shpin' me verë,
me grur, val e hjiromer![2]
Me gjith' bilzit me shëndet.
rroft' e past sa dëshron vetë.
Këjo Pashk' i dhëft' një det
me të mira, sa t'jet jetë!...[3]

Arbëreshët e Italisë
Frasnitë — Kozencë, 1894

1) Raki (nga it. acquavite).
2) Dhjamë derri.
3) Këndohej në tryezën e festës nga miqtë e ftuar dhe nga vizitorët që vinin për urim.

54

EREMOJ

Eremoj[1],
balt' e shoj,
ruji bollat
e xhapitë
mo na i hanë
dhent e dhitë!
Eremoj, Eremoj,
xhith' e mojra
në shtëpojë[2].

Totesh — Strugë, 1976

1) Eremi (me kthimin e *i*-s së theksuar në *oj*. Kështu edhe më poshtë *shi-shoj*, e mira - *e mojra*, shtëpi - *shtëpojë*). Festa e Eremisë kremtohej në rrethinën e Strugës më 1 maj (sipas kalendarit të vjetër). Natën e kësaj feste fëmijët shkonin duke rrahur legena e kumborë nëpër ahure, anës gjerdheve etj., për të trembur bollat e gjarpërinjtë (si natën e Vangjelizmoit). Shëtitjet në natyrë dhe këngët e vallet e të rinjve e të rejave, burrave e grave të kujtojnë festën e Ditës së Verës që kremtohej në Gjirokastër pikërisht në 1 maj.

2) Në shtëpi.

55

HEREMOJ HEREMOJ

Heremoj, Heremoj
balt' e shoj,
balt e shoj.
Hikni, bolla,
e xharpij,
se t'u vrasim
me shkopij!
Hikni, bolla,
e xharpij,
se vojn' shpata
me tepsij!

Veleshtë — Strugë, 1976

1) Variantet e festës së Eremisë.

56

O SHËN GJERGJ I BARDHË

O shën Gjergj i bardhë,
njishti motmot m'gjeç me djalë![1]
O shën Gjergj i mushtullu,
njishti motmot m'gjeç martu!
Sa ky li,
të bahen flokt e mi![2]

Picallë — Tiranë, 1953

---

1) Kështu thoshin nuset.

2) Katër vargjet e fundit thuheshin nga vajzat.

Ditën e shën Gjergjit nuset e vajzat delnin që herët në mëngjes dhe rrokulliseshin nëpër livadhe duke thënë vargjet e mësipërme. Shën Gjergji festohej më 6 maj me zakone e ceremoni të bukura. Pleqtë e motit thoshin se kjo është festa që «shpëtojnë njerëzit e bagëtitë prej dimrit e bijnë në sene të re» (Mat). Shumë krahina si Luma, Mati, Dibra, Kruja etj. e quanin shën Gjergjin krye viti. Në këtë ditë lidheshin marrëveshjet për punë etj. që zgjatnin deri në shën Mitër.

Ashtu si në Ditën e Verës, natën e shën Gjergjit zbukuroheshin shtëpitë dhe sidomos kasollet e bagëtive, vathat, enët e bulmetit etj. me degë të gjelbra e me lule. Në disa vise të Jugut ndizeshin zjarre rituale. Të vegjlit përzinin gjarpërinjtë duke tundur kumborët. Në mëngjes njerëzit zgjoheshin shpejt, lanin sytë me ujë të ri dhe dilnin e rrokulliseshin nëpër bar. Bënin edhe kurora me kulpra dhe i vinin në kokë ose rreth mesit, për të mos u dhëmbur koka a shtati. Me ujë të ri spërkatnin shtëpitë brenda

e jashtë. njerëzit e bagëtinë. Për shën Gjergj therej një qengj i rritur për këtë ditë. Bagëtive u jepnin kripë të përzier me të gjitha llojet e barërave e të luleve të stinës. Po këtë ditë këputeshin shqerrat dhe fillonte mjelja. Me këtë rast fshatarët bënin qumështor me kulloshtër. Në disa krahina ngulnin në ara një degë të gjelbër ose ngrinin potka për të trembur shpendët që dëmtonin prodhimet bujqësore.

Shkodra shën Gjergjin e festonte dy herë; më 23 prill dhe 6 maj (sipas kalendarit julian); i pari quhej shën Gjergji i ri, ndërsa tjetri shën Gjergji plak. Koha midis tyre thirrej «midis dy Shën Gjergjash». Këto ditë ngriheshin edhe shtregullat të cilat shoqëroheshin me këngë e valle idilike (shih këngët nr. 75-98). Këngë shtregullash këndoheshin edhe në Kosovë, Elbasan, Korçë, Kolonjë etj. Siç shihet shën Gjergji, nga gjithë ritet e zakonet është një festë e lashtë, që lidhet me ringjalljen e natyrës, me kultet e pjellorisë bujqësore e blektorale.

Krs. AIKP «Këngë të festave popullore kalendarike. Vëllimi i III — Dibër — Ceren f. 288, Sllatinë f. 284, Shumbat f. 295, 296; *Elbasan* — Gjinar, f. 297; *Gjirokastër* — Labovë, f. 301; *Korçë* — Arzë. f. 304, Bradvicë, f.307; Dardhë, f. 309-311, Dolan. f. 313, Sinicë, f. 316; *Mirditë* — Mali i Lushit, f. 317; *Pogradec* — Volorekë, f. 318 *Shkodër*, f. 319; *Tepelenë* — Vasjar, f. 330; *Tiranë* — Mënik, f. 331 Shëngjergj. f. 332, 334; *Vlorë* — Poro, f. 335, 336; *Kosovë* — Bellacërkë — Prizren, f. 337, Domanek, f. 339.

57

DUM E DUM-O PO BJEN DEFI

Dum e dum-o po bjen defi.
t'lumet na, na erdh shin Gjergji
T'lumet na, na erdh pranvera,
jan' mush' fushat dhen e shtjerra.

Llap — Podujevë, 1976

58

SEÇ NA U TREMËN DHENTË

Seç na u tremën dhentë,
moj, seç na u tremën[1].
Menuam se ishte ujku.
Kur aj ishte zoti shin Gjergj,
po shënote qengjin e vet.[2]

Valësh — Elbasan, 1954

1) Përsëritet pas çdo vargu.

2) Ka qenë zakon që ditën e shën Gjergjit të therej qengji më i mirë i tufës, i ruajtur qëllimisht për këtë ditë. Kishte raste që thereshin edhe bagëti të tjera a shpendë. Sidoqoftë bërja e një kurbani në këtë festë ishte e domosdoshme.

Kënga e mësipërme bënte pjesë në «këngët e shën Gjergjit.» (Shih shën. të këngës nr. 71).

59

LUM E LUM PRANVERA ÇE NA KA ARDHË

Lum e lum pranvera çe na ka ardhë.
se shën Gjergji i bukur na ka dalë.
Ki shën Gjergji na zu shnosh.
nusja zinka edhat n'kosh[1],
shkojnë pleçt' për uj' t'ri.
me stërpikë ket shpi.

Shëmri — Kukës. 1982

1) Ditën e shën Gjergjit zakonisht këputeshin qengjat dhe kecat nga nënat e tyre.

60

ERDH SHIN GJERGJI MORI BIJA

Erdh shin Gjergji, mori bija,
hajde qesim gurabija;
gurabija hoka-hoka,
t'bohmi t'randa, t'dridhet toka;
t'dridhet toka, e t'dridhet udha,
shkojm' sokakut sikur suta.
Erdh shin Gjergji, mori bija,
hajde qesim gurabija;
gurabija topa-topa
e t'luhatem me konopa,
me konopa e me zingjira,
nër katunde jem' ma t'mira!

Damanek — Rahovec, 1976

61

SA U RROJT KI GRUNI

Sa u rrojt[1] ki gruni,
aç u rrojtshin fjokt' e moja![2]
Për ni javë sa ni stavë,
për ni muj sa ni duj,
për ni mot sa ni shkop,
për ni vjet sa ni qep,[3]
sa bishti i kalit,
sa litart e samarit,
sa udha e pazarit![4]

Veleshtë — Strugë, 1976

---

1) Sa u rrit.
2) Flokët e mi.
3) Plep (me kthimin e *pl* në *q*).
4) Zgjatet duke përsëritur tërë vargjet për thekrin, trëndelinën etj.: *Sa u rrojt ki thekri...*

Ditën e shën Gjergjit, herët në mëngjes, të rejat dilnin nëpër ara «për të kullotur» flokët në tri grunaja, në tri thekra dhe në bimë të tjera. Shthurnin gërshetat, ulnin kokën, i lëkundnin flokët, dhe i puthnin me kallinjtë e bimëve («gjoja për t'i ushqyer») që të kishin flokë të gjatë e të bukur. Ndërkaq thoshin edhe vargjet e mësipërme.

Riti është i njohur edhe në popujt e tjerë të Ballkanit.

92

MAJI MAJI RRITNA LESHTË

Maji, maji, rritna leshtë,
si vllastareja në vreshtë,
si bishti i kalitë,
si drurë të malitë,
si kut' i pazaritë.[1]

Jug, 1878

1) Këndohej nga vajzat në maj (Shënim i Th. Mitkos).

63

JEMI GROJT' HERET

Jemi grojt'[1] heret,
mo t'na munin shelnet;[2]
jemi grojt' sot,
tu cicrue zojt.
Jon' grojt' nonat,
tu zbilue thonat;
jon' grojt' babat,
tu zbilue dardhat;
jon' grojt' vllaznit,
tu zbilue kallzit;
jon' grojt' motrat,
tu zbilue kodrat.

Sllatinë — Dibër, 1964

1) Jemi ngritur.
2) Shelgjet, shelgjishta.

64

JEMI GROJT' SOT

Jemi grojt' sot,
mo t'na munin zojt.
Si t'na çelin shelnet,
t'trazoj dada delet;
t'i çoj fjal' zogjit,[1]
t'vije ditn-e logjit;
t'i çoj fjal' pllumit,
t'vije ditn-e t'lumit.[2]

Sllovë — Dibër, 1964

1) Djalit a burrit që kishte në kurbet.
2) Ditën e shën Gjergjit.

65

NA KA ÇEL' STAFXHONI

Na ka çel' stafxhoni,
grojhi[1] e trazoni,
sa t'vajn'[2] prej Tironës,
prehni tehin gërshonës.
Grojhen qehallartë
e mushin meratë.
Çeli lisi qak[3],
shtektarët najsen[4] vark.
Si u vro[5] havaja,
ka qefin qehaja,
t'boje kllos' meraja.

Sllatinë — Dibër, 1964

1) Ngrihuni.
2) Të vijnë.
3) Plak (me kthimin e *pl* në *q*).
4) Nisen.
5) U vrenjt.

66

KUR T'NA VEJ SHËN XHERXHI

Kur t'na vej shën Xherxhi[1],
vejn' i majri e i keçi;[2]
i majri le t'vej-e,
i keçi le t'rrej-e;
i majr' e i keç,
t'na ven' për shën Xherxh.
Kur t'çelin lethejat,
vin' ket[2] gjemt te shpajat;
kur t'na çelin dardhat,
vin' ket gjemt te babat;
kur t'na çelin xhanat.
vin' ket gjemt te nanat.[3]

Sllovë — Dibër, 1952

1) Kur të na vijë shën Gjergji

Teksti i mësipërm sjell veçoritë karakteristike të të folmes së Dibrës. Në këtë të folme *i*-ja e theksuar kthehet herë në *aj*: *i majri* për *i miri*, *shpajat* për *shpijat* (v. 3, 5, 8), herë në *e*: *lethejat* për *lejthijat* (v. 7), *le t'rrej* për *le të rrijë*. Kështu kthehen edhe bashkëtingëlloret *gj* në *xh*: shën *Xherxhi* për shën *Gjergji* (v. 1, 8); *q* në *ç*: *i keçi* për *i keqi* (v. 2, 5); *dj* në *gj*: *gjemtë* për *djemtë* (v. 10, 12).

2) Krejt.

3) Ka qenë zakon që kurbetçinjtë stinorë të ktheheshin në këtë festë në shtëpitë e tyre.

67

SHËN XHERXHI NA ERDH

Shën Xherxhi na erdh,
dukati me redh!
O, na erdh shën Xherxhi
me riza për brezi;
o, na erdh shën Kolli[1];
me riza Stamolli[2].

Luzni — Dibër, 1937

1) Shën Kolli, në disa krahina të Dibrës, Matit e Krujës festohej afër shën Gjergjit. Në Luzni (Dibër), Karicë, Dukagjin e Urxalla (Mat), festohej të enjten pas kësaj feste, ndërsa në Laç (Krujë), pas dy javësh.

2) Shpesh kurbetçinjtë që vinin t'i kalonin këto festa në shtëpitë e tyre, dalloheshin nga rizat (peshqirët) që mbanin në qafë.

68

I KAM ÇU FJAL' ZOGJIT

I kam çu fjal' zogjit
të vaj ditn e logjit.
Kur t'çelën kajsajat,
mblidhni veresajat[1].
I majr' e i keç
të vajni për shën Xherxh.
I keçi le t'rraje,
i majri le t'vaje.
Ene i keçi mos t'met,
se vajn te nana e vet.

Debresh — Gostivar, 1976

1) Kur të çelin kajsitë, (kur të afrohet shën Gjergji) kurbetçinjtë të mbledhin paratë që kanë dhënë veresi, hua, dhe të bëhen gati për të ardhur në vendlindje.

69

I SHËN GJERGJ TA KEMI MALLË

I shën Gjergj, ta kemi mallë,
more i shën Gjergj[1],
për një lugëzë me dhallë.
Dolla ditën e shën Gjergjit,
humba sumbllat e jelekut,
m'i gjetke i biri mbretit,
m'i tretke plumba dyfekut[2]

Shtikë — Kolonjë, 1955

1) Përsëritet pas çdo vargu.

2) Këndohej ditën e shën Gjergjit nga gratë, duke hedhur valle rreth faltores së fshatit që mbante emrin e këtij shenjti. Një motërzim është mbledhur edhe në Bradvicë të Korçës, ku njihet si «valle pashkësh» (Krs. AIKP vëll. III, f. 307).
Vargjet e fundit duken si shtesa të mëvonshme.

70

ORE ZOGJ I PLEPIT

Ore zogj i plepit,
potkat e shën Gjergjit.
Zogj-e, more zogj,
dita jote sot[1].

Topojan — Kukës, 1982

1) Ditën e shën Gjergjit fshatarët ngriheshin herët në mëngjes dhe ngulnin nëpër ara e livadhe nga një degë të gjelbër, «për të siguruar prodhime të bollshme.»

71

ISHTE 'I FUSH' E GJAT' E GJANË

Ishte 'i fush' e gjat' e gjanë[1].
lajthij-o,[2]
ishin tre bari me gja,
kishin tre fije[3] në brest.
Kur i bijshin fyllit parë,
çohshin gjaja me ngran' bar;
kur i bijshin fyllit dytë,
çohshin gjaja me gran' krypë;
kur i bijshin fyllit tretë,
çohshin gjaja me pi vetë.[4]

Gjinar — Elbasan, 1954

---

1) Varg karakteristik që haset edhe në ndonjë baladë tjetër të Veriut.

2) Përsëritet pas çdo vargu.

3) Fyej.

4) Në krahinën e Shpatit (Elbasan) kjo këngë, e cila siç shihet, ka një subjekt balade, quhet *këngë shën Gjergji*. Me këtë emër thirreshin dhe një tog këngësh të tjera lirike — të festave pranverore, këngë lulesh, këngë dashurie me elemente rituale etj., të cilat kanë qenë kënduar prej vajzave dhe nuseve të reja në këtë ditë. (Si të tilla njihen këngët: *Ju, moj lule, gjith' sa jini, Çeli lulja e kumbulls-o, Sipër e ma sipër-o, O moj lule vergje-vergje* etj.). Këto këngë dhe praktika rituale, veç të tjerash, hedhin dritë për vendin e veçantë të shën Gjergjit në festat kalendarike të popullit tonë.

72

RE SHIN GJERGJI KAVALLAR

Re shin Gjergji kavallar[1],
m'at te glatinë kondar![2]
E zë frika, kush e sheh,
edhe pritetë dë mes.
Ti na jep ga ajo forë[3]
edhe mban armët dë dorë,
sepse krie çë të kemi,
jejshmë edhe do jemi[4].

Arbëreshët e Greqisë
Eleusinë, 1980

---

1) O shën Gjergji kalorës.
2) Heshtë, shtizë.
3) Fuqi, forcë.
4) Ishim dhe do të jemi (gjithmonë) arbëresh.

Poezia e mësipërme dhe dy poezitë që vijojnë, sikurse kuptohet nga përmbajtja e nga forma e tyre vijnë nga letërsia e shkruar. Me gjithë prejardhjen e tyre, ato dëshmojnë se ç'rrënjë të thella kishin në ndërgjegjen etnike të arbëreshëve të Greqisë e të Italisë figura dhe praktika rituale të festës së shën Gjergjit. Prandaj u përfshinë në këtë vëllim.

73

RE SHIN GJERGJI ZOTI IM

Re shin Gjergji, zoti im,
ti me kalë kavallar,[1]
shum' të dua pse je trim
e të trembënë ga[2] parë[3].
Re shin Gjergji, je arvanit,[4]
kapetan na ti të kemi,
falemi nat' edhe ditë,
si ti trima tër' të jemi.
Ti shin Gjergj, na besove,[5]
të luftojmë bashk' me kalë;
ga ti pam' kondar' çë çove
edhe neve e bëm' pallë.

Arbëreshët e Greqisë
Eleusinë, 1980

---

1) Kalorës.
2) Nga, shko.
3) Përpara, tutje.
4) Në ndërgjegjen e arbëreshëve të Greqisë, shën Gjergji quhej një shenjt i etnosit të tyre.
5) Na mësove.

74

TË FALEMI I SHËN GJERGJ

Të falemi, i shën Gjergj,
o nder i math i jetës,
dëshmor i të vërtetës,
i gjarpërit armik.
Të falemi e përdita,
të lutemi tue thënë:
«O ndihm' e horës tënë,
mos lerna në rrezik!»
Klyshedhra aq' e tmeruarë,
çë ti lavose e preve,
la farën, ç'edhe neve,
të zërë po kërkon...
O shëjti thavmasor,
ti ndihma të guxojmë
e vendin të shpëtojmë
nga ajo klëshedhr' e shkretë.
Të jet' nga gjindja e lirë,
i falur me haidhi,
i larti perëndi,
nani e për mot' e jetë![1]

Arbëreshët e Italisë
Siqeli, 1923

1) Te dorëshkrimi i Kieutit (1737) një këngë e thjeshtë dashurie mbaron me vargjet: «In zot. ndihna shën Mëri vo,/ ndihna

Arbërit fanmiri,/ te ku ndodhenë e dergjenë,/ se jan' pak të mierit-o/ edhe sot për shumë mot! Në këto kushte duhet t'u jetë dhënë edhe këtyre këngëve një karakter patriotik. Në tekstin origjinal të kësaj kënge, në disa vargje që i lamë pa përfshirë këtu, përmendet, bashkë me shën Gjergjin, edhe shën Mitri, si dy mbrojtësit e Skënderbeut.

75

ULU ROZ' NË HALLI

Ulu, Roz',[1] në halli,
gjith' të mirat i ke në shpi.
Ulu, Roz', në sexhade,
të vjen kafja limonade,
Ulu, Roz', ti në tokë,
gjith' të mirat i ke në odë.
Hopa, hopa![2]

Shkodër, 1957

1) Emri i vajzës që ulej në shtregull.

2) Midis dy festave të shën Gjergjit (shën Gjergjit të ri e shën Gjergjit plak) në Shkodër janë festuar me këngë e valle idilike edhe shtregullat. Ato ngriheshin nëpër shtëpitë me oborre të gjera. I zoti i shtëpisë ftonte njerëzit e lagjes: «Të urdhnoni në shtregull!» Kështu mblidheshin miqtë dhe fillonin këngët e vallet. Zakonisht vallen e nisnin dy të rinj me prindër gjallë. Ulej vajza dhe ndërsa djali e përkundte, ajo këndonte vargjet: Hovi madh,/ hovi vogël,/ shkon e vjen/ nëpër Shkodër. Këtë e përsëriste me të njëjtin intonacion grumbulli i grave e i burrave që rrinin në këmbë. Si zbriste vajza në vend të saj ulej djali. Kështu hidheshin në shtregull palë-palë gjithë të pranishmit. Ai që do të përkundej do të niste gjithmonë një këngë a valle të re. Nëpër familjet e pasura merrnin edhe ahengçinj për argëtimin e miqve. I zoti i shtëpisë i gostitte të ftuarit sipas rastit me sheqerka, pije freskuese, kafe.

Në shtregulla këndoheshin këngë lirike që i përshtateshin frymës së festës: si këngë e valle për përtëritjen e natyrës, për të rinjtë e të rejat, balada dashurie etj. Te moshuarit thumboheshin me këngë humoristike. Argëtimi i shtregullave vazhdonte deri vonë në mesnatë, ndonjëherë derisa zbardhte drita. Në agimin e 6 majit, kur largoheshin prej shtregullave pjesëmarrësit në festë stolisnin me lule ose degë të gjelbra dyert e shtëpive të tyre. E kishin për mirë të venin të tilla edhe në dyert e të tjerëve se thoshnin: «Kush ven gemin e gjelbërt në derën e tjetrit për shën Gjergj, ia merr nafakën!».

Vënien e një dege të gjelbër ose të një plisi me bar të njomë në derë si simbol dashurie e pjellorie endeshim edhe të rumunët. Ky zakon i njohur me emrin *armindenul* bëhet në festën e 1 majit.

Këngë të veçanta për këtë festë këndoheshin edhe në krahinën e Shpatit (Elbasan). Këto bënin fjalë gjithashtu për përtëritjen e jetësh (shih shën. 4 të këngët nr. 71). Në Kosovë këngët e shën Gjergjit këndoheshin më shumë nga vajzat. Këngët e shtregullave kanë qenë të njohura edhe në krahina të tjera si në Pogradec, Korçë e Kolonjë. Të gjitha këto dëshmojnë për një shtrat ritesh e zakonesh të përbashkëta, me zanafillë të lashtë, të kësaj feste, që nuk mundën ta zhdukin ndikimet e feve monoteiste. Është për t'u vënë në dukje fakti se jo të gjitha këngët që këndoheshin me këtë rast ishin këngë shtregullash. Më poshtë po jepen disa prej këngëve më karakteristike të këtij repertori.

76

PO NDRIT HANA PËRMBAS MOLLASH

Po ndrit hana përmbas mollash,
o pellum, more pellum,[1]
mir' po i ndrit shtregullat tona.
T'madhe varzat po këndojnë,
dora dorës po vallzojnë.
Djelmt e ri kan' qit' e pvetë:
— Han' e re, han' e re,
e bukra dheut ku ka metë?
Gjeja rrugën vashës s'shkretë,
se me gjas' rrugen ka tretë.

Shkodër, 1958

1) Përsëritet pas çdo vargu.

77

E BUKURA SI SKYFTERË

E bukura si skyfterë,
po na del e bardha verë.
E bukura porsi mollë,
po na rrin ku binte borë.
E bukura posi yll,
si hana qi ndrit në pyll.

Shkodër, 1958

78

HYPA NË BAJAM E KNDOVA

Hypa në bajam e kndova,
te po vinte vetullholla
me bishtaleca si bolla;
balli i shndritte porsi bora,
njate deshta, njate mora.

Shkodër, 1958

79

KUR KAM KEN' NJI HER' I RI

Kur kam ken' nji her' i ri.
lum, lumi une,[1]
sa mir' shkova me kojshi.
me nji vajz' zuna miksi.
Gjith' ditën na hijeve,
gjith' naten gardhijeve,
tuj i ra karadyzenit
e tuj ba kokrren e qejfit.
Dikush erdh e na prigjoi.
mjer', mjeri unë[2],
nana vajzën e fejoi,
e fejoi me Venedik,
e me xuni tjer' ashikë.
Zemra eme u disprue.
jaranesha më ka lshue.

Shkodër, 1911

1) Përsëritet si refren deri në vargun e tetë.
2) Përsëritet pas çdo vargu deri në fund.

80

NEN NJI RRAS' E NEN NJI TANDË

Nen nji rras' e nen nji tandë,
aman, aman,[1]
kishte ndej' nji zoj' e randë
me dallfes-o në njen' anë.
— Avitu se ta godis.
— Largou, djal', se po m'shastis,
kenke nur' i bukurisë.

Shkodër, 1958

1) Përsëritet pas çdo vargu.

81

SHKAPËRCEVA 'I MAL ME BORË

Shkapërceva 'i mal me borë,
më priti nji djal' me dorë.
— Mos më prek, o more djalë,
se jam vash' e pakunorë.
Sharto dardhën bashk' me mollë,
sharto dardhën e venia fikut,
të mirën jepja fisnikut.
Porse aj fisnik mos kjoftë,
nepër male ai meloftë,
raft-e shi e e sbuloftë,
fryft-e era edhe rrxoftë,
i raft' breshni e e coptoftë!

Shkodër, 1911

82

TI NË MOLL' E UN' NË MOLLË

Ti në moll' e un' në mollë,
të dy jena na belhollë.
Ti në dardh' e un' në dardhë,
të dy jena faqebardhë.
Ti në fik e un' në fik,
shoqi-shoqit jem' ba ashik.
Ti në ftue e un' në ftue,
të dy jena pa martue.
Ti në pjeshk' e un' në pjeshkë,
do t'martohna na në vjeshtë.

Shkodër, 1964

83

MORI TI MOLLA JESHILE

Mori ti, molla jeshile,
Gjylsyme, o moj Gjylsyme[1],
a t'kam than', moj, mos u rritsh,
gem as deg' në rrug' mos qitsh,
se vijn' djelt-o aty pari
e u ngatrrohet peshtemalli.

Shkodër, 1964

1) Përsëritet pas çdo vargu.

84

JU ZOTNI QË RRINI BASHKË

Ju zotni, që rrini bashkë,
ju ka xan-o nata jashtë;
ju zotni, që rrini grumbull,
ju ka xan-o nata n'lundër;
ju zotni, që rrini tubë,
ju ka xan-o nata n'rrugë.

Shkodër, 1964

85

HAJDE LUEJM' SHNJEGULL ORE LAL-O

Hajde, luejm' shnjegull,
ore lal-o[1],
ta bajm' tajm[2] e mjegull.
Ore zogj i shtogjit,
sot asht dita e logjit[3].

Fshat — Kukës. 1982

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) Tym.
3) Ditën e shën Gjergjit fëmijët luanin «shnjegull» (kolovajzë) dhe gjatë lojës këndonin edhe këtë këngë.

86

KUSH KA HIP' N'LUSHAQ TË DRUNIT

— Kush ka hip' n'lushaq të drunit?
— Ka hip' motra e NN fodullit.
— Kush ka hip' n'lushaq të telit?
— Ka hip' motra e NN dilberit.

Shipkovicë — Tetovë. 1976

87

HUL – HULAJA NË KONOP

Hul-hulaja në konop,
kur t'hulatmi sot motmot;
sot motmot e sot ni vjet,
kur t'hulatmi për shën Gjergj,
ishalla me ni kismet![1]

Greshnicë – Kërçovë, 1976

1) Me një fejesë.

88

KY KONOPI PIKA-PIKA

Ky konopi[1] pika-pika,
t'lumet na çi jemi çika;
jemi çika, jemi varza,
na marojm' xhamper me krrabza.
Kti xhamperi i nxhesim pulla,
për shin Xherxh shkojna për lula:[2]
shkojm' për lule kakureka,
n'dishek t'nanës na xen dreka[3].
Kur t'vjen nana me na thirrë,
«Shka ke qit', oj nan' për sillë?»
Buk, të grytë e tamël t'dhene,
tamël t'dhene e buk' t'sejmene,
tamël t'dhive, buk' t'zotnive!»[4]

Damanek — Suharekë, 1973
Bob. 930/16

---

1) Litari i shtregullës.
2) Zakon tjetër karakteristik i kësaj feste ka qenë edhe këtu shëtitja në fusha dhe mbledhja e luleve.
3) Me lulet që mblidhnin vajzat stolisnin sidomos shtresat e fjetjes.
4) Vargjet e fundit janë me efekt humoristik.

89

KY KONOPI GOGLA-GOGLA

Ky konopi gogla-gogla,
t'lumet na çi jemi t'vogla;
jemi t'vogla për me lue,
s'na pret maxhja me gatue;
s'na pret fshisa me fshisue,
na pret shkolla për me msue.

Bellacërkë — Rahovec, 1973
Bob. 930/15

98

SEÇ MBOLLA NJË MOLLË

Seç mbolla një mollë,
molla lëshoi rrënjë,
rrënja lëshoi degë,
dega lëshoi fletë,
fleta lëshoi lule,
lulja bëri mollë,
ta ha me bandillë,
me atë belhollë.[1]

Manastir, 1976

1) Edhe te shqiptarët e Manastirit sikurse në Shkodër çdo vajzë kur hipën në lëkundëse (kollovoz) duhet të këndojë një këngë shën Gjergji (shtregullash). Kënga e mësipërme me motiv përtëritjen e jetës, i përket këtij repertori.

91

SALLANXHAKI PIKA-PIKA

Sallanxhaki pika-pika,
t'lumet na shka jemi çika.
Çka ka dudi qi gjimon?
Beçaricat s'un po i man.
Çka ka dudi qi livrit?
Beçaricat s'un p'i nis.

Bellacërkë — Rahovec, 1976

92

PO NA PJEKIN LAPAT E PLEPIT

Po na pjekin lapat e plepit,
ku do t'lujna ditën e shën Gjergjit?[1]
Do t'lujna në deg' të arrës,[2]
lujni cauca n'der' të babës;
do t'lujna n'deg' të thanës,
lujni cauca n'der' të nanës.

Shipkovicë — Tetovë, 1976

1) Ku do ta ngremë lëkundësen për të luajtur ditën e shën Gjergjit?
2) Do ta ngremë në degë të arrës.

93

LUJNI MOJ CAUCA SA INI

Lujni, moj cauca, sa ini,
se këtë shën Xherxh s'ën e xhini!
Lum kush e ka beqarllejkin,
ta përlajm' na sevdallejkin!
Lum kush e ka, ne ta mbaje,
mjer' kush s'e ka, ne ta kaje!¹
Lum kush e ka, ne ta këndoje,
mjer' kush s'e ka, ne ta vajtoje.

Shipkovicë — Tetovë, 1976

1) Le ta qajë.

94

LUJNI CAUCA ENE SIVET

Lujni. cauca, ene sivet,
lum kush a xhall' qera vet!
Mot' e qera në do jesëm,
nuk e kimi menden të vdesëm.
Mot' e qera do t'jetojna,
nuk e kim' menden t'martohna.

Shipkovicë — Tetovë, 1976

95

SHKO CAUCO SHKO KA KE SHKUE

Shko, cauco, shko ka ke shkue,
sa je beqare pa martue,
sa i kije kamët pa pengue,
sa nuk kije fer' me t'ferue,
sa nuk kije za me t'shitue!
Shko, cauco, shko ka kije kanë,
sa jie beqare e padhanë!

Shipkovicë – Tetovë, 1976

96

LUNI ÇIKA DRIDHNE KATUNIN

Luni, çika, dridhne katunin,
se vjen vakti m'i korr' grunin.
Grunet jan' hala te verdha,[1]
ato korren kur t'vjen vera.
Kur t'vjen vakti për me korrë,
bahni bashk' me drapnoj n'dorë,
n'dimi t'mira, n'mafes t'hollë,
Renatores ja kem' lakmi,
ma e para shkon tuj pri.
Renatorja n'dimi t'verdha,
lum e lum qi na erdh vera.

Klinë, 1976

1) Të gjelbra.

97

SHPIJA JON' ME TULLA ME TULLA

Shpija jon' me tulla, me tulla,
na ka ardh' shën Gjergji me lula, me lula;[1]
shpija jon' e lyme me qireç.
ani e kemi lye për shën Gjergj.
Shpija jon' me cinglla, me cinglla
e pritëm shën Gjergjin me çika, me çika.
Shpia jon' e lyme me horasan,
na po luhatemi në tok' e n'tavan.[2]
Hul-hulaja, shkojmë ke daja,
rrijmë dy net, vijmë apet.[3]

Greshnicë — Kërçovë, 1976

---

1) Përveç repertorit tradicional të festës, shpeshherë kur të rinjtë lëkundeshin në shtregulla, improvizonin vargje, siç dëshmon kënga e mësipërme.

2) Ka qenë zakon që ditën e shën Gjergjit të lyheshin shtëpitë me gëlqere.

3) Në këtë këngë janë përzier vargje 6-rrokëshe dhe 4-rrokëshe të dyzuara. Nga ana e ritmit janë shfrytëzuar rima e asonanca fundore (vargjet 1-8), po edhe rime e kadenca të brendshme si në vargjet 9 e10. Në çdo rast luajnë rol edhe përshtatjet me lëvizjet në shtregull (hedhjet në litar).

98

SHIN GJERGJ-O

Shin Gjergj-o,
shin Gjergj-o,
frajk[1] na erdhe,
frajk na shkove.
Kur na erdhe,
na gazmove;
kur na shkove,
na shëmtove.

Greshnicë — Kërçovë, 1976

1) Vrik, shpejt.

e ceremonive të varrimit. Thërritnin me zë të lartë: «*Nëno, moj nëno,/ ardhi dielli dhe nuk të gjeti.*» Pastaj ndanin naforë, grurë e misra të zier.

Me këtë festë lidhen edhe Rrëshajat që festoheshin pak a shumë në të njëjtën kohë në Veri. Sipas studiuesve duhet të kemi të bëjmë këtu me rite të lashta, me kultin e të vdekurve, sidomos me flijimin e një hyjnie të bujqësisë e blegtorisë, me ringjalljen si forcë të pjellorisë së tokës dhe të gjësë së gjallë.

101

RUSICA ME RUSICA

Rusica, me Rusica,
na dërgoi zoti Ristoz
për një doçkë miell,
për një kupkë vaj!
Rusica, me, Rusica,
të bëj petanik, të ftonj,
të më vish për shënë Koll!
Rusica, me, Rusica!

Hoçisht — Korçë. 1962

Bob. 205/10

(Transkriptimi muzikor nr. 5)

102

RUSA PAPUSA

Rusa papusa.[1]
Na dërgoi Rusica
për një doçkë miell,
të bëjmë kulaçe.
Dil, moj dalç e bardhë,
gjer mot me një djalë![2]

Rëmbec — Korçë, 1984

1) Në besimet popullore «Rusa, Papusa» përfytyrohej si një figurë mitologjike, me të cilën trembin fëmijët: «Pusho se vjen e të ha Rusa Papusa», prifti.

2) Formulë e zakonshme e festave pranverore për darovitjen e të vegjëlve.

103

QERSHORI-QERSHORI

Qershori, qershori,
qershitë na solli.
O kalli i ri,
ruaj syt' e mij,
gjer sot, si tani,
sa të dal' i ri.

Jug, 1908

104

TRIKO-TRIKO I SHËN GJINI

Triko, triko, i shën Gjini,[1]
se na vjen zot' i shën Pjetrë.
I shën Gjini erth e shkoi,
i shën Pjetri na aëroi.

Jug, 1878

1) Festa e shën Gjinit ishte më 24 qershor. Në këtë ditë vajza e nuse dilnin jashtë fshatit, duke kënduar e mbledhur lule. Të vegjlit vinin në kokë kurora të thurura me një lloj bari të quajtura *triko*. Zakoni kryesor i festës ka qenë ndezja e *zjarrmoreve*. Zjarret kishin kuptim simbolik. Ato bëheshin kryesisht me byk, me kashtën e të lashtave. Hirin e këtyre zjarreve ia hidhnin tokës «për mirë» (për të shtuar pjellorinë). Zjarrmoret kapërceheshin duke përsëritur vargjet e mësipërme. Në Berat e Myzeqe digjnin edhe rrogozë të vjetër. Herë-herë, vajzat vendosnin në kokë edhe kurora të ndezura. Festa e shën Gjinit me këto praktika kishte karakter bujqësor. Në disa krahina si në Dukagjin e Mirditë ajo quhej edhe festa e malit, e çojës (e ngjitjes së bagëtive në bjeshkë). Me gjithë emrat e krishterë, festat ruanin në përmbajtjen e tyre tiparin pagan. Ato lidheshin me ditën më të gjatë të vitit (21 qershorin). Emrat e krishterë duhet të kenë zëvendësuar ndonjë hyjni vendase të bujqësisë e blegtorisë.

105

TRIKA-TRIKA VJEN SHËN GJINI

Trika,trika, vjen shën Gjini,
vjen shën Gjini, vjen shën Pjetri,
vjen me zjarr në dorë,
vjen me drapër duke korrë.[1]

Gjyres — Korçë, 1951

1) Të dy festat kremtoheshin ngá fundi i qershorit. Kjo ishte edhe koha e të korrave në zonat malore.

106

TRIKO-TRIKO I SHËN GJINI

Triko, triko, i shën Gjini,
i shën Gjini shkoi e vate,
po na vjen zoti shën Pjetër.[1]
— I shën Pjetër, o biri im,
kalle dorën e më qit.
— As të qit, as të kllas,
po të shtie ndë kollas![2]

Jug, 1908

1) Shën Pjetri festohej më 29 qershor. Ai lidhej gjithashtu me të korrat. Në Dardhë (Korçë) këtë ditë njerëzit dilnin shëtitje te «Kodra e Vogël», «Rrahu» etj., ku mblidhnin shënpjetrat (një lloj luleje e verdhë), luanin valle dhe këndonin «këngë të verës», të kurbetit, të dashurisë etj.

2) Sipas letërsisë kishtare shën Pjetri ishte ruajtës i parajsës dhe i skëterrës. Kënga, me humorin e saj, kërkon të thotë: s'vjen shpëtim nga shenjtorët».

107

KORRIKU-KORRIKU

a) Korriku, korriku,
vjen rrotull shiniku.

Jug, 1908

b) Shiu i korrikut,
mall i Venedigut.

Shkodër, 1943

108

RRI RRI SHËNDËLLI

Rri, rri, Shëndëlli,[1]
rri, moj zonjë, shë Mëri,
më një fron të art' e t'akullt,
mba orë, mba korë,
mba zonë mbë një dorë.
Moj zonjë, zonj' e shtëpisë,
nxerma rrogjen e rakisë,
t'ua ndajmë djelmurisë.
Mos na e qit nga e liga,
se të gjitha bëhi shtriga.

Kolonjë. 1878

1) Këndohej nga të vegjlit në festën e shën Illisë, më 20 korrik. Në këtë festë, në disa krahina si në Korçë, Kolonjë e Përmet, të vegjlit shkonin nëpër shtëpitë duke kënduar vargjet e mësipërme. Amvisat i gostitnin me vezë, miell etj., që i gatuanin dhe i hanin në shetitje.

109

VJESHTORJA MADHËSHTORJA

a) Vjeshtorja,
madhështorja.

Shkodër. 1943

b) Shkon vapa me gusht
e vjeshta me rrush.

Shkodër, 1943

c) Kur xihet rrushi,
xihet deti.

Ulqin. 1943

ç) Shë Mhilli,
rjep gërmilli.[1]

Jug. 1980

1) Kërmilli.

110

DITA E SHËN MITRIT ERDHI PRRU' NË PRRUE

Dita e shën Mitrit erdhi prru' në prrue,
me shum'sende t'mira ne na ka gëzue.
Na kallxon për kohën, dimni si do t'jetë,
i vërejna delet qysh jan' ra me fjetë.
Nëse delja shtrihet me dy kamt e para,
dimni asht i butë, veç rueju për mrapa.
Nëse delja shtrihet katër kamët tubë,
pregatit për dimën ushqim, dru e bukë.
Dimni asht i vshtirë, pregatitu mirë,
mjeri ai i mjeri, qi rrin me duer lidhë.
Dita e shën Mitrit, ti qofsh e bekueme,
saher' qi na vjen, ti na vjen e lume,
zijna kungullore, hana[1] moll' e ftue...[2]

Petrashticë — Drenicë, 1976

1) Hamë.
2) Nga mënyra e ndërtimit, kënga duket si krijim i vonë.

111

E JËMA E SHÉN MITRIT

E jëma e shën Mitrit[1]
e mbëjidh e bën kunxile,[2]
e të mbëjidh diellin
e të m'e mbëllini n'filaqi[3]
e brënda thell' ndë një grutë
e përpara stisur me botë
e mos t'i hini fare dritë
e të më sill bononatë[4]
e vjen vera e bën vapë.
E dimëri, mot' i mirë
e të më bëni grurë shumë
e të martojmë ata guanjunë[5]
e të më marrësh ato kopile,
çë më rrin' helmuarith[6].

Arbëreshët e Italisë
Shën Kostandin Albaneze. 1972
Bob. 904 4

---

1) E ëma e muajit tetor (shën Mitrit).
2) Bën këshillë.
3) Të ma mbyllni në burg
4) Të mirat.
5) Djem.
6) S'pas mbledhësit, kjo këngë këndohet në muajin tetor për të mbjellat. E ëma e shën Mitrit, me erë e shi dëmton të mbjellat. Ajo kërkon që të mbyllë diellin në shpellë, por nuk ia arrin dot.

112

TË FALEMI SHËN MITER

Të falem, i shën Mitër,
o trim i Shqipërisë!...[1]
Te jeta e trubulluarë
një zjarr thellonjës kleve;
ndër t'errëti shkëlqeve,
si drita në mëngjes...
O gjak i gjakut tënë;
i trimave i pari
të truhet tyj shqiptari,
ku ndodhet e jeton.
O trim çë rri krenushëm,
me flamurin në dorë,
vështro me mall ktë horë
çë bë polemi i jit.
Polemi shum' i dashur,
çë shkoi në vënt të huaj,
lirin'e fen' të ruaj,
nga i sëmuri armik.[1]

Arbëreshët e Italisë
Siqeli, 1923

1) Ndonëse me prejardhje letrare, u përfshi në këtë vëllim për karakterin e saj popullor. Shën Gjergji dhe shën Mitri janë quaj-

tur nga arbëreshët e Italisë si dy mbrojtësit e Skënderbeut. Për këtë nderim të veçantë ndaj këtyre dy figurave flet edhe fakti se shën Gjergji dhe shën Mitri kanë mbetur deri në fund edhe si dy festat më të shënuara, të kalendarit të festave tona popullore të motmotit.

113

DITA NË SHËNËNDRE

Dita në shënëndre
hidhetë si zogu në ve.

Labëri, 1943

Dimëri me dimër do të dalë.

Jug, 1943

Dimni n'gomar nuk shkon.[1]

Shkodër, 1943

Dimni struk delitë[2].

Shkodër, 1943

Shënëndreu
rjepqeu;
jenari
rjepgomari.

Labëri, 1943

1) Dimri do ta bëjë të vetën, do ta sjellë të ftohtin.
2) Dimri i shtrëngon të mblidhen edhe burrat trima.

Kollozhegu
djegështegu.

Jug, 1908

Kështndella e verë
e sh'Njin e dimën[1].

Shkodër, 1943

Hanza e kallnurit
si dilli i qershurit[2].

Elbasan, 1930

Hëna e janarit
si dielli i allonarit.

Jug, 1935

Fruer kcen shjeku[3] terthuer

Malësi e Madhe — Shkodër, 1943

Frori bishtnori.

Shkodër, 1943

Shkurti shkurton urët,
marsi merr lëkurët.

Jug, 1908

Frori lig,
marsi rip.

Labëri, 1943

---

1) Në Këshëndella fillon të zgjatet dita dhe të vijë pranvera: kurse në shën Gjin nis të shkurtohet dhe të vijë dimri.
2) Është shumë e ndritshme.
3) Shelegu.

Kallnori kangatori.
Po na vjen frori.
kangatori e tamlori.
Tesh lopa bie në bar,
kau lidhë për kular.[1]

Ulqin, 1976

1) Fillon të mbijë bari dhe të bëhen përgatitjet për punimet bujqësore.

114

PËR MUAJT E STINËT

Jenari,
lejmonjari,
lutrovjari,
vatër-zjarri,
qesëndjari.
Flevari,
hap flevët,
të bën edhe drekët.
Marsi,
karsi,
djegahuri,
hunjërit e koshtret i shkuli.
Marsi,
marteris.
Prilli
monofilli.
këndon qiqia dhe birbili.
Mai,
mais,
koshtret i qindis.
Mai, qeth dhëntë,
theritiu mpreh dhrëpinjtë.
allonari fshin lëminjtë.
Erdhi gushti,
u nxi rrushi.

Erdhi vjeshtra
u vol vreshta.
Vjeshtër,
ore mjeshtër,
kollo-mjeshtër,
as na bën një gunë për vjeshtër.
Vjeshtra hiri e vjeshtra shkoi,
u mbush katoi
mjeshtëri s'e këpëtoi.
Shënëndreu,
mërenet dheu.

Varfanj — Gumenicë
Fitore — Vlorë, 1945

115

O KOLENDRA MELENDRA

O kolendra melendra!
Mirëdita, moj kadënë,
mirë sod, mirë mot.
ashtu dalç për shumë mot!
Dil, kadënëz' e shtëpisë,
hap derën e perëndisë,
nxir kullakn' e zotërisë.
Dil, moj, dalç e bardhë,
gjer mot me një djalë.
Dil, moj, dalç e kuqe,
gjer' mot me një nuse![1]

Jug, 1878

---

1) Festa e kolendrave kremtohej më 24 dhjetor. Ka qenë festë e përgjithshme për Jugun e Veriun; në Veri, sidomos në Shkodër, ditën e borës së parë ose natën e Vitit të Ri. Zakoni më i njohur i festës ka qenë gatimi i kuleçëve, që quhesnin sipas krahinave: *kuleçë* e *kolendra*. (Korçë, Kolonjë, Përmet, Myzeqe), *kullakë* (Pogradec, Berat), *kullana* (Shkodër). Natën e kolendrave të vegjlit (kolendarët) shkonin shtëpi më shtëpi për të uruar, duke kënduar vargjet e mësipërme. E zonja e shtëpisë i gostitte me kuleçë.

Kolendrat kanë qenë të njohura edhe te arbëreshët e Italisë,

të cilët me fjalën kullana quanin një lloj ëmbëlsire; po kështu edhe te shqiptarët e Ukrainës.

Kolendrat i kanë festuar dhe popuj të tjerë të Ballkanit e të Evropës. Sipas studiuesve, emri kolendër vjen nga fjala *calende* e latinishtes. prej nga ka ardhur edhe fjala kalendar. Te rumunët festa është e njohur me emrin *kolinde*, te bullgarët e sllavët e Jugut me emrin *koleda*, te rusët e çekët *koliadka*, te francezët *kalandë*.

116

MIRËDITA PËR KULLANA

Mirëdita për kullana,
me një par' kupa t'argjana!
Mirë sod e mirë mot,
na ndihmo, i lumi zot!
Del, zoja, zoj' e shtëpisë,
me kulaç të zotënisë!
Del e del e dalç e bardhë,
sod me barr' e mot me djalë!
Këtu ka një shej' të mirë, shej' të mirë!
Kalë kamëbardhë, vithe të prarueme,
zojë të ngarkueme.
Apo del, apo shkojmë?

Shkodër, 1878

117

MIRËDITA PËR KULLANA

Mirëdita per kullana,
me'j tubë patrixhana,
mirë mot e mirë sot,
na nimo, i lumi zot.
Njitu kenka shej shejmirë:[1]
kali kambardhë,
vithja prarueme,
zoja narkueme.
Del e del, e zoja e shpisë,
me kunor-o të zotnisë;
del e del e dalsh e bardhë.
sot me barr' e mot me djalë.
A po del, a po shkojmë?
Njitu kenka nji pus me rika,[2]
t'zojës shpisë i raft' pika;
njitu kenka nji pus me pula.
t'zojës shpisë i raft' gerbula:
njitu kenka nji pus me pata.
t'zojës shpisë i raft' lëngata![3]

Shkodër, 1962
Bob. 213/10

1) Vargjet 5-13 thuheshin kur shiheshin shenja për **gostitjen** e të vegjëlve.
2) Ndërsa vargjet 14 — deri në fund kur nuk u jepnin **gjë.**
3) Këndohej në Shkodër natën e Vitit të Ri.
(Transkriptimi muzikor nr: 6.)

118

PO VJEN BUZMI BUJAR

Po vjen Buzmi bujar
me gjeth e me bar,
me edha, me shtjerra,
mbas tyne vjen vera.[1]

Shalë — Shkodër, 1923

---

1) Buzmi festohej në malësitë e Veriut — Mirditë, Shkodër, Kosovë etj., sidomos nga besimtarët katolikë më 24 dhjetor. Kjo ishte një festë ku ruheshin doke e zakone të lashta pagane. Në viset e lartpërmendura me ceremoni rituale priteshin drunjtë a kërcuri i buzmit. Natën e festës një djalë i shtëpisë (me nënë e baba) i sillte ata duke thënë vargjet e mësipërme. Zhvilloheshin në këtë festë dialogë, bashkëbisedime e praktika që nënkuptonin, mbeturina besimesh të kultit të zjarrit, të manizmit, të riteve bujqësore, blegtorale etj. Kryefamiljari zbrazte në një cep të kërcurit nga një lugë prej tërë gatesave të festës. Derdhte mbi drunjtë edhe raki duke thënë: «Mirse m'ardhsh, o buzmi bujar» ose «Cungu na e ka dhënë». Familjarët i përgjigjeshin «Cungu le ta pijë!» Kryefamiljari: «Toka na e ka dhanë!» Familjarët: «Toka le ta pijë» etj. [me radhë përmendeshin edhe drunj a sende të tjera]. Dikur, të ulur rreth vatrës, shkrepeshin anët e buzmit dhe ndërsa ngriheshin shkëndijat përsëriteshin: «*Sa gacllema dalin prej teje./ aq dhiz shtjerra, dhen, dhi* etj. *du prej meje*» ose vargjet e këngëve nr. 119. Sofra lihej shtruar gjithë natën dhe drita ndezur se thuheshin «do vinë shpirtërat e të parëve» (mbeturina të manizmit). Nën sofër dhe nën njerëzit shtrohej kashtë thekri. Të ne-

sërmen me këto kashtëra rrethohej trupi i pemëve, sidomos i filizave të sapombjellë.

Buzmi duhet të ketë qenë një festë popullore e mbarë vendit tonë. Mbeturina të riteve të tij janë gjetur edhe në Jug — Himarë, Gjirokastër etj.; por edhe te arbëreshët e Greqisë e të Italisë. Sipas gjuhëtarëve tanë fjala *buzëm* është fjalë autoktone e shqipes e trashëguar nga shtresa e lashtë indoevropiane.

Kristianizmi këtë festë popullore e ka përfshirë në kalendarin e tij, duke e lidhur me lindjen e Krishtit, me Kërshëndellat a Krishtlindjen. Por praktikat rituale dhe vargjet që janë ruajtur deri në kohët e vona, tregojnë se ajo është një festë e lashtë tipike pagane.

119

GAC' E KARRICË

a) Gac' e karricë,
gac' e shtërrij.[1]

Pukë, 1963

b) Gac' e mashkuj,
gac' e karricë
gac' e bereqet.

Rrafshi i Dukagjinit — Kosovë, 1973

c) Gac' e gja,
gac' e lopë,
gac' e dele.

Lugu i Baranit — Pejë, 1980

1) Shumësi i emrit shtjerrë; tërësia e qengjave dhe e kecave.

120

SA GJACLLEMA DALIN

Sa gjacllema dalin,[1]
aq gjelm na u shtofshin!
Aq gjelm na u martofshin!
Aq pen' dhe na u shtofshin!
Aq pen' qe na u ngofshin!
Aq barr' drithi gjeçim!
Aq koshare u mushshin!
Aq kulla na grefshin!
Aq kumon' tingllofshin!
Aq sofra u shtrofshin!

Mirditë, 1964

1) Përsëritet përpara çdo vargu deri në fund.

121

NOLA-NOLA KRISTANOLLA

Nola-nola, Kristanolla,[1]
qirie elejson,[2]
tre kallinj një killë grurë;
tre kallëp' një killë misër![3]

Ziçisht — Korçë, 1959

---

1) Krishtlindje.

2) Nga fjalori kishtar ortodoks (greqisht) që do të thotë: Mëshirona o zot. Formulime të shtuara mbi një bazë urimesh pagane.

Përsëritet pas çdo vargu.

3) E thoshin gratë gjatë procesit ritual që bëhej ditën e «Ujit të bekuar» (6 janar), duke shkuar në lumë, për të hedhur kryqin në ujë.

122

IGËNASHT — IGËNASHT

Igënasht-Igënasht,
petulla në grazhd.
Dhenj e dhi e bagëti;
o i zoti shëndëlli,
as i ndih kësaj shtëpi.
me fëmi, me bagëti.
Paska qën mustaqezi.[1]

Pogradec, 1944

1) Igënashtī. (25 dhjetor), thonë pleqtë, hidhet këndezi nga grazhdi, se merr dita nga nata. Atëherë bëhen petulla me pllocë.

123

NJË MILË VITËRA TË RONJË

Mir' se të vinjë Viti i Ri,
mir' se mir' të na çonjë,[1]
zonja e shtëpisë edhe zoti,
një milë vitëra të ronjë.[2]
Të ken' të miratë hare[3] dhe gazë,
të mos kanë pote siklet,[5]
kaimo[6] edhe marazë.[7]
Aqë të jeni jeorgo,[8]
një milë shosh' të beni,[9]
të bloni[10] shtëpinë plot,
të mbetëtë dhe nga lemi.[11]
An të jeni çopan[12] me dhen edhe me dhi,
të shtonënë kopetë tri herë,[13]

---

1) Mirë se erdhi, mirë se të na gjejë!
2) Një mijë vjet të rrojnë (i zoti dhe e zonja e shtëpisë).
3) Hare, gëzime.
4) Poté (gr.): kurrë.
5) Sëklet (tr.). siklet, shqetësim, mërzitje.
6) Kaimo (gr.): hidhërim.
7) Maraze. Të mos kenë kurrë mërzitje, hidhërim e maraze.
8) Jeorgo(gr.). bujk (Nëse jeni bujq).
9) Një mijë shosha bereqet të bëni.
10) Të mbushni.
11) T'ju mbetet (teprojë) edhe nga lëmi.
12) Në qoftë se jeni çoban.
13) Të shtohen kopetë tri herë.

sa të shkonjë Viti i Ri,
të mblonetë[14] mali edhe llaka,
tërë llajo[15] edhe bardhaka.[16]
Aqë bëni njatrë punë,[17]
dhiafori[18] të jetë lumë.
Me zëmërë, me shpirt,
u shomi mote shumë.

Arbëreshët .e Greqisë
Koropi. 1978

14) Të mbushet.
15) Llajo: dhen të zeza.
16) Bërdhaka: dhen të bardha.
17) Nëse bëni tjetër punë.
18) Dhiafori(gr.): ndryshimi (të mirat t'ju vijnë si lumë).

124

MIR' SE TË VINJË VITI I RI

Mir' se të vinjë Viti i Ri,
mir' se të na pëlqenjë!
Gjegjuni, vllezër, gjegjuni,
gjegjuni, do u pëlqenjë,
si nestrë thoinë të palea,[1]
thoinë[2] të shën Vasili,
pse ish njeri nga areti,[3]
njeri nga glikomili.[4]
Një thatë dru keni për bastun,
bastun për të kumbisej;
i thati dru nxuar vllastar,
tre zoqtë qelaidhisen,[5]
çë keinë shitë[6] si dhiamand
dhe ndë hriso[7] e ndishnë.[8]
Ndë derë, nd' ajo deravli,[9]
nga një duble[10] u shtinë.

---

1) Palea (gr.): i vjetër.
2) Thoshin (këndonin) për shën Vasilin.
3) Areti (gr.): virtyt (se ishte njeri me virtyte).
4) Glikomili (gr.): me të folur të ëmbël.
5) Qelaidhisen (gr.): këndonin.
6) Sytë.
7) Hriso (gr.): ar.
8) Ndishnë: veshnë (Dhe në ar e veshnë).
9) Deravli: derë oborri.
10) Duble: dyfish (një çift plumba (pushkë) u shtinë).

Shi[11] nestre klisha panagjir,
të droni[12] edhe të veni.
Nga klisha tukë ardhurë
dhe ndë shtëpi të veni,
trapezetë të shtruarë,
të hani dhe të pini
.dhe në jetë[13] ndonjë gjiton ftoho.[14]
ndonjë gjiton i shkretë,
mirnë dhe atë në trapezë,
ndë lierë[15] prindët t'u thetë.
Ndë jetë ndonjë i shklepërë,[16]
çë s'mund të vinjë vetë.
tregonani[17] fainë[18] atje
edhe ju toidhjo[19] do t'u vinjë.
Edhe sot të jeni mirëzë,
të thoni shin Vasilinë
me gol' edhe me lirë.[20]
Edhe mot të jemi mirë,
me shëndet, me bereqet,
të shkojmë Vitin të Ri!

Arbëreshët e Greqisë
Peania, 1978

---

11) Si (nesër në kishë panairi).
12) Të ndërroheni.
13) Në jetë: Po të jetë.
14) Ftoho (gr.): i varfër (Dhe po të jetë ndonjë fqinjë i varfër).
15) Lierë: ndonjë («U ndjehtë prindët» do t'u thotë)
16) I shklepër: i gjymtuar, që çalon. (Po të jetë ndonjë i çalë).
17) Dërgojani.
18) Fainë (gr.): gjellën.
19) Toidhjo (gr.): E njëjtë, njësoj (Edhe ju njësoj do t'ju vijë).
20) Këto këngë deri disa vjet përpara shoqëroheshin edhe me lirë. Për këtë arsye quheshin ndonjëherë edhe «Këngë lire». Por tani lira nuk përdoret më.

125

VITI I RI MIR' SE NA GJET

Viti i Ri, mir' se na gjet,
më mirë mot, se sivjet,
me shëndet e bereqet:
kush ka njerëz në kurbet,
i ardhçinë me shëndet,
me një mij' lira në xhep!

Kaninë — Vlorë, 1945

KAPITULLI I DYTË

KËNGË DHE VARGJE PËR YSHTJET, ZOGJTË, INSEKTET, LULET DHE DUKURITË E NATYRËS

126

DAJE PËRDAJE

Daje, përdaje,
çoje, kaptoje
ke s'ngitet ka e plurë.
ke s'ngitet ka e plurë.
ke s'han' e ke s'pinë,
ke s'folin e s'ligjërojnë,
ke s'marrin e ke s'apin![1]

Tiranë, 1949

1) Yshtje kundër syut të keq (për të larguar marrjen mësysh) po edhe kundër sëmundjeve
Një plakë hidhte mbi një kaci me prush farë liri dhe shtynte me dorë tymin nga i sëmuri duke thënë tri herë vargjet e mësipërme.

127

SI IKËN DITA

Si ikën dita,
t'ikij e liga,
si ndahet dita,
të ndahet e liga.
Në është nga sy,
në është nga peri,
në është nga mish,
të ve[1] tek ish.
Ngjitu dell[2] e ngjitu mish,
e hajde në vënd që ish![3]

Gjirokastër, 1959

1) Të vejë.
2) Delli (që mund të ishte këputur).
3) Yshtje për të këputurit mish.

128

KËTU MBI KËTU SHPI

Këtu mbi, këtu shpi,[1]
këtu shkuanë ca dhi,
lëshuan ca kakërdhi,
këtu shkuanë ca desh,
lëshuan një tufë lesh;
këtu shkuanë ca kafshë,
lëshuan një tufë kashtë,
dhe duallnë gjëmbat jashtë.

Frashtan — Gjirokastër, 1945

1) Thuhen me zë të ulët nga ai që i është mpirë këmba ose krahu.

129

KUTU MBI KUTU SHBI

Kutu mbi,
kutu shpi,
kutu gjarpëri kërthi,
kutu një fill kashtë,
merre e hidhe jashtë[1].

Lopës — Filat
Xarrë — Sarandë, 1970

1) Vargje që i thotë me zë të ulët njeriu që i është mpirë këmba ose krahu, për t'u çmpirë.

130

D'EMËR ZOTIT D'EMËR BIRIT

D'emër zotit, d'emër birit,
edhe pelister të mirit![1]
I lidhur, i pazglidhur;
i lidhur, i pamundur.
Ik nga këtu, do të mund,[2]
shko dë male, njor në fund!
Atje gjelit thirma s'ndihet
e donjë me njatrën s'njihet.
Atje ç'ishtë nat' e vapë
e kush vete, s'priret prapë.[3]

Arbëreshët e Greqisë
Eleusinë, 1980

1) Dy vargjet e para përsëritën 3 herë.
2) Të iki, (të shpërndahet, të largohet) nga të mundet e liga.
3) Për t'u pasur parasysh afria e formulave të yshtjeve arbëreshe të Greqisë me ato të truallit kombëtar rreth largimit të të ligave në një botë të largët e të panjohur («tej Detit Zi», te s'këndon as pulë as gjel etj.).

131

O TI MAL I KOLLOVOZIT

O ti mal i Kollovozit,[1]
na març të ligat e motit!
O more ti mal i zi,
na jep shëndet e fuqi!

Leskovik — Kolonjë, 1955

1) I ferrit (xhehenemit).

132

ME SA I DHEMB GJA CARACIT

Me sa i dhemb gja caracit,
njaqi më dhimt mu!
O carac e im vëlla,
vlla s'të kam e vlla do t'zaj,
ethet e mia ty do t'i laj.
O mal i Dajtit,
më marrç të ligat e shtatit!
O mal i zi,
më jep shëndet e fuqi!
O zogu fluturac,
marrç të ligat e fukarasë!
O zogu i zi,
marrç të ligat e djalit të ri!

Tiranë, 1955

133

SIÇË ÇAHET KJO LAGJINË

Siçë çahet kjo lagjine
edhe bënet copra shumë,
ashtu edh' ajo e liga
e të mbitetë dë lumë!
Jah, të çahetë e liga,
si kjo lagjine e tëra.
Haroja[1] copra të bënet,
dë si Harosë gjilpëra!
Mbitu, Haro, çahu copra
si ato çikrat e lagjines,
natë edhe gozhda sivet,
i qorepsur le të bënesh.
Shter një si, re inizot,
jep Haros shkepëtimë!
Ga ti u lemë, gati jemi,
pse e le e na merr, s'e dimë.

Arbëreshët e Greqisë
Eleusinë. 1980

---

1) Haroja ndoshta Aresi, perëndia e luftës, sipas mitologjisë greke (Marsi i romakëve). Aresi (Arosi Harosi), që banonte në

rajonet veriore (në Traki) përfytyrohej si personifikim i furtunave e i stuhive. Ndonëse i biri i Zeusit dhe i Erës, ai nuk gëzonte simpatinë e perëndive të Olimpit. Atij i pëlqenin zhurmat e luftës, vrasjet, gjakderdhjet etj. I bënin shoqëri Erisi (perëndesha e grindjeve të përgjakshme), Enyo (perëndia e shkatërrimit të qyteteve), Deimosi e Fobosi (të tmerrit e terrorit).

134

TI SHIN GJERGJI KAVALLAR

Ti Shin Gjergji kavallar,[1]
m'at' të glatinë kondar,[2]
shteri dhemonit një zjarm,[3]
për t'i diqen ato armë!
At' të ligën te shërosh[4]
e t'e vrasësh kur t'e çosh.[5]
Merr të ligënë ga kurmi,
t'hapen sitë, t'i vinj' gjumi.[6]

Arbëreshët e Greqisë
Eleusinë, 1980

1) Kalorës
2) Heshtë, shtizë.
3) Digje djallin (të keqen).
4) Të ligën ta shërosh.
5) Kur ta gjesh.
6) E thonë për të yshtur fëmijët e sëmurë, por ndonjëherë edhe për t'i zënë gjumi (kur nuk flenë).

135

O MADHNI ME PLOT FUQI

O madhni me plot fuqi,
pritja smundjen njiti,[1]
hiqja, hiqja si me dorë,
shën Gjergjit tjetër nji kunorë![2]

Ulqin, 1976

1) Gra të moshuara «që bënin prime» dilnin me të sëmurin ditën e shën Gjergjit në mëngjes pranë ndonjë burimi dhe pritnin të lindte dielli. Ndërkaq drejtonin një thikë të vjetër tri herë nga dielli duke thënë vargjet e më sipërme.

2) Ka qenë zakon të dërgohej një kurorë me lule të njoma në atë vend ku bëheshin primet (kur shërohej i sëmuri).

136

PO T'LAN NANA BIR-O

Po t'lan nana bir-o,
me t'tana të mirat-o.
Po t'lan nana me uj' të nxetë,
djali jem shkoft' përpjetë,
gjith' patt jet' edhe shnet.
Ujt shkon teposht' — teposhtë,
t'ligat djalit ja largoftë![1]

Turjakë — Rahovec, 1973

1) Thuhej nga nënat ditën e shën Gjergjit, kur lanin fëmijët. Në ujë hidhnin lule dhe gjelbërime të stinës.

137

UJËT TEPOSHTË

Ujët teposhtë,
unë terma!
T'ligat Drini,
t'mojrat unë!
Patsha shëndet,
patsha, kismet![1]

Veleshtë-Strugë, 1976

1) Në festën e Eremisë (në 1 maj) fshatarët e Strugës, sado larg që të ishin, zbritnin në Drinin e Zi dhe laheshin ose spërkateshin me ujërat e tij, duke thënë me zë të ulët vargjet e mësipërme.

138

KAH T'UM SHEH SYNI I SYNIT

Kah t'um sheh syni i synit,
i ardht' tamli dhenve t'NN-it!
Kah t'um sheh syni i zi,
u ardht' tamli dhenve t'mij!
N'mot t'sontit p'e tuni tpinin,
mos na u nalt tej n'dit' t'dimnit!
T'lumet na-o n'ket konak,
de t'i mjelim për marak.
T'lumet na-o për ket ditë,
i shohim kingjat tuj u rritë.
T'lumet na-o për ket natë,
na prift' e mara, u bafshim rahat.[1]

Rahovec, 1976

1) Thuhej nga amvisat kur tundnin qumështin për herë të parë ditën e shën Gjergjit.

139

A TA PRES

— A ta pres?
— Jo, se bon me thes.
— A ta hosh?
— Po, se ban me kosh.
— A t'i sojll?[1]
— Mo, se bon me kojll.[2]

Veleshtë — Strugë, 1984

---

1) A t'i sjell?
2) Prodhon me killë.
Kur bëjnë shërbime nëpër kopshtije (në janar), dy veta me kashtë thekri në sqetull dhe me sopatë në dorë u afrohen drurëve një nga një dhe thonë vargjet e mësipërme. Pastaj lidhin kashtën e thekrit pas trungut të pemëvet.
Në krahinat veriore të ish-besimit fetar katolik këto rite (matja e pemëve për t'i prerë, lidhja me kashtë etj.) bëheshin rregullisht natën e Buzmit.

140

ÇA PO BËN ATY

— Ça po bën aty?
— Po lidh gojën e ujkut.
— Ça po bën aty?
— Po lidh gojën e dhelprës.
— Ça po bën aty?
— Po lidh gojën e nepërkës.
— Ça po bën aty?
— Po lidh gojën e larashit.
— Ça po bën aty?
— Po lidh gojën e sqyferit.
— Ça po bën aty?
— Po lidh gojën e zogjëve.[1]

Duhanas — Berat, 1965

1) Ditën e Verës, në disa krahina, kishin zakon «të lidhnin gojën» e kafshëve apo të shpendëve që dëmtonin bagëtinë, njerëzit a prodhimet bujqësore. Në mëngjes herët një grua e moshuar lidhte nyjë një silxhim, duke thënë vargjet e mësipërme. Këtë e hidhnin në kryqëzime rrugësh.

141

ÇAR' PO QEP ASHTU

— Çar' po qep ashtu?[1]
— Qep syt' e gjarpërit.
Un' e pafsha dhe e vrafsha,
ai më paft' e mos më ngaftë![2]
— Çar' po mbyll ashtu?
— Mbyll gojën e ujkut.
— Çar' po mbyll ashtu?
— Mbyll gojën e skiles.[3]

Divjakë — Lushnjë, 1955

1) I njëjti rit si në këngën e përparme, por që bëhej duke qepur një copë plaçkë.
2) Zgjatej duke përmendur edhe emra zvarranikësh të tjerë sidomos nepërkat e shigjetat.
3) Zgjatej për çakallin, ariun etj.

142

OJ SHOÇE XHIT JE TO BO ATËJ

— Oj shoçe, xhit je to bo[1] atëj?[2]
— Jam to lidhë moknat e Ditës Verës,
jam to lidhë flamat,
jam to lidhë bollat,
jam to lidhë gjarpëjtë.
jam to lidhë mijtë,
jam to lidhë ukin[3],
jam to lidhë vjetllën,
jam to lidhë dhelpnën,
jam to lidhë ata[4] si m'dashtë keç,
jam to lidhë ata si m'boftë keç,
jam to lidhë hasmin,
jam to lidhë hasmëtoren,
jam to lidhë mugjitoren[5],
jam to i lidhë e jam to i bo gjur e gjurec.
— Po i gozhdoj e po i thumoj
t'mos nisen me ardhë te shpëja[6].

Bicaj — Kukës, 1982

---

1) To bo = duke bërë
2) Atëj = aty
3) Ukin = ujkun
4) Ata (atâ) = atë
5) Mugjitoren = magjitoren
6) Te shpëja = në shtëpi

Ky dialekt zhvillohet kur vajzat shkonin «për me lidhë moknat».

143

LIDHET ZOT

Lidhet zot
e nata e Mojt
e dita e verave:
Un' pak e zoti shumë
Po i lidhim shtrigat!

Dukagjin — Shkodër, 1964

145

MOJ LARASKË, KAKARASKË

Moj laraskë, kakaraskë,
na këtë dhemb të drunjtë,
më jep një të shtrunjtë[1].

Ersekë — Kolonjë, 1987

1) Të shtruftë; prej bronzi. Metali që kërkohej në fillimet e këngës ka qenë bronzi. Më pas, siç duket në disa variante të përmbledhjes së Mitkos e të Diņes, është bërë argjendi e floriri.

144

UN' TUND FIGNË

Un' tund fignë,
fiiku tund dhenë,
dheu tund denë,[1]
të m'i kthej' nuses bylmenë![2]

Seman — Fier, 1949

1) Detin.
2) Bulmetin: qumështin.
Kur i ikte qumështi një nuseje. shkonte me të vjehrrën ose me një plakë tjetër pa zbardhur drita në agim, pranë një fiku. Plaka me fytyrë nga deti, tundte një degë fiku, duke thënë 3 herë vargjet e mësipërme.

146

HËNËZË MOJ HËNËZË

Hënëzë, moj hënëzë,
na një të kokallimtë[1],
am një të florimtë.

Karbunarë — Paramithi
Fier, 1960

1) Fëmija i thotë këto vargje kur heq dhëmbët e qumështit dhe i hedh mbi çatinë e shtëpisë.

147

DIELL-O DIELL-O

Diell-o, diell-o,
hidhna një thes miell-o
të martojmë lalënë,
lalë këmbëçalënë,
që na bëri djalënë,
në krie të vatrësë.[1]

Gjirokastër, 1962
Bob. 215/9

1) E thoshin të vegjlit kur delte dielli, pas shiut. (Transkriptimi muzikor nr. 7)

148

HITHNA NJË THES MIELL-O

Diell-o, diell-o,
hithna një thes miell-o;
të martojmë lalën;
t'i japim të çalën;
të martojmë Vangjelinë,
t'i japim Kostandinë[1].

Malëshovë — Përmet, 1957

1) Thuhej nga të vegjlit, pas një moti me shi, kur fillonte të delte dielli.

149

DIELL, DIELL

— Diell, diell,
t'jap një kupë miell,
mos ke parë bukuroshen?
— Bukuroshja pas mua shkoi,
as më pa, as më shikoi.

Jug, 1929

150

AMA BUK' E MIELL-O

Diell-o, diell-o,
ama buk' e miell-o,
sa të hamë prëmë,
bashkë me time ëmë;
sa të hamë prapë,
bashkë me tim atë.

Margëllëç — Fier, 1970

151

HAN' E MIRË KOFTE

Han' e mirë koftë,[1]
han e mrapshtë koftë,
kallamoqi na bleroftë![2]

Tropojë, 1952

1) Qoftë.
2) Thuhej kur hidhnin farën e parë.

152

HAN' E RE

Han' e re,
drapnore,
un' puntore,
ti kyvet
e un' shnet.[1]

Dukagjin — Shkodër, 1972
Bob. 877/8

1) Thuhej nga vajzat kur shihnin për të parën herë hënën e re.

153

HAN' HAN' E RE

Han', han' e re.
ti e re, un' e re;
ti hantore,
un' puntore.[1]

Tropojë, 1969
Bob. 692/12

1) E thoshin gratë kur shihnin hënën e re për herë të parë.

154

HËN' E RE VASH' E RE

Hën' e re, vash' e re,
ti në gjum e un' në punë,
ti gërshet e un' shëndet.[1]

Poro — Vlorë, 1964

1) Këndohej kur shihnin hënën e re.

155

HANA E RE HANA E RE

Hana e re, hana e re,
vash' e re, vash' e re,
ti nalt e un' përdhe;
ti kunorën e artë,
unë gërshetin e gjatë.

Reçan — Gostivar, 1976

1) E këndojnë vajzat natën e shën Gjergjit kur dalin ndër të lashtat «për të kullotur flokët».

156

HËNË MOJ HËNË

— Hënë, moj, hënë,
mos pe baban' tënë?
— E pashë në fushë,
më puthi në gushë;
e pashë në arë,
më dha paranë,
bleva koshallvanë;
më dha mexhiten,
bleva simiten.[1]

Gjirokastër, 1938.

1) E këndonin fëmijët kur dilte hëna e re.

157

SI KOFT' HANA

Si koft' hana,
ma past ana.
Hana jashtë,
zemra ma dashtë;
hift' për tul
e jo për asht.
Hana mrena,
ma dasht' zemra.[1]

Markaj — Tropojë, 1959

1) **E** thonë kur hanë djathë të ri, misër të ri e pinë qumësht të ri.
Vargjet 5-8 duken si shtesa me ngjyrë humoristike.

158

HANË-HANË REJA

Hanë-hanë reja,
buzëpalareja.
Un' shëndet e ti shëndet,
ethet e mija në det![1]

Krujë, 1986

1) Metrat e këngëve rituale, shpeshherë janë të paqëndrueshëm, siç shihet edhe këtu, ku dy vargjet e para janë 6 rrokëshe dhe dy të fundit 8 rrokëshe.

159

HËNË E RE

Hënë e re
vashë e re,
ti gërshet,
u shëndet.
Ti si drapër,
u si gjarpër[1].
Ti me kokë tambura[2],
u qesenë plot para!

Mursi — Sarandë, 1970

1) I shkathët si gjarpri.
2) Hënë e plotë.

160

HËNËZ MOJ HËNËZ

— Hënëz, moj hënëz,
mos më pe babanë?
— E paçë në fushë,
E putha në gushë.

Janjar — Sarandë, 1960

161

TIMI U ÇOFT' MA PËRPJETË

Timi u çoft' ma përpjetë,
të tan' kofshim mir' me shnet!
Timi u çoft' edhe ma përpjetë,
shpia jon' koft' mir' me shnet!
Timi u hapt' nëpër tokë,
baçicës i shkofshin mir' loptë![1]

Junik — Gjakovë, 1971

1) Këndohej në Kosovë nga të vegjlit, kur bënin zjarret e Natës së Verës.

162

ATEJ PUL' E BARDHË

Atej pul' e bardhë,
këtej pul' e zezë,
s'ke fajde ka unë,
hidhu në të tjerë![1]

Dragomi — Paramithi
Elbasan, 1967

1) Thuheshin prej të vegjëlve për të larguar tymin.

163

JA E DHROMI EC' E SHKO

Kutu bij,
kutu frij,
kutu ngarko;
atje shkarko;
ja e dhromi, ec' e shko![1]

Karbunarë — Paramithi
Vlorë, 1967

1) Edhe këto vargje thuhen për të larguar tymin. (Shih shënimet e këngëve të përparme).

164

NJERGULL — NJERGULL

Njergull,
njergull,
paranjergull,
hik, hik,
se t'arrejmë.[1]
Gur' i zi,
me t'vra,
me t'pre,
me t'fut
me t'mlu
me gur' e dhe[2].

Dragu — Dibër, 1970
Bob. 761/9

---

1) Se të arrijnë.

2) Kur binte mjegull e dendur, të vegjlit thoshin vargjet e mësipërme dhe e goditnin mjegullën me gurë për ta shpërndarë. Kënga është paraqitur nga ana metrike, ashtu siç ka qenë regjistruar prej mbledhësit me vargje 2-4 rrokëshe. Këto janë zakonisht edhe vargjet karakteristike të këngëve rituale. Por ato mund të ndërtohen edhe me vargje gjashtë a tetërrokëshe: Njergull, njergull, paranjergull,/ hik, hik, se t'arrejnë.. Gur i zi, me t'vra me t'pre...

Krs. K.Zelaj, Kolesjan-Kukës, 1958; O. Xhatufa Kërrnajë-Tropojë bob. 11.655, 1972.

Re-re, koko re,
je në qiell, zdrik mbë [illegible].
të bleva një par dizgjé,
më të mira seç i ke!

Nikolicanj — Paramithi
Aliban — Vlorë 1955

166

RE-RE BUKUR RE

Re-re bukur re,
lëshona shinë më dhe!
Pa të dërgoj lalën,
të të tundë djalën;
djalën e Veliut,
çupën e kadiut.[1]

Malëshovë — Përmet, 1957

1) Thuhej nga të vegjlit verës, kur nuk binte shi dhe kur shihnin të dilte në qiell ndonjë re.
Katër vargjet e fundit duken si shtesa që kanë zëvendësuar vargje të tjera rituale të zhdukura.

167

FRIJ MOJ JUGË FRIJ MOJ ERË

Frij moj jugë, frij moj erë;
me ngadalë jo me terrë[1],
të dalin retë këtej,
të na bjerë shi në verë,
shi i butë e me karar,
tri në prill e tri në maj.
Në gusht e në allonar,
të bëhet misër e bar,
zahire për gjë të gjallë,
grur' e thekër plot hambarë,
të na dalë zi e parë,
të na metet dhe për farë.

Zhulat — Gjirokastër, 1972

1) Jo me stuhi.

168

RONA-RONA PEPERONA

Rona-rona, peperona,
bjerë shi në arat tona;
të na bëhet misëria,
të hanjë varfëria;
të na bënet bereqeti,
të hanë gjithë mileti!

Rehovë — Kolonjë, 1937
Bob. 155/22

---

1) Mbeturina kultesh kanë qenë edhe praktikat rituale të Ronës a të Dordolecit që bëheshin gjatë thatësirave të verës për ndjelljen e shiut. Në të tilla raste grupe të vegjlish mbulonin me degë të gjelbra me fier, qingla etj. një shokun e tyre të zhveshur lakuriq dhe shkonin shtëpi më shtëpi e lëmë më lëmë, duke kënduar vargjet e mësipërme. E zonja e shtëpisë i hidhte fëmijës së veshur me gjelbërime një enë me ujë dhe e gostitte me një lugë gjalpë, vaj, miell, vezë. Këto i gatuanin dhe i hanin së bashku. Ronën a Dordolecin e prishnin buzë një lumi a përroi. Si Dordolec visheshin zakonisht djemtë. Por në ndonjë fshat (si në Borovë e Rehovë të Kolonjës) thuhet se Rona kanë qenë bërë edhe vajzat e pafejuara.

Në ndonjë krahinë si në Labëri e Mirditë për të ndjellë shiun thereshin edhe bagëti. Kurbanet në të tilla raste bëheshin në

vende të caktuara, p.sh. në Qafë të Dërrasës në Kudhës e në Qafë të Kikës (Labëri), në Grykën e Shkallës (Tepelenë) etj.

Daljet e fundit për shi kanë qenë bërë në ndonjë fshat rreth viteve 30.

(Transkriptimi muzikor nr. 8)

169

RONA-RONA PEPERONA

Rona-rona, peperona,
hojlije, hojlije,[1]
bjerë shi nër arat tona.
Shkon një zogë bishtëbardhë
me një pollog në gojë,
një pollog e dy tre okë,
të na mbush' hambarët plot.[2]

Potkozhan-Pogradec, 1957
Bob. 155/3

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) E thoshin të vegjlit në verë, kur bënte thatësirë për të ndjellë shiun.

170

RONA-RONA PEPERONA

Rona-rona, peperona,
bjerë shi mbi arat tona.
Të bënetë grurëtë,
të hanë kahurëtë;
të bënetë misëria,
që të hanë turqëria.

Berat, 1878

171

RONA-RONA TRIPERONA

Roṇa-rona, triperona,[1]
bjer(ë) shi dë arat tona,
të na ritet bereqeti,
më shumë gruri se thekri.
Vaj-vaj, dodole![2]

Hoçisht — Korçë, 1962
Bob. 205/9

1) Ndoshta nën ndikimin e një etimologjie popullore: tri perona. Në variantet e tjera peperona.
2) Muzikalisht ky varg interpretohet me karakter elegjiak. (Transkriptimi muzikor nr. 9).

172

DORDOLEC BJERNA SHI

Dordolec, bjerna shi,
të na bëhet misri i ri;
misri i ri sa trari,
të na mbushet hambari!

Jug, 1947

173

DORDOLEC BJERË SHI

Dordolec, bjerë shi,
o i zoti shënd Illi!
As na ep një pikë shi,
të na bëhet grur' i ri,
një karroqe, një kalli.
Ju shenjtorë, piamberë,
që ju lutemi përherë,
lutij zonjës shën Mëri
me kryq e me luvari.[1]

Berat, 1878

1) «Këto vargje thuheshin nga të vegjlit, kur donin të binte shi». (Shën. i Mitkos).

174

DORDOLEC MOR DORDOLEC

Dordolec, mor Dordolec,
Dordolec me shpëndëra,
ja sonte, ja nesër mbrëma,
të na bjerë shi me shtëmba.
Sot ja nesër të bjer' shi
të na bëhet misëri,
misëri dhe gruri...

Bishan — Vlorë, 1965

175

DORDOLEC ME SHPËNDËRA

Dordolec, me shpëndërà,
sonte e nesërë mbrëma,
bjerë shi, bjerë me shtëmba;
bjerë, o shi, me rrëke,
se u dogjën gur e dhe!

Sevaster — Vlorë, 1965

176

DARDALEC O DARDALEC

Dardalec, o dardalec,
ban dua të gjerë shoj[1],
t'boen grunat me kalloj.
Dardaleci shkon ke daja
t'boen groshat me bishtaja.

Veleshtë — Strugë, 1976

1) Shi (me diftongimin e i-së së theksuar në oj, karakteristikë e kësaj të folmeje: Kështu edhe më poshtë: kallij-kalloj).

177

SHIU NË QERSHUR

Shiu në qershur,
dheu mamur;
shiu në korrik,
matet me shënik;
shiu në gusht,
matet me grusht.

Elbasan, 1930

178

SHI-SHI LAG O SHI

Shi-shi, lag, o shi,
porsi uji në mulli,
t'bahet bereqet' i ri.
Kshtu si gurët qi janë lagë,
sonte shiu raftë me shtrugatë.
Shi, shi, shi o i madhi zot,
na shendo ti neve sot!
Shiu natën tuj bumullue,
nesër gurt kem' me i largue.[1]

Ulqin, 1976

1) Kur bënte mot i thatë, fëmijët në Ulqin shkonin buzë detit, duke thënë vargjet e mësipërme. Aty hidhnin zaje. Po të binte shi me rrëmbim, i largonin këto zaje që të mos kthehej shiu në shtrëngatë.

179

FALE O ZOT BEREQET

Fale, o zot bereqet,
sa mot, sa sivjet
elb e grur, e kallamoq,
u baft' sheka dymdhet' grosh![1]

Gjakovë, 1930

1) Duke recituar këto vargje hidhej edhe ujë përpjetë, që të binte në trajtën e shiut (element magjik i llojit imitues).

180

SHI-SHI BJERNA SHI

Shi-shi, bjerna shi,
të na bahet misri ri,
ta ken' njerzit shpi për shpi.
Misri ri me bereqet,
ma shum' mot se simjet.

Labinot — Elbasan, 1954

181

FALNA O ZOT SHINË

Falna, o zot, shinë!
Sa vjet-bereqet!
Elb e grun e kallamboq,
zot, na i mush gavixhat plot!
Sa gavixha kena n'shpi,
na i mbush misër të ri!!

Shkodër, 1962

1) Kur nuk binte shi verës, fëmijët shkonin në breg të Drinit duke thënë vargjet e mësipërm. Si mbaronin këngën, hidhnin gurë në ujë.

182

BJERË SHI O PERËNDI

Bjerë shi. o perëndi,
të na bënet misëri,
misëri e gruri,
të hajë kauri;
kauri i varfër,
gjashtë muaj zbathur,
zbathur edhe zhveshur,
me llërë përveshur.

Zagori — Gjirokastër, 1958

183

SHI-SHI BOBO SHI

Shi-shi, bobo shi,
hipi plaka mbi shtëpi,
bëri tre kuleç' të zi
një për mua, një për ti,
një për Xhiko plakënë,
që cimbisi djalënë.[1]

Gjirokastër, 1961
Bob. 215/10

1) Variante për të joshur shiun.

184

YLYVER O YLYVER

Ylyver, o ylyver,
eja dhe mua më merr;
ylyver, o rathë-rathë,
të kaloj, të bënem djalë[1].

Gumenicë — Vlorë, 1944

1) Thuhej nga vajzat kur dilte ylberi në qiell. Sipas besimeve të kota popullore, «po ta kalonte vajza ylberin, bëhej djalë».

185

O MOJ BORË BOR' E RE

O moj borë, bor' e re,
mirë se na erdhe,
që shkele këtu përdhe
edhe vendin e zbardhe[1].
Ti e ftoht' e un' e ngrohtë![2]

Jug, 1908

1) Fjalët *erdhe, zbardhe,* (në v. 2 e 4) kur recitohen, theksohen në rrokjen e mbrapme, për t'u përshtatur kështu me 8 rrokëshat e vargjeve të tjera.

2) Thuhej nga të vegjlit kur binte bora e parë

186

ZBORË MOJ ZBORË

— Zborë, moj zborë,
mos pe Hasan Qorrë?
— E pashë në Vlorë
me treqint kumborë;
kumborët e Zeqosë,
Zeqos së Malilesë,
buzëkarafilesë,
asaj xhixhileresë[1].

Gjirokastër, 1962
Bob. 215/11

1) E thoshin të vegjlit kur binte bora e parë (transkriptimi muzikor nr. 10)

187

BIE BORA FIJE-FIJE

Bie bora fije-fije,
pa shiiko seç paska hije.
Mbuloi drrasa, mbuloi dhenë,
s'kanë zoqtë ku të venë;
s'kanë zoqtë se ç'të hanë,
t'u japin ata që kanë.
— Ipuni, o ju që kini,
të ngordhinë mos i lini.

Zagori, — Gjirokastër, 1958

188

O MOJ BOR' E BUKUR

O moj bor' e bukur,
e bardhë, e dukur,
na po bëjmë bukët,
që të marrëm lugët;
të luajm' me topa bore
si zërat e malit Çorre.

Kudhës — Vlorë, 1987

189

BIE BORA FLOKË-FLOKË

Bie bora flokë-flokë,
mbi shtëpi të gjori Gjokë[1].
Gjori Gjokë pa këmishë,
s'ka me se të vej' në kishë.
dogji mjekërrën me pishë.
Gjori Gjokë copë-copë,
s'ka me se të dal' në shokë.

Zagori — Gjirokastër, 1953

1) Njëri prej banorëve të varfër të fshatit. Krs: KBQD i f. 136.

190

ARDHI DIMBRI

Ardhi dimbri,
ardhi zijà,
me lot qajnë
varfërija.

Pogradec, 1944

191

O JU MOJ LULE

O ju, moj lule,
ju, moj burbuqe,
disa të bardha,
disa të kuqe;
o kur të çilni,
të na gëzoni,
male e fusha
t'i hijeshoni[1].

Veleshtë — Strugë, 1976

1) Këndohet në pranverë nga vajzat kur fillojnë të çelin lulet e para.

Është paraqitur me vargje pesërrokëshe, por, duke pasur parasysh rimat e çdo distiku (dyvargëshi), kënga përbën një shembull tipik të përdorimit të dhjetërrokëshit.

192

JU MOJ LULE GJITH' SA JINI

— Ju, moj lule gjith' sa jini,
të parën lule çin[1] kini?
— E para lulekaçezà[2],
e dyta manushaqejà,
e treta lulverejà,
e katërta trëndelina,
e pesta lulemarina.

Shpat-Elbasan, 1937

---

1) Cilën.
2) Lulja e parë që çel në pranverë (ka petale të bardha në të verdhëme a në ngjyrë vjollce).
Vargjet 3, 5 theksohen në rrokjen e fundit, duke formuar kështu tetërrokësha të rregullt.

193

BEHARI NA ERDHI SIMJET-E

Behari na erdhi simjet-e,
dimri na iku,
dunjaja na u zbukurua,
na u bo si xhenet, oj xhenet.
Ju moj lule, të gjitha sa jeni,
ma t'parën-o cin e keni?
Ma të parën kemi karafilë,
përmbi trëndafil, oj trëndafilë[1].

Loderisht — Strugë, 1973

1) Katër vargjet e para i përkasin krijimeve të Nezim Frakullës. Vijimi ka në bazë vargjet e këngës së njohur të luleve. Edhe këtu kanë depërtuar elemente të mjedisit qytetar (karafilat e trëndafilat, në vend të luleve tradicionale-kaçes, manushaqes etj.).

194

PO VJEN MOTI PREJ SË MBARI

— Po vjen moti prej së mbari,
çilin vjollca e zymbyla;
myzhde, djal', se vjen behari,
bahçet mbushen me bylbyla.
Mori lule, moj bërbuqe,
a s'na çilni, moj, na gzoni,
sa jeshile, sa të kuqe
e dyrnjan' ç'e zbukuroni.
Mori lule, t'gjitha sa jeni,
ma të parën cilën keni?
— Vezir kemi dranofillen,
padishah kem' karajfilen[1].

Shkodër, 1959

---

1) Këngë karakteristike e mjedisit qytetar shkodran. Këtu, shpeshherë, këngët për përtëritjen e natyrës dhe bukurinë e luleve shprehin botën shpirtërore të të rinjve.

195

NDË VAFSHI PËR MANUSHAQE

Ndë vafshi për manushaqe,
mermëni dhe mua,
Pa ndë mos diça t'i mbleth,
psomëni dhe mua.
Ndë mos diça t'i bëj tufë,
psomëni dhe mua.
Tufë-tufë manushaqe,
t'i rënditimë mbi faqe[1].

Jug, 1978

1) Këngë karakteristike që këndohej nga vajzat në disa krahina të Jugut (Pogradec, Korçë etj.), kur shkonin për të mbledhur lule në festat pranverore. Mbeturina të këtij kulti kemi edhe në vise të tjera të Shqipërisë si edhe në ngulimet arbëreshe. Ditën e Verës të rinjtë në Elbasan, mbledhin manushaqe e karakafte. Mirditorët stolisin kokën dhe trupin me lule. Arbëreshët e kishin zakon të dilnin për lule një natë nga fundi i prillit. Në Odonia Albaneze, Palaco Adriano etj. (Siqeli) të rinjtë e sapomartuar varnin në ballkon kurora lulesh të verdha, të lidhura me kordele ngjyra-ngjyra. Dukagjini e ka quajtur këtë ditë «E diela e luleve» ose «Dita e endet» (e endjeve) apo «Dita e Maranajve».

196

VINË VASHAT VALLE-VALLE

Vinë vashat valle-valle[1],
gushë, gji e stolisurë;
një pëllumb, një sysorkadhe,
na vjen m'e mbollisurë.
Shoqe-o në bregë-za,
më mirrni edhe muë-za,
nër pyj' e korijë-za.
Në mos diça të bëj tufë,
më lini, moj, atje-në.
Në ju pyet njeri për mua,
«Ç'u bë flokbalosheja.»
i thoni, «në një përrua,
e zu gjarpërusheja:»
i thoni «e hëngri krymbi
atë belkëputurën».
«Nd' e zu gjarpri, u shëroftë,
nd'e zu trimi, u trashëgoftë»[1].

Pogradec, 1944

---

1) Edhe ky motërzim i zgjeruar këndohej «Ditën e Luleve», kur venin vajzat në mal për të mbledhur manushaqe, poleska, ka-

çe etj. për llazore. Me gjithë përpunimin e ndonjë vargu nga Lasgush Poradeci, kënga e ruan frymën e saj popullore.

Këngë për dulet sipas materialeve arkivore të IKP («Këngë të festave kalendarike» Vëll. III) janë mbledhur në: *Kolonjë*-Rehovë; *Korçë*-Bradvicë, Dardhë. Sinicë, *Përmet*-Kreshovë; *Pogradec*-Pleshisht, Potkozhan; *Shkodër*-Qytet, *Vlorë*-Piqeras, Tragjas; Strugë.

197

KUKUREKU I ROJ

Kukureku[1] i roj,[2]
rumi sojt e moj,[3]
njçin e nivjet,
kurrxho mos m'i xhet[4].

Veleshtë — Strugë, 1984

1) Lulja e kukurekut (e shpendrës), që çel para luleve të tjera në këto vise, mbahet si simbol i ardhjes së pranverës.
2) I ri. Kthimi i i-së së theksuar në *oj* është karakteristikë e të folmeve të këtyre krahinave.
3) M'i ruaj sytë e mi.
4) Kënga sjell elemente kulti për lulet e para.

198

SIPËR E MA SIPËR-E

Sipër e ma sipër-e,
dalim majë malit-e,
mu në shesh të luleve.
Vin' e na këpusin-e,
tufë na ujdisin-e.
mu në kry' na vinin-e,
mu në gjoks na shtinin-e[1].

Gjinar — Elbasan, 1937

1) Fjala e fundit e çdo vargu lexohet e theksuar në zanoren e shtuar: sipër-ë, malit-ë etj. (8 rrokësh).

199

ÇELI LULJA E KUMBULLS-O

Çeli lulja e kumbulls-o,
në faqe të s'bukurs-o
Hajd', e bukur-o, me ne,
në Vijos', në dhethit tanë.
Ungju, bij' e merru erë,
se nuk gjinden si çdoherë,
mot për mot e nganjiherë[1].

Shpat — Elbasan, 1937

1) Këtu duhet të jenë bashkuar elemente të këngëve të mërgimit ose të ceremonialit të dasmës (ndarjes së vajzave nga gjiri i shtëpisë, me martesat larg familjes).
Krs. KPL$_1$, f. 269; KP, f. 9.

200

O SHKËNDI SHË MËRI

O shkëndi, shë Mëri,
ajde më këtejza,
të të ve në dorë,
të të jap një mollë,
të të ve kurorë![1]

Dardhë — Korçë, 1960

1) Thuhet nga të vegjlit kur shohin xixillonjat e para në pranverë.

201

BUKURE

Bukuré
bukuré,
hyn në maxhe,
n'palaré.[1]

Kukës, 1964

1) E ligjëronin të vegjlit kur dilnin xixillonjat e para. Atëherë zinin një xixillonjë dhe e futnin në magjen e bukës. Thoshin se kështu «shtohet bereqeti».

202

REZE-REZE BUKUREZE

Reze-reze, bukureze,
shiko prapa se u ndeze,
me kandil, me fitil,
me vajguri, me vaj t'mirë.[1]

Vlorë, 1960

1) U këndohej bukurezave (xixillonjave) në pranverë.

203

BUBURRE-BUBURRE

Buburre-buburre[1],
në je jona, rri bë dhe.
Në s'je jona ngreu e ik,
hoj n'Agji[2], hoj në Shenicë[3].

Arilë — Margëlliç
Fier, 1960

1-3) Vargje që recitojnë fëmijët kur kapin ndonjë buburrickë. E vënë mbi shputë të dorës dhe e pyesin në është e fshatit të tyre. Po të mos jetë, ajo fluturon dhe ikën, shkon nga Arila në Angji ose në Shenicë, (dy fshatra shqiptare të besimit kristian).

204

MOLL' — MOLLA KUQE

Moll' — molla kuqe,
kampipiruqe,
me shami të kuqe,
vajza u ba nuse!

Durrës, 1964

1) Recitohej nga të vegjlit kur dilnin mollëkuqet (insekt me pika të zeza — Coccinella semptempunctata). Atëherë zinin një mollëkuqe, e vinin në pëllëmbë të dorës dhe e linin të fluturonte. Kur ikte ligjëronin: «Iku, iku, u ba nuse!» Në disa vende të tjera thoshin: «Andej do ta kem nusen unë» (Nga ai drejtim që fluturonte mollëkuqja).

205

MOLLAKUQE PIPIRUQE

Mollakuqe, pipiruqe,
kah shkosh, u fejosh,
kah ardhsh', u martosh[1].

Veri, 1965

1) Mollëkuqja në disa popuj nordikë (gjermanë, skandinavë etj.), mbahet si lajmëtare e martesës, prandaj këta popuj i këndojnë; *Lajmëtarja e virgjinës Mri,/ fluturo nga len dielli,/ fluturo nga perëndon dielli,/ fluturo atje ku rri dashuria ime.* Këtë bazë kuptimore kanë dhe vargjet e varianteve tona ku kërkohet të dihet se nga do të jetë nusja? Baza pra është e përbashkët.

206

MOLL' E KUÇE

Moll' e kuçe,
moll' e kuçe,
zenia Agimit
ni nuse[1].

Bicaj — Kukës, 1982

1) Vajzat e merrnin mollëkuqen në dorë dhe ndiqnin drejtimin e fluturimit të saj, duke besuar se andej do të fejoheshin vëllezërit e tyre.

207

MISKË-MISKË MUMURISKË

Miskë-miskë, mumuriskë,[1]
nga do më vij babai?
Pe posht' apo pe lart?

Dardhë — Korçë, 1964

1) E ligjëronin të vegjlit kur zinin një mumuriskë (mollëkuqe) dhe e vinin në pëllëmbë të dorës. Andej nga të fluturonte, thoshin, do t'u vinin njerëzit prej kurbeti (babai, vëllai etj.), (element i ri që zëvendëson drejtimin e marrjes së nuses. Krs. variantet e mëparshme).

208

BURBULLIC' E VOGËL-O

Burbullic' e vogël-o,
mblidh e mblidh e grumbullo:
kathe dita ti pëno:
po të gjitha humbur-o![1]

Karbunarë — Paramithi
Fier, 1965

1) Fëmijët këto vargje ia recitojnë bubuzhinkës (zhuzhinjës, vizhës), e cila punon pa u lodhur, por topat e vegjël që bën; më të shumtët i lë rrugës, pa i çuar në strehë të saj. Vargjet këndohen edhe për ndonjë njeri që punon pareshtur; por nuk arrin të përmirësojë gjendjen e tij ekonomike.

209

FLUTUR-FLUTUR,

Flutur-flutur,
zonj' e bukur,
palare,
bjer përdhe!
Tha bilbili,
trëndafili:
bjer përdhe,
palare![1]

Turan — Tepelenë, 1952

1) E ligjëronin të vegjlit kur ndiqnin fluturat.

210

FLUTUR-FLUTUR

Flutur-flutur,
zonj' e bukur,
krahëshkruar,
pse nxituar?
Jemi shokë,
të shkojm' tok.[1]

Panaja-Vlorë, 1965

1) Variant për kapjen e fluturave.

211

PILI — PILIVËSA

Pili — pilivësa,
m'qet tri kokrra vësa[1],
nji për mu, nji për ti,
nji për Gjonin e hallës Mii.[2]

Dajç-Shkodër, 1961

1) Vezë.
2) Ia thoshin të vegjlit pilivesës (kumuharkut). Me njërën dorë e mbanin për fletësh dhe me dorën tjetër pritnin vezët që lëshonte.

212

ZEK-ZEK

Zek-zek
bylyrek,
ngre nji gur,
ngre një shkrep,
zek, zek.[1]

Bulqizë — Dibër, 1970
Bob. 761/15

1) Thuhej për t'i larguar zekthin lopëve a qeve.

213

CIXULLI

Cixulli,
minxulli.
Nëm një cinxull
ta cinxoj,
pa pastaj,
ta dërgoj.

Pogradec, 1944

214

ZOT ME SE MË MUNDE QYQENË

— Zot, me se më munde qyqenë?
— Ndë mëngjez kur putha lulenë.
Moj goja me mjaltë e buzasheqer,
dhëmbë edhe dhëmballë gjithë me qemer,

Jug, 1878

1) Qyqja është një nga zogjtë simbolikë të këngëve pranverore. Kënga e saj nuk duhet t'i zërë njerëzit në shtrat. Prandaj fshatarët tanë, në festën e Ditës së Verës, çohen shpejt «për të mundur qyqen». Plogështia e përtesa janë në kundërshtim me ritet tradicionale.

215

QYQE-QYQE MONO QYQE

Qyqe-qyqe, mono qyqe,
ku e ke ti tyt vëlla?
Ta kan' therë posi ka,
posi ka e posi lopë,
ta vërvitën më një gropë;
gjaknë ia pinin me lugë,
mishnë ia hanin me bukë.
«Kuku» ia bën stan më stan,
kërkon motra të vëllanë.[1]

Damëz — Tepelenë, 1952

1) Për qyqen tregohet kjo legjendë: «Kanë qenë dy vëllezër duke qethur dhëntë. U bëhet djalli si cjap dhe vërret ndanë të kopesë. Vëllai i madh i thotë të voglit; — Shko e prite atë cjap. Kur vete ky, djalli humbet, por, kur kthehet djali te i vëllai ia nis prapë. «Meeee». Kështu dëgjohet disa herë deri sa të dy vëllezërit zihen shoq me shoq dhe vrasin njëri-tjetrin me gërshërët që po qethnin bagëtinë. Kur vjen e motra dhe i gjen vëllezërit të therrur, thërret e lebetitur: «U, u bëfsha qyqe! Dhe që prej asaj kohe, thuhet se u krijua qyqeja. Tani shkon duke bërë «ku ku ku» për të kërkuar të vëllezërit.»

Në frymën e kësaj legjende, qyqja është mbajtur më shumë si një shpend ogurzi. Siç shihet edhe nga materialet e këtij vëllimi, (qyqes), i këndohen edhe këngë të tjera, si ato për ndryshimet që gjen me ardhjen e pranverës, për «tregimin e moshës» etj. Në vendet e Veriut (Finlandë etj.) «qyqja është një shpend i hareshëm, lajmëtar i stinës së përtëritjes së natyrës dhe të jetës.

216

BEHARË Ç'E BËN KËTU

Beharë ç'e bën këtu,
moj murga qyqe [1],
dimbrit ike në kurbet.
Sa lezet të ka kur flet,
kur flet e kur qesh.
Hapi manushaqja,
s'bëre me shëndet.
Sa lezet të ka,
kur flet e kur qesh.
Beharë ç'e bën këtu,
moj murga qyqe,
dimbrin ç'e bën në kurbet.
Sa lezet të ka kur flet,
kur flet e kur qesh.
Hapi trëndafili,
s'bëre me shëndet,
sa lezet të ka,
kur flet e kur qesh.

Dardhë — Korçë, 1961

1) Përsëritet pas çdo vargu.

217

PSE S'KËNDON TI MURGA QYQE

Pse s'këndon, ti murga qyqe.
pse s'këndon?[1]
Kur të vij' koha e verës,
kur të mbushet mali gjethe,
mali gjethe, fusha lule,
fusha lule, fshati trima,
fshati trima, lumi nuse,
lumi nuse, sheshi çupa,
ahere do këndonj' unë.[2]

Dardhë — Korçë, 1946

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) Këndohej kur afrohej Dita e Verës.
«Qyqeja edhe dashurohej edhe druhej si ogurzezë.» (Pohim i raps.).

218

KËNDON QYQEJA MI LIST

Këndon qyqeja mi list,
o moj Mineja,
pa dëgjoni seç ia thotë,
moj bandilleja:[1]
Ata djemat që lash' vjet
ardha t'i martonj sivjet.
Ato çupat që lash' vjet
ardha t'i martonj sivjet.
Ata pleqtë që lash' vjet
ardha t'i mbulonj sivjet.
Ato plakat që lash' vjet
ardha t'i mbulonj sivjet.
Ata trimat që lash' vjet,
ardha ti gëzonj me djemtë![2]

Dardhë — Korçë, 1958

1) Të katër vargjet e para formojnë një farë refreni që përsëritet pas çdo distiku. Përsëritja e tij shmang deri në një farë mase monotoninë që krijohet me strukturën e njëjtë të distikëve. Edhe vargjet 2 e 4 me përbërjen dhe alternimet e tyre këtij qëllimi i shërbejnë.

2) Kënga i përket repertorit ritual të pranverës.

219

KËNDON ÇIÇJA LIS MË LIS

Këndon çiçja lis më lis:
jesemine moj,[1]
ata gjem çi i lash' vjet
kom ardh' t'i fërcoj simet.[2]
Këndon çiçja lis më lis:
ato vajza çi lash' vjet,
kom ardh' t'i martoj simet.
Këndon çiçja lis më lis:
qakat e qeçt[3] çi i lash' vjet,
kom ardh' t'i pastroj simet.

Veleshtë — Strugë, 1976

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) T'i fejoj sivjet.
3) Plakat e pleqtë.

220

QYQE-QYQE MONOQYQE

Qyqe-qyqe, monoqyqe[1],
ç'i bëre deshtë me byqe?
Ç'na e bëre tët vëlla,
që ta therë mu si ka.
mu si ka e mu si lopë,
ta vërvitnë në një gropë?
Gjakunë në kupë,
e gjerbnin me lugë,
mishtë në një napë,
varur në kërrabë.

Dhëmblan — Tepelenë. 1955

1) Kur ktheheshin zogjtë shtegtarë nga vendet e nxehta. si qyqja, kali i qyqes, dallandyshja etj. ai që do t'i dëgjonte i pari duke kënduar, duhej t'u drejtohej me vargjet përkatëse për secilin zog shtegtar që ta mundte atë. Për ndryshe do të qushme gjatë gjithë verës.» Vargjet e mësipërme thuheshin në Labëri, kur dëgjonin qyqen për herë të parë. Në këtë kohë merrnin edhe tre gurë pa folur, i futnin në xhep dhe ia lidhnin dybekut në shtëpi, duke besuar se kështu do të zinte më shumë gjalpë.

221

SEÇ IA THOTË QYQEJA

Seç ia thotë qyqeja,
bilbil, moj nana,
bilbil-o,
bilbil, moj sheg-o,
bilbil-o[1],
seç ia thotë malit-o!
Mali mban kusarët-o,
kusar' kolonjarët-o.
Seç ia thotë qyqeja,
seç ia thotë fushës-o.
Fusha na mban çupat-o,
çupat meskëputurat-o![2]

Rehovë-Kolonjë, 1954

1) Vargjet 2-5 përsëriten si refren pas çdo distiku.

2) Këndohej kur dëgjonin qyqen për herë të parë.

Këngët për qyqen janë nga më të përhapurat midis këngëve tona të shpendëve. Më poshtë po jepen disa nga variantet që janë regjistruar në krahina të ndryshme të vendit sipas fondeve të Arkivit të Institutit të Kulturës Popullore («Këngë të festave kalendarike», Vëll. IV): *Berat*, Qytet, Sinjë; *Dibër* Peshkopi; Sllovë, Vleshë; *Elbasan*, Qytet; *Fier*, Greshicë; *Gramsh*, Qendër, *Gjirokastër*,

Lazarat; *Kolonjë*, Luaras, Qinam, Rehovë; *Korçë;* Bradvicë, Dardhë, Maliq, Qytet; *Krujë*, Mamurras; *Librazhd*, Bërzeshtë; *Lushnje* Qendër; *Mirditë*, Malaj, Rrëshen; *Përmet* Brezhdan, Leskaj; *Pogradec*, Trebinjë; *Skrapar*, Çorovodë, Munushtir; *Sarandë*, Nivicë-Bubar; *Shkodër*, Dukagjin; *Tepelenë*, Kashisht, Turan.; *Tropojë*, Markaj; *Çamëri*, Arpicë, Grikohor.

222

ORE ZOG BILBILI

Ore zog bilbili,
çeli tranafili;
tranafili çeli
me xhethe jeshili;
tranafili hapi
me xhethe bojxhaki.

Sinjë — Dibër, 1962

223

ZOG O MORE ZOG

Zog, o more zog,
dita jote sojt!
Ore zog i ferrës.
erdh Dita e Verës!
Knon bilbili drunave
për çejfin e çunave;
knon bilbili thuprave
për çejfin e cucave.
Ore zogu tunës,[1]
na erdh vakti i punës!

Shumbat — Dibër, 1956

1) Zogu bishtatundës

224

PO KËNDON BILBILI

Po këndon bilbili,
po këndon no[1] ferrë;
këndo, të lumt' goja,
se duolëm[2] në verë.
Po këndon bilbili,
nëpër fusha t'xhana[3],
këndo, bilbil, këndo,
se verza — e jona.
Po këndon bilbili,
po këndon tu dera;
këndo, bilbil, këndo,
se na erdh pranvera![4]

Kuk — Prizren, 1979

1) Në.
2) Dolëm.
3) Të gjera.
4) Bilbili është një nga zogjtë që simbolizojnë ardhjen e pranverës, në këngët tona.

225

PO KËNON BILBILI

Po kënon bilbili,
po lilon jeshili;
po kënon bretkosa,
po lilon kullosa.

Sllatinë — Dibër, 1962

226

DAGHANDRISHE-DAGHANDRISHEZË

Daghandrishe [1]-daghandrishezë,
mirsevjen, ngado e na vjen!
Sbora u jos[2] mbi malet tanë,
sosi dimbri e jardhi vera,
me gjith' lulezit, me dieghin,[3]
se ti u prore, o daghandrishe.
Biu[4] folezën nen dritsoren,
nën dritsoren e shpin' time,
të më zgjosh menat' njize[5],
të të jap gjagjë të hash,
me gjith' bijzat çë do kesh,
Daghandrishe-daghandrishezë,
mirsevjen, ngado e na vjen!

Arbëreshët e Italisë
Molize, 1955

1) Në të folmen e Molizës (arbëreshë të Italisë) **gh-ja** i përgjigjet tingullit **ll**; pra **dallandrishe**.
2) Bora u shkri
3) Me diellin Shih. shën. 1.
4) Bën.
5) Shpejt.

227

DALLËNDYSHE-DALLËNDYSHE

Dallëndyshe-dallëndyshe,
na këtˈ verore të kuqe,
të ma shpiesh anës detit,
të më siellç bukë shëndetit[1].

Korçë, 1878

1) «Ditën e parë të marsit çupat e Korçës lidhin një lithcë të kuqe në qafë apo dorë dhe këndojnë këtë këngë». (Shënim i Mitkos).
Krs. KPÇ, f. 27.

228

DALLANDUSHE BUZBURBUQE

Dallandushe, buzburbuqe,
na këtë gjalmën e kuqe[1],
shpjere në det,
bjena shëndet,
hidhna gjalpë në dibek!

Lazarat — Gjirokastër, 1945

1) Marset ose veroret, i lyejnë me gjakun e kurbanit që theret ditën e verës dhe i varin në degët e trëndafilit e gjetkë, duke besuar se aty do të vijë t'i marrë dallëndyshja e t'i çojë në det, që t'u sjellë shëndet.

Ditën e Verës, vajzat në moshë martese shkonin shëtitje në pyll apo lëndinë. Aty këndonin e luanin. Më në fund bënin edhe «prerjen e këmbës» në tokë. Gërvishtnin një vijë rreth shputës dhe në madhësinë e saj prisnin plisin dhe e nxirrnin nga toka. Shikohej gropa: Në qoftë se ajo apo plisi do të kishte krimb, vajza do të kishte një fat të mirë, do të merrte një djalë siç e ëndërronte.

229

VERORET NË DET

Veroret në det,
të ligat në mal të shkretë!

* * *

Dallëndyshe faqekuqe,
merr veroret shpjeri në det
na sill tri qerre shëndet!

* * *

Dallandyshe bishtgërshërë
na këtë gajtan të gjerë,
hidhe ti në det,
na siell buk' edhe shëndet.[1]

Jug, 1949

1) Në Veri *veroret* i mbanin deri në shën Gjergj, kurse në Jug deri sa vinin dallëndyshet e para. Atëherë i hiqnin dhe i vinin mbi trëndafil a lule të tjera, duke thënë vargjet e mësipërme.

230

DALLANDYSHKË

Dallandyshkë,
veshkëlyshkë
mere këtˈ verorkë,
vere ti në qafë,
na sjell bukˈ e djathë!
Ciri viri viu![1]
Dallandyshkë,
veshkëlyshkë,
mere këtˈ verorkë,
vere ti në kleçkë,
na sjell bukˈ e veçkë!
Ciri viri viu!
Dallandyshkë,
veshkylyshkë,
mere këtˈ verorkë,
vere ti në bishç,[2]
na sjell bukˈ e mish!
Ciri viri viu!

Dardhë — Korçë, 1956

1) Fjalë onomatopeike.
2) Bisht.

231

DALLËNDOJSH-DALLËNDOJSH

Dallëndojsh-dallëndojsh
prem' nizet e ni këmojsh,
njo ta mbaj, njo ta ruj,
njo ta çoj në der' të huj;
njo ta boj xhevina-xhevina,[1]
njo ta boj rrush me temina.

Veleshtë — Strugë, 1976

1) Copë-copë. Ndoshta onamatope për të rimuar me vargun që vijon.

232

MERRE MARSEN IKË TUTJE

Dallandushe faqekuqe,
merre marsen ikë tutje.
Merre, shpjere në folé
qep jelekë kadifé[1].

Lopës — Filat
Shijak. — Durrës. 1970

1) Këto vargje i këndojnë fëmijët më një mars të çdo viti, kur lidhin marset a veroret në nyeth (llërëzë) të dorës së djathtë. Këto i heqin më 30 të këtij muaji dhe i vënë më ndonjë trendafil apo ferrë, që t'i marrë dallëndyshja e t'u sjellë shëndet.

233

MUNU KAL' I QYQES

Munu[1] kal' i qyqes,
dil përpara qyqes,
me rrush e me kumbulla
plot gjirin me sumbulla.
Sumbullatë nemi mua,
kumbullatë jepi hua!

Lazarat — Gjirokastër, 1945

1) Mundu, qofsh i mundur.

234

GJON-GJON

— Gjon, Gjon,
çë ke çë kërkon?
— Bora[1] dhitë s'mund t'i çonj.[2]
— Nga i bore, re[3] bështardhë?[4]
— Ade la[5] nga bota e bardhë.[6]

Arbëreshët e Greqisë
Atikë, 1978

1) Humba.
2) Nuk mund t'i gjej.
3) Ore.
4) Bastard, djall.
5) Atje sipër, larg.
6) E thonë të vegjëlit kur dëgjojnë të këndojë natën zogu Gjon.

235

DO NA VEJ' TATA NDË HORË

— Gjon, Gjon,
çë ke, çë kërkon?[1]
— Bora mëmënë, s'e çonj.[2]
— Mëma vate ndë Kokon,[3]
ha e pi edhe këndon.
Bie shi, bie borë,
do na vej' tata ndë horë,[4]
do na sellë një kumborë,
te ia vëmë dhisë Florë.[5]

Arbëreshët e Greqisë
Korint. 1978

1) Çfarë ke që kërkon.
2) Nuk e gjej.
3) Fshat
4) Vend, qytet.
5) Tjetër këngë që i këndohet Gjonit nga të vegjlit tek arbëreshët e Korintit.

236

GUGUFTU

— Guguftu,
ç'bën aty?
— Bëj gajtan.
— Kush ta mban?
— Ime njerkë,
si lefterkë.[1]

Mifol — Vlorë, 1968

1) I këndohej guguftusë (kumurisë). Thuhet se guguftuja ka qenë vajzë e gjetur. Me që ishte vajzë e bukur, e njerka e kish mbytur me gajtan, dhe prandaj kumëria ka në qafë një vijë të zezë.

237

O LEJLEK HAXHIBEG

O lejlek haxhibeg[1],
thuj jot ame e tyt et,
të të presi nji jelek;
pa pre me gërshanë,
pa qep' me gjylpanë,
të rrijë dede[2] n'kamë[3].

Elbasan, 1948

1) Haxhi+bej; që shtegton në vise të ngrohta.
2) Drejt.
3) E thoshin të vegjlit, kur shihnin lejlekët për herë të parë.

238

O LEJLEK

O lejlek,
gjëj një shtek,
kur të veç,
fal me shndet
gjakut t'gjinisë,
plakut t'shtëpisë,
gardhit t'oborrit,
viçit t'mushkorrit.

Poro — Vlorë, 1960

1) U këndonin të vegjlit lejlekëve.

239

O LELEK O ZOTËRI

O lelek, haxhilelek,
keshe shtëpinë në breg,
në Breg të Sallatës,
te Xhami e Shkallës[1].
O lelek, o zotëri,
ti u bëre efendi,
efendi me flutura,
xhikonuse e bukura.

Margëlliç — Çamëri
Petovë — Fier, 1970

1) Toponime në Margëllëç.

240

AXHIXHËLEK BI BI

Axhixhelek[1], bi, bi,
qetri pruni eblebi[2];
axhixhelek, pare, pare,
qetri pruni sheqerpare;
axhixhelek trak, trak,
qetri pruni ni tabak.

Veleshtë-Strugë, 1976

1) Nga haxhi—lejlek.
2) Leblebi.

241

KOJRRILA KOJPATA

— Kojrrila, kojpata,[1]
ku të zuni mramë nata?
— Tu Gjelina qafëgjata.
A çu vetë Kole Spata
me të pre. me rrufe,
si kumona n'shënanre.
Rrulli e bulli,
kamëpërcëllumi,
laknuerdjeguni.
bukëpapjekuni.[2]

Obot — Shkodër, 1972
Bob. 888/11

1) Gojë ose këmbëpata (?)
2) Kur shihnin krillat duke fluturuar në pranverë, të vegjlit thoshin vargjet e mësipërme dhe si ngulnin një thikë në tokë, prisnin që ato të uleshin.

242

KOJRRILË KOJPATË

Kojrrilë, kojpatë,
m'i thuej çasaj plakë
mos han, mos pin,
katër male mos m'i din?

Hajmel-Shkodër, 1972
Bob. 887/7

1) U këndohej krillave kur shkonin fluturim.

243

KORRILA KOPATA

Korrila, kopata
ku të zuni pramë nata?
Tu Gjelina qafëgjata,
Sidhi e pshtilli,
si mullini n'kosh,
si peni n'bosht![1]
Eni rreth ksaj gjylpanë,
se ni mujsha kam me u zanë.[2]

Ljare — Shestan, 1977

1) Besohej në popull se po t'i numërosh korrilat në ajër u prishet drejtimi e sillen rrotull.
2) Gjithashtu besohej se mund t'i ulësh e t'i zësh ato, duke ngulur në tokë një gjilpërë dhe duke fhënë vargjet e mësipërme.

244

KRRAK-KRRAK TI KORRAK

Krrak-krrak,
ti korrak;
kokën tënde,
djelt e tu,
i hangërsh me thojt' e tu![1]

Margëlliç — Çamëri
Fier, 1960

1) Këto vargje i drejtohen korbit (korrakut) që me krakëllimën e tij të mos ndjellë vdekjen e ndonjë të afërmi të tyre.

245.

MOJ LARASKË

Moj laraskë
këmbë kaskë,
na këtë dhëmb pe koske.
nem një pe floriri.[1]

Pogradec, 1944

1) E thonë fëmijët kur hedhin mbi çati dhëmbin që shkulin.

246

HAJ-HAJ SKIFTER HAJ

Haj-haj, skifter, haj,[1]
s'janë petulla me vaj,
që kush i do, mund t'i haj'!

Gjorm — Vlorë, 1944

1) Thuheshin nga fëmijët për të trëmbur skifterin kur binte mbi pula.

247.

TI MOJ KUKUMJAÇE

Ti, moj kukumjaçe,
ti, moj kukëmaçe,
më març këto paçe,
shko te Maj' e Bigës,[1]
ha bukën e shtrigës!

Gumenicë — Vlorë, 1944

1) Maja më e lartë e malit të Gumenicës.

248

LUAN Ç'LUAN DHELPËRA

Luan, ç'luan dhelpëra,
në grur' e në elbëra,
krihet e limonet-o,
kthehet e vështronet-o,
thotë: «Ç'jam e bukur-o
si nusj' e filanit-o»!

Gjirokastër, 1945

249

TI MOJ DHELPËRA MARRJOLE

Ti, moj dhelpëra marrjole,
gjithë pulatë m'i more,
me lëkurë m'i pagove.
Me një plump në ballë,
se më more larën.
shkova përtej arën,
ta mora lëkurën,
atje ndëra urën[1].

Vratilë — Paramithi
Fier, 1960

1) Këto vargje fëmijët i thonë kur shohin ndonjë dhelpër, që ajo të mos dëmtojë pulat e tyre.

250

NUSELALË-NUSELALË

Nuselalë-nuselalë,
nuselalë, moj e bukur,
nuselalë je si flutur,
Nuselalë, nuselalë,
a je çupë, a je djalë?
Çupë? Vëllan' burrë do ta jap.
Djalë? Motrën nuse do ta jap.

Gjorm — Vlorë, 1961

1) Fshatarët nuselalën e quanin kafshë helmuese. Për të marrë me të mirë, i këndonin vargjet e mësipërme.

251

LEJTI DILLI PLLAMË-PLLAMË

Lejti dilli pllamë-pllamë,
zemërkuçe xhanë-xhanë,
tepi-tepi, kollë-kollë,
aty xheta ti ni mollë,
ajo molla zhengërli,
aty knova hajmali;
hajmalitë i kenova,
buklat-o ç'i shitova.[1]

Lubizhdë-Rahovec, 1973

Bob. 937/20

1) Këndohej për të përzënë buklën (nuselalën).

252

BUKULO BUKULESHË

Bukulo, bukuleshë,
mos u treb[1] se s't'ban gja kush.
Mos u treb, gja s'kam me t'thanë,
hajde mren' se kam me t'lanë;
buk' e djath' e bosht' e furkë;
bosht' e furk' t'i la pi derë,
bukën, djathin në pixherë[2].

Ljare — Shestan, 1977

1) Tremb.
2) Ndryshe nga kënga e përparme në Ljare besohet se është mirë të vijë bukla (nuselalës) në shtëpi. Thonë se po ta kesh kuletën prej lëkurës së buklës, nuk mbetesh kurrë pa para. Gjithashtu mendohet se, po ta fërkosh gjirin e sëmurë me lëkurë bukle, shërohet.
Buklës i lënë një bosht me furkë në derë dhe pak bukë e djathë në dritare, që të mos u hajë gjitë bagëtive.

253

NUSELALE-NUSELALE

Nuselale-nuselale,
merre furkën, hidhu valle.
Hidhu valle si te desh,
të jap një ziur, ta kesh,
hoj për mish e hoj për lesh[1].

Gumenicë — Çamëri
Tiranë, 1960

1) Këto vargje fëmijët dhe gratë ia drejtojnë nuselalës kur e shohin rrugës, që ajo të mos zemërohet dhe të mos i hajë.

254

NUSE NUSELALË

Nuse, nuselalë,
me bosht e me furkë,
na një taim bukë;
na një copë djathë,
të mos vish në vathë!

Fterrë — Sarandë, 1944

KËNGË TË PUNËS

KAPITULLI I PARË

KËNGË PËR BUJQËSINË

255

TË BËJMË GATI UGARË

Të bëjmë gati ugarë,
se u bë balta për farë.
Erdhi koha për të mbjellë...

Këllëz — Gjirokastër, 1967

* * *

Siç i ngjitet ferra dheut,
të mos i shqitesh dhe ti parmendës.[1]

Leskovik — Kolonjë, 1954

1) Në disa krahina si në Leskovik, Përmet etj., ka qenë zakon të pritej një degë ferrë dhe të mbulohej në brazdën e parë, duke thënë vargjet e mësipërme («gjoja për të mos iu ndarë kau parmendës»).

*

* *

Ara jonë lara-lara,
na u bëft' misri sa arra!!

Përmet, 1957

1) Kur do të hidhej fara e misrit, e grurit etj. në disa vise përzihej me arra; «që të bëhej kokrra e misrit apo e grurit e madhe si arra». Thyenin edhe ndonjë kulaç të panisur mbi zgjedhë si edhe bënin rite të ndryshme që «të siguronin prodhime të mbara». E stolisnin farën me degë thane, lule e gjethe të gjelbrta; e linin të flinte një natë jashtë etj.

256

NESËR MJELLIM ARËN-O

— Ç'bën ashtu, mori nën-o?
— Po bëj hazër farën-o,
nesër mjellim arën-o.
Kur të ngriheç qëmenatë,
ormisu, mos ktheheç prapë,
në prak hidh këmën e djathtë[1],
të mos keç asnjë merak.
Kur ta hedhç koqen e parë,
thuaj të na vejë marë,
të rritet gjithë për farë.
Hidh farën me tenxheré.
kok' e rrënjë e kallame,
si në Vurg[2] e Myzeqe,
kallëzit me di e tre.

Zhulat — Gjirokastër, 1970

1) Kur nisej për të mbjellë, fshatari duhet të dilte nga shtëpia me këmbën e djathtë dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të kthehej nga rruga. Respektimi i këtij besimi lidhej me mbarësinë e të mbjellave.
2) Fushë e begatshme në rrethin e Sarandës.

257

DO MBREJM' QETË DO SHKOJM' N'ARË

Do mbrejm' qetë, do shkojm' n'arë,
shoqeni,[1]
do mbjellim misër të bardhë,
do ushqejm' fëmijët tanë,
t'i rrisim, t'i bëjm' të mbarë.

Kutalli — Berat, 1977

1) Përsëritet pas çdo vargu.

258

HAJT BALË HAJT DJALË

Hajt, Balë[1], hajt djalë,
'i ditë t'lume e kryen ni arë,
ni arë e ni bashtinë,
tybe, hallall e ki tagjinë!
Hajt, Balë, hajt, djalë.

Vojnik — Drenicë, 1972

1) Emër kau (ka me pulla të bardha). Po kështu edhe në këngët që vijojnë emrat: Gajtan, Kazil, Kuqal, Larush, Merxhan. Verdho etj. janë vendosur sipas ngjyrës së lëkurës.

259

SEÇ I MORA QETË DHE SHKOVA NË ARË

Seç i mora qetë dhe shkova në arë,
sta[1], more Kazil[2], bra[3], more Merxhan[4]!
Po kjo sylarushja seç më hidhte farë.

Qafë — Skrapar, 1961

1) Thirrje karakteristike që u bënte bujku qeve për t'i nxitur në punë. Në variante të tjera gjejmë: ha, ho, hop, vrap, sto, etj.
2, 4) (Ka i zi, ka i kuq)
3) Vargu i dytë përsëritet edhe pas vargut të tretë.

260

MENATË PA GDHIRË DITA

Menatë, pa gdhirë dita,
marrim qetë edhe farë,
shkojmë tutje nga selishta,
të punojmë me babanë.
Babai ka zënë qetë,
u vë zgjedhën e kularë,
— Hajde, djalë, më thërret,
të mbjellim misër të bardhë.
Të dy bashkë me babanë,
një liron, tjetri hedh farë.

Zogas — Skrapar, 1981

261

UN' NGAS QETË E TI HUDH FARË

Un' ngas qetë e ti hudh farë,
o moj goc' prezjane[1],
të mbjellim misër të bardhë,
ene grunë kokërmadh
e ta korrim palë-palë,
e ta shijmë me atllarë,
e ta ham — o të dy bashkë.

Prezë — Tiranë, 1949

1) Përsëritet pas çdo vargu.
Krs. KP, f. 89.
AIKP. — Q. Haxhihasani, Sharrë — Tiranë, 1950 (Vëll. IV, f. 140); ART. 1961 (Bob. 64/7, 76/7).

Lëvrimi i tokës (K. Kodheli)

262

MBËRTHEVA QETË ND' ARË

Mbërtheva qetë nd'arë,
sta Larush e sta Kuqal![1]
Hajde, djal,' të vajtë mbarë!
Duart e kuqe hidhnin farë,
hidhnin far', misër të bardhë.

Poro — Vlorë, 1960

1) Përsëritet pas çdo vargu.

263

PLIS MË PLIS E BRAZ' MË BRAZË

Plis më plis e braz' më brazë,
të vrafshin, të prefshin![1]
Çpo, Kazil, kthej Verdhonë.
Mollokofi yt më mbuloi ugarë,
me dorën e bardhë seç më hidhje farë.
Kur ta sjellësh bukën, ma sill me gomar,
mos ma sill të thatë, ma sill me oshmar!

Ogren — Përmet, 1964
Bob. 320/10

1) Përsëritet pas çdo vargu.
(Transkriptimi muzikor nr. 11)

264

MERRNA QET' E EC' NË ARË

Merrna qet' e ec' në arë,
trim, ore Kazil, o burr', o Gajtan![1]
O duart e kuqe seç na shtinin farë.
ky Kuqali ynë na theu kularë,
ky Kuqali ynë s'po na bën për mbarë.

Velçan — Pogradec, 1961

1) Përsëritet pas çdo vargu.

265

KOKRRA-KOKRRA E QESIM FARËN

Kokrra-kokrra e qesim farën,
për ni dit' e mjellim arën,
u rrit' drithi ma shpejt se shtogu,
hangshin robt, mini e zogu!
Punojm' mir' arën, shnosh n'kofshim[1],
plot me drith' e mushim koshin.

Shushicë — Istog, 1972

1) Në qofshim.

266

KNON BYLBYLI NË BEHAR

Knon bylbyli në behar,
jam feju me nji djal' beqar,
djal' beqar e gjynafqar,
si gjithnji punon në arë,
ai njek qet' e un' hudh farë,
Do ta mjellim arën marë,
do ta mjellim misër t'bardhë.
Merre drapnin, bje në arë,
që ta korrim arën marë
e ta korrim palë-palë
e ta hudhim në hamar.

Bujan — Tropojë, 1969
Bob. 667/12

267

DO TA MBJELLIM ARËN-O

O nuse e bukur-o,
do ta mbjellim arën-o,
do ta mbjellim misër-o,
do ta mbjellim misër t'bardhë,
ta bëj' koqen si stërrall;
edhe grurë halëzi,
të na ken' bota zili.
Do ta korrëm palë-palë,
do ta shijmë me atllarë,
do ta mbarëm ne të dy,
do ta bluajm' në mulli;
pa do korrëm edhe kashtë,
gjithënjë, ne, të di bashkë,
do ta vëm' si hipi jashtë.

Vranisht — Vlorë, 1966

268

MUELL VASHA ARËN MUELL

Muell vasha, arën muell,
shpesh e qiti, rrall' i bini,
puntor' thirri edhe mihi,
çoi e thirri nga dy vetë,
nja dy vet' — o ke desht' vetë,
i thirri, i erdhën n'resë,[1]
i hidhshin redat me shpejt.

Ostros — Krajë, 1972

1) Në rend, në radhë.

269

LUMET NA QI JENA ÇIKA

Lumet na qi jena çika,
dy sahat na duket dita,
marrim udhën me shku n'ara,
vetë permas, vllaun përpara.
Më qet vllau renatar,
më thot' baba: — Puna marë!
— Të mar' paç, o baba jonë,
po marojna arën tonë!

Trestenik — Viti. 1978

270

O HAJT SHAT O BIR KOVAÇI

O hajt, shat, o bir kovaçi,
luni durt, he gzime paçi,
luni durt, se po nxen vera,[1]
po nxen vera, po vjen vapa,
kqyrne shatin pa gjurm' mrapa!
O hajt, shat, ty kush po t'prin,
ma puntori-o n'argatinë,
sod po mihim-o në kët' shpi,
nesër mlidhna-o nër kojshi.[2]

Kabash — Pukë, 1980

1) Prashitjet bëhen më shumë në pranverë. Sipas kalendarit astronomik të pranverës (21 mars — 22 qershor) prashitjet në përgjithësi mbarojnë.

2) Ka qenë zakon që fshatarët e një lagjeje të ndihmonin në prashitje njëri-tjetrin. Gjatë këtyre punëve këndoheshin këngë të ndryshme që quheshin në ndonjë krahinë (Shkodër, Pukë etj.) «këngë shati». Këto dalloheshin sidomos për karakterin e tyre improvizues.

271

HAJT SHAT HE QYKAN

Hajt, shat, he qykan,
bacin Sefer ki m'i nxanë,
hajt, shat, he, qykan,
se Sokolit s'ki çka i ban,
hajt, shat, he qykan,
sot prashit, nestra n'tavan.[1]

Vojnik — Drenicë, 1972

1) Vendi ku mbaheshin veglat e punës.

272

FILLOI BIMA ME BIMUO

Filloi bima me bimuo,
lypka shatin me punuo.
— Si n'mos ardhsh, ti shat, në muo,
shoqet kanë me ma kaluo,
puntort' kanë me qeshë me muo.

Stjepoh — Trijesh, 1972

273

FRYJ ER-O NA FRYJSH E BARDHË

Fryj, er -o, na fryjsh e bardhë!
Njat' ma t'mirën qitna n'arë,
sa t'na thot -o «puna mbarë!»
O të mbar' paç, bardhokja e bardhë!
T'na thot': — Toka si ka dalë?
— Plisi i but' pa gram, pa tallë.
Mbushu mir' kallini i njomë,
bardh' t'na dalin buka jonë![1]

Bërdicë — Shkodër, 1980

1) Këndohet kur fshatarët vihen në rresht e fillojnë prashitjen. Krs AIKP — K. Vasili, Samrish — Shkodër, 1980. N. Pano. Barbullush-Shkodër, 1981.

274

VADA E PAR-O MARSHALLA

Vada e par-o, marshalla,
merr kollomoqin nja ka nja,
nja ka nja, o, tuj vaditë,
se me pjeh[1] me kan' mush' dhitë.
Amanet, o mori çikë,
kqyre nanen kah vaditë,
se n'shpi t'hoj'[2] ke me shkue,
puna e mir' ka me t'nderue,
sa t'jesh gjall-o me jetue.

Miçoj — Pukë, 1972

1) Pleh.
2) Të huaj.

275

KALLAMOQ HE SHOQ

Kallamoq, he shoq,
kur nuk t'punova,
me ty u idhnova;
kur erdha me t'qit' pleh,
u bane qi s'po m'njeh,
kur erdha me t'prashitë,
nizet santin ishe rritë;
kur erdha me t'mushë,
ishe ba sikur arushë,
kur erdha me t'pa,
rroke alltin', deshe me m'vra.
Mos ke[1] kungulli, me na da,
kallamoqi ke tu m'vra.

Gaçkë — Ferizaj. 1980

1) Mos qe; të mos ishte.

276

N'KËT' SABAH N'KOPËSHT PO HI

N'kët' sabah n'kopësht po hi,
me kam' t'marr' vadic të ri,
riga-riga bash si shi,
në çdo zagën fell' ka hi,
bashk' me ujin edhe klli.
Dielli ra, un' nër zagna,
tuj heq' bar e tuj vaditë,
durt e mija dalin n'dritë,
dalin n'drit' e më nderojnë,
kur kopshtije trimat kërkojnë[1].
Dal prej kopshtit, krahin plot,
për në sofër e për turshi,
mos m'ja pas' kërkuj lakmi.

Micoj — Pukë, 1972

1) Kur i shijojnë perimet.

277

E KY GRUNI QYSH PO MBILLET

E ky gruni qysh po mbillet?
Paj, me dorë po lëshohet,
paj, me dhe po mulohet.
Lavertar, o mir' e ke,
ngul uminin thik' për dhé.
E ky elbi qysh po millet?
Paj, me dorë po lëshohet,
paj, me dhe po mulohet.
Lavertar, o mir, e ke,
ngul uminin thik' për dhé.

Micoj — Pukë, 1970

278

PUNA E MARË O LAVËRTAR

— Puna e marë,
puna e mar', o lavërtar,
shka po mjell,
shka po mjell, o lavërtar?
— Të marë paç,
të marë paç, o ti udhtar!
Un' po mjell,
un' po mjell do grun' të bardhë.
— Tungatjeta,
tungatjeta, o shpijanik!
Jam i largët,
jam i largët, o shpijanik.
— Eja bujmë,
eja bujm', o more mik!
si n'shpi tande,
si n'shpi tande, more mik!

Kacarevë — Kamenicë, 1972

279

HAJDE SE DO MBJELLIM GRUNIN-O

Hajde, se do mbjellim grunin-o!
Qysh hudhet fara e grunit-o?
Nji kështu, dy kështu, me doraz-o.
Hajde çveshe kamën-o,
se do marrim vallen-o,
valle pupëçalen-o!
Hajde, se do mbjellim elbin-o!
Qysh hudhet fara e elbit-o?
Nji kështu, dy kështu, me doraz-o.
Hajde, çvishe kamën-o,
hajde, t'marsh vallen-o,
valle pupëçalen-o![1]

Luz i Vogël — Durrës, 1964
Bob. 314/11

1) Këngët për mbjelljet zgjerohen shpesh me elemente simbolike të dashurisë, të dasmës, etj. Ato përbëjnë ndonjëherë edhe tekstet që shoqërojnë vallet e punës. Gjejmë dendur të bashkuara në këto këngë kultura të ndryshme (si mbillet grurı, misri, orizi, elbi etj). ose veprime të ndryshme (si mbillet, si korret, si shihet etj.) Në këtë kapitull janë futur disa nga kën-

gët që i përshtaten më mirë punimeve të stinës, pa u zgjatur me elemente të tjera.

Teksti i sipërm shoqëron një valle pune.

Krs. AIKP — R. Bogdani, Slabinjë — Pogradec, 1972 (Bob. 872/10); M. Dule. Ndroq-Tiranë: 1974 (Bob. 1037/13) (Bob. 1059/12); F. Reka; Pezë-Tiranë: 1974 (Bob. 1133,1); K. Vasili, Lezhë, 1980 (Fl. 14; f. 14).

280

ANI KËSHTU MBILLET MOJ FARA E GRUNIT

Ani, kështu mbillet, moj fara e grunit,
nji kështu me dorë, dorat-e,
o ule gishtin, o lal' përdhe.
Ani, kështu mbillet, moj fara e elbit,
nji kështu me dorë, dorat-e,
o ule gishtin, o lal' përdhe.[1]

Milot — Krujë, 1973
Bob. 975/4

---

1) Këndohet në valle.

Krs. AIKP — A. Mustaqi, Ndroq — Tiranë, 1964 (Bob. 293/28); R. Bogdani, Zadrimë — Lezhë, 1972 (Bob. 843/8); Hajmel — Shkodër, 1972 (Bob. 897/8); Xh. Selami, Milot-Krujë, 1973 (Bob. 916/15); M. Dule, Grëbllesh-Tiranë, 1974 (Bob. 1061/21); Xh. Selami — H. Filja Zall-Dajt — Tiranë, 1974 (Bob. 109/2); Shëngjin — Tiranë, 1974 (Bob. 1093/11); Zall-Bastar — Tiranë, 1974 (Bob. 1094/13); Selbë — Tiranë, 1974; (Bob. 1099/14); V. Qamili, Mal i Bardhë — Krujë, 1978 (Bob. 1325/23)

281

SI NA MBILLET FAR' E GRUNIT

— Si na mbillet far' e grunit?
— Nji kështu me dorëz-o.
— Hajd të mjellsh, moj nusja e re,
të ulësh belin sall përdhe.
— Si na mbillet far' e misrit?
— Nji kështu me dorëz-o.
— Hajd ta mjellsh, more dhanri ri,
ta ulsh belin edhe ti.
— Si na mbillet far' e orizit?
Nji kështu me dorëz-o.
Hajd ta mjellsh, mor dhanri ri,
ta ulsh belin edhe ti.
— Si na mbillet far, e orizit?
Nji kështu me dorëz-o.
— Hajt të mbjellim të gjith' bashkë.
të mbushim hambarët-o.

Zallher — Tiranë, 1974
Bob. 1132/5

(Transkriptimi muzikor nr. 12)

282

MOJ E MIRA BARDH' SI PLLUMI

— Moj e mira bardh'si pllumi,
hoj dado hoj,[1]
a m'kallxon qysh millet gruni?
— Gruni millet ni kështuni.
Moj e mira bardh' si pllumi,
a m'kallxon qysh harret gruni?
— Gruni harret ni kështuni.
— Moj e mira bardh' si pllumi,
a m'kallxon qysh korret gruni?
Gruni korret ni kështuni.
— Moj e mira bardh' si pllumi,
a m'kallxon qysh fshihet gruni?
— Gruni fshihet ni kështuni[2].

Krumë — Kukës, 1970
Bob. 770/14

1) Përësritet pas çdo vargu.
2) Kënga vazhdon edhe për këto proçese pune: bluarjen, zënien e brumit, pjekjen e ngrënien e bukës.
(Transkriptimi muzikor nr. 13).

283

ORE GRUR' O HALËZI

Ore grur', o halëzi,
na u bëfsh, o për zili,
të bëjm' pet' e revani,
për dasma e për gosti!

Kutalli — Berat, 1983

284

JEMI TO KORR' GJRUNË

Jemi to[1] korr' gjrunë,
hoj, me shoqe shumë,
kush të më vëje,
«mashalla» — t'na e bëje.
Bëjnia, «mashalla»,
se më asht gjunah.

Përbreg — Kukës, 1982

1) Duke.

285

MË DËGJONI MOJ SHOQE

Më dëgjoni, moj shoqe,
ngrihi, mos rrini në hie,
koqe e grunit ra përdhe,
edhe kashta kallame,
Ngrihi, se nuk kemi nge!

Këllëz-Gjirokastër, 1976

286

TE NJI MAL E NË NJI ARE

Te nji mal e në nji arë,
te nji kumbull lulebardhë,
herr e korr nji vash' e bardhë,
me dy drapna për nan dorë,
me njanin herr, me tjetrin korr.

Peshkopi — Dibër, 1955

Krs. AIKP — K. Vasili, Gjadër-Lezhë, 1980 (Bob, 1425/11).

287

A PO NDIN SE ÇKA PO THOJNË

A po ndin se çka po thojnë,
mori fëllanx-o[1].
«Na asht ba gruni m'u korrë».
Bini, vasha, të shpejtojmë,
bash' me drapijt' të këndojmë.

Millë-Ulqin, 1964

1) Përsëritet pas çdo vargu.

288

MARRIM DRAPNIN SHKOJM' PËR ARA

Marrim drapnin shkojm' për ara,
naj qet vllau bagtit' përpara.
Po vjen baba: — Puna marë!
Puna mar', bijat e mija,
në kofshi lodh', shkoni te shpija.
Lumet na, që jemi çika,
dy sahat na duket dita!
Po vjen nana: — Puna marë!
Puna e mar' çikat e mija!
A jeni lodh', moj tuj punue?
Shkoni n'hije me pushue!
Ju kam pru piten tuj vlue,
edhe kosin hiç pa trazue.

Kaçanik, 1959

289

DADA MORA DRAPNIN ANI ME KORR' THEKËN

Dada, mora drapnin, ani. me korr' thekën,
hajde, zog i dadës. se s'u boka vetëm!
Dada, mora drapnin, ani, me korr' grun-e,
hajde. zog i dadës, se s'u boka punë!

Brezne-Prizren, 1978

290

PO BJEN GRUNI PALË-PALË

Po bjen gruni palë-palë,
moj, puna marë[1],
Drapni jot me fat të bardhë,
po na bjen bukën e bardhë.
Zagën n'zagën, hidhu varza,
kush në fund të dalë e para.
Nuset zogjt'[2] i kan' nër ara,
mos qyrni me u dal' para,
jan' të shkretat me duar t'zana.
Shkëlqen gruni si florini,
mblidhnu, varza, mblidhnu, gra,
Zotnimadhi[3] vjen me u pa.

Rashtinë — Ana e Malit, 1972

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) Me kuptimin: fëmijët e vegjël.
3) Këtu me kuptimin i pari i burrave.

291

Ç'U NGRESH HERËT PA DAL' DRITA

Ç'u ngresh' herët pa dal' drita,
çou, o çun, o se ke punë[1];
nji kov' uj' pusi ta qita,
t'i lajsh syt' e bardh' si drita,
syt' e bardh' syt' e larë,
merre drapnin, ja[2] t'shkojm' n'arë,
e t'korrim uriz të bardhë,
e ta ham-o të dy bashkë.

Tiranë, 1955

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) Eja.

292

U MUSHËN KOSHA U MUSHËN HAMARË

U mushën kosha, u mushën hamarë,
xhit kana kan'[1] kjo ver' e bardhë,
ver' e bardhë adalet,
kana kanë bereçet.[2]

Përbreg — Kukës, 1982

1) Çfarë paska qenë, si paska qenë.
2) Këndohej mbasi përfundonte mbledhja e bereqetit.

293

HAJT LULOJ HE HARAP

Hajt, Luloj[1], he Harap[2],
shije grunin e ri,
se unë ty t'qes tagji
kallamoq edhe tërshanë,
sa t'doni kam me ju dhanë!

Hërticë — Podujevë, 1972

1,2) Emra kuajsh; po kështu edhe emrat Balosh, Çil, Dori, Gjok, Harap, Kuqo, Luloj, Laroj etj. që hasen në këngët që vijojnë. Krs. LPLL, f. 59.

294

HAJT OHO-HO

Hajt oho-ho,
hajt oho-ho,
merre nëpër kamë,
derdhe nëpër lamë,
dërrmé, dërrmè, dërrmè!
Hajt oho-ho,
hajt oho-ho,
han' e re, buk' e re,
hajde, Gjok, ta ham' ne,
dërrmé, dërrmé, dërrmé!
Hajt oho-ho,
hajt, oho-ho,
hajde, Gjok, lama plot,
mashallah ma shoum' mot,
dërrmé, dërrmé, dërrmé!
Hajt oho-ho,
hajt oho-ho,
merre nëpër kamë,
derdhe nëpër lamë,

---

1) Te disa këngë të kësaj teme, më shumë se sa shtjellimi i elementeve poetike, vërehet theksimi i ritmeve të punës thirrjet për nxitjen e kafshëve etj., siç dëshmojnë vargjet e mësipërme dhe ato që vijojnë.

dërrmé, dërrmé, dërrme!
Hajt, oho-ho,
hajt oho-ho,
hajt, Gjok, me bereqet,
ma shoum' simjet se vjet,
dërrmé, dërrmè, dërrmè!

Zajaz — Kërçovë, 1980

295

HAJT GJOK MASHALLAH

Hajt, Gjok, mashallah,
hajt, bir, hajt
ngaj, bir, ngaj,
puna t'na shkoj marë,
hajt, bir, hajt,
u ha-ha!

Trestenik — Viti, 1978

Krs: KNP. f. 37, 40.

296

HALLA BYK HALLA

Hajde t'knojmë halla, byk, halla,
t'na njëje[1] gjithë mëhalla,
gjithë mëhalla e gjithë kojshija,
t'na vinë trimat, gratë e thmija,[2]
por ma shum, t'na vin' djelm t'ri.
djelm t'ri e vajza shumë,
se pa ta nuk bahet punë,
Halla, byk, halla!

Ljare — Shestan, 1974

1) Të na ndjejë, të na dëgjojë.
2) Fëmija

297

DY REDASH GRUNI NË LAME

Dy redash gruni në lamë,
na duhet me e shi të tanë,
red mas redit ta redojmë.
të gjithë grunin ta marojmë.
Bini, bini, me shqupi,
kta grunë sa ma shpejt me e shi!
Grahni, burra, grahni, gra,
grunin pej kashtet me e da!
Gajret, djelm e gajret, vajza,
u hangët n'tueja dasma!

Ljare-Shestan, 1974

298

OJ DORI MORI

Oj Dori, mori,
hajt, bi, mori,
sillu pa pritue,
se bashk' kem' me shkue,
n'mul!i për me blue,
pa mill s'mujna me rrnue[1]!
Hajde, bi, mori,
sillu-sillu,
u-ha-ha-ha![2]

Sherret — Ferizaj, 1962

1) Nuk mund të rrojmë.

2) Thirrje karakteristike ashtu si edhe «hajt loj, hë, halla byk halla, hajde bir bre, hajde bi mori, hoj-hoj-hoj, herevan, herevan, laga-laga-lago, etj», me të cilat nxiteshin për punë kafshët gjatë shirjes së lëmit.

299

HAJT LAROJ FSHIJE GRUNIN E RI

Hajt, Laroj, e hajt, Luloj,
fshine ju grunin e ri,
se, un' ju, ju qes tagji,
kallamoq edhe tërshanë,
sa t'doni kam me ju dhanë!
Hajt, Balosh, e hajt, Harap,
fshine ju grunin e ri,
se un' ju ju qes tagji,
kallamoq edhe tërshanë,
sa t'doni kam me ju dhanë.

Llap — Podujevë, 1974

300

HOJ-HOJ-HOJ-HOJ

Hoj-hoj-hoj-hoj,
herevon-herevon,
mere kashtën nëpër komë,
bone bik, bone bik,
bone bik, mos u frik,
bone bik, bone bik,
bone bik, ene hik

Veleshtë — Strugë, 1972

301

HAJT E HAJT E EH

Hajt e hajt e eh,
hajt e hajt e eh,
laga-laga-lago,
laga-laga-lago,
hajde, Gjok, hajde, Gjok,
bane kashtë,
hidhe jashtë,
me fturqe,
me rrëshqela,
me kual
dhe me pela!

Oblikë — Shkodër, 1965
Bob. 424/3

(Transkriptimi muzikor nr. 14).

302

SHIJE MOJ SHIJE LOMIN E GRUNIT

Shije, moj shije, lomin e grunit,
shije, moj shije, lomin e tagjisë,
shije, moj shije, lomin e tepës,
shije, moj shije, lomin e elbit.
Shini, moj goca, shini, grunin e lomës
hudhni, moj goca, hudhni, grunin e lomës,
hudhni nëpër hambarë, grunin e lomës.

Pezë — Tiranë, 1974
Bob. 1133/13

Krs. AIKP — K. Vasili, Tiranë (Fl. 14, f. 15).

303

AJS KUQO

Ajs Kuqo,
ajs Kuqal,
bëne bik,
mos ki frikë,
bëne kashtë,
nxirre jashtë,
bëne mirë,
mos bëj firë!

Lukovë — Sarandë. 1971

Krs. AIKP — A. Mustaqi, Greikovç — Suharekë, 1974 (Bob 1187/3); Bllacë — Suharekë, 1974 (Bob. 1192/48).

304

KUQUA N'STRUMBULLAR

Kuqua n'strumbullar,
gruri në hambar,
Kuqua në lëmë,
kashta nëpër këmbë.
Kuqua vërdallë,
gruri në pinadhë,
grurët bashkë,
kashta jashtë.

Lukovë — Sarandë, 1971

305

ALA HOP ALA HOP ALA HOP

Ala hop, ala hop, ala hop.[1]
hajt-hajt Çil,
bane kashtë,
qite n'grazhd,
qite n'fyt!
Ala hop, ala hop. ala hop![1]

Shajne — Prizren, 1979

1) Vargjet e mësipërme fshatari i thotë kur fillon të shijë grurin, duke lëvizur kamxhikun sipas ritmit të ecjes së kalit.

306

HAJT KUQO HAJT DORI

Hajt, Kuqo, hajt, Dori,
shije grurin për zili,
shij grurë e ndaj kashtë,
bukën veç e kashtën bashkë.
Hajt, Kuqo, hajt, Dori,
me shëndet grurin e ri,
hajt-hajt-hajt, Kuqo!

Lukovë — Sarandë, 1962

307

KJO PRANVERA QË KA ARDHË

Kjo pranvera që ka ardhë,
shum' ka pru lule e bar,
mrehni kosat, o kostarë,
ta fillojm' renin e parë!
Dit' e hajrit, more hej,
qëmenat' ngrihet kostari,
n'cep t'livadhit nji kos' kërcet,
lagte tokën me djers' t'vet,
si rrufeja barin pret,
kanga e tij shokët i thrret.

Iballë — Pukë, 1983

308

NA KA DAL' NI VER' E MADHE

Na ka dal' ni ver' e madhe,
ka ra kosa nër livadhe,
ka ra kosa me kositë,
di livadhe për ni ditë.

Bicaj — Kukës, 1964
Bob. 334/26

Krs. Gj. A, 1972 III, f. 183; LPRrK, f. 7.
AIKP — A. Xhagolli, Rugovë, 1979 (Bob. 1396/15).
(Transkriptimi muzikor nr. 15.)

309

HAJT T'I MARRIM FTURÇIT

Hajt, t'i marrim fturçit,
po shkojm' me mbledh' bar,
toj fol' e toj keshë,
t'xhitha me ni fjalë!
Hajt, t'i marrim drapnat,
po shkojm' na me korrë,
toj fol' e toj keshë,
t'xhitha me ni gojë!

Kuk-Prizren, 1979

310

DIT' E NXETË VER' ME LULE

Dit' e nxetë, ver' me lule,
bash shyqyr për kta crrule,
i lam' grumbull n'çosh t'livadhit,
t'ia lshojm' kosat gjithkund barit.
T'i lujm' kosat, mor kostarë,
se tash bari na vjen marë,
na vjen mar', mos m'u çuditë,
cajo pjak' t'i fërkoj' sytë;
e n'mos, more, i fërkoftë,
sa mrrift' n'shpi u përvëloftë!

Qerret — Pukë, 1972

311

SHKOJ I MIRI ME KOSITË

Shkoj i miri me kositë,
tri livadhe për ni ditë.
Shkoj e mira me korr' n'arë,
për ni dit' — dy sheka farë.
Kur t'shoh, mor djal', tuj punue,
shum' mirati' po m'bohet mue.

Shajne — Prizren, 1979

Krs: KNP, f. 42.

312

HALLANI PUNTOR' HALLANI

Hallani, puntor', hallani,
sanën m'u terë hapeni!
Mlidhni, nuse, mlidhni,
sanën mos e digjni!
Afroni, vajza, afroni,
sanën navikë e vnoni![1]
Bini, trima, bini,
navikët, qe, ku i kini!

Vuthaj — Gusi. 1978

1) E vini, e rendisni.

313

SI E MBJELLIM NE ORIZIN

Si e mbjellim ne orizin?
Ja kështu, moj, ja kështu,
hidhe kambën përmbi gju.
Si e korrim ne orizin?
Ja kështu, moj, ja kështu,
hidhe kambën përmbi gju.

Gostimë — Elbasan, 1983

314

DO TA RRAHIM NE ORIZIN

Do ta rrahim ne orizin
me dybek prej drurit,
do ta hedhim ne orizin
me erën e lumit.
Do ta marrim ne orizin,
do ta çojmë në shtëpi,
do ta bajm' pilaf të bardhë,
do ta bajmë kabuni.

Gostimë — Elbasan, 1983

315

SHKOVA ME MLEDH' GROSHË

E mora peshterkën-o,
shkova me mbledh' groshë,
e gerkova[1] fushën-o,
qosh e më qoshë,
simjet ni pojk' shoj-o[2],
zoti nuk na dha,
ka puna e groshës-o
imi[3] fukara.

Veleshtë — Strugë, 1972

1) Kërkova, kontrollova.
2) Një pikë shi.
3) Jemi

316

MORE KUNGULLI PA BISHT

More kungulli pa bisht,
nandërna e nandërna,[1]
të marrish gardhin përpjetë.
Po të mbiell, më lumtë dora,
kush t'këput, iu thaftë dora!

Manastir, 1972

1) Refren onomatopeik.

317

FURKËZ-O DRUGËZ-O

Mbolla li te Plep' i Gjatë.
furkën-o, moj nën-o.
Si e mbollëm, do dhe shkulur,
si e shkulëm, do farosur,
si e farosim, do dhe regjur,
si e regjim, do dhe tharë,
si e thajmë, do dhe rrahur,
si e rrahim, do dhe krehur.

Mbrostar — Fier, 1983
Bob. 1527/3

1) Toponim në afërsi të fshatit Mbrostar-Sheq.
2) Përsëritet pas çdo vargu.

318

MBOLLA LI TE PLEPI I GJATË

Mbolla li te Plepi i Gjatë,
furkën ballëmadhe, furkën.
Si e mbolla, donte thurur,
si e thura, donte ruajtur,
si e ruajta, donte rritur,
si e rrita, lçoj farën,
si lçoj farën dhe u poq,
si u poq, donte xhvekshur,
si e çfarosa, donte shkundur,
si e shkunda, donte regjur,
si e regja donte tharë,
si e thava, donte mbledhur,
si e mblodha, donte rrahur,
si e rraha, donte krehur,
si e kreha, donte tjerrë,
si e torra, donte zjerë,
si e zjeva, donte endur,
si e enda, donte bërë,
si e bëra, donte larë,
si e lava, donte tharë,
si e thava. donte qepur,[1]

Poro — Vlorë, 1960

1) Kënga vë në dukje vështirësitë e punës artizanale për nxjerrjen e perit të lirit.
Krs. Gaz. «Jeta e re», 1955, nr. 1. f. 90.

319

MUELL VASHA ARËN MUELL

Muell vasha arën muell,
gjith' e muell far-e lini,
shpesh e muell, rall' i bini.
Shkon nji tub-e krushq asajna,
nuk ja shkelën arën-o,
as s'ja shkelën, as s'ja kputën.
Shkoi i dami shokëvet,
ai ja shkeli arën-o,
ai ja shkeli e ja kputi.
Zu vasha me nemun-o;
— O i dam' i shokëvet,
si ma shkele arën-o?
Kurr' nër shok' mos u përzjesh!
Ty të plast-e hati n'rrugë,
e ja marrsh frangit' nën dorë,
e ja marrsh potkojt' nën ksulë,
qi ma shkule, ma këpute!
— Mos nem, vash', e bardha vashë,
se edhe un' di me nemë.
Ti u njiç virgjën me barrë
e t'leshin tre djelm sokola!
Mos paç djep-e n'se me 'j lidhë,
por i qiç-e në tërfojnë!
Aty raft-e ujku pej malit

e ta marrt' të parin djalë!
Daltë gjarpni pej nën gurit
e ta marrt' të dytin djalë!
Aty raft-e kaçabeja
e ta marrt' të tretin djalë
e meç qyqe pa kurrnji!

Trijesh, 1982

320

PO SHKON VAJZA BREGUT DRINIT

Po shkon vajza bregut Drinit.
për me zbut' fijen e linit,
me i end' jelekun trimit.
tir-shtir.
Po kndon vajza bregut Drinit.
me at' za porsi t'bylbylit.
buza i qesh, qerpiku i svnit.
tir-shtir.
Po shkon vajza bregut Drinit,
fija e mndafshit rreze dillit,
me i qendis' jelekun trimit,
tir-shtir.[1]

Barbullush — Shkodër. 1978

1) Sikurse shihet, kënga ka një ndërtim strofik. ku vargu i fundit është një refren.
Krs. BMK, f. 217;
AIKP — T. Daija, Shkodër, 1980.

321

O QYSH RRIFET MOJ KY PIPERI

O qysh rrifet, moj ky piperi,
o moj ky piperi?
Hajde nji kështu, moj gjunjaz-o,
o moj gjunjaz-o.
O qysh rrifet, moj ky piperi,
o moj ky piperi?
Hajde nji kështu, moj afër-o,
o moj afër-o.
O qysh rrifet, moj ky piperi,
o moj ky piperi?
Hajde nji kështu, moj hedhaz-o,
o moj hedhaz-o.

Pezë e Madhe — Tiranë, 1977

1) Teksti i mësipërm shoqëron «Vallen e piperit». Megjithëse piperi është një kulturë që nuk kultivohet te ne: «Vallja e piperit» ka një farë përhapje në krahinat e Jugut: Titulli mund të jetë një huazim, por ndërtimi poetik i tij përputhet me atë të teksteve të tjera të kësaj teme (Qysh mbillet gruri, elbi, misri, orizi etj.).
Krs. AIKP — P. Zaka, Liborfsh — Fier, 1980 (Fl. 7, f. 9).

322

T'LUMET NA ÇI JEMI ÇIKA

T'lumet na çi jemi çika,
dalim' mledhim boronica!
Mjer ata çë jan' baçica,
s'muj të dalin për boronica,
veç pedaten me korita.
Na jemi çika, bajmë sefa,
kemi lidh' besën mos m'u da,
mos m'u da sa t'jetë jeta.
ver' për ver' lutmi si kleka,
ato mledhim dredhza e mjedra,
pak ma nalt boronica t'zeza.
Kuçen façet kur i hamë,
bjeshkatart kshtu knojnë,
për boronica ata kur shkojnë.

Radovc — Pejë, 1972
Bob. 820/14

Krs. Gaz. «Jeta e Re» 1952, nr. 1, f. 390, Gj. A. 1962, I, f. 164. AIKP O. Xhatufa Kerrnajë — Tropojë, 1972, bob. 645/9; Q. Haxhihasani — H. Filja Strellc i Ulët — Deçan 1973 bob. 939/4.

323

DOLA N'BREG ME I RA KAVALLIT

Dola n'breg me i ra kavallit,
qe, po vijn' dy fëllanxa t'malit.
— S'jem' fëllanxa, por jem' çika,
jem' tuj shku për boronica.
nëpër bjeshk' na kalon dita.
Dola n'breg me i ra kavallit,
qe, po vijn' dy zana malit.
— S'jena zana, por vajza t'bukra,
jem' tuj shku për dredhza t'buta.

Suharekë, 1977

324

DRETHE MOJ DRETHE RRUMBULLAKE

Drethe, moj drethe, rrumbullake,
mir' po t'gjej në një kto shpate,
mir' po t'gjej n'nji kota shpati-e,
sikur mollën mi gardhi-e,

Vuthaj — Gusi. 1978

Krs. Gj. A. 1962 I, f. 165.

325

FRYNI NI FRESKI E HOLLË

Fryni ni freski e hollë
po more, jo more,[1]
na i lshoi dardhat tan' përtokë,
Çohni, vajza, mlidhni dardha,
Çohni, djelm, e zgjidhni t'bardha.
Fryni ni freski e hollë,
na i lshoi mollat tan' përtokë.
Çohni, vajza, mblidhni molla,
çohni, djelm, e zgjidhni t'holla.
Fryni ni freski e hollë,
na i lshoi pjeshkat tan' përtokë,
Çohni, vajza, mlidhni pjeshka,
çohni, djelm, e zgjidhni t'zeshkëta.[2]

Shënkoll — Lezhë, 1981

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) Këndohej nga vajzat kur mblidhnin pemët.

326

TË MË KISH BËRË PERËNDIA DARDHË

Të më kish bërë perëndia dardhë,
dardh', o bir, dhardhë,
lidhe, bir, lidhe,
tunde, bir, tunde,
ngrie, bir, ngrie,
qae, bir, qae,
hënj-hënj-hënj!
Të më kish bërë perëndia mollë,
moll', o bir, mollë,
tunde, bir, tunde,
ngrie, bir, ngrie,
qae, bir, qae,
hënj-hënj-hënj!
Të më kish bërë perëndia pjeshkë,
pjeshk', o bir, pjeshkë,
tunde, bir, tunde,
ngrie, bir, ngrie,
qae, bir, qae,
hënj-hënj-hënj![1]

Poro — Vlorë, 1960

1) Këndohej nga gratë kur shartonin pemët. Njëra këndonte dhe tjetra qante, kur e para thoshte fjalët: «qae bir, qae».

327

KJO VRESHTA TORË TRAP

Kjo vreshta torë trap,
sa u ritë kaqë vrap!
Kjo vreshta me rrush shumë
do na japë verë lumë!
Kësaj vreshtës me rush plot,
i vu dorën inizot.

Arbëreshët e Greqisë
Eleusinë 1980

1) E thonë kur vjelin rrushin.

328

NUSE TË KAM NJË HATËR

Nuse, të kam një hatër,
butin na e bën hazër.
laje, mbushe, bëne dritë,
që të mos pikojë pikë.
Këto ditë do vjelim rrush,
do ta mbushim plot me musht:
kur të vijë im bir mot[1],
ver' e raki të kemi plot.

Erind — Gjirokastër, 1958

1) Kupto: kur të vijë djali nga kurbeti

329

RRUSH-RRUSH HA BABUSH

Rrush-rrush, ha babush,
kur t'mjelli, s'vjen kërkush,
kur t'ha. vjen gjithkush.

Vojnik — Drenicë, 1972

330

DEL GRUA TE DERA

Del, grua te dera,
se na rrodhi vera,
vera dhe rakija,
vjen rrotull shtëpija![1]

Brezhdan — Përmet, 1939

1) Këndohet kur fillon prodhimi i verës dhe i rakisë.

331

RRUSH I BARDH' I DËNDUR-O

Rrush i bardh' i dëndur-o
bën verën të ëmbël-o,
pin' sa dehen pleqët-o,
sa harrojn' takijet-o,
andej nëpër hijet-o.
Rrushi i bardh' i dendur-o
bën verën të ëmbël-o,
pin' sa dehen plakat-o,
sa harrojn' napat-o,
andej nëpër krabat-o.

Ndërmënas — Fier, 1981

332

RRUSH I KUQ I DËNDUR-O

Rrush i kuq i dëndur-o,
na bën ver' të ëmbël-o,
të dehenë burrat-o,
të harrojnë gunat-o.
Rrush i kuq i dëndur-o.
na bën ver' të ëmbël-o,
të dehenë djemat-o.
të harrojn' shamiat-o,
të dehenë nuset-o,
të harrojnë cullufet-o.

Vërzhezhë — Skrapar, 1966

333

RUSH I ZI I DENDURË

Rush i zi, i dendurë,
bën verën e ëmbëlë.
Pinë plakat, dehenë,
dehen rrëkëllehenë
e ç'i shajnë nusetë.
Rush i bardh', i dendurë,
bën verën e ëmbëlë.
Pinë nuset, dehenë,
dehen, rrëkëllehenë
e ç'i shajnë vjerratë.

Pogradec, 1944

334

NDË VRESHTË NDË NJË KUCUR

Ndë vreshtë, ndë një kucur,[1]
këndon një zok i bukur;
këndon dhe ia thotë:
— Ku veni ju, vre shokë?
Ndë vreshtë, ndë një kucur,
ishtë një vajzë e bukur;
ndë kucur, ndë një vreshtë,
ishtë një vajzë e zeshkë.
Vajta t'e çonjë[2] vreshtënë,
çova të e zeshkënë.
— Kush na e shkundi pergulenë[3]
edhe u ça[4] atje përdhenë?
Kush na e shkundi. kush,
pergulea kei[5] rush[6]?

Arbëreshët e Greqisë
Vilë-Atikë, 1978

1) Kërcu.
2) Të gjej.
3) Pjergullën.
4) U ça. u këput.
5) Kishte.
6) Arbëreshët e Greqisë i kanë kushtuar mjaft këngë vjeljes së rrushit, duke gërshetuar në to edhe elemente erotike.

335

IA ZOT TË PISH NJË VERË

Ia, zot, të pish një verë,
dë kup' zonja do ta shterë!
Isht' nga vera jona, zot,
zonja na e siall[1] sot.
Një kupë t'e pimë plot,
të urojmë e për mot.[2]

Arbëreshët e Greqisë
Eleusinë, 1980

1) Na e sjell.
2) E thonë kur pinë verën e re për herë të parë.

336

VURA NJË VËSHTË NDË MALE

Vura një vështë ndë male,
rrodhe, moj Vasiliko,
rrodhe, moj të keqen-o[1],
vura pemë dhe çdo pemë,
vura dhe një degë ftua,
vura dhe qitro lejmua.
vura dhe një degë mollë,
me një vajzë, moj, belhollë.

Labovë — Gjirokastër, 1974
Bob. 1128/23

1) Vargjet 2 e 3 përsëriten pas çdo vargu.

Krs. AIKP — A. Fico, Nivan Gjirokastër, 1959, (Vëll. 3, f. 10): R. Durolli, Berat, 1968 (Fl. 14, f. 4): (Fl. 16, f. 21): M. Dule, Gjerbës-Srapar, 1975 (Bob. 1201/13);
ART — Lumas — Berat, 1975 (Bob. 1214/26).

337

SHUM' HYZMET ME I BA HARDHISË

Shum' hyzmet me i ba hardhisë,
me u vu mirë n'ven t'plehnisë,
mos t'e han goja e baktisë,
për punë màngut mos me e lanë,
nuk vonon nj'ather' me zanë,
po lidh gemat nalt në tanë,
Kur t'vin koha, si me thanë,
do ta dlirim me gërshanë,
manej qet filiza t'ri,
bân rrush t'bardh' e razakli.
Sa e mir' âsht kokrra e ti!
Vilnje n'shport', qitnje n'fuçi,
shtypnje mir', bânje bëlsi,
dani venë, piqni raki,
sa t'mirë âsht o për me e pi,
nër dit' festna për miqsi,
oda e prites lyp me e pi,
për të lodhun t'hjek mërzi.
Fort me men duhet me e pi.
Kush t'e pijnë rakin' për qejf,
e bân sokol e gjâ t'lehtë,
kush e pi ni grim' ma rânë,
e bân trim, porsi asllan,
e s'ke frig-o për kërkan.

po rrah gjykthin për mejdan.
Me nêj' tepër n'ta tuj pi.
bje në shpin', zhgërryhe si thi.
Me pasë veshun noj petk t'ri,
bjen nëpër balt' e nëpër hi
e s'shef mir' ather' me sy.
gjâ, qi a ni, t'duket dy,
as njef shoq. as kumari,
as njef nrikull, as njef bi.
Nis e flet do fjal' të kqija.
nis e flet e s'din çka thua.
t'prishet gjaku si i tërbua,
djerst për ball' nisin me t'shkua.
Nis e flet e s'di ç'me thanë.
veçse lef si qeni n'hanë.
Nuk vanon, me ner me thanë,
qet për gojet çka ke ngrânë.
E flen mirë e nis m'u çua
e shef mirë se ke gabua.
nër shokt tuj rrin i turpnua.
Shokë për mu mos u dishproni,
ma pak pijen ta vazhdoni,
rrypin tâj le ta shtërngoni.
Ç'e luvdume gemin e hardhisë,
ju rrit' nera t'zotit shpisë![1]

Rrilë — Lezhë, 1950

1) Ngritur nga rapsodi i njohur lezhjan Gjon Nikollë Sokolaj (në vitet '30).

Buka e duarve tona

(S. Kamberi)

338

PO FILLOJM' KATKN' E BUJQSISË

Po fillojm' katkn' e bujqsisë,
si me i ba hysmet arllisë,
me i piell'[1] tokat e plehnisë,
mos t'i haj goj' e bagtisë.
Kaj her' n'vjet, sa me thanë,
duhet me i kije me gërshanë.
Ban rrush t'bardh' e ban rrush t'zi,
vilen n'korp[2], qiten n'fuçi,
bajne ven', piqin raki[3].
Kush e pin-o rakin' shumë,
ta dij' mir' se i ban zullum,
kush e pin-o rakin' me rad[4],
bahet trim e zebërgjanë,[5]
qet për gojet çka ka ngranë.
Tash po lam' katkn e bujqsisë,
ju rrit nderja zotit shpisë.

Trijesh, 1972

1) Për t'i mbjellë.
2) Kosh.
3) Ziejnë raki.
4) Me radhë, me rregull.
5) Zemërgjerë.

339

KSHTU NA MSOJN' PUNT' E BUJQSISË

Kshtu na msojn' punt e bujqsisë,
si me i ba hyzmet hardhisë,
me e vu n'vend të plehnisë,
t'mos e haj' goja e bagtisë.
Qet filiza anembanë,
me e kye[1] me gërshanë,
menjiher' bahet tanë,
qet rrush t'verdh', qet rrush t'zi,
sa e mira kokrra e ti,
vile n'shport', plase n'fuçi,
shtype mir', bane bëlsi[2],
me e ba ven', me e ba raki,
Kjo rakia e mir' për t'pi,
si për fest', si për shoqni.

Laç — Krujë, 1967
Bob. 536/5

1) Folja *kij, kiej* — krasis (përdoret vetëm për hardhitë)
2) Bërsi.

340

S'DO PËRDORUR PËRTEKA

Ci-ci-ci, moj cermeli,
po lidh kokra çdo ulli,
kokrat hidhëroshe,
ngjyrë kaltëroshe.
S'do shkund' me përtekat,
se na thyhen degat,
kokrat na lëndohen
dhe na kalbëzohen.[1]

Maknor — Tiranë, 1971

1) Këndohej bashkërisht ose tek e tek në kohën e mbjelljes së ullinjve.
Këngën e këndonin mbledhësit të gjithë së bashku ose secili më vete.

341

DUANI NDIHUR MOJ KOPILE

— Duani ndihur,
duani ndihur, moj kopile?
Duani ndihur t'mbjidhni ullinj-ë?
— Nga e na ndih,
nga e na ndih, moj trim,
nga e na ndih, t'mbjedhmi ullinj.
Pra, të mbitojmi,
pra, të mbitojmi, moj trim.
pra, të mbitojmi me bukva[1].
— Moj vash, edhe u' t'solla,
tek trastea di molla[2].

Arbëreshët e Italisë
Ejaninë — Kozencë, 1981

1) Pra, të ftojmë, more trim, me bukëvale.
2) Bëhet fjalë për mbjelljen e ullinjve në fshatrat arbëreshe.

KAPITULLI I DYTË

KËNGË PËR BLEGTORINË

342

ERDHI VERA SI NGAHERA

Erdhi vera si ngahera,
birbili në mal këndon,
nëpër gropa ngrihen stane,
tërndelina lulëzon.
Shkojnë dhëntë vergje-vergje,
çobani përpara shkon,
del e shoqja buzëqeshur
dhe të shoqin e ndihmon.
Mbushur vedratë me shkumë,
përpara shtrungës i çon,
kur shikon djalin me nusen,
plakut zemra i gëzon.

Zhej — Gjirokastër, 1959

Krs. AIKP — A. Fico, Stegopull-Gjirokastër, 1959 (vëll. 2, f. 515); M. Muho. Lezhan-Vlorë, 1964, (Fl. 2 f. 36); Vlorë, 1966, (Fl. 16 f. 2).

343

HAJDE SEÇ U NISËN TUFAT VALLE-VALLE

Hajde seç u nisën tufat valle-valle,
ç'u nisnë nga fusha udhës për në male!
Seç e muar' udhën, Shkumbinit përpjetë.
që të ngrehin stanet në Gjemth[1] e në Meçë![2]
Ç'u dualën përpara me gëzim fëmija,
i zunë për qafe shqera e kërthija!
Nënë Gjemth e Meçë seç u ndezën zjarret.
zu të kundërmojë mali nga oshmaret,
zunë të ushtojnë këngët edhe vallet.

Pogradec, 1978
Bob. 1353/3

1-2) Male në rrethin e Pagradecit, në kufi me Librazhdin, që shërbenin si kullota verore për Myzeqenë.

344

SHOKË Ç'TË SHIKOSH NË QAFAT E SHPELLËS

Shokë, ç'të shikosh në Qafat e Shpellës[1],
nga Gropat e Malit[2], që lirohen verës?!
Në ditët e majit, mëzi shkon pas pelës,
kecërit kullosin në fletët e ferrës,
shelegët në bar majë luleverdhës.

Picar — Gjirokastër, 1964

1-2) Toponime në rrethin e Gjirokastrës.

345

NËPËR GËRXHE NËPËR MAJA

Nëpër gërzhe, nëpër maja,
me llaja, çoban, me llaja,[1]
bytyn bejka dhe cigaja,
plaku me rrobat e bardha,
seç i shkon tufës përpara,
kur i sheh, të merr sevdaja!

Dukaj — Tepelenë, 1965
Bob. 398/10

1) Përsëritet pas çdo vargu. (Transkriptimi muzikor nr. 16).

346

KUR ZBRESJE NGA ATO MALE

Kur zbresje nga ato male,
malësore dalngadale,[1]
për dore mushkën xanxare,
samari prej bojë arre,
ngarkuar me koçimare,
bëje tëndat e çobane,
furkat-o prej qiparizi,
dhënt' e tua mizë lisi.

Zhej — Gjirokastër, 1959

1) Përsëritet pas çdo vargu.

347

BERRJA JEME ME CINGARE-O

Berrja jeme me cingare-o,
t'tjetërkujna dalshin fare-o,
dalshin fare, u farofshin-o.
për ni muj n'Serbic'! i çofshin-o,
n'Mitrovic' i coptofshin-o!
Po del baçica me vajtue-o,
thrret çabani: — Oj kuku për mue-o!
S'po kam gja, me i kap', me i lshue-o.
Berrja jeme, lulja e gjyvezit-o,
mir' e din, oj vaktin e mëngjesit-o.
Si bylbylat nëpër peme-o,
berrja jeme ren-rene-o.
Dy lulkuqe, dy lulkuqe-o,
— A u ngine, oj melaqe-o?
— Un' u ngina, kangra bolle-o.
Treqin copa dhen e lope-o.
Berrja jeme ba tub'-tube-o,
kush të sheh ty do me t'hupe-o.
Berrja jeme n'bari t'verdhe-o,
t'jetërkujna hala mshele-o:
hala mshele, hala ngujue-o,
s'ka çoban-o për me i rujte-o.
Berrja jeme pi uj' n'deti-o,
te vjen era lulxheneti-o...

Berrja jeme me bajrake-o,
nuk po t'zan' tri sokake-o,
ka tri sokake, o ni ulice-o,
lumja un', oj nane baçice-o!
Berrja jon', oj me yllin në ballë-o,
Na i tranove tri mahalle-o,
tri mahalle, o tri qireza -o,
rreth e rreth n'lule gjyveze-o,
Berrja jeme, drita e fenerit-o,
t'dha uj-e, o n'Bunar t'Kamerit-o[2].
Kur t'i qes u n'kodra tona-o,
Shtat' cingare, o shtat' kumona-o,
krejt' Palacin[3] e tranojna-o,
krejt Marinen[4] n'kam' e çojna-o.
Berrja jeme, f'eta e duhanit-o,
mir' e din, oj vaktin e akshamit-o
O minili vija-vija-o,
oj berre, po t'çoj te shpija-o.
po t'çoj te shpija me t'ngujue-o,
para tanve, oj ty t'kam lshue-o.
përmas tanve, oj t'kam me t'ngujue-![5]

Kryshevc-Drenicë, 1973

1-4) Toponime në krahinën e Drenicës.
5) Këngë e frymëzuar nga dashuria për tufën dhe kujdesi për mbarështimin e saj. Këtë mënyrë shtjellimi e gjejmë edhe në disa këngë të tjera me temë të punës (shih variantet që vijojnë etj.).

348

ANI BERRJA JEME JALLA PI UJË N'KRUE

Ani, berrja jeme, jalla, pi ujë n'kruc,
i me ni e unë me ty, o moj lale, i taj to![1]
Ani, i vjen era, jalla, moll' e ftue.
Ani, berrja jeme, amon-o, kullot n'arë,
ani, tjetërkujna, ani, i coftë n'ahër!
Ani, berrja jeme, aman-o, kullot n'ledinë,
tjetërkujna, aman-o, i coftë n'detelinë!
Ani, berrja jeme, aman-o, kullot n'sërrmishtë,
ani, tjetërkujna, aman-o, i coftë n'torishtë!

Turiçevc-Drenicë, 1978

1) Përsëritet pas çdo vargu.

349

BERRET E MIJA TOPA — TOPA

Berret e mija topa-topa,
kah po shkoni, dridhet toka,
dridhet toka edhe shpija,
se po ju man bab' zotnija.
Berret e mija bishtin si mnash,
lumja un' qi ju shkoj mas!
Pini uj' e shterrne rekën,
se keni hangër bari tepër.

Gumnishtë — Vuçitërnë. 1960

352

BERRJA JEME OJ U NGI U RRAS

Berrja, jeme, oj, u ngi, u rras,
t'tjetërkujna, jalla, jan' ba drrasë:
jan' ba drrasë, oj, jan' ba teneqe.
si shpenkeqe, jalla, ty, ty, ty.
s'e kan' pa-e, oj, barin me sy.[1]

Klladërnicë — Drenicë, 1978

1) D.sa nga këto këngë i këndojnë blegtorët e vegjël. kur shkojnë me bagëti.

Ndërtimi me kundërvënie vërehet edhe në këngët e kullotjes së gjelave të detit (Krs. këngët nr. 471, 472 etj).

353

BERRJA JEME N'BARI T'VERDHË

Berrja jeme n'bari t'verdhë,[1]
e tjetërkuj po han therrë[2];
berrja jeme n'bari t'gatë,
e tjetërkuj n'guri t'thatë;
berrja jeme me kumonë,
e tjetërkuj me patkoj;
berrja jeme, o bylyk,
hije t'ka cingara n'fyt;
berrja jeme bishtin me tufë
lumja un' qi t'qes në fushë;
berrja jeme bishtin me gogla,
lumja un qi t'qes në kodra!

Vojnik — Drenicë. 1972

1) Fjala e verdhë në Veri përdoret me kuptimin «e gjelbër»; këtu pra «në bar të gjelbër». Shih edhe këngën që vijon «Lugjet e verdha» — Lugjet e gjelbra.

2) Fe.rë.

354

PRIJ OGIÇ BISHTIN ME TUFË

Prij ogiç, bishtin me tufë,
po t'run ty çika Xufë;
prij, ogiç, brinat me dredha,
po t'run çika n'Lugje t'Verdha.
Priji bylykut, bisht mundash,
lumja çika qi t'vjen mas.
Prendoj dilli vija-vija,
hajde, t'i çojna gjan' te shpija.
Hajde, çik', se ka ra hana,
tash pisket, moj, baba e nana!
Hajde, ogiç, ç'ka t'kam kallxu,
drejt te shpija tash me shku,
kërkuj udhën mos me ja lshu!

Budakovë-Suharekë, 1976

355

NIQIN DHEN NIQIN BARDHOKA

Me t'qit' zoti n'kodra tona,
m'i pa ugiçt-o me kumona,
kah p'i bina, kah p'i çojna,
me kumona rrumbullojna!
Ti s'ki shum', veç dy-tri copa,
un' e lumja, niqin copa,
tana t'mira, dhen bardhoka,
e kan' leshin dej[1] tu toka.
Pri ugiç, t'u prift' e mara,
niqin copa mas e para,
gjysa t'zeza, giysa t'bardha!
Niqin dhen, niqin, bardhoka,
hije i ka çabanit shoka,
hije i ka shoka e mitani,
p'i njell dhet', p'i qet pej mali.
Zo', kto berre, uj' ku pinë?
Qatje posht', në qat lendinë.
Mall ma ka çabani shpinë,
mall e ka shpin' e vet,
për m'i hangër do buk' t'nxetë.

Dushi i Madh — Prekorupë, 1972

1) Deri.

356

PRI BYLÝK TY T'PRIFT' ALLAHI

Pri, bylyk, ty t'prift' allahi!
Ju lshoj heret para sabahi.
Pri e pri, ore bylyk,
ty të ruej si lirën n'fyt!
Kam bylykun shara-shara,
gjysën t'zeza, gjysën t'bardha.
Kam bylykun lara-lara,
lum u'i lumi, qi u dal para!
Dhet'[1] e mija për ornica,
qesin tamël si bollica.
O bylyk, o dylber,
për ven krype u qes shiqer.

Bajgorë — Shalë, 1969

1) Dhentë.

357

JU MOJ DHEN E JU MOJ DHI

Ju moj dhen e ju moj dhi,
ku i mbushët ato gji?
M'ato prrënj, atje lart,
ku pikonte gjethja mjaltë.

Divjakë — Lushnjë, 1953

358

HAJDE BIJË BIJ' ÇOBANI

Hajde, bijë, bij' çobani,
hajde, se po të pret stani,
të shpjem' dhëntë në kullotë,
të na mbushin vedrat plot.
Të shpjem', dhëntë në bregore,
të dëgjojmë zile këmborë,
t'i ngjisim përpjet' në brinjë,
të han' bar e trëndelinë.

Podgoran — Përmet, 1981

359

KUR M'I NGISJE ATO SYSKA

Kur m'i ngisje ato syska,
krraba jote pika-pika,
llaj, more çoban,[1]
l!aj, more çoban!
Syska dhe syska me dorë[2],
mbushej vëndi me këmborë[3].
— Çoban, i thërret çobanka,
do nxjerrim djathin nga napa.

Dëshnicë — Përmet, 1981

1) Vargjet 3-4 përsëriten pas çdo dy vargjesh.
2) Të zgjedhura me dorë.
3) Gjëmonte vendi nga këmborët.

360

Ç'VJEN NJË ERË TRËNDËLINË

Ç'vjen një erë trëndelinë,
trëndelina kundërmon,
erdhi prilli si ngaherë,
bilbili fushës këndon.
Atje sipër, maje malit,
këmbor' e zile dëgjon,
çobani, cylës dyjare,
i bie, fare s'pushon.
Dashi me brirë të dredhur,
para dhëne seç përçon,
shelegetë blegërijnë,
cjapi posi trim kalon.
Dielli fillon të ngrohë,
bar e ara gjelbëron,
kullosin dhentë gjith' ditën,
edhe nata po afron.
Bariu shum' i gëzuar,
në shtrungë vete i çon,
Merre, moj, vedrën të thashë,
se do mjelim, a dëgjon!

Del' e shoqja buzagaze,
të shoqit seç i ndihmon,
ja dhe djali i gëzuar,
dhentë seç i numuron.*

Lazarat-Gjirokastër, 1959

*) Nga gjuha, ndërtimi me rimë të alternuar etj., krjimi i vonë (shih edhe nr. 354, 356, 367).

361

DOLLI HËNA BUZË MALIT

Dolli hëna buzë malit,
hën', o hën' e bukur-o,
o yll i këputur-o.[1]
Ngreu, çoban, e çkuli dhëntë.
jepu lart këmbën[2] e malit,
të hanë majën e barit,
të pin' ujët e spitharit.

Progonat — Tepelenë. 1973
Bob. 972/1

1) Përsëritet pas çdo vargu
2) Rrëzën e malit.

Krs. AIKP. — A. Mustaqi, Pilur — Vlorë, 1972 (Bob. 858/1).

362

MIRË SHTRUNGË

Kur kullosin delet malit,
qumshti i deles verdh' si ari,
mirë shtrungë.
Kur kullosin delet fushës,
plot me qumësht mjelsen e mbushin
mirë shtrungë.

Barbullush — Shkodër, 1981

363

AMANET MOJ DELJA RUDË

Amanet. moj delja rudë,
as ma fal nji kingj të butë,
kingj të but' e lara-lara.
sa t'i dal' djalit përpara,
verë-verë aman!
Amanet, moj delja rudë,
as ma fal nji kingj të butë.
ta kullos, moj. rrug' më rrugë:
rrug' më rrug' e ferr' më ferrë.
ta qeth baca në pranverë,
verë-verë aman!

Dajç — Lezhë. 1981

Krs. AIKP — K. Taipi. Shkodër. 1938 (Dos. 1. f. 87): J. Panajoti, Librazhd, 1965 (Bob. 414/27).

364

ASAMAN MORI DELJA GALË

Asaman, mori delja galë,
as ma ban nji qingj të bardhë,
ta kullos, mori, mhall' në mhallë!
Asaman, mori delja rudë,
as ma ban nji qingj të butë,
ta kullos, mori, rrug' në rrugë!
Moj e mira në rudinë,
kullot bjeshkën pa travinë,
kujdes hiç, marak nji grimë,
kullot bjeshk' edhe livat,
kujdes hiç, marak aspak,
Un' në bjeshk-o kur mballova,
sa ma shpejt grigjën e shtova.

Arbnesh — Krajë, 1972

365

KUR FILLOI GËRSHËR' E PARË

Kur filloi gërshër' e parë,
moj aman, aman,[1]
me hair e me të mbarë.
të mbushim bashkat me radhë.
t'i shkrifim, t'i bëjm' shtëllungë.
t'i tjerrim, t'i bëjmë gunë,
t'i kemi gati në strungë.

Vidhishtë — Fier, 1983

1) Përsëritet pas çdo vargu.

366

SA LEZET QË KA ÇOBANI

Sa lezet që ka çobani,
kur e merr krrabën në dorë,
seç i mbledh delet te stani,
ashtu siç e ka zakon.
Ndjell syskë, bejk' e balë
edhe deshtë me këmborë,
merr gërshërët mengadalë
dhe u qeth flokun si borë.

Zogas — Skrapar, 1981

367

JANË DHENT' E TONA

Janë dhent' e tona,
janë bardh' si pllumi,
i ka rrëjtun[1] nana,
hoj, me kokrra gruni![2]

Përbreg — Kukës, 1982

1) Rritur.
2) Këto vargje këndoheshin kur laheshin dhentë në lumë.

368

DALIN TE RANËT

Dalin te Ranët,[1]
na mprehin gërshanët,
na grahjen[2] gjemtë
e na qethin dhentë.
Dalin qehallarët,
na mushin hararët.

Fshat — Kukës, 1982

1) Në breg të përroit, te rëra (toponim).
2) Ngrihen.

369

LUMJA UNË PËR HAVA

Lumja une për hava,
shkoj me gja e baj sefa.
Sefan' teme kush s'e di,
se gjith' ditën ungjun rri.
Berret e mija me kumonë,
u lshoj heret, u bij vonë,
nuk ju çoj n'sahati tetë,
deri t'bjen terri në rekë,
terri n'rek-o, me u terrue,
gjithmon' kshtu kam me u çue.

Skromë — Vuçitërnë. 1961

370

PRAROJ DIELLI OJ U KUQËN RETË

Praroj dielli, oj, u kuqen retë,
hajde, oj motër-o, i çojna dhetë!
Hajde, oj motër, i çojna te shpija.
gjajm' kunatën, jalla, tuj pjekë flija.
— Oj kunat-o, a me hjek' ni ren?
— Po vallahi, jalla ja n'kit' ven

Zhiti — Podujevë, 1973

371

PRAROI DIELLI DUELËN RETË

Praroi dielli, duelën retë,
u ba vakti me i çue dhetë.
Haj e haj, o gjajat tona,
n'at' an' bregu ju nihet kumona.
Pri, oj Allxh', t'u prift' e mara,
treqin kumona mas e para!
Pri, oj Allxh', bisht kllobodan,
javash ec e javash han!

Llap — Podujevë, 1974

372

PRI BARDHOKA ME CINGARE

U nis terri me u terrue,
i nisun dhet-o n'shpi me i çue,
pri Bardhoka me cingare!
Dhet' e mija jan' malltare,[1]
tana t'tjerave u dalshin fare, ,
dalshin fare, u farofshin,
nja tu shpija mos u shkofshin!
Dalshin nanat tuj vajtue,
nisshin çikat me i grushtue:
— Dhet', ku i kini? Mos pritshi m'i prue!
Ja kan' lane, oj, ukut me i rue.

Hërticë-Kamenicë, 1973

1) Prodhimtare, që japin qumësht shumë.

373

PO RRJEDH PREJ BURIMIT UJËT E KULLUAR

Po rrjedh prej burimit ujët e kulluar.
sa lezet ka vëndi, vëndi i lulëzuar,
përkëdhel veriu kaçarin përçuar,
e shikoj barinë me kope trazuar.
Atje te mërzimi, të vesh afër, druan.
se e ka Gumenin[1], që, kur fle, e ruan.
rri edhe përgjon, kur shkulet, e zgjuan!

Picar — Gjirokastër, 1969

1) Emër qeni.

374

KU KE QENË ME KULLOT TI

Ku ke qenë me kullot' ti,
moj lum nana[1])?
Mal mi mal e shkam mi shkam.
T'ma bijsh qumshtin me kazan.
Ku ke qenun me pi ujë?
Në at' kru që nuk' me[2] kurrë.
Ku ke qenë me kullot' ti
T'ma bijsh qumshin me kusi.

Pezë-Tiranë, 1977
Bob. 1303/17

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) Më nuk ngelet.
(Transkriptimi muzikor nr. 17)

375

BLEGËRON DELJA NË MAL

Blegëron delja në mal,
blegëron, kërkon çoban.
— Ç'ke, dele, qi blegëron?
— Kam nevoj' me blegërue,
se çobani m'a martue.
S'po m'vjen keq se asht martue,
po m'vjen keq se asht madhshtue,
n'rrug' e neshinj, s'flet me mue.
Kur kishnjesh çoban beqar,
hanjesh gjeth e hanjesh bar,
hanjesh bar-o malevet,
pinjesh uj-o kronjevet,
banjesh mriz-o nalt në bjeshkë.
Si m'u martue çobani,
po banj mriz-o nën murriz,
po pi uj-o brrakavet,
po ha bar-o rranxave.

Ljare-Shestan, 1950

376

PO ÇKA LKUÇJA ÇI BLEGRON

— Po çka Lkuçja çi blegron,
vaj Loce, vaj?[1]
— Kam nevoj' e me blegrua,
se çobani m'a martua.
Kur kam pas' çoban beqar,
un' ma e para n'bjeshk' kam dalë
e kam hagër maje lulash,
e kam pi uj' prej gurrash.
Tash e mjera kullos rrugash,
tash e mjera pi uj' pusash.
tash më mjelin nëpër ulica,
fmija m'rrahin n'lopatica.

Muzheçk — Trijesh. 1980

1) Përsëritet pas çdo vargu.

377

PSE S'KËNDON BIRBILI VALLË

Pse s'këndon birbili, vallë,
herët e pa gdhirë mirë?
Pse s'këndon? Ku e ka hallë?
T'ia thotë në mugëtirë,
kur çobanka rreh dubeknë.
na talër mëleth shëllirë?
Këndona, birbil, këndona,
këndona përmi mërzimnë,
atje ku mërzen kopeja,
ku çobani bën pushimnë;
gjum' i ëmbël ç'e ka zënë,
rreth e përqark bagëtinë,
thuaja me ato këngë,
thuaja, se na vjen mirë!

Picar — Gjirokastër, 1940

378

HOJE-HOJE VOFSHI MARË

Hoje-hoje, vofshi marë,
sikur bima nëpër arë,
sikur bima hajmeli,
tana prama m'ardhshi n'shpi,
tana prama m'ardhshi n'derë,
iu del dada me ju mjelë.

Vuthaj — Gusi, 1978

379

KAM QEJF KUR SHIKOJ KOPENË

Kam qejf kur shikoj kopenë,
që kullosin lart në pllajë,
çobani ka marrë fyellë
dhe i bie me të qarë.
Bariu u del përpara
dhe u hedh kripë në gjollë,
i ndjell delet i gëzuar,
që me vrap pas tija shkojnë.
Dhe si hanë kripë delet,
i shpije ujë të pinë,
që t'u ket' lezet kullota
dhe t'u shijojë më mirë.

Zogas — Skrapar, 1981

380

O ÇOBAN ÇOBAN T'KAM THANË

O çoban, çoban t'kam thanë,
po t'thërrr[1] nana, buk' me t'dhanë.
Çobanit bukën me janxhik,
gjellën qenve në koritë.
Dhenve krëipën[2] ku me jau lshu?
Drejt në mrriz duhet me i çu,
drejt te mrrizi tuj fishllu[3],
nor[4] kta aha me i mrizu.

Gjergjefdoll — Kaçanik, 1972

1) Thërret.
2) Kripën.
3) Duke fishkëllyer.
4) Ndër.

381

PO VJEN LACA ME TRE EDHA

Po vjen Laca[1] me tre edha.
— Ku ke ken', o Lac' e mjera?
— Kjeç[2] në bjeshk', u gina therza,[3]
m'molën grat', m'ruejtën fmija,
m'u blodh keq, ika tu shpija,
M'kan' mjel' ka tri her' n'ditë
e nuk m'kan' dhan' kokërr krypë.
Më kan' lidh-e te shkozbardha
e nuk m'kan' qitë gja përpara,
Mos me ken' shoqja e malokut,
m'u kujtuo, për hatër t'zotit,
e me m'zgidhë prej konopit,
paç me cof' para shna Rrokut![4]

Budë — Trijesh, 1972

1) Emër i përveçëm dhie.
2) Qeshë, isha.
3) U ngopa me ferra.
4) Festë fetare e ritit kristian.

382

RA DIELLI NË VATHË

Ra dielli në vathë,
erdhë mushkatë me djathë;
ra dielli në avlli,
erdhë mushkat në shtëpi,
prunë djathë, qumësht, kos,
vesh më vesh janë furrosë.[1]

Nivicë-Sarandë, 1968

1) Kënga këndohet nga të vegjëlit, kur vijnë mushkat nga stani dhe sjellin bulmetin në shtëpi.

383

DO VESH ME DHËN APO JO

— Do vesh me dhën apo jo,
moj shelege e vogël-o?[1]
— Do të vete, domosdo,
do t'u shpie bukën-o.
s'e di se ku mblidhen-o?
— Në nome të vjeshtës-o.
— A ka farmak[2] apo jo,
që të farmakosen-o?
Më plasi shpirti me to.

Zhej — Gjirokastër, 1959

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) Fjala farmak (helm) përdoret me kuptimin figurativ të kullotës që gjëndej me vështirësi.

384

NISIN BREJAT ME FISHKLLUE

Nisin brejat[1] me fishkllue,
nisin zogjtë me pushue,
nisin stanet me u shkretue,
sall ni jav' dojm' me i lshue.
Kur të dalim n'Ledinë t'Shalës,[2]
të mir' meç o Kroni i Arës,[3]
kur të bimë[4] në Sallanxhak[5],
të mir' meç, o baba plak;
kur të bim-o na te Kisha[6],
mlidhen Shala[7] e Berisha[8];
kur të him-o na n'Deçan,
të mir' meç, o more stan![9]

Strellc i Ulët-Pejë, 1973
Bob. 939/10

1) Bredhat.
2,3,5,6) Toponime në rrethin e Pejës.
4) Kur të zbresim.
7-8) Fshatra në rrethin e Pejës.
9) Këndohet kur bagëtia ikin nga bjeshkët e zbresin në vende të ulëta me të nevojtë për të kaluar dimrin.
(Transkriptimi muzikor nr. 18)

385

TUNDA-TUNDA VAJA-VAJA

Tunda-tunda, vaja-vaja
sod dy jav' na vijn' karvaja.
Kërcet pushka, bahet nami,
bahet nami tan' tuj knue,
buk' me hangër, me u ftillue,
n'Gura t'Nuses[1] me pushue,
bukë me hangër, n'shpi me shkue,
kur t'na dalin nanat përpara,
na apin molla, na apin dardha.[2]

Pobergjë — Deçan, 1952

---

1) Toponim në rrethin e Pejës.

2) Zbritja e bagëtive nga bjeshkët kur fillonte të ftohej koha, kthehej në një festë të gëzueshme jo vetëm për barinjtë, por edhe për pjesëtarët e tjerë të familjes.

Bashkë me bagëtitë vinte gjalpi, maza, djathi etj. i grumbulluar gjatë gjithë verës. Me këtë rast organizoheshin gostira me mishra, mazë e ëmbëlsira ku thirreshin sidomos bijat e shtëpisë, martuar jashtë fshatit.

Verimi i bagëtive në bjeshkë ka qenë karakteristikë për tërë Veriun (Malësinë e Madhe, Dukagjinin, Nikaj-Merturin, Malësinë e Gjakovës, Lumën e Kosovën). Çdo krahinë ka pasur bjeshkët e saj. Atje kalonin verën edhe familjarët, me përjashtim

të ndonjë të moshuari që mbetej në fshat për të ruajtur shtëpinë. Ditët që kalonin në bjeshkë ishin nga më të gëzuarat për malësorin. Kullotat, mbledhja e boronicave, flladitjet nëpër gurra e kroje, mrizet nëpër hije, këngët e çikave me gisht në fyt, lahutat, çiftelitë, sharkitë, lodrat, çastet idilike të të rinjve mbeteshin kujtime të paharruara për jetën e tyre.

Si ngjitja, ashtu edhe ulja (zhdjerga) bëheshin të organizuara në kohë e rrugë të caktuara për të mos ndodhur pështjellime, përzierje të tufave gjatë shtegtimeve.

386

O TUNA-TUNA E VAJA-VAJA

O tuna-tuna e vaja-vaja,
o sod ni jav' na vin' karvaja:
o vin' karvaja varg e vi,
o sikur dhent' në Ruseli:
o vin' karvaja vija-vija,
o na i bin teshat në shamija,
o sod ni jav' po shkojm' te shpija:
o vin' karvaja si zamoni,
o veton tirja, kllapodani,
li ja-o, li ja-o,
u va-o, u va-o.[1]

Drenovc-Rahovec, 1962

1) Këngët e ngjitjes së bagëtive në bjeshkë dhe të «zhdjergës» së tyre janë quajtur edhe «këngë karvajesh». Ato këndoheshin zakonisht nga bareshat, duke vendosur gishtin e madh në fyt për t'i dhënë një dridhje të veçantë zërit. Në hapësirat e kullotave këto lloj këngësh që thirren nga ky shkak edhe «Kangë me fyt», krijonin një melodi me dridhje të posaçme.

Traditat e këtyre këngëve (këngëve me fyt) është e njohur edhe në krahina të tjera të vendit tonë (Malësi të Gjakovës, Postribë, Kavajë, Kërrabë, Tepelenë), por edhe në disa zona të alpeve dinarike. Duke u nisur nga disa dëshmi të arkeologjisë, mendojmë se ajo duhet t'i përkasë një tradite vokale të lashtë, të trashëguar nga periudha e stërgjyshërve tanë ilirë.

387

KUR TË SHKOJË KARVAJA TE SHPIJA

Kur të shkojë karvaja te shpija,
kërcet pushka, kërcet alltija,
thrrasin miq, po thrrasin bija,
po vlon pitja në tepsija,
po vlon maza në kusija,
po vlon mishi n'haranija.

Pobergjë — Deçan, 1952

388

EU VIN' KARVAJA TAN' TUJ KNUE

Eu, vin' karvaja tan' tuj knue,
o n'Guri i Nuses[1] me pushue,
o bukë me hangër, me fillue,
o sa ma shpejt teshat m'i prue.
o nesër nadje n'shpi me shkue.
E kur të dalim te dera e stanit,
o të mirë meç, moj, maja e malit!
E kur t'shkojmë na te shpija,
e gzohen pleçt e gzohen thmija.
O ne na dalin nanat para,
o plot pshtjellakt molla e dardha:
o prehet dashi, prehet dhija.
o zihet mishi n'haranija,
o piçet pitja në tepsija,
o zihet maza në kusija,
o thrrasim miç e thrrasim bija,
e knojmë kangë me çiftelija,
o tak e tuk kërset alltija,
a ha, se karvaja erdh te shpija,
li ja-o, li ja-o,
u va-o, u va-o![2]

Strellc — Pejë, 1962

1) Toponim në afërsi të fshatit Strellcë.
2) Zëra që theksonin tingëllimin e veçantë të këngëve me «ryt» të vajzave.

389

VAJA-VAJA VIJA-VIJA

Vaja-vaja, vija-vija,
sot ni jav' po shkojm' te shpija,
na vjen Xhogu dhe Dorija,
na bjen baci kurabija.
Thot: — Jam ardh' m'u zhdjerg te shpija.
Kapullanen dhezim me dllija,
përreth saj kcein tan' thmija,
se po dojnë me shku te shpija,
i bojmë zhdjergat për xhyhret,
veshem, nrrohem për lezet.
Tamli trashun na pret n'kusi,
maza e zime asht tu zi.
Kryhet silla, nisem për shpi.
tuj fshi lotë, kthehet baçica.
— Sot un' shum', thot', u murzita,
se me shkue sot thmija e shkollës,
s'kam me kan[1] t'nrroj' i fjal' t'gojës.
Gzim të madh kem' sod na thmija,
çe jem nis' me shku te shpija,
se kur dalim n'Breg të Shkallës[2],
i vjen era kumllës e thanës;
se kur dalim te Kroni i Bazes[3],
i vjen era kumllës e dardhës;
se kur dalim te Kroni i Doçit[4],
i vjen era kallamoçit;

se kur dalim mi[5] katunit,
i vjen era bukës grunit;
se kur t'him' në der' t'oborrit,
i vjen era kungullorit;
se kur t'him në shpi te gratë,
thon' se erdhën bjeshkatartë.[6]

Radovc — Pejë, 1972
Bob. 820 2

1) Me njeri.
2-4) Toponime në Radovc.
5) Përmbi, majë katundit.
6) Kënga këndohet me gisht në fyt, kur përgatiten për të zbritur nga bjeshkët.

390

VAREN BARINJTË NGA MALI

Varen barinjtë nga mali,
varen me kope,
zbresin poshtë në kullota,
derdhen fushave,
dëgjohet cula tek Guri[1],
përtej në rrëke,
fryn dyjarja lart në pyje,
kullot, moj kope,
secilit zëmra i do
gaz edhe hare.

Ramicë — Vlorë, 1974
Bob. 1151/5

1) Toponim në afërsi të fshatit Ramicë.

391

HOPA MASHALLA TI MOJ DELJA BALË

Moj, dolle nga Vlora me kalin me shalë,
hopa mashalla, ti moj delja Balë![1]
T'enjten n'Qarr' të Korçës[2]. Korçë të xhumanë,
t'u mbluadh' kasapët, ç'e prishe pazarë,
të hoqën këmborën, të shkuan gjerdhanë.
Kur e therën Balën, u thevi hanxharë,
Kur i çanë barkun, shtatë okë dhjamë,
kur peshuan mishin, u thevi kandarë,
dyzet okë mish, lëkurën mënjanë!

Ersekë — Kolonjë, 1957
Bob 158/10

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) Qafë mali, kufi midis rretheve të Korçës e Kolonjës.
Krs. AIKB — M. Ristani, Vërçun-Korçë, 1966 (Fl. 1, f. 6)

392

DASHI-DASHI LESH MTASHI

Dashi-dashi, lesh mtashi,[1]
ma ke brinin porsa pashi,
ma ke mishin për zotni,
ma ke leshin për vorfni.

Trijesh, 1972

1) Mëndafshi.

393

BARIU SHOKË BARIU

Bariu, shokë, bariu,
kur gjëmon e fryn veriu,
është përjashta fatziu,
e rreh breshëri e shiu[1].
Bariu me krabë në dorë,
ruan deshtë me këmborë.
Hani, moj bagëti, hani[1],
plot qymësht mbushet kazani.
Vetëtin drita e diellit.
bariu i bie fyellit.

Zhepovë — Përmet, 1978

1) Vargje që të kujtojnë poezinë e njohur të Çajupit.

394

LUM SI KUDHRA IME E ERGJËNDA

Lum si kudhra ime e ergjënda,
haja pak e rrija brënda,
ç'm'u deshnë këto të rënda.
Dimëri po më mundon,
mir' me topa më qëllon,
po me pish' pse më kërkon?![1]

Vuno — Vlorë, 1980

1) Simbas të thënave, kovaçit i pëlqeu puna e blegtorit në stinën e verës, kur mileshin bagëtitë e përpunohej qumështi, prandaj me dëshirën e tij e la zanatin dhe shkoi në mal, për të kullotur bagëtinë. Iku vera dhe erdhi dimri me vështirësitë e tij. Me topa, nënkuptohen në këngë bubullimat, ndërsa me pishë, vetëtimat.

395

SHTEG MË SHTEG BIE KËMBORA

Shteg më shteg bie këmbora.
këmba-këmbës i ndjek bora.
blegërasin për vëgjolla,
Shkon baresha si lastonja,
flak' e kuqe posi molla;
mbeti çatorja te pënja,
asnjeri nuk të rri brenda.
po punojnë vajza, mëma,
vënë llabanen në kokë,
shtjerrat i marrin në shportë.

Picar — Gjirokastër. 1969

396

KNON BYLBYLI GROP' NË GROPË,

Knon bylbyli grop' në gropë,
t'lumët na po shkojm' me lopë,
se me lopë a sefaja,
se me dhen a belaja.
Knon bylbyli nëpër plepa,
t'lumët na po shkojm' me vjeta,
se me vjeta a sefaja,
se me dhen a belaja.

Korishë — Prizren, 1974
Bob. 1185/16

397

KUR PO VJEN LOPA N'AKSHAM

Oj nana plakë, lshoma lopën,
se nuk e çoj une n'kodër,
por e çoj prrue m'prru,
ani, i bjen gjit-o sikur kru,
ani, ta kulloti un' 'i motmot,
ani, i bjen gjit-o gjithmon' plot,
ani, e kulloti une n'fusha,
i qes kollomoq në të musha.
Ani, kur po vjen lopa n'aksham,
ani, nëpër oborr veç lodron.
Ani kadal' lop' nona ty t'mjel,
ani kët' hak ty-o sot ta nxjerr.

Kamenicë — 1982

398

NOLLA VIÇIN MOJ SELVI

Nolla[1] viçin, moj Selvi,
ma lsho tamlin ti në gji,
ma lsho tamlin dalkadalë,
ma lsho tamlin fort të bardhë,
ma lsho tamlin ndër kusija
e ta ndej un' ndër tepsija
e ta ndej un' ndër çinia!
Ti m'i knaq rob e fmi,
t'u shtoft' tamli, ty, në gji!

Dajç — Lezhë, 1981

[1] Ndolla.

399

QASE KAMËN MOJ VERUJE

Qase kamën, zoti t'rujtë,
shtylla e shtëpisë,
lshoje tamlin me shumue
jetën e fëmisë!
Qase kamën, moj Veruje,
viçi tasht afrue,
lshoje tamlin n'cica t'bardha.
ty t'u priftë e mara!
Ç'po gufon ky tamli i bardhë.
ty t'u priftë e mara!

Millë. 1970

400

MUSHE MJELSEN DËR TE GRYKA

Jerr, mori lop'. ti m'vash marë,
porsi bima nëpër arë,
ma ke ba nji viç të bardhë!
Ty nana, mori, po t'kndon,
viçi tamlin ma maron.
T'kam të mir' e t'kam të butë,
ti mjelsen prap' po ma mushë.
Me kullot', moj, du me t'çue,
prap' ti tamlin me na prue,
me na pru tamlin te mjelsa,
se po t'pret viçi te dera.
Po t'pret viçi te hajati.
ç'po pi tamël, he e preft' kasapi!
Sa po baj punë nëpër shpi,
po m'maron tamlin unji,
s'po m'le asnji pik' n'kusi.
Pej ti, ty m'duhet me t'da,
ty, kyt gja, duhet m'i ditë,
për te, ma mos me bërtitë.
Njashtu, pra, t'u dhasht' e mira,

na mush mjelsen der te gryka!
Ty ta dhasht' zoti të marën,
se na njome ne kashatën!
Po ban tamli vue-vue,
zoja e shpis' tuj u shendue.

Arbnesh — Krajë, 1972

401.

OJ ALLXHO BISHTIN ME TEL.

Oj Allxho[1], bishtin me tel,
lum baçica ty qi t'mjel.
Oj Allxho, tufa e meçikut,
dihet gjaja e shpija e mikut.
Hajt, Allxho, bishtin me topa,
kur po t'lshojmë po dridhet toka.
Hajt Allxho, bishtin me mnash,
lum çobani qi t'vjen përmas.
Hajt Allxho, sa t'kum[2] kallxue,
kurkuj udhën mus[3] me ja lshue,
veç allahit edhe mue
edhe çobanit qi t'ka rue[4]

Llap — Bodujevë, 1974

1) Emër lope. Shpesh në këto këngë lopët përmenden me emrin e tyre të përveçëm: Allxho, Balushe, Ballhanë, Bardhanë, Ciclaricë, Kalinë, Kallushë, Kuqeshë, Larë, Larje, Larukë, Larushe, Mallushë, Molla, Mollo, Murrë, Murricë, Selvi, Sharukë, Shegojë, Shkurtë, Verujë, Xhuf etj.
2) Kam.
3) Mos.
4) Ruajtur.

402

JA BARDHANA JA BARDHANA

Ja Bardhana, ja Bardhana,
të pastë nana, të pastë nana,
të çon nana n'fusha t'gjana,
ti ha bar, un' baj gjitana.[1]
Ato fusha tu' kërkue
ato shegja gjrumullue,
kush të baft-o ty mëgji[2]
na i plast-o gjali i ri,
i bift' ferra në shtëpi,
mos i bift-o nja, po tri!

Bisakë — Mirditë, 1976

1) Gajtanë.
2) Magji.

Krs. AIKP — D. Përshqefa, Klos — Mirditë, 1976

403

MOJ BARDHANË MOJ BARDHANË

Moj Bardhanë, moj Bardhanë,
ça t'bij para mos me lanë,
tamli s'del, o për pa ngranë,
për pa ngranë e për pa pi,
tamli duhet për dit' në shpi!
Moj Bardhanë, moj Bardhanë,
mu zoj' shpije nuk më lanë,
pa lang t'bardhë në sahan!
Mos ban buz', oj të past' nana,
se, mas kashtës, po vjen sana!
Moj Bardhanë, moj Bardhanë,
mushma okën plot për plot,
t'mush koritat edhe kaca,
se në shpi po duhet maza!

Trun — Pukë, 1970

404

CICLARIC' HAJRI T'U PATË

Ciclaric', hajri t'u patë.
Ciclaric' o ti vash[1] marë,
porsi bima qi bin n'arë!
Ciclaric', të mjel ty nana,
moj Laric', hajri t'u patë.
ma lsho tamlin, mori bijë.
se t'mjel nana ty për fmijë!

Mes — Shkodër, 1965
Bob. 431/7

1) Vafsh.
Krs. GJ A, II, 1972, f. 187.
AIKP — A. Mustaqi, Koplik — Shkodër, 1965 (Bob. 428/20).

405

KUQESHË — KUQESHË

Kuqeshë-Kuqeshë,
e mirë, mretneshë,
mos gjuej, mos qit[1],
sa t'mjeli pak, prit!
Prit-prit, Kuqeshë,
e bukur mretneshë!

Vuthaj — Gusi, 1978

1) Mos gjuaj me shqelm, mos godit.

406

OJ KUQESHË MORI BI

Oj Kuqeshë, mori bi,
mushja nanës qet kusi!
Oj Kuqeshë, oj Murricë,
jepja nanës njanën cicë,
t'mush kusinë me tamël spicë.

Ostrozub — Prizren. 1971

407

LOP' E MURRME LARA-LARA

Lop' e murrme lara-lara,
ma nxir tamlin bardha-bardha,
ma nxir tamlin bardh' si bora.
ta mel nana me kto dora;
të bje nana viç me pika,
viç me pika e lara-lara,
hidhma tamlin në mashtraba!
Hidhma tamlin he t'past' dada!
Hidhe tamlin dalkadalë,
dalkadal' e shkumë-shkumë,
qite tamlin e bane shumë!
Lopa ime, moj larushë,
të krun nana për nën gushë.
Gjit' e tu si buljera
ti m'i paç o plot përhera!
Lop' e murrme lara-lara,
ma qit tamlin bardha-bardha!

Kabash — Pukë, 1979

410

MOLLA E NANËS MORI BIJË

Molla e nanës, mori bijë,
të past' nana hajrin ti.
ma lsho tamlin si ke n'gji![1]
Të tan' malet m'i kërkofsh,
ktu ke nana ardhsh gjurrofsh!

Domgjon — Kukës, 1972
Bob. 901/2

1) Që ke në gji.

Mjelësja

(Z. Shoshi)

411

SHKURTE VIÇ MOJ BIJA JEME

Shkurte viç, moj bija jeme,
seç ma gzove zemrën teme.
Shkurte viç, moj kjosh bekue,
tuj të mjel' e tuj kënue.
Lumja dad' qi t'ka n'konak,
se ty t'kam fort për marak!
Ty t'mjel dada dit' për ditë,
m'bash ka' i viç, ti, vit për vit!
Shkurte viç, moj zemra e barkut,
të pat'[1] hajrin gjithë konaku!
Dada e jote t'qet me ngranë,
Shkurt' e dadës, moj sulltanë.

Blinisht — Lezhë, 1963
Bob. 258/14

1) Të paftë.
Krs. KPL_1 f. 302; KTPP, f. 18; KPL_2 f, 194.

(Transkriptimi muzikor nr. 19)

412

SHKURTA VIÇIN MOJ SULLTANE

Shkurta viçin, moj sulltane,
duje, bij-o, djalin tan-e,
duje djalin me dashni,
haj, t'naj mushish kët' kusi!
Shkurta viçin, moj bija jeme,
se ma gzove zemrën teme.
Shkurta jeme, kjosh bekue.
ty të mjel-o tuj kendue!

Bujanovc, 1979

413

MOJ LARUK' E MOJ GJIBUTË

Moj Laruk' e moj gjibutë,
po t'mjel dada e me m'ndej' urtë,
me m'ndej' urt', me m'ndej' si nuse,
mjelsen me tamël ç'po ma mbushke!
Po t'lmon dada e të don mirë,
tash t'nap uj', ku t'jetë ma i ngritë[1],
tash t'kullos, ku t'jet' ma mirë,
t'maj si djalin për dishirë!

Melgushë — Shkodër, 1968

---

1) Ku të jetë uji më i freskët.
Krs. KP, 89; Rev. «Nëntori», 1955, nr. 2, f. 119; KPL$_1$, f. 303; KPL$_2$, f. 194.
AIKP — A. Mustaqi, Batër — Mat, 1963 (Bob. 243/6); Kashar — Tiranë, 1964 (Bob. 295/16); Muriqan — Shkodër, 1965 (Bob. 426/29); R. Bogdani, Vlahën — Kukës, 1970 (Bob. 770/16).

414

JA MOJ BIJ' T'MJEL NANA TY

Ja, moj bij', t'mjel nana ty,
ja, moj bij',
ma lsho tamlin dalkadalë,
ja, moj bijë!
Dalkadalë hajrin ta pasha,
dalkadalë,
dalkadalë ty po t'mjel lokja,
dalkadalë!
Lumja unë, moj, qi t'kam ty,
ja, moj bijë,
un' ta pasha hajrin ty,
ja, moj bijë!

Dajç — Lezhë, 1981

415

PO SHKON VJEHRRA ME MJEL' LOPËN

Po shkon vjehrra me mjel' lopën,
gujas-e — gujas-o[1],
Po shkon reja[2] me i nimue,
hjedhas-e — hjedhas-o[3].
Po shkon vjehrra me mjel' dhentë,
gujas-e — gujas-o.
Po shkon reja me i nimue,
hjedhas-e — hjedhas-o.
Po shkon vjehrra me mjel' dhitë,
gujas-e — gujas-o.
Po shkon reja me i nimue,
hjedhas-e — hjedhas-o.

Krumë — Kukës. 1970
Bob. 769/15

1) Gjunjazi. më gjunjë.
2) E reja, nusja e djalit.
3) Duke u hedhur, duke kërcyer.
Krs. AIKP — R. Bogdani. Krumë — Kukës, 1970 (Bob. 770/1).

416

LOK LOKSH-O LARGOU

Lok, Loksh-o,[1] largou,
ik, ik e marrou,
ik, ik e marrou,
dajakun[2] p'e han.
Lok, Loksh, o beter,
tamlin jam k'e mjel.
Ik, ik, o Larosh,
ha bar, banu kosh![3]

Vuthaj — Gusi, 1978

1) Loksh, Larosh, emër i përveçëm për viçin.
2) Drurin, të rrahurën.
3) Këtu në kuptimin: shëndoshu.

417

SEÇ PO VJEN KJO LARA

Seç po vjen kjo Lara
me brirë kurorë,
ngreu, bij' e nënës,
merr poçen në dorë
e na mil qumësht
të bardhë si borë.
Seç po vjen kjo Kuqia,
me brirë përpjetë,
ngreu, moj bij' e nënës,
ngreu me të shpejtë,
i lësho Larushin[1],
le ta pijë vetë.

Tërpan — Berat, 1975

1) Viçi lara-lara.

418

HAJDE BALLHANË TA PAJSHA HAJRIN

Hajde Ballhanë, ta pajsha hajrin,
ta pajsha hajrin, lëshoje tamlin!
Mos ja mshe mushtjerrës-e,
se t'qes bar edhe tagji-e!
Ti m'u bash si katanë,
se në dimën e tash t'qes sanë!
Ballhana harron,
tamlin ma lëshon.

Oblik — Shkodër. 1965
Bob. 424/2

419

NANA T'PAST TY MOJ BALUSHË

Nana t'past. ty moj Balushë,
që kullot ti napër fushë,
napër fushë e n'rudina,
t'fërkon nana ty te shpina,
tamlin tan po ma kthen shtila,
ma kthen shtila krejt në djathë,
djath' me tlyn, djath' të ri,
mushen shekat ni ka ni.
Moj Balushë, kto robt t'tanë,
prej ne t'dujash[1] don me ngranë,
me bylmet çdo dit' në sofër,
buk' t'xet t'pjekme n'votër!
O t'past' nana, moj Balushë,
vedren pjot çdo dit ma mushë,
t'jep nana ty gjell' e sanë,
sa t'jesh e zoja për t'ngranë.

Pukë, 1975

1) Prej ne të dyjave.

420

LAR' OJ BIJË LAR' OJ BIJË

Lar', oj bijë, Lar', oj bijë,
mushma nanës çet[1] shtrungi,
se t'çes nana janxhë[2] e tagji.
Lar', oj bijë, Lar', oj bijë.
mushma nanës çet shtrungi,
se t'çes nana gjellë n'kusi.
Larën teme e due fort,
se ma mushë shtrungin plot.

Përbreg — Kukës, 1982

1) Këtë,
2) Të jep nëna jonxhë.
Krs. KPK, f. 31.
AIKP, K. Vasili, Grizhë — Shkodër, 1980, Fl. 26.

421

MURRICA E NANËS MASHALLAH

Kadalë, moj loke, kadalë, moj Murrë,
se t'qet nana ty pak krunde!
Kadal', moj Murrë, ngoje[1] nanën,
se unë t'qes krunde e ti mue tamël!
Hajt, moj Murrë, mashallah,
syni i keq ty mos me t'pa!
Kush t'shef tye, t'merr lakmi,
Murr' e nanës, mashallah!

Caravran — Rahovec, 1972

1) Dëgjoje.

422

ÇASE KAMËN BIJA E NANËS

Çase kamën. bija e nanës.
nana t'çet taxhi,
lshoje tamlin, bi!
Çase kamën, bija e nanës.
mushma vedrën. bi,
nana t'çet taxhi!
Çase kamën. bija e nanës.
nana t'çet taxhi,
lshoje tamlin, bi!
Çase kamën. bija e nanës.
mushma vedrën, bi,
nana t'çet taxhi!

Cërnicë — Gjilan. 1972

423

I PAÇ ME JETË KTO BAGTI

Ti, more i zoti i shpisë,
i paç me jetë kto bagti,
gjithmon' t'ardhshim në këtë shpi.
gjithmon' t'ardhshim për miqsi.
e ma shum' t'gjeçim bagti,
ma shum' rob e miqasi!
Kur ke rob e miqasi,
je shpi me shum' fuqi,
gjen gjith' t'mirat në këtë shpi.[1]

Ishull — Lezhë, 1980

1) Këto vargje thuheshin kur qethej bagëtia. Të ftuarit dhe miqtë mblidheshin në formë rrethi në mriz ku zakonisht bëhej qethja. Këndonin e hidhnin valle.

424

DETI ME UJË

Deti me ujë,
tunsi me qumësht;
deti me valë.
tunsi me gjalpë,
deti me hopa.
tunsi me topa.[1]

Seman — Fier, 1949

1) Topa gjalpi.
Plakat e shtëpisë, kur tundnin për herë të parë qumështin e vitit, ktheheshin me fytyrë nga deti dhe thoshin me zë të ulët vargjet e mësipërme.

425

SI PASQYRA NDRIFTË

Si pasqyra ndriftë,
si lëmshi u mështiellë,
si guri u forcoftë,
si lulja lulëzoftë,
si bari na bleroftë![1]

Kallmi i Madh — Fier, 1976
Bob. 1273/13

1) Kur tundej qumështi për herë të parë, varej pranë dybekut një pasqyrë, një lëmsh leshi dhe një gur. Shtrohej bar i njomë poshtë dybekut dhe thuheshin vargjet e mësipërme. Në këtë mënyrë besohej se tundja do të ishte e mbarë.

426

TUNU MTËJ VRRËJK E VRRËJK

Tunu. mtëj, vrrëjk e vrrëjk,
qite tlyenin me shanejk,
tunu mtëj rena-rena.
se kam lanë gjanë mrena.

Fushë-Lurë — Dibër, 1977
Bob. 1300/18

1) Këndohej kur tundej qumështi.

427

TUNU FTOJ HE GJALI JEM

Tunu, ftoj[1], he, gjali jem,
bone kokën sa ni lem![2]
Tunu, ftoj, he lum për toj[3],
ko[4] çobani niçin dhoj.[5]
Tunu, ftoj, u tunsh i bardhë,
bone kokën sa ni dardhë,
kokën tane e ve n'kanari.
Sa ni dardhë, sa ni ksoj,
tunu-tunu, more ftoj!
Ia çes pites, ia çes flisë,
të ma hanë robt e shpisë.

Përbreg — Kukës, 1982

1) Fti, mti, tundës.
2) Sa një kokërr lende dushku.
3) Ty.
4) Ka.
5) Dhi.
6) Një kusi.

428

DUM-DUM MASHALLA

Dum-dum, mashalla,
dum-dum, mashalla,
nisja tamël me ba borë,
dora e nuses t'ka në dorë.
Dum-dum, mashalla,
tlyen-tlyen, mashalla,
tlyen-tlyen, për fli,
tlyen-tlyen, për shpi.
Dum-dum, mashalla,
tlyen-tlyen mashalla,
dora e nuses t'ka në dorë,
dora e nuses çi ka shkollë.

Martinaj — Gusi. 1978

Krs. KPG, f. 29.

429

TUNDU PTI O TUNDU PTI

Tundu, pti, o tundu, pti,
se tesh[1] tlyni do të vi,
tundu. pti, dalëkadalë,
sa t'dahet qe ky llallë!
Lumja dore, more pti,
që n'ket' ndratje[1] po tund ty,
mushe qypin si flori,
plot me tlyn, tlyn të ri,
gzove gra e gzove fmi,
bukën njom e kan' me ty.

Pukë, 1970

1) Mëngjes.

430

TUNU TPI-E U TUNSH I BARDH-E

Tunu, tpi-e, u tunsh i bardh-e.
rritnaj kokrrën sa ni dardh-e!
Tunu, tpi, rrum e bum-e.
çitnaj tunën[1] sa ni cung-e!
Hae t'mira[2] do t'marojm-e.
u çojm' burrave çi livrojn-e!
Tunu, t'pi-e, paç nafak-e.
se na jena kallabllak-e.
t'madh e t'vogël me na ngi-e.
se s'un rrnojm-o na pa ty-e!

Sherret — Ferizaj, 1962

1) Na qit të tundurën (gjalpin) sa një cung.
2) Këtu me kuptimin: gjellë të mira.
Krs. AIKP — N. Pano, Fushë-Krujë, 1978 (Bob. 1352/5); V. Qamili, Milot — Krujë, 1978 (Bob. 1327).

431

TUNU TPI U TUNSH I BARDHË

Tunu. tpi, u tunsh i bardhë,
çitma tunmen sa ni dardhë,
ta marr, ta çes n'kanar,
të vjej[1] e tunmja sa ni kile,
të mos jet' t'lyn' me hile.
E kam tun'. e tuni apet,
me kan' vjehrra, e kish ngran' krejt.

Pusi i Thatë — Kukës. 1981

1) Të vijë. të peshojë.

432

TUND-TUND TUNDALINI

Tund-tund, tundalini.[1]
o, sa mir' po tundka tpini!
Tundu, maz', u tundsh e bardhë,
ma shum' tlyn e ma pak llallë[2].
Tund-tund, tundalini,
doli tlyni si florini,
lumi aj, qi e ka n'shpi,
tund-tund, tundalini.

Barbullush — Shkodër, 1981

1) Fjala tund, e zgjeruar për shkak të rimës a metrit.
2) Dhallë.

Krs. AIKP — A. Mustaqi, Drenovicë — Berat, 1975 (Bob. 1211/19); Q. Haxhihasani, Marinëz — Fier, 1976 (Bob. 1273/12); K. Vasili, Barbullush — Shkodër, 1980 (Bob. 1427/12).

433

TUNU FTËJ RRUM E BUM

Tunu, ftëj, rrum e bum,
bane kokrrën sa ni pllum,
sa ni pllum, sa ni dardhë,
do ta mati me kanar,
do ta qes nesër n'pazar.

Gjergjefdoll — Kaçanik, 1972

434

TUNDU TPI O KOFSH BEKUE

Tundu, tpi. o kofsh bekue.
rrite kokrrën sa ni ftue!
Tundu, tpi, o kofsh i bardhë.
rrite kokrrën sa ni dardhë!
Tunu, tpi. o tpi i hollë.
bama kokrrën sa ni mollë.
Tundu, tpi. o tpi i mirë.
qitma tundmen sa ni killë!
Lumja une qi jam da.
tpini i madh mue m'ka ra.
vet' e tundi. vetë e ha!

Svircë — Kamenicë. 1972

435

LOPË-LOPË E MAJR-O

Lopë-lopë e majr-o,[1]
lopë-lopë marshalla,
qasshin sajt çi t'kan' pa,[2]
qasshin sajt e kçij
i rafshin n'Dri,
Drini u klloftë[3],
si ari e si vistari,
lopa u baft ma majr,
si ka konë ma s'pari!
Tunu mtaj rrotull e rrotull-o,
çitma tlinin me oka e oka-o![4]

Sllovë — Dibër. 1962

1) E mirë.
2) Plaçin sytë e këqij që të kanë parë.
3) Kulloftë.
4) Kënga ka marrë formën e një yshtjeje që ka si qëllim të mbrojë lopën nga «syri i keq». Këndohej zakonisht gjatë tundjes së qumështit.

436

TUN-TUN. TUNU-TUNU. TPI

Tun-tun. tunu-tunu. tpi.
tuj punue. jam me ty.
Tunu. tpi. u tunsh i bardhë.
se shum' zhiz'[1] ka me m'dalë,
m'del tlyni sa 'i kokërr arrë.
Tunu tpi. o pa pritue.
mu fatzezën mos me m'munue.
se argat' i kam tuj punue.
hala bukën s'ja u kam gatue.

Panore — Rahovec. 1972

1) Gjizë.
Krs. Gj A, 11, 1972, f. 164.

437

TUNU TPI U TUNSH I BARDHË

Tunu, tpi, u tunsh i bardhë,
m'ka shku' burri në pazar,
për me m'ble t'kuq e t'bardhë!
Kur po t'tuni, fort u gzova,
tri teneqe i rrafshova.
Tunu, tpi, dhe me shyhret,
të dhasht' zoti bereqet!
Tunu, tpi, u tunsh i mirë.
e bafsh kokrrën sa ni lirë!

Gaçkë — Ferizaj, 1980

438

TUNU TPI O TPINI I RI

Lum e lum u ba sabah.
rroka tpinin me bismilah.
Tunu, tpi, o tpini i ri,
nisma kokrrën sa i lejthi!
Tunu. tpi. o tpini i bardhë.
nisma kokrrën sa ni dardhë!
Tunu, tpi, o kofsh bekue.
nisma kokrrën sa ni ftue!
Tunu, tpi, o tpin i gjanë.
m'kapërcei vakti me mjel' gjanë!
Tunu. tpi. o tpini i ri.
m'ka marr' malli me qit' fli
e me hangër me gjith' thmi!
Tunu, tpi, he kofsh bekue,
tana shoqet ty po kshyrin,
tlynin. o me ta syshue.
Tunu. tpi. o tpin i gatë.
banma kokrrën sa ni dardhë.
se ka me m'ardh' daja për darkë!
Un' ta qes ni bakllavë
e ta ha. o me gjith' dajë.
Tpini jem. o asht' i ri.
tana shoqet ja kan' lakmi.

Dazhdinë — Kamenicë, 1972

439

TUNU TPI E RRAKATEL

Tunu, tpi, u tunsh i bardhë,
se po t'presin argatët n'arë,
tunu, tpi e rrakatel,
ni kill' tlyn-o përniherë.
Tunu, tpi, për bukuri,
se po t'presin fmija në shpi!

Reçan — Suharekë, 1974
Bob. 1192/3

Krs. Gj A, II, 1972, f. 166-167.
(Transkriptimi muzikor nr. 20)

440

TUN-TUNA TUNALINI

Tun-tuna, tunalini!
Sa qime ka mini,
aq palmuça m'qit' tpini!
Qyqja unë e panafaka,
tan' me hangër Mhill Staka![1]
kur m'thirri deri te arka![2]

Koqë – Trijesh. 1972

1) Emër njeriu i njohur në mjedisin ku këndohej kënga. Duhet të jetë tagrambledhësi.
2) Arka ku fshatarët paguanin taksat e ndryshme.
Krs. Gj. A, II, 1972, f. 163.

441

ZENU DJATH' U ZANSH I BARDHË

Zenu djath', u zansh i bardhë,
po t'qes shlinën[1] dalëngadalë,
po t'hedh viln-o[2] pluhun t'bardhë.
Mbushet shegja[3] plot e plot,
sa ta kem për sot dhe mot.

Burbullush — Shkodër, 1980
Bob. 1427/11

1) Shilën.
2) Fara që lidh djathin.
3) Ena e djathit, shekja.
Krs. — N. Pano, Barbullush — Shkodër, 1981.

(Transkriptimi muzikor nr. 21)

KAPITULLI I TRETË

KËNGË
PËR BLETARINE ETJ.

442

HAJDE GJET' E HAJDE BI

Hajde, gjet'[1], e hajde bi,
hajde, hin në zgju të ri,
se në male po bje shi;
po bje shi e po bje vdorë,
hajde, ktu të t'shtëj[2] në odë![3]
E butë, e amël, me tamël!

Zall-Dardhë — Dibër, 1963
Bob. 272/8

---

1) Bletë (me kthimin *bl* në *gj*, sipas veçorive gjuhësore të të folmeve të Dibrës).
2) Të të shtie, të të fus.
3) Këtu: në zgjua, në koshere.

Krs. Gj. A, II, 1972, f. 160, 163; LPK, f. 44. AIKP — H.Shehu, Vleshë — Dibër, 1962 (Fl. 2, f. 22); A. Mustaqi, Batër — Mat, 1963 (Bob. 243/7); Kashar — Tiranë, 1964 (Bob. 295/15); Obot — Shkodër, 1965 (Bob. 425/10); Boks — Shkodër, 1965 (Bob. 431/6); Çerkez — Tiranë, 1974 (Bob. 1076/5); Q. Haxhihasani, Ungrej — Lezhë, 1963 (Bob. 256/32); J. Panajoti, Gurras — Pogradec, 1973 (Bob. 950/9); M. Dule, Ibë — Tiranë, 1974 (Bob. 1053/30); Xh. Selami, Marikaj — Tiranë, 1974 (Bob. 1077/14; K. Vasili, Gllobojçicë — Kaçanik, 1975 (Bob. 1277/59); D. Përshqefaj, Fran — Mirditë, 1976 (Fl. 1, f. 40).

(Transkriptimi muzikor nr. 22)

443

MBLIDHU ZOGËZ ZOGËZ-O

Hu-hu-hu,
përdhe-përdhe-përdhe,
Mblidhu, zogëz, zogëz-o,[1]
në pun' tënde, në pun' tënde!
Hu-hu-hu,
përdhe-përdhe-përdhe,
mblidhu zogëz, zogëz-o,
eja nën-o, eja nën-o, eja nën-o!
Hu-hu-hu,
përdhe-përdhe-përdhe,
mblidhu zogëz, zogëz-o,
nikoqire-nikoqire-nikoqire!

Gjirokastër, 1963
Bob. 253/11

1) Bleta e re, sidomos mbretëresha, emërtohet edhe me emra të veçantë si: Zogëz, Maro, Marinë, Matkë, Nikoqire, Nishane etj. Krs. AIKP — ESHGJ, Krutje e Sipërme — Lushnjë, 1957 (Bob. 176/13); A. Mustaqi, Drashovicë — Vlorë, 1963 (Bob. 250/8); Çamëri, 1964 (Bob. 314/10); Lluk' e Epërme — Gjakovë, 1964 (Bob. 291/8); Lushnjë, 1964 (Bob. 286/5, Bob. 287/26); Q. Haxhihasani, Gjadër — — Lezhë, 1963 (Bob. 257/12); Lohje e Sipërme — Shkodër, 1964 (Bob. 339/30); H. Filja, Gjadër — Lezhë, 1980 (Bob. 1425/10); N. Pano, Mërtish — Lushnjë, 1981 (Fl. 1, f. 15).

444

YP-YP-YP E AMËL-O

Yp-yp-yp e amël-o,
hajde, bijë, e butë-o,
lule n'mal e lule n'fushë,
me mjaltë zgjonin me ma mushë!
Hajde, bijë, n'konak të ri,
se â vrâ e po bjen shi,
priju, nanë, bijave,
priju, nanë, zogave!
Hajde, lume,[1] hin n'babunë,
se po t'kndoj me grue e fmi,
hajde, bijë n'konak të ri.

Dajç — Shkodër, 1978

1) E lumja, e lumtura ti.
Krs. BKM, f. 221.
AIKP — N. Pano, Dajç — Shkodër, 1981 (Fl. 1, f. 5).

445

MIZ' E BUT' E BUTË

Miz' e but' e butë[1],
nër zgjut, nër zgjut,
po bi shi, po bi shi,
ke nona në shpi.
Miz' e but', e butë,
nër zgjut, nër zgjut.
Po bi shi, po bi shi,
ke nona në shpi.

Ndroq — Tiranë, 1974
Bob. 1059/9

1) Bletari e ndjell bletën me thirrje dhe shprehje plot përkëdheli, si: «bija e nanës», «mat oj bijë», «hajt o bijë», «matkë e butë», «mizë e butë», «amzë e butë», «mizë e amël», «zogëz e bukur», «moj e bukur-o», «e mira e nanës», «të pastë nana», «matico», «nikoqire», «zogë», «zogëz-o», «yp-yp e amël-o», «parëz-o», «e amël-o», «e but-o», «e mir-o», e mbar-o» etj.
Krs. AIKP — H. Filja, Ndroq — Tiranë, 1974 (Bob. 1058/7).

446

BLETË-BLETË BLET' E BUTË

Bletë-bletë, blet' e butë,
hin' n'krojshe, mos u tut,
se po vjen ni rigë shi,
po t'i lag gjith' kta thmi!
Mat-mat-mat,
hajde hin, n'shpi t're,
mjaltën n'krojshe le!

Llaushë — Podujevë, 1972

Krs. Gj. A, I, 1962, f. 155; LPLL, f. 54.

447

MIZ' E AMËL MIZ' E BUTË

Miz' e amël, miz' e butë,
ja ke nana të t'fus në zgjut;
miz' e amël, miz' e mirë,
ja ke nana t'çoj në shpi;
miz' e amël, miz' e bukur,
hec ke nana shpejt si flutur!

Laknas — Tiranë. 1964
Bob. 293/17

Krs. AIKP — A. Musaqi, Vorë — Tiranë, 1964 (Bob. 295.1); Laknas — Tiranë, 1974 (Bob. 1075/2).

(Transkriptimi muzikor nr. 23)

448

HAJDE AMA E BUTË HAJDE AMA E BUTË

Mat, mat, mat!
Hajde, ama e butë, hajde, ama e butë,
primju bijave, primju bijave!
Hajde, bi, e mos u tut!
Hajde, bi, e hin n'shpi t're,
se po vjen-o ni rig' shi,
na le pa plang e pa shpi,
po na lag-o mu e ty!
Hajde, motër me vllazni!
Hajde, ama e butë, hajde ama e butë!
Hajde, bi-e, mos u tut!
Mblidhnu, ama e bija,
u priftë perenija!

Zheger — Gjilan, 1982

449

HUSH-HUSH TË PASTË NANA

Hush-hush, të pastë nana,
zdrigjmu.[1] zdrigjmu ti mbëdhe.[2]
të kam sjell' pekmes me thana
moj zogëz, nuse e re.
Mblidhmu, mblidhmu, mori zonjë,
futmu brenda në kupri,[3]
a kam bler' në Mesollonjë[4]
ta ka bër' nana kuti.
Hush-hush, moj punëtore,
e mir', e uruarë.
ti për mir' nanës i dolle,
për të më gëzuarë.
Hush-hush, moj mbretëreshë.
m'u shtofshi si miza e lisit,
plakë nana, s'mund të presë,
zdrigjmu ti nga qiparizi.
Hajde, mjalcë bilëz-o,[5]
përmbi degëz mos qëndro,
hajde-hajde, kulumbri,
futju nanës në kupri.

Konispol — Sarandë, 1982

1) Zbrit.
2) Përtokë.
3) Zgjua.
4) Qytet në Greqi.
5) Bijë.

450

YP-YP-YP HAJDE MOJ BI

Yp-yp-yp, hajde moj bi!
Hin. moj bi, në kosh të ri!
Ti m'u bafsh iqineimi!
Hajde bi, ti ardhsh e bardhë,
se t'pret dada dalkadalë!

Carroticë — Preshevë, 1979

451

YP-YP BLET-O TË PAST' NANA

Yp-yp, blet-o, vash' e marë,
rreshti jot mos t'u daftë,
zgjoja jote u mbushtë plot,
ty të rujt' i madhi zot!
Yp, blet-o, të past' nana,
mushe zgjojen porsi zana!

Koplik — Shkodër. 1965
Bob. 428/19

452

EJA AMZA E BUT' EJA AMZA E BUTË

Eja, amza e but', eja amza e butë,
hajde hi n'zgjue t'ri,
se po na bje 'i rigë shi,
e po na lag mu e ty,
eja, mori e bekueme!

Miliska — Pukë, 1974

Krs. AIKP — D. Përshqefa, Thirrë — Mirditë, 1976 (Fl. 1, f. 40).

453

YP-YP ULU MOJ ZOGE

Yp-yp, ulu, moj zogë!
Mos më rri, moj n'at' qershi[1],
hajde hy në zgju të ri,
se po t'lag ty, moj, 'i rigë shi,
Priju, amë, ti bijave!
Yp-yp-yp-yp-yp-yp![2]

Dajç — Lezhë. 1963
Bob. 258/15

1) Pema ku ka zënë vend bleta e re.
2) Vargjejt u drejtohen bletëve të reja për t'i mbledhur në zgjua. Mbledhësi, zakonisht një grua, troket dy gurë ose dy rrasa, të cilat i mban në dorë, ndërsa burrat fishkëllejnë. (Shih dhe shënimin e këngës nr. 462).
Krs. AIKP — N. Pano, Ishull —Lezhë, 1981 (fl. 1, f. 18).

454

MAT-MAT-MAT E BUTË

Mat-mat-mat e butë,
hajde, bij-o, mos u tut,
lokja jote asht tuj t'pritë,
mos e le loken m'u mërzitë.
Mat-mat-mat e butë,
hajde, hajde te bijat tua,
sikur nana kur i tubon,
mushna koshin si gjithmonë!
Mat-mat-mat e butë,
hajde, bij-o, mos u tutë.
Mat, te lokja, mat, mat,
hajde, bij-o, banu rahat.
Hajde, lum lokja, hiç pa ngutë,
kadal-kadalë, hiç pa u tutë.

Potoçan — Rahovec, 1972

455

MAT-MAT-MAT OJ BI

Mat-mat-mat. oj bi,
hajde hin drejt në shpi,
se po vjen ni rigë shi.
po t'i lag kraht e ri,
e po t'lag me xhithë thmi.
po na lag mu e ty!
Hajt e bardhë. hajt e butë.
hajde hin, s'ban m'u tutë.
amë-amë, oj bi!
Mat-mat-mat. oj bi.
mblidhi bijat kah i ki,
hajde hin n'konak t'ri!
Po shkon ama tuj flutru.
t'tana bletët tuj afru,
n'shpi të re m'u rahatu.
si zojë shpije m'i sunu.
se pa amë s'mujn' me rrnu.
am'-am'-amë, oj bi.

Ferizaj, 1972

Krs. Gj A, 1962 I, f. 154, 157; Gj A, II, 1972. f. 162.

456

MATO BI MATO BI

Mato bi, mato bi,
hajde hin në kosh t'ri,
se po vjen ni rig' shëi,
po na lag mu e tëi.
Mato bi, mato bi,
mos të pafshin sëit e kshi,[1]
na marrin msëish mu e ti.
Mato bi, mato bi,
mat, mat , mat, mat, mat!

Kaçanik, 1982

1) Sytë e këqij.

457

YP-YP-YP HAJDE MOJ BI

Yp-yp-yp, hajde, moj bi!
Hin, moj bi, në zgju të ri,
ti m'u bash njiqind e nji mi!
Hajde, bi, ti ardhsh e bardhë,
se t'ndjell dada dalkadalë!

Zadrimë-Lezhë, 1968

Krs. KPL$_1$, f. 303; KPL$_2$, f. 195.

458.

HAJDE MAT HAJDE BI

Hajde mat, hajde bi,
haj të himë n'kosh të ri,
maaaaat, mat-mat,
se fryn erë e veri,
pa na bien breshën e shi,
maaaaat, mat-mat!

Veleshtë-Strugë. 1972

459

AMA-AMA-AMA-AMA

Ama-ama-ama-ama,
ha-ha-ha-ha!
Amsia e butë, amsia e butë, amsia e butë,
hajde te nana, hajde te nana,
pri ama t'biave, pri ama t'biave,
ama-e mashalla, ama-e mashalla![1]

B. Curr-Tropojë. 1969
Bob. 292/15

---

1) Vargjet për ndjelljen e bletës tingëllojnë si yshtje. Krs. Gj A, II, 1972, f. 159.
AIKP — A.Mustaqi, Mërtur—Tropojë, 1963 (Bob. 242/13); Q.Haxhihasani. Palaj—Shkodër, 1963 (Bob. 244/6, Bob. 244/8).

460

JA BI-BI JA BI-BI

Ja, bi-bi, ja bi-bi,
ja e hyn në zgju të ri,
sa t'du un', s'të do njeri.

Shupal-Tiranë, 1969
Bob. 680/9

Krs. AIKP — Xh. Selami, Zall-Bastar — Tiranë, 1974 (Bob. 1094/19).

461

BLETË BIJ BLETË BIJ

Bletë, bij, bletë, bij,
hajde hin në zgjua t'ri,
e parë oooj,
e marë oooj,
e amël oooj!
Bletë, bij, bletë, bijë,
hajde hin në zgjue t'ri,
tëj më je shema e parë,
tëj më ardhsh e marë!

Përbreg-Kukës. 1982

AIKP — K. Vasili. Begracë-Kaçanik, 1975 (Bob. 1228/25).

462

HAJDE BIJ' E HIN N'ZGJUE T'RI

Hajde, bij' e hin n'zgjue t'ri,
prij, o bij', e nan' e vetme,
hajde, bij', e hin n'zgjue t'ri,
hajde, e lume hin n'babune!
Hajde, bij', e marshalla,
t'jap sheqer e ti m'jep mjaltë,
ty t'u prift' si â ma mbarë!
Yp-yp marshalla,
yp-yp e amla,
yp-yp e buta![1]

Dajç-Lezhë, 1981

1) Bletën zakonisht e mblidhte gruaja, se besohej që zërin e saj ajo e pëlqente më tepër se atë të burrit. Gruaja mbante në kokë një shami të kuqe, merrte dy gurë, i trokiste me njëri-tjetrin dhe këndonte këngën e mësipërme. Por, ndodhte që shaminë e kuqe e hidhte edhe mbi një dru peme (zakonisht kumbull), ndërsa vetë trokiste gurët, që mbante në duar, duke kënduar vargjet e këngës.

463

HAJDE BLETË MASHALLAH

Hajde, bletë, mashallah,
t'i ruejtë zoti ata krah,
priju bijave në shpi.
se po bjen ni rigë shi,
e t'i lag bijat ty.
Hajde, matë, mos u tut,
se t'keqen e gjuejm' me dhé!
hajde, matë, mos u pre.
se t'keqen e gjuejm' me barut

Llap-Podrijevë, 1972

---

1) «Syrin e keq».
Krs. Gj A, II, 1972, f. 161; LPLL, f. 55.

464

O MOJ BLETA KURORINË

O moj bleta kurorinë[1],
si në maj edhe në prill,
o moj bletë, o moj sheqere,
me ç'sihariq, o moj më erdhe?
Bletën e hodhëm në sëndyk të ri,
do ta marrim në shtëpi,
të kullosë mal dhe fushë
dhe qypat me mjalt' t'i mbushë.

Podgoran-Përmet, 1981

1) E mbledhur në formë kurore.

465

GJET' E NANËS MORI BLETË

Pi-pi-pi, pi-pi-pi,
Gjet' e nanës, mori bijë,
hajde hin në zgjue t'ri,
se asht te ra[1] ni re shi,
me na lagjë[2] mu e ti,
pi-pi-pi, pi-pi-pi.

Fshat-Kukës. 1980

1) Duke rënë.
2) Lag.

466

PRI MATICË SATE BI

Yp-yp-yp, matico, Malo!
Pri, maticë, sate bi, Malo,
për me hi në xhama t'ri[1], Malo,
se â vrâ, do me ra shi, Malo!

Koqë-Trijesh, 1972

1) Në zgjua të ri.

467

JA KTU-KTU N'ZGJU T'RI

Parë, marë, parë, marë,
ja ktu-ktu, n'zgju t'ri,
se ktu, moj, nuk bje shi;
ja ktu-ktu, oj bijë,
eja, hin n'konak t'ri.

Burrel-Mat, 1963
Bob. 243/20

468

PTY MAR-O PTY BIR-O

Pty, Mar-o, pty, bir-o,
në sëndyq të bukur-o!
Pty, Mar-o, pty, Marinë,
ja, tek ta kemi shtëpinë,
me mjalt e me trëndelinë!

Malëshovë-Përmet, 1957

*

* *

Dhëntë në kullotë

469

ZOGËZ-O PULËZ-O

Zogëz-o, pulëz-o,
po t'vë vezë t'më nxjerrish zoga,
të tëra zoga me çafka,
një kaposh ta hajë tata.[1]

Malëshovë-Përmet, 1957

---

1) Baba.
Këndohet kur shtrojnë klloçkën.
Krs. AIKP — A. Mustaqi, Fushë-Gjeç, Tiranë, 1974 (Bob. 1070/9).

470

HANI GJELA TUJ KULLOTË

Hani, gjela, tuj kullotë,
dad', o gjel-o[1]!
Mbushni, gjela, gushën plot!
Hani, gjela, se u ba vonë,
shkoi sahati tet' a nonë![2]

Garunjë e Madhe — Elbasan, 1974
Bob. 1123/15

---

1) Përsëritet pas çdo vargu.
2) Nëntë.

Këndohet nga vajzat «me fyt» (duke prekur laringun me gishtin e madh), kur kullosin gjelat e detit, (shih shënimin 1 të këngës nr. 386)

Krs. AIKP — A. Mustaqi, Belsh-Elbasan, 1962 (Bob. 220/5); Laknas-Tiranë, 1964 (Bob. 292/14); Belsh-Elbasan, 1967 (Bob. 611/12); Gjeç-Fushë — Tiranë, 1974 (Bob. 1070/7); Bërxullë-Tiranë, 1974 (Bob. 1075/5); O. Xhatufa, Zikxhafaj-Durrës, 1970 (Bob. 760/8); Zanbizhë-Durrës, 1971 (Bob. 787/18, Bob. 787/19, 787/20); Cikallesh-Durrës, 1971 (Bob. 788/14); Vashaj-Elbasan, 1973 (Bob. 908/11); Shezë-Elbasan, 1973 (Bob. 912/19); Garunjë e Madhe-Elbasan 1974 (Bob. 1123/14).

471

ZOGJT' E DADËS JAN' BA GJELA

Zogjt' e dadës jan' ba gjela[1],
o dad', o gjel-o[2],
zogjt' e botës harabela.
Zogjt' e dadës hajn' uriz,
zogjt e botës kput n'kurriz.
Zogjt' e dadës na hajn' grunë,
zogjt' e botës jan' sëmunë[3].

Garunjë e Madhe — Elbasan. 1974
Bob. 1123 16

---

1) Gjela deti.
2) Përsëritet pas çdo vargu.
3) Ky lloj ndërtimi që kundërvë kujdesin e bashkëfamiljarëve nga njëra anë dhe pakujdesinë e të huajve nga ana tjetër, vihet re edhe në një sërë këngësh të kullotjes së bagëtive (Krs. këngët nr. 352, 353, 355 etj).
Krs. AIKP — A. Mustaqi. Fushë-Gjeç — Tiranë, 1974 (Bob. 1070/9).

472

O PULAT E TUJA GOCE

O pulat[1] e tuja, goce,
t'i ka hangër huta,
o pulat e mija, goce,
nuk i zente rruga.
O pulat e mija, goce,
e kan' gushën plot-e,
o pulat e tuja, goce,
kan' ngel' pa kullot-e.

Gjeç-Fushë — Tiranë, 1974
Bob. 1070/8

1) Pulat e detit.

Krs. AIKP—ESHGJ, Krutje e Sipërme-Lushnjë, 1957 (Bob. 176/12); A. Mustaqi, Divjakë-Lushnjë, 1964 (Bob. 287/25); Gjeç-Fushë — Tiranë, 1974 (Bob. 1070/9); Q. Haxhihasani, Obot-Shkodër, 1972 (Bob. 888/11); O. Xhatufa, Pekisht-Elbasan, 1973 (Bob. 912/14); J. Panajoti, Agimi-Fier, 1974 (Bob. 1115/2).

473

PO T'ÇON LALA ME KULLOTË

Po t'çon lala me kullotë,
gjel, gjel-o[1],
ta mbush lala gushën plot,
Po t'çon lala ke mullini,
gjeln e huj e ha hutini.
Po t'çon lala ke përroi,
gjeln e huj e ha fajkoi!

Vaqar — Tiranë, 1968

1) Përsëritet pas çdo vargu.

Krs. KPL, f. 303: Rev. «Nëntori», 1955, nr.2. f. 119; KPTT, f. 19.

AIKP — A. Mustaqi, Gjeç-Fushë — Tiranë. 1974 (Bob. 1070/8); Bërxull-Tiranë, 1974 (Bob. 1075/5); J. Panajoti, Agim-Fier, 1974 (Bob. 1115/2); O. Xhatufa, Garrunjë e Madhe-Elbasan, 1974 (Bob. 1123/14, Bob. 1123 15, Bob. 1123/16); N. Pano, Gradishtë-Lushnjë, 1981 (Bob. 1419/20).

474

T'KEQEN NONA MRE GJEL I RI-E

T'keqen nona, mre gjel i ri-e,
shko me nonën në shtëpi-e!
Gjeli i nonës tuj kënua
gjeli i gocës tuj vështrua,
gjeli i nonës hajte grunë,
gjeli i gocës ishte smunë,
Të lshoj nona n'barin e njomë,
ecni, gjela, se u ba vonë.
të lshoj nona n'barin e thatë,
ecni, gjela, se u ba darkë.

Peza e Madhe — Tiranë, 1977
Bob. 1303/27

(Transkriptimi muzikor nr. 24)

475

T'I ÇOJ LALA MOJ GOCE KU DI VETË

T'i çoj lala, moj goce, ku di vetë,
zogjt, e tu, moj goce, gjith' me kom' përpjetë.
T'i çoj lala, moj goce, ke ullini,
zogjt' e tu, moj goce, o ç'i han hutini,
zogjt' e lalës. moj goce. tu kuq kryt,
zogjt' e tu, moj goce, tu mbyll' sytë.

Maknor — Tiranë, 1971

AIKP — J. Panajoti, Kavajë — Durrës, 1962 (Fl. 3, f. 3).

KAPITULLI I KATËRT

KËNGË PËR GJAHUN, PESHKIMIN, DETARINË ETJ.

476

MER DYFEKUN E SHKO PËR GJA

Mer dyfekun e shko për gja,
xhamadan, more, me sumbulla,[1]
ti t'i shofish, un' t'i vras,
ti t'i vrasish, un' t'i marr,
opo t'i çojm' te xhamija,
të na i hajë qefalija,
nga nji killo për shtëpi,
ngaj një felë për njeri.

Zagraçan — Strugë, 1930

1) Përsëritet pas çdo vargu.

477

NDËR MURRIZA DEL ME GJUE

Ndër murriza, del me gjue.
t'kujen pel-o me shalue.
po shalojm' pelën e ati trimi.
e s'çon barrën si çdo barrë.
po çon barrët e florinit,
ç'po ju knaqka shpirti trimit.

Dardhë — Pukë, 1977

478

HAJT QILLOFSHI-QILLOFSHI

Hajt qillofshi — qillofshi,[1]
me gjah plot[2] u gëzoshi,
gjithë neve na shëndofshi!
Shumë peshk e shumë bli,
çofshim të gjith' në shtëpi,
u shënofshi me bir e bi!
Ja mbushshin rrjetat plot,
zemra juej me shum' lezet.
shujka[2] paftë si dyrbi,
masat e peshkut karkuli,[4]
kapidani me ju pri![5]

Ulqin, 1976

1) Qëllofshi në peshq! Kështu u thuhej atyre që niseshin për peshkim.

2 Plot.

3) Peshkatari që caktohej për të vëzhguar lëvizjet e peshqve.

4) Me shumicë, plot.

5) Gjatë stinës së peshkimit (në vjeshtë) organizoheshin në Ulqin mbrëmjet e peshkatarëve. Në këto mbrëmje, merrnin pjesë edhe të ftuar, që dikur e kishin ushtruar këtë profesion. Mbasi hanin e pinin, këndonin këngën e mësipërme, që t'u shkonte mbarë peshkimi. Ndodhte shpesh që peshku që zihej atë natë tu shpërndahej bashkëqytetarëve falas.

479

ÇONI VELAT TË BAJM' BISHT

— Çoni velat të bajm' bisht.
se shirok tash do me u çue.
na duhet njiher' trimnisht,
Otrantin na me e kalue.
Kapidan, mos na u mërzit
n'bark' gjithçka isht rregullue.
qysh se ishim në Gjirit,
bashin fort e kem' shtërngue[1].

Ulqin, 1977

1) Në kanalin e Otrantos detarët shpeshherë rrezikoheshin nga dallgë të fqishme që çoheshin kur frynte shiroku. Kënga bën fjalë për shqetësimet e kapitenit të barkës.

480

MOR HARAP MORE KULINË

— Mor harap, more kulinë,
barkën a na e ke ceku?
Do të nisna për Ulqin,
shpejt barkën me e rregullu!
Gërset hamari rraparrap.
— Ngutu shpejt, more harap.
— Peqe, peqe, kapidan,
i thot' Saiti[1] zotnis' ti,
mos u bon-o ti pishman,
se krejt barka mir' isht fshi.

Ulqin, 1977

1) Njëri prej punëtorëve që kujdesej për mirëmbajtjen e barkës.

481

PO VIJN' BARKAT RENDA-RENDA

Po vijn' barkat renda-renda.
dilni shifni çka kan' mrena.
Po vijn' barkët tuj fishkllu.
dilni shifni çka kan' pru.

Ulqin, 1977

482

KUR TË LEJN' DIELLI N'GJERANA

Kur të lejn' dielli n'Gjerana,
çou, moj bij', se na vjen baba;
kur t'bijn' dielli mbi lima,
do t'na vijn' gjemxhijt' me gja.
Po na vijn' barkat me vela,
bijn' oriz edhe sheqera,
bijn' florinj e buhasina,
mbushin dugaj' e magazina.
Çou, moj bi, vajza e nanës,
ka ardh' baba n'Punt' t'Gjeranës[1].

Ulqin 1977

1) Punti i Gjeranës, vendi ku qëndronin zakonisht barkat e ulqinakëve.
Kënga shpreh atmosferën e gëzuar që krijohet nga ardhja e barkave apo anijeve prej udhëtimeve të gjata.

483

MERR KONOPIN SHKO PËR DRUE

Merr konopin, shko për drue,
bashk' me fmi, ti moj grue,
un' marr kalin e dal qarshi,[1]
me ble buk' për qeto fmi.
Kur të kthehi ju prej mali,
ke mullini kqyr e ndali,
se un' drithin pa pru n'shpi,
po e baj miell n'qat mulli.
Pra, n'mulli n'mos me gjetsh,
zjarmin n'furr' ti ta kesh.
se un' millin e marr n'qarshi,
brum' në magje, buk' në shpi,
unshëm kush ktu mos me metë,
se t'zot e punës jemi vetë.

Kryezi-Pukë, 1970

1) Në pazar.

484

Ç'PO NA VOJN' KUAJT' ME DRU

Ç'po na vojn' kuajt' me dru,
jabubu, moj, jabubu.[1]
Dil, moj nuse, me i shkarku,
drekën burrit me ja shtru,
buk' e petë për me gjatu!

Dollogozhdë-Strugë, 1974

1) Përsëritet pas çdo vargu. Ububu.

485

NGA I BËRE MALATË

— Nga i bëre malatë?[1]
— Poshtë nga fundjaratë[2].
Posht' atje, nga vgjetë tanë.
popo mala se sa janë.
Motrëmë, moj motrëmë,
sellë telë[3] nga pasve[4].
të të benj mala me datë,
të të bënj, të ta ngarkonj.
ndë shtëpi të ta shkarkonj.
— Bëri drutë, vre djal-o.
bëri drutë dhaka-dhaka[5].
pse ma njeh mëma me tata.
E, po t'i njohënë, djal-o,
shumë më qërtonjë,
edhe për dru më s'më trëgonjë[6].

Arbëreshët e Greqisë, 1978

1) Degët (majat, majishtet).
2) Nga drurët e bëshëm (Fudjar-gr.: i bëshëm, i fryrë).
3) Litar.
4) Sille litarin me vete (pres).
5) Dhëmbë-dhëmbë.
6) Nuk më dërgojnë.

*) Në ishujt arbëreshe të Atikës (Greqi) këndohen shumë këngë për pyllin (për nxjerrjen e recinës, përgatitjen e druve etj.). Ato u bëjnë jehonë idileve që ndodhnin në këto mjedise, ku shkonin për të bërë dru jo vetëm djemtë, por edhe vajzat. Atje, ashtu si edhe në punë të tjera (në lëmë, në ara, vreshta etj.) djemtë u ndhmonin vajzave. Në të tilla mjedise pune, lindnin shpeshherë ndërmjet të rinjve ndjenjat e para të dashurisë, që përfundonin edhe në martesën e tyre.

486

PRESIM SHKARPA E PRESIM DRU-O

Presmi[1] shkarpa e presmi dru-o.
për kaloqe[2] bëjmi hu-o,
shkelmi llaka,[3] shkelmi brinja-o.
po na dërsijen kurrizi e linja-o[4]
Ka Shëjtezit[5] prehemi nj'çik-o.
ulet tek një gur mik ini-o,
di vjershe malli atje shllojmi-o.[6]
e gjellë[7] e zemër na gëzojmi-o.

Arbëreshët e Italisë
Ejaninë — Kozencë. 1981

1) Presim.
2) Shkop.
3) Lugina.
4) Të linjtat.
5) Toponim në fshatin Ejaninë.
6) Lëshojmë, themi.
7) Jetë.

487

NDË MALT VENË PËR DRU VENË PËR DRU

— Ku vete, moj, ku vete jot bilë?
— Shkuan shokazit e e muartin.
— E ku vénë, moj, ku vénë ato kopile?
— Muartin topar, muartin tel[1],
ndë malt vénë për dru.
Lart Krivit[2], pa gjegje si kndoven[3],
si kumbulla ato lulëzojen,
zëmrën e tire me haré mbjojen.

Kalabri — Itali
Ejaninë — Kozencë, 1981

1) Morën sëpata dhe litar.
2) Toponim në afërsi të Ejaninës.
3) Këndonin.

488

LLOÇIN E ÇEREPIT MOR JEMI TUJ SHKELË

I kemi vu shamijat me topa[1],
jemi kon', mori, me çel' gropa,
i kemi vu shamijat me pika,
jemi kon', mori, te Kreveçica[2].
Lloçin e çerepit, mor jemi tuj shkelë,
botën kur e morëm, shumë e kemi zgjedhë.
O çerepi i ri, bota e tokës tonë,
dora e devojkës, po t'limon për anë.
Shamijat me theka larg po na vetojnë,
çerepet e rinj ne po i venojmë.
Sallanxhak sixhimi, ktu e te mejtepi,
mule, vlla e motër, se m'â kput gërsheti,
sallanxhak sixhimi ktu e te Dubrava[3],
me jeremin', tonë u hjeshue Pllava.
Ori nanë, nana jeme,
m'le me shoqet, t'bajmë ryfene,
to ta vej çerepin, to ta vej në zjarrm.
botën xhi ta pjeki, zemrën to ta knaq.[4]

Pllavë — Prizren, 1979

1) Shami koke të zbukuruara me lule në formë rrethi.
2,3) Fusha afër fshatit Pllavë në krahinën e Opojës
4) Këndohet gjatë përgatitjes së enëve prej balte. Kjo mjeshtëri në Opojë duhet të ketë tradita të hershme, mbasi zhvillohet me një tog praktikash zakonore, këngësh e ceremonish interesante.

489

PËR ÇEREP NA LLOÇIN SOT JEMI TOJ SHKELË

Për çerep na lloçin sot jemi toj shkelë,
botën, kur e morëm, shum' e kemi zgjedhë.
O çerep i ri me bot' t'tokës sonë,
dora e devojkës po t'limon për onë[1]
To ta vej çerepin, to ta vej no[2] zjarm,
bukën xhi ta pjek, zemrën to ma knaç.
Shamija me theke lark po na veton,
çerepot e ri na po i venojmë.
Kur to na vijn' vllaznit, vllaznit pi gjyrbetit
no çerep to[3] rij bukën to jau pjekim.

Opojë, Prizren, 1979

1) Anë, a — e theksuar shqiptohen si **o** — karakteristikë e të folmes së vendit.

2-3) Kështu ndodh ndonjëherë edhe me **ë**-t; **no-në, çerepot-çerepët;** edhe më poshtë: **të rinj.**

490

RECINJAR MARKOPULJOT

— Recinjar[1] markopuljot.[2]
sa recinë nxore sot?
— Tre oka edhe njëqint.
t'i bënj nusesë fljorinj.
— Recinjar, sqeparin tënt
do t'e hjus[3] t'e bënj argjent.
Lje sqeparin mbëljith drutë.
pse erth hera e do hash bukë.
Lje sqeparin lule krinë[4]
e skolas[5] e bën fainë[6].
Mbëljo[7] spitharinë[8] botë.[9]

---

1) Ai që mbledh rëshirë.
2) Prej Markopuli.
3) Do ta derdh.
4) Zymbyl.
5) Bëj pushim, pusho.
6) Gjellën.
7) Mbush.
8) Enë e madhe prej druri; but.
9) Baltë.

të jesh i parë ndë shokë.
Mbëljo spitharin thimarë[10],
të jesh i parë ndë recinjarë.

Arbëreshët e Greqisë
Eleusinë, 1981

10) Bimë aromatike.
Krs. Jona Miks Qedhusi, «Ta Vilia tou Kithairona kai to arvanitika traghoudhia tous», Athinë, 1980, f. 84.

491

RECINJARI VGJE MË VGJE

Recinjari[1] vgje më vgje,
hje më hje,[2]
s'e ze dielli poté.[3]
Lepsinjot[4] nga Lepsina,
thuama sa ka recina,
sivje' çë e mblodhi krina?
— Di dhrahme do ka recina.[5]
— Recinjari koropiot,[6]
sa recinë mblodhe sot?
Mblodha një karo edhe di.
po sa do gjegjesh mbrena ti.
Recinjari me recinë,
harova djalinë t'e porsinjë[7]
t'e porsinjë fshehura,
të më sill garufalla.[8]
Andë[9] parë, prapa malitë.

1) Recinjari: rrëshirëmbledhësi.
2) Hije më hije.
3) Pote (gr.): kurrë.
4) Banor nga fshati Lepunë.
5) Dy dhrahmi (monedhë greke) do të ketë recina.
6) Nga fshati Koropi.
7) Ta porosit.
8) Garufalla (gr.): karafile.
9) Atje.

llambaris[10] sqepar' i djalitë,
llambarisën vgjet' e malit.
Llambarisën djali i pari,
llambarisën edhe jalisën,[11]
vgjet' e malit paleqisën,
Recinjari ama këndon,
tërë vashëzëtë marrëson.[12]
Atje çë ka vgjetë djali
ia sjell dhrosinë[13] mali;
atje çë ke vgjetë ti,
të sjell deti dhrosi...[14]
O ta blonj[14] spitharë[15] botë,[16]
të vesh i parë ndë shokë;
o ta blonj spitharë krina.[17]
të të shtonetë recina.
Ah, ai mali i Makripllait
çë ishte luja e sevdait.[18]

Arbëreshët e Greqisë
Peranhorë — Korinth. 1978

10) Llamburit, shkëlqen.
11) Jalisën (gr.): shkëlqen.
12) I marros, i prish nga mentë.
13) Dhrosinë (gr:): freskné.
14) Ta mbush.
15) Qypin.
16) Me tokë.
17) Me zambakë.
18) E dashurisë.

Vjelja e rrëshirës nga pishat ka qenë një mjeshtëri e zakonshme. Kjo mjeshtëri kishte romantikën, e saj. Fshatrat e Atikës ishin të shpërndara në krahina të pyllëzuara me pisha, sipas shënimeve të autores krahina të tilla ishin: Poliokudura, Kriekuqi, Madra, Vila. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Perahorën e Korinthit e gjetkë.

492

RECINJARËT ERNË PRAPË

Recinjarët[1] ernë[2] prapë,
jan' çë sallën[3] atë vapë.
Ernë recinjarëtë,
krisin kukunarëtë.
Ga shin Gjergji edhe parë,[4]
sheh katundi recinjarë.
Ga shi Mitri edhe parë,
bar[5] katundi recinjarë.

Arbëreshët e Greqisë
Eleusinë, 1980

1) Ata që nxjerrin dhe shesin rrëshirë (recinë) pishe.
2) Erdhën.
3) Sollën.
4) Nga shën Gjergji edhe tutje.
5) Humb.

493

QË ZILEPSE VILESË

— Çë zilepse Vilesë?[1]
— Lugën e recinesë.
Ku të vesh, s'të le recina,
edhe ajo tremendina,
Sa vilot' aq recinjarë,
milra vgjenjë kanë ngarë.

Arbëreshët e Greqisë
Eleusinë, 1980

1) Vila (fshat malor arbëresh në rrethet e Athinës) që merret me nxjerren e rrëshirës (recinës).

494 -

SA TË SHQER' ÇARIHJE KENI

Sa të shqer' carihja keni,[1]
na vjen dimër e t'i dreni;[2]
sillni për t'u drenj çë doni,
na vjen dimër, s'do më çoni[3].
Re, u erdha njor[4] dë derë
për këpucatë të shqerë.
Çë këpucë, çë kaliqe,
çë pandofla dhe carihje.
Sillni t'u drenjë mirë,
ga monedha shumë lirë.

Arbëreshët e Greqisë
Eleusinë, 1980

1) Sa këpucë të grisura keni.
2) Ndreqni.
3) Gjeni.
4) Deri, gjer.

KAPITULLI I PESTË

KËNGË
PËR PUNËT SHTËPIJAKE ETJ.

495

NGREU MOJ NUSE NA NDIZ ZJARRË

Ki-ki-ki, këndezi i parë,
ngreu, moj nuse, na niz zjarrë!
Ki-ki-ki, këndezi i dytë,
ngreu, moj nuse, na laj sytë!
Ki-ki-ki, këndezi i tretë,
ngreu, moj nuse, na bëj drekë!
Ki-ki-ki, këndezi i katërt,
ngreu, moj nuse, na bëj darkët!

Selenicë — Kolonjë, 1954

Krs. AIKP — R. Durolli. Berat. 1968 (Fl. 15, f. 16);
A. Mustaqi. Pllavë — Opojë, 1979 (Bob. 1357/17);
D. Nikollari. Bënjë-Përmet, 1981 (Fl. 1, f. 4).

496

KALLU ZJARM HE MOS U KALLSH

Kallu zjarm, he, mos u kallsh!
Treqin dhen, treqin dhi,
treqin lopë me taxhi.
Kallu, zjarm, he, mos u kallsh!
Vloje tomlin në kusi,
kos e tlyn t'xjerrsh pej ti,
Gjath' e gjizë, plot bylmet,
t'mush fllanikin me lezet,
të ken' miqtë shka me ngranë,
edhe zoti naj run gjanë.

Shkup, 1969

497

NDIZU ZJARR E BËNU FLAKË

Ndizu, zjarr, e bënu flakë,
se kemi zonja për darkë,
duan pritur e përcjellë,
duan buk' e duan gjellë.
Na kan' ardhur në shtëpi,
duan mish e revani.

Çorovodë — Skrapar, 1966
Bob. 501/6

Krs. Gj A, II, 1972, f. 168.
AIKP — R. Alikaj, Kuç-Vlorë, 1929 (Fl. 4, f. 200); R. Sokoli, Berat, 1964 (Fl. 3, f. 23); A. Mustaqi, Nojë-Krujë, 1967 (Bob. 1036/6); Fterrë-Sarandë, 1972 (Bob. 851/7); Korishtë — Prizren, 1974 (Bob. 1106/4); D. Përshqefa, Bisakë — Mirditë, 1977 (Fl. 1, f. 40); P. Gjika, Rubik-Mirditë, 1980 (Fl. 1, f. 24).
(Transkriptimi muzikor nr. 25.)

498

KALLU ZJERM — E KAPULLUR-E

Kallu zjerm-e kapullur-e,
ta çet dada ni laknur-e,
ni laknur-e sa ma shpejt-e,
se po pritin nizet vet-e,
nizet vet-e jan' untue,
n'ara ditën tuj punue!
Kallu zjerm-e kapullur-e,
ta çet dada ni laknur-e,
ky laknuri pet' për pet-e,
jan' tuj pritun nizet vet-e.
Jan' tuj pritun nizet vet-e,
don me shkue n'pun' ma shpejt-e.
N'pun' ma shpejt-e don me shkue.
nëpër ara me punue,
me punue, hiç pa u nal-e,
për me korr' grun të bardh-e.

Sherret — Ferizaj. 1962

Krs. KPL$_2$, f. 193.

499

KALLU ZJARM U KALLSH I BARDHË

Kallu, zjarm, u kallsh i bardhë,
sod ni javë me ni xhalë!
Kallu, zjarm, u kallsh me kimet,
shpija jon' past' bereçet!
Kallu, zjarm, bubullur,
ta çet dada ni laknur!
Ai laknuri petë-petë,
s'un c han' as tridhet'vetë.

Cërnicë — Gjilan, 1982

500

NDIZU ZJARR BUBULAN

Ndizu, zjarr,
bubulan,
se erriu dadë Dija
me një barrë gjeshtra,
se arriu bubuzhina,
me një barrë trëndelina!
Ndizu, zjarr e bënu flakë,
se kemi ca miq për darkë,
do t'u therëm pulën plakë.

Ramicë — Vlorë, 1943

501

NDEZU ZJARR E MOS U SHUAJ

Ndezu zjarr e mos u shuaj,
se errinë tre të huaj
me bixhak e me uruar;
se erriu dadë Dija
me një barrë karëthija,
se erriu dadë Suta
me një barrë dru të buta.

Çorraj — Sarandë, 1944

502

ÇIKË-ÇIKË NË DËRRASË

Çikë-çikë në dërrasë,
mos më diq, se të kam vashë;
çikë-çikë në thëngjill,
mos më diq, se të kam bir!
Sa çika në çati,
aqë dhën e aqë dhi,
aqë pela në shtëpi![1]

Zhulat — Gjirokastër, 1955

1) Thuhej nga fëmijët ditën e Vitit të Ri, kur shkonin nëpër familje për të bërë «këmbë» për mbarësi. Njerëzit e shtëpisë në këtë kohë shkrepnin urat e zjarrit që të ngriheshin çikat, shkëndijat.

503

TIM-TIM GOGOTIM

Tim-tim, gogotim,
as andej, as këtej,
nga oxhaku e dil përtej,
Shko përpjetë, si shigjetë.
të të bëj lakror me petë.
Vate Afrua në bletë,
hëngri fiq, u fëlliq,
u var kokëposhtë e vdiq.[1]

Sasaj — Sarandë, 1945

1) E thoshin të vegjëlit për të larguar tymin.

504

TIMI-TIMI TERA

Timi-timi, timi tera,
ikë te hallë Katera,
të të bëj' përshesh me kos,
të të therë një gallosh![1]

Shëvasi — Sarandë. 1945

1) Variante të tjera për largimin e tymit.

505

BLUJ MULLI HEJ QOFSH I BARDHË

Bluj mulli,
bluj mulli, he qofsh i bardhë,
bluj mulli,
bluj mulli, he qofsh i bardhë!
Gruni i ri,
gruni i ri sot të ka ardhë,
gruni i ri,
gruni i ri sot të ka ardhë.
Në qoft' se guri,
në qoft' se guri nuk ta bluen,
n'qoft' se guri,
në qoft' se guri nuk ta bluen,
bahem gur,
bahem gur e t'rri mbi fletë,
bahem gur,
bahem gur e t'rri mbi fletë.
Ti m'jep ujë,
ti m'jep ujë, un' sillem vetë,
ti m'jep ujë,
ti m'jep ujë, un' sillem vetë[1].

Ishull — Lezhë, 1973
Bob. 965/15

1) Përsëritet i njëjti tekst edhe për misrin.
Krs. Rev. «Nëntori», 1955, f. 124.
AIKP — N. Pano, Barbullush-Shkodër, 1981, (Fl. 1, f. 46).
(Transkriptimi muzikor nr. 26)

506

BLUJ MULLI HEJ KJOFSHI I BARDHË

Bluj. mulli. hej kjofsh i bardhë.
bluj. mulli[1],
larg duket nji kal' i bardhë.
ishalla, po na vijn' barrë,
Po na vjen barra me u blue.
pogaç' gruni me gatue;
po na vjen barrtor i ri,
na sjell grunin si flori,
thuja kangës, mullixhi.

Fishtë — Lezhë, 1981

1) Përsëritet pas çdo vargu.

507

BLUEJ-BLUEJ MOKËN-O

Bluej-bluej, mokën-o,
bluej but' e mos u ngut,
nalu pak e qiti prapë,
merre shoshën, miell shosh,
mos t'kalojë koha bosh,
n'brum me e shti e n'furr' me e qitë,
të dal' buka për mjesditë!

Ljare — Shestan, 1972

508

BLUAJ E BLUAJ O MOKËR-O

Bluaj e bluaj, o mokër-o,
misrin nga një kokërr-o,
të gatuajmë lakrat-o,
të rrisim fëmijët-o,
Ndaje mirë misrin-o,
se s'kemi tjetër-o,
një qase e para shpi,
mban të rritur e fëmi.
Bluaj e bluaj, o mokër-o,
misrin nga një kokërr-o,

Mbrostar — Fier, 1978
Bob. 1344/6

509

AMAN MULLIXHI

Dielli kaptoi, nata seç u nxi,
aman, millona, aman, mullixhi,[1]
bluajm' bereqetin, të shkoj në shtëpi,
bluaje të butë si për bakllava,
bluaje të butë si për trahana.

Borsh — Sarandë, 1981

1) Vargjet 3-4 përsëriten pas çdo dy vargjesh.

510

SOD NË MAGJE O BUKA E RE

Sod në magje, o buka e re,
ardhsh e bardh' n'shpi me ne.
m'knaqe robt' e m'knaqe mue,
me uj' t'nxet' jam tuj t'përvlue,
jam tuj t'pjek' sod në furrë,
t'paça n'sofër bashk' me burrë;
jam tuj t'pjek' moj ty n'hi,
t'paça n'sofër bashk' me fmi.
Tash po t'pjeki besa n'ezull,
se kërkan nuk due pezull,
veç me pezull, s'ka gja n'hi,
drithi vjetër nuk zen t'ri[1].

Fush-Arrëz-Pukë. 1981

1) Në pjekjen e bukës së parë (me miellin e ri) kishte praktika të ndryshme rituale. E zonja e shtëpisë, që kur zinte brumin në magje uronte: E hangshim me shëndet e me zemër të mirë! Mot më shumë! Mos na mungoftë asnjëherë! U shtoftë e u bleroftë si bari, si uji! Buka e parë duhet të piqej në prush anës së vatrës. Urime bëheshin sidomos në sofër nga i zoti i shtëpisë. Kafshata e parë duhej të shoqërohej me qumësht a me nënprodhimet e tij (kos, dhallë, djathë) dhe në fund me një gjë të ëmbël.

Pas Çlirimit kanë ardhur duke u zgjeruar praktika të tilla: Organizohen festa me kooperativistët. Bëhen urime për realizimin e tejkalimin e planeve, për prodhime të bollshme, për jetë të gëzuar e të lumtur, për mbarëvajtjen e kooperativës apo të NBSH. Lëmi i parë pas shirjes çohet në depo me këngë e valle, me karro të stolisura, kooperativistët vishen si për festë etj.

511

HADE BRUM' O ARDHSH I BARDHË

Hajde, brum', o ardhsh i bardhë,
hajde, brum, sod për pite,
t'ka gjesh' nana si simite,
pita t'mira sot me qitë
e ti doren me ma ndritë.
Shtriju petë tuj hollue,
maza gati, asht tuj vlue,
t'kuqun jan' saxh' e çerepë,
lumi nana, mir' po pjek,
e shtrojm' sofrën sa ta hjek.

Pukë, 1980

512

BRUMI-BRUMI BEREQETSHUMI

Brumi-brumi bereqetshumi,
mblidhu, o i bardh', po vjen katuni,
vjen katuni në argati,[1]
për me mih' arat nan' shpi.
Dy kuleq pa i pjek n'hi,
me i ndreq' heret çeto fmi,
dy të ker'[2] po i la me i tha,
a thu s'flasin çeto gra.
Bukt' me t'mira në argati,
thon' ka zojë[3] çe kjo shpi.

Trun — Pukë, 1970

1) Të punojnë argat.
2) Dy të tjerë.
3 Ka nikoqire.

513

NGREU BIJË QËMENATË

Ngreu, bijë, qëmenatë,
mblidh drëpinjtë për ergatë.
që nesër nga qindia,
më vinë shoqet e mia!
Ryj në magje, bëj lakruar,
se s'jam për të turpëruar!
Në mulli e blova,
në kungull e hodha,
shoqet i nderova,
nuk u turpërova.

Këllëz — Gjirokastër, 1976

514

SITE PITE NI KRILANË

Site, pite, ni krilanë,
jua qes grave, nuk e hanë
jau qes grave, nuk e hanë
jau qes thmive, e përlajnë.

Selac — Shalë, 1972

Krs. LPK, f. 18.

515

BAN KUSIJA VU-VU-VU

Ban kusija vu-vu-vu,
lumja unë, tamli m'u vlu,
m'u vlu tamli, mola gjanë,
u pjek pitja, e çova n'lamë,
n'lamë e çova, te argashtija,[1]
u hangër pitja, u kthy tepsija.

Vojnik — Drenicë. 1972

1) Tek argatët.

516

VLOI KUSIJA I RA FUNI

Vloi kusija i ra funi,
maxhetore, diça uni.
Fshije bërllogun, le mas dere,
ta qet, vjehrra pej pranvere,
n'dash' me sêj,[1] n'dash me kerre!

Bajçinë — Podujevë, 1982

1) Me sajë.

517

ORE-ORE MAGJATORE

Ore-ore, magjatore,
buk' e mrume, bukatore.
Site holl', o mori sit-e.
bukn' e re të bardhë qite.
Grun' i bardh', si tamël shtrungue.
buk' e amël, si mjalt' rrunxe.
Qite holl', o mori sit-e.
bukn' e re bane kadife.

B. Curr — Tropojë. 1983
Bob. 1533/6

518

O HOLLOJU BUK' HOLLOJU

O holloju, buk', holloju,
buk' e re, moj buk' e re[1]!
O gatoju, buk', gatoju,
piqu, buk', moj, piqu mirë!
Sa e ambël buka jonë!
Kjo asht buka e tokës sonë.

Barbullush — Shkodër, 1980
Bob. 1427/13

1) Përsëritet pas çdo vargu.

519

MOJ E MIRA BARDH' SI PLLUMI

— Moj e mira. bardh' si pllumi.
a m'kallzon qysh bluhet gruni?
— Gruni bluhet ni kështuni.
— Moj e mira, bardh' si pllumi.
a m'kallzon qysh mbruhet brumi?
— Brumi mbruhet ni kështuni.
— Moj e mira bardh' si pllumi.
a m'kallzon si haet gruni?
— Gruni haet ni kështuni.

Krumë — Kukës. 1970
Bob. 770/14

Krs. LPK. f. 17
AIKP — Q. Haxhihasani. Pukë. 1956 (Vëll. 17. f. 53); R. Bogdani. Blinisht-Mirditë. 1970 (Bob. 722/9).

520

UDHA MAR' KULAÇ I BUKËS

Udha mar' kulaç i bukës.[1]
shko në mrize drejt udhës.
fal' me shnet çobanve t'mirë,
që rriten me berre t'lirë!
Pash ty buk' që t'gatova,
t'qita me zemër, nuk pritova,
luti zanat atje n'mal,
të shtohen berret kadal-kadalë,
plot me kinxha lesh e tamël!
Udha mar', kulaç i bukës!

*
* *

Po na vjen kulaçi-o,[2]
eni, zana, të hami-o,
të gjith' si vlla me vlla,
të lumët na për kit' sevda!
Kemi berre, kemi fyll,
kemi nana, kemi pyll,
do ta hamë, do ta hamë,
gjyshit tonë shum' selam.

1) Këto këngë këndohen në festat e barinjve.
2) Këndojnë të gjithë barinjtë.

*
* *

Po këndojm' në valle-o,[1]
Pran' kulaçit tamël-o.
eni, zogj, e na ndihmoni,
eni, flutra, me ne gzoni!
Kemi qitun kulaç-kulaç,
oj baçicë, të mirë paç!
O t'u shtoft-o vathi ty.
edhe t'mirat ty në gji!...

Drenicë, 1977

1) Këndon prijësi i valles.

521

PIQE PESHKUN NË FURTERE

Gere, gere, pipigere,
piqe peshkun në furtere,
piqe mir' e mos e digj,
se na vin' mraman dy miq!

Trijesh, 1982

522

FSHIJ-FSHIS' FSHIFSH PËR T'MIRË

Fshij-fshis', fshifsh për t'mirë.
ma fshij odën për musafirë.
për musafir', kam' të mar-e,
oda e jon' me faqe t'bardh-e;
me faqe t'bardh', me der' çelë.
burrat ton', zemrën mal.
Mali me bor', mali n'pranverë.
si Lipiteni[1] me bor' përherë,
si Lipiteni plot me lula,
oda e jon' plot me burra;
plot me burra, plot me trima.
oda e jon' ma e mira.

Dubravë — Kaçanik, 1972

1) Luboteni, një nga majat më të larta të vargmalit të **Sharrit** (Kosovë, 2496 m); lidhet nga krahu lindor me Grykën e **Kaçanikut**. Krs. Rev. «Nëntori», 1955, nr. 1, f. 127.

523

TIR — SHTIR

Tir — shtir[1].
bosht i vogël-o nuk po mbushet,
dal n'oborr drita s'po duket,
por po duken disa saraje.
N'at' saraj ishte nji plep-e,
n'atë plep ishte nji lejlek-e,
aj lejlek po bate çerdhe,
bate çerdhen-o të mëndasht-e,
të mëndasht-o fije — fije,
beqarit-o po i ban hije,
po i ban hije me lezet-e,
me i shku moti-o me shyhret-e.
At' e past' nanlokja vet-e!

Shkodër. 1982
Bob. 214/47

1) Përsëritet pas çdo vargu.
Krs. KP, f. 90; Rev. «Nëntori», 1955, nr. 1, f. 129; BMK, f. 219. (Transkriptimi muzikor nr. 27)

524

TIR NANA TIR

Tir, nana, tir, bosht'i vogël,
bosht'i vogël nuk po mushet,[1]
dal në der', drita s'po duket,
po na duken do kanaçe,
do kanaçe e pa shkallë,
preva arën, vuna shkallën,
gjeta i nuse nën duvak-e,
i dhash' uj- o me bardak-e·
mu bardaku m'ngrini n'dorë,
gjimsa akull, gjimsa borë.

Gjonëm — Krujë, 1978
Bob. 1352/8

1) Vargjet 1-2 përsëriten pas çdo vargu.
Krs. AIKP — Xh. Meçi, Kabash-Pukë, 1979 (fl. 3, f. 13).
(Transkriptimi muzikor nr. 28)

525

TIR' NAN-O TIR

Tir', nan-o, tir,
tire nji furk' lesh,
çorap t'ri për me veshë!
Tir' nan-o, tir,
tire nji furk' lesh,
fenell' t're për me veshë!
Tir', nan-o, tir,
tire nji furk' lesh,
kopole t're për me veshë!
Tir', nan-o, tir,
furkat-o plot me lesh,
kanac t'ri për me veshë,
për me vesh', për me i shky.
arkat pjot i kem në dry.

Micoj — Pukë, 1975

526

TIRE SHTIRE LIRIN-O

Tire, shtire lirin-o,
furkëz-o, drugëz-o,
drugëz-o, furkëz-o,[1]
se siç tjerri lirin-o,
tjerrim, shtjerrim hallet-o,
hallet, dertet e dynjasë,
të dynjas', të fukarasë.

Mbrostar — Fier, 1933
Bob. 1527/3

1) Vargjet 1-2 përsëriten pas çdo vargu.

527

BUKUR TJERRIM LININ-O

Ejani, shoqe, në këtë valle,
të fillojm' një pun' të re,
hej-hej sa gëzim![1]
Lshoni za fllanxës ndër male,
po ja endim kmishën-o,
Puno vashë, t'lumtë dora,
mbi manganë, ti mos pusho!
Ju lumt' dora, mori shoqe,
bukur tjerrni linin-o!
Xhamadan me shtat' gajtana,
po qendis për trimin-o!
Djal' e vajz' presin me mall,
për një kmish' të bukur-o.

Kallmet — Lezhë, 1978

1) Përsëritet pas çdo dy vargjesh.
Krs. AIKP — K. Vasili, Troshan-Lezhë, 1980, fl. 24.

528

MORI E MIRA PO BAN VEK

— Mori e mira, po ban vek,
ban qylyma e ban dyshek.
T'lumshin duert, sa rrept' po qet!
— Njana kam' po m'hjek' zahmet.
njana kam' e njana dorë,
ka po baj pëlhur' të hollë.

Cërcë — Istog. 1972

Krs. Gj A, II, 1972, f. 192.

529

JA KEM' NIS' ME EN' ME MLU

Ja kem' nis' me en',[1] me mlu,
ni qylym dojm'[2] m'i maru-o,
dojna pejt' me nis' m'i mlu.
Ja nis vekit me punu-o,
me grim t'madh gjith' tuj këndu,
ni qylym dojm m'i maru-o.
Marou, qylym, me shpejti,
tana shoqet me t'marr' lakmi-e-o.
Lula e kuqe dranofilli,
